

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

*11 - 2020
Vjeti V i botimit,
Shkodër*

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

11-2020

Vjeti V i botimit,

Shkodër

Redaksia:

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër
dhe Bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Përmbajtja

▪ Editorial ▪

Frano KULLI

Teatri 7

▪ Mendimi i traditës ▪

Lumo SKËNDO

Për shkrime te haruarë dhe të pa-diturë 11

▪ Intervista ▪

Primo SHLLAKU

Ne as nuk shkojmë kundër rrymës e as nuk e lamë me na marrë rryma 17

▪ Arkeologji ▪

Helidon SOKOLI

Lisi. Tipologjia e fortifikimit të tij, në periudhën antike 25

▪ Trashëgimi kulturore, arkitekturë ▪

Ledian BREGASI

Arkitektura vernakulare dhe peizazhi kulturor i zonës së Shkodrës 33

Ledian BREGASI

Ngulimi dhe ndërtimi sipas traditës..... 39

▪ Letërsi ▪

Shkodra si frymëzim poetik në poezinë e Shirokës, Koliqit,

Pipës dhe Camajt..... 44

▪ Kritikë letrare ▪

Andreas DUSHI

Të jesh i humbur, fati i personazhit shqiptar të tranzicionit 58

Arben PRENDI	
“Botët e shmangura” në tregimet e novelat e M. Camajt	63
Alfred ÇAPALIKU	
“Kritika” e Arshi Pipës	74
▪ Teatër ▪	
Gëzim PUKA	
“Kjo nuk është për të qeshur”. Refleksione mbi dramën	
“Tre vetë në një varkë” të S. Çapalikut	77
▪ Muzikologji ▪	
Ridvan KARAKAÇI	
Ndryshimet që pësoi “Ahengu Shkodran” në gjysmën e dytë	
të shek.XX.	81
▪ Skena të jetës universitare ▪	
Grup autorësh. Koha për t’u kthyer universiteteve	
autonominë	86
▪ Personalitete të shqueme të artit e kulturës ▪	
Ridvan KARAKAÇI	
Ramadan Sokoli, krijues i një tradite studimore	94
Willy KAMSINino Saraçi, jeta e një artisti	98
▪ Bibliofili ▪	
O. KAKARRIQI; V. BËRDICA	
Një jetë në tempullin e bibliotekës	98.
▪ Tradita të pushtetit lokal ▪	
Gëzim JUKA	
Kryetarët e pushtetit vendor në Shkodër 1912-2020	118

▪ **Filateli** ▪

Besnik FISHTA

Andrea Skanjeti, hartues i katalogut të parë shqiptar të

pullave 125

▪ **Enciklopedi** ▪

Zenepe DIBRA

Luftëtarë dhe personalitete të hapësirës shkodrane në krah të Skënderbeut. Heroi në veprat e autorëve të hapësirës

shkodrane 133

▪ **Shëndetësi** ▪

Merzuk HOXHA

Vështrim mbi përhapjen e kolerës në Shkodër 160

▪ **Recensione** ▪

Seit MANSAKU

“Skicë historike mbi Malin e Zi sipas traditave gojore shqiptare”

me autor Pashko Vasa 164

Nexhmi BUSHATI

“Tiranopedia”- poemë thuajse e panjohur e poetit desident

Luigj Tonit 169

▪ **In memoriam** ▪

Erzen KOPERAJ

Vepra gjuhësore e prof. D. Lukës arritje dinjitoze në fushën

e studimeve albanologjike dhe gjuhësisë historike 174

Eduard GRISHAJ

Arshi Pipa, ura lidhëse mes kulturës shqiptare dhe asaj

evropiane perëndimore 182

Editorial

Frano KULLI



TEATRI...

“Se njerëzit e shtetit s’janë Shqipnia...”

Tregon At Anton Harapi: “Kam ndodhë vetë aty kur një shqiptar i vjeter, tueu ankue një ditë me At Fishten për shpërdorime të disa nënpunsave të shtetit, gadi si i dishpruem i thotë: -Pater Gjergj, shporru Shqipniet, persé [sepse] Shqipni nuk ka!- Fishta, i prekun prej shfrimit të plakut edhe i zemruem, por jo i trazuem po don t’ia spjegojë bashkëfolësit se njerëzit e shtetit s’janë Shqipnia... E atëherë plaku, për me i diftue se kishte mbetë i bindun i thotë Fishtës: “-Po na s’e kemi ditë mor Zotni, veç prej jush e kemi mësue se shka asht Shqipnia...”¹

Biseda e kaherëshme, që për mua u bë shtysë të shkruaj për të disaten herë për shembjen e teatrit kombëtar, është bërë në vitin 1923. Gati një shekull më parë. Kaq të tëhuajtura[të largëta] ishin bërë marrëdhëniet e njerëzve të shtetit me shtetasit, sa për shumicën e popullatës, lëshohej shfrimi i kobshëm: “Nuk ka mâ Shqipni!” Edhe pse kishte kaluar vetëm

¹ "At Gjergj Fishta 1871-1940", B. Dema 1941, fq. 51

dekada e parë që vendi i tyre, Shqipëria, ishte e lirë pas robërisë së gjatë. Tashma me shtetin e vet, me kuvendin dhe me qeverinë e vet e me zyrtarë shqiptarë. Por ata, zyrtarët, njerëzit e shtetit pra, kaq shpejt ia kishin bërë borxh njerëzve të mbarë popullit sa “me t’u ndye vetja”[këtu: neveritë], shfrenin ata e me të dalë ky gulç zemërimi e neverie për njerëzit e shtetit, tashma jo të huaj e që ti i ke zgjedhë që të të administrojnë vetjen tënde, lirinë dhe pasurinë, mallin e gjënë dhe sigurinë e jetës. E mandej, në dëshpërim të thellë, njerëzia mbarë i drejtonin sytë tek ata të paktët shqiptarë të njëmendtë; tek ata që e kishin provue para ndërgjegjes së kombit se punojnë për vendin, për Shqipërinë, për shqiptarët. Me punën e me veprën e tyre të njëmendtë. Këtë na e thotë historia, e shkuara jonë...

Po a nuk po ndodh kështu e gjithë ditën edhe sot?! Gati një shekull më vonë? !

Rruga jonë e shtetformimit demokratik vërtitet në formë spiraleje dhe ngjitet thuajse në hiç. Në krejt hapësirën demokratike që ne dëshirojmë ngjitja është asmatike. Asaj po i merret fryma prej të përpjetave të forta, të stisura. Edhe te kultura, gjithashtu. Tashti, kryeministri ia arriti ta shembë godinën e teatrit kombëtar të Shqipërisë se nuk i pëlqen e nuk intereson e diçka tjetër preferon të bëjë në vend të teatrit. Prishjen po kërkon ta rregullojë me ligj, që kështu ta taposë e ta bëjë të paprekshëm aktin e tij të rilindjes kulturore të Shqipërisë europiane, të ngritur “mbi gërmadhat e botës së vjetër”. Asnjë shenjë, asnjë dëshmi s’do të mbetet më. Tashti që ajo ngrehinë u shemb dhe diku aty afër vendndodhjes së saj të sotme do të jetë ngritur një ngrehinë tjetër e betontë a e xhamtë, diçka si kubiste, që mbas monstrimit të parë publik që i është bërë atij projekti, me diçiturën poshtë: *Teatri, fyen rëndë shijen më të zakonshme qytetare*. E do të rrethohet me kulla të larta, e kështu do të groposet thellë e më thellëkujtesa për godinën e bashkë me të gjithë historinë që ajo mbart...

Në Tiranë vërtet pak më vonë, por në Shqipëri edhe teatri ka historinë e vet të hershme. Zanafilla është në Shkodër, në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Njëri prej emblemave të këtij zhanri të arteve në Shqipëri, aktori dhe regjisori Lec Shllaku, në librin e vet “Maskat shkodrane” Shkodër 2002, sjell si fillesë të teatrit të mirëfilltë të komedisë vitin 1860 (?), *kurse salla e parë laike në të cilën u mbart trupa e parë e komedianëve t’Oborrit të Fishtorëve-shkruan ai- që mbas kazermës...që kishin ndërtue turqit ndonjë vjetë ma parë*.

*Garnizoni turk e hoqi prej andej depon e ndërtesa mbeti e mbyllun e po fillonte të damtohej.Me kërkesen e grupeve teatrore, një tregtar nxorri leje prej komandës së garnizonit që ta riparonte e ta përshtaste për shfaqje... (Është viti 1891!)*²

Kurse, shumë pak vite më vonë, në fillimin e shekullit të shkuar, vetëm në Shkodër kishte jo më pak se shtatë salla shfaqjesh teatrore. Pranë shkollave si “Liceu Ilyricum” i françeskanëve kur ishte futur, me shumë mund e përpjekje gjuha shqipe si gjuhë mësimi, nga drejtori i saj At’ Gjergj Fishta me 1902, njëherësh u ngritën edhe sallonet e para të shfaqjeve. Pra, Teatri.

*Salloni i jezuitëve me 450 vende(ishte ngritë që me 1890), i françeskanëve me 300 vende, i motrave stigmatine (1914) me 250 dhe që nga viti 1919 edhe një teatër veror me 600 vende në oborrin e shkollës françeskane. Pas dhjetëvjetëshit të parë të shek.XX vijnë sallonet e shoqërive kulturore të qytetit: Bogdani (me 350 vende), Rozafat (me 400 vende), Vllaznia (me 400 vende), Shkolla e Parrucës (me 400 vende). Në vitet ’30 në Shkodër bëheshin shtatë teatro (ndonjë edhe kinoteatër), me gjithsej 2500 vende.*³

Në këto salla janë luajtur asokohe pjesë dramatike, krijime të autorëve shqiptarë (krijime sipas Molierit e Shekspirit), po kryesisht pjesë origjinale nga po autorë shqiptarë, Fishta, Anton Xanoni, Hilë Mosi, Kolë Mirdita (Helenau), Zef Mark Harapi etj. E interpretë të këtyre pjesëve në sallat teatrore të Shkodrës janë: Loro Kovaçi, Pjetër Gjoka, Marije Logoreci, Gjon Karma e të tjerë që më pas janë bashkëthemelues të Teatrit Kombëtar në Tiranë,që tashma u shemb...

E ndërkohë që godina e teatrit u shemb janë ringritur si dëshmi të historisë sonë nën regjimin komunist, “Shtëpia e gjetheve”, domethënë shtëpia e zezë e spiunëve, bunkeri: “bunkart” e ngrehina të tjera mund të priten... E ç’përfaqësojnë gjithë këto në historinë tonë? Njëren prej pjesëve më makabre të historisë sonë, që s’mund ta zhbëjmë e s’kemi pse ta fshehim.

Po atëherë, pse gjithë kjo neveri e histeri për ta shembë siç u shemb godinën e teatrit,që mirë apo keq është *shtëpia e parë*, është zanafilla e Teatrit Kombëtar, e cila, për një vend normal është histori qytetërimi dhe kulture.

E njerëzia, të habitur e të mpirë gjymtyrëve të mendjes i kanë ngulitë

² Lec Shllaku"Maska shkodrane", fq.59

³ T. Çobani, Koha Jonë, 10.03.2018

shikimet e tyre në rrugën e ikjes,të shportjes prej këtu. Se...ky vend nuk bëhet! (Se Shqipni nuk ka!).Madje duket se këtë ia kërkojnë edhe Mirush Kabashit e Robert Ndrenikës, të cilët janë kaq të pezmatuar e me telat e shpirtit të prekur deri në skaj të revoltës. E do pak të tjerëve si ata që kanë mbetë këtu në Shqipëri. Se ky vend nuk bëhet, thotë pikëllimi i tyre, (se Shqipni nuk ka). Të ikin, duket sikur u thonë me apatinë e tyre, Mirushit, Robertit e atyre pak të tjerëve. Njerëzve në shenjë në memorien e kombit, që me punën e veprën e tyre na kanë treguar se e duan Shqipërinë më shumë senjerëzit e shtetit. E duan teatrin e kulturën kombëtare shumë më shumë se Ministresha e Kulturës e se të tjerë ministra pararendës. Shumë më shumë se ata!

“Sokrati” i Mirush Kabashit na ka bërë të ndjehemi shumë më tepër shqiptarë se rituali i qokave të kryeministrit tonë nëpër Ballkan e herë e herë në Europë. Dhe kur u pyet, z.kryeministër, pas protestës së parë të aktorëve se: “A e ka dëgjuar Robert Ndrenikën”, ai qe përgjigjur: “Unë nuk i dëgjoj ata që s’ dinë se ç’kërkojnë... “

Udhëheqësinë e bezdis teatri... Për t’u vënë në skenë “Gomari i Babatasit” drama-satirë e Fishtës, dy vjet më parë,prej veqilave të udhëheqësisë qe kërkuar që më parë të shihet (kontrollohet) teksti, edhe pse e shkruarnë vitin e largët 1923.E prap’ kërkohet siguri se mos fshikullimi që u bëhet aty, personazhit të kryeministrit e deputetit të marrë prej rruget e të futun në parlamentin e atëhershëm do të “dogonisë” shefin e veqilit sot...

Njësoj si atëherë edhe sot, njëqind vjet ma vonë...

▪ **Mendimi i traditës** ▪

Lumo **SKENDO**

PËR SHKRIME TË HARRUAR DHE TË PADITUR

A është vërtet se gjyshët dhe stërgjyshet t'anë nukë janë mejtuarë që të përdorin gjuhën e tyre si një veglë marredhënjeje, si një mjet kulture, ose, për të mbushurë nevojat e jetës' së përditëshme, në mos të intelektualesë?

Shumë herë njeriu, është' i shtrënguarë që të thotë se përdorimi praktik i gjuhës nuk e fillon në Shqiptarët përveç se më 1879, më përlindjen që gjen në formim të shoqërisë në Stamboll dhe t'asaj së Buku-reshtit. Gjer ahëre pa ndehim se gjuha jonë ka mbeturë më nj'anë e haruarë, e neglizhuarë, e pakujdesurë, e përcëmuarë.

Padyshim askush set s'munt të mohojë vjetresin' e studimevet të shqipesë; libra dhe shkrime të afëro katër qint vjetësh më parë na vërtetojnë mbi besimin tënë. Po këta të shkruarë të gjuhës s'ënë a ka qënë me një menyrë të vazhduarshme dhe praktike, a po e kanë përdorurë' vetëm disa diletante si një luks, si një dëfrimshpirtor?

Për të përgjigjurë ne kjo pyetje duhetë që njeriu të ketë në dorë të tij arshivat dhe dokumentet e jetesë që kanë rrojturë Shqiptarët në kohë të shkuarë, të ketë nënë sy gjurmat dhe kronikat e vitevet të flutuarë. Të dimë ç'kanë mejtuarë, si kanë rrojturë, ç'ka qënë brënda në shpirt dhe në zemrë të tyre puna frymore veç asaj jete gjithënjë buçatëse dhe kërcëllimtare me të cilën e shohim të pajuarë racën t'ënë dhe q'i është bërë si gjyra karakteristike e saj.

Për fat të keq këto gjurmët e vjetra s’kemi ku t’i gjejme! Ne vetë kemi shkruarë fort pakë punët dhe jetën t’ënë, dhe të huajtë na kanë njohurë edhe më pak’akoma. S’kemi as arshiva, as kronika, as no një gjurmë të duruarshme të jetës s’ënë së shkuarë.

Po qysh do bërë që të hedhë njeriu pakë dritë mbi këtë që pyesim? – Duhetë që të konstojmë vetëm ató shënja që durojnë që janë mbajturë gjer më sot.

Më parë le të shohim sa libra kemi në gjuhët tënë, të ditura dhe të ruajtura; me një fjalë të bëjmë një radhua të monumenteve t’anë literarë dhe historike; një bibliografi.

Për fat të keq një bibliografi shqiptare e plotë akoma s’ka dale dot në dritë; sa për tani m’e mira dhe më seriozeja është ajo e të ndjerit profeso Emile Legrand, shtypurë me 1912 në Paris; në këtë librë, e pasuarë prej dy shkollarë pas vdekjes’ së Legrand-it, janë kataloguarë 724 vepra; me parë këti profesori, i dëgjuari albanolog i diturë, Gustav Meyer, kishte vënë një provim bibliografije shqipe në fund të librës së tij Fjalurë etimologjik shqip (Strassburg, 1881); radhit 193 vepra mbi Shqiptarët ose në gjuhët shqipe, prej të cilavet 80 shkruarë shqip dhe prej Shqiptarëvet.

Nga të 724 librat e kataloguara prej Legrandit, gjer në mot 1900, se bibliografi’ e tij s’vete më tëhu, vetëm 125 janë të shkruara shqip; të tjeratë janë, ose studime mbi gjuhët, të bërë prej të huajvet, ose libra historije, shetitijeje, mbi kombin dhe vëndin t’ënë.

Për të kupëtuarë njeriu metësin e bibliografis’ së Legrand-it arrin shumë here të ktheje fletët e një katalogu librari; për shëmbllë, katalogu No, 611 e librarit Joseph Baer dhe Co. ne Frankfurt, numuron 9 vepra që mungojn’ në librët të profesorit francës.¹

Pra, jo vetëm kërkimet në kartrat e pluhuruara dhe të verdhura prej kohës, në bibliotekat e mbëdha dhe në arshivat e qeverivet, po edhe shumë here hazardi do të na vërë mbi gjurmë të tjerave libra shqipe të panjohura: se na duketë që kemi të drejtë të besojmë se gjuha jonë s’do

¹ Një evaluim që më duketë i vërtetë më bën të besonj se, në qytetet e ndryshme: Shkodrë, Bukuresh, Sofje, Korçë, Selanik, Stamboll, Bruxelles, Paris, Athine, Vjene, Itali, Misir, Amerikë, do të jenë shtypurë afëro 400 libra dhe broshura shqip, pa numruar e gazetatat, që pa dyshim kapërzejnë të 90-at dhe arrijnë të 100-at, sado që të nëntdhjet për qindat kanë qënë fletë që nuke duruanë dot më tepër se disa të pakë numure, në mos dhe nga një here një të vetëm.

Do të vimë një ditë mbi këtë pyetje në faqet e së perkohëshmes s’ënë.
(Notë shkruarë në Korrik 1916)

të ket qënë dhe kaqë shum'e hedhurë menj'anë sa e pandehim ne vetë.

Frëngu i Bardhë, në parëthënje të fjalurit latinisht-shqip të tij, a nuke thotë se gjuha jonë po vdirotë dhe po bastardhohetë? Kjo frazë na duketë si një klithje kundrë shkrimit me lathim të shqipesë, dhe jo si një qërtim për foljenë me gojë. Është pra për të besue se shqipeja përdorësh si gjuhë e gjallë dhe praktike, në kohët në të cilët shkronte Frëngu i Bardhë.

M'anë tjetrë Bogdani, në parëthënje të veprës' së tij shqipe, Cuneus Prophefarum, shtypurë me 1685, na dëftën se ka pasurë dhe akoma libra të tjera të shkruara shqip prej tij, po që, në udhëtimet, dhe prej prapësis së fatit, i janë treturë si kripa në ujë. Munt të themi se edhe tani gjurmat e ralla të gjuhës s'ënë që na janë ruajturë formojnë një vark të pakëputurë. Po edhe sa të tjera që nuk' i dimë, që na "janë treturë si kripa në ujë", ose që edhe po pesin në çipat e dollapëvet, mbase gjysmë dhe të mykura!

Ná këtu ca kujtime të informimevet dhe shënimevet që munda të mbleth mbi të tilla vepra. Me 1909 kur isha në Elbasan për kongresin e shkollavet, pashë ne Z. Lef Nosi nga ky qytet, një dorëshkrim shqip, të voglë, një Liturgji të Thodhor Haxhi Filipit, pas Sht Gjon Hrisostomit, e mbeturë nga fundi i shekullit të 18-të, dhe shkruarë me ató shkronjat e ndryshme të Thodhrit, që Hahn-i i ka marrë për shkronja shqipe arhaike.

Prapë shkruarë me ato shkronja gjendësh në duart të mësonjesit Z. Dot Biba një kateqismë dhe një defter tregëtije, pa një importencë titerare, padyshim, po shum' me rëndësi si shënjë që gjuha jonë përdorësh për të mbajturë llogarít e tregëtisë.

N' Elbasan mësova se një mësonjës greqishteje, i quajturë Tushi Pina dhe vdekurë i ri nj'a 25 vjet më parë, kishte lënë ca dorëshkrime, "ca përkthime, etj, të cilët sot gjenden në duart të Z. Gj. Pekarnezi, në Vjenë; këta dorëshkrime i zë ngoje dhe Pekmezi në një studim të voglë që ka shkruarë gjermanisht mbi shkronjat hundore të gjuhës s'ënë²

Më 1913 kur qeshë në Shkodrë, i njohuri vjershëtor Atë Gjergj Fishta, më thoshte se gjenden në duar të disa shokve të tij priftër, njëmbledhje vjershash të priftit të Mirditës, Zarish-it, vdekur rreth, motit 1780.

Në Berat, më 1913, kasha parë ne Z. Sulo Resuli, një dorëshkrim

² Zotin Pekmezi që e pieta me një letrë mbi këtë çështje, pati mirësinë të më përgjigjetë këtë më poshtë, me date 3 Shtator 1926 :

"Me 1901 u-dërgova prej Akademisë së Diturisë, Komisionit Ballkanik të Vjenësë, në Shqipëri, për studime dialektologjike, dhe me një porosi të veçantë nga ana e profesorit t' em Jagiçit, përshkrimin e vjetrë të Elbasanit..."

shqip (po me shkronja turqishte) të vjershavit të një Sylejman Ramazan, vjershetori dëgjuarë n'atò anë, Beràtas, dhe rrojturë afërò një qint e një ze tvjet më parë; këto vjersha, edhe në mos paçin një të madhe vleftë si literaturë, do të kenë një importencë dokumentare, për mendimet, mbase dhe ngjarjet e kohësë.

Në Berat prapë mbahenë dhe ruhenë dorëshkrime të tjerë të vjershëtorëvet Hasan i Zyko Kamberit dhe Nezim-it; dhe unë vetë kam pasurë në mes të libravet të mija dy dorëshkrit..e të vjershavit të Hasanit Zyko Kamberit, tër në shkronja tyrqishte, dhe njeri prej të cilevet të pakën një qint vjeç i vjetrë.

Dy libra fetare në vjershë, të shkruara në Frashër prej Dalib dhe Shahin bejvet, këndohenë dhe sot në teqet e Bektashivet.³

Libratë fetare muhamedane janë shkruarë me germa arabishte.

Sot gjendenë shumë mevlude, ilahi dhe vjersha të tjera kështu të ruajturë. Disa prej vjershëtorëvet të tillë kanë shtuarë dhe vepra të tjera në prodhimi i tyre. Hafëz Ali Ylqyni, më thonë se ka lënë një fjalor shqip-tyrqisht, një tjetër tyrqisht-shqip si edhe dy libra të tjera, mbeturë akoma në dorëshkrim:⁴

Në një defter që kam tani përpara syvet, dhe ku është shkruarë një fjalë që ka mbajturë Joan Vretus, në një mbledhje Shqiptarësh për të filluar një degë shoqërije shqipëtare në Bukuresht, me 20 Kallendor 1882, këndonj këto fjalë se, një fare Stefan Postenani, që s'e paska arritur as babaj i Vretos, paska lënë një shkronjëto të gjuhës greqishte ndë shqipe; ky dorëshkrim i paska rën në dorë Vretos kur ishte djal' i voglë, dhe i paska dhënë mendimin që të bëjë gramatikën greqisht të tinë.

Në një fjalë tjetër që mban prapë në Bukuresht me 14 Kallendor (Janar) 1896, tër ay I. Vreto, thotë se:

“Panajotidhi Meksaj nga Labova, që është shëronjës në Pargë, shkruantej aty matinaj, se ka bërë një mbledhje të tillë (do-me-thënë ka mështuellë këngë, vajtime etj) sa ka mundurë, veç të shkruarvet të tija, edhe i vjen ndi' hëngërtë, myku.”

Këtu zë ngoje ató që pashë dhe që di, sado që as koha, as fati, s'më kanë dhënë lejë të bënj një shëtitje studimi, me nge dhe me qetësi zëmre,

³ Mësonj tani se, veç këtyre dy Hadikave, qënka edhe një tjetre, vënë në vjersha prej Haxh Çiçko, nga Korça; dorëshkmi i kësaj libre u-gjendësh sot në teqet të Melçanit. Hadika e Haxhi Çiçkos do të ket qënë vjershëruarë nja 50 vjet më parë.

⁴ Ky Hafëz Ali është autori i një mevludi që po e përshkrojmë në artikullin Bibliografi Shqipetare.

në Shqipëri. Edhe nuke bënj fjalë për dorëshkrime të rinj, libra të gatijta që presin ditën dhe volinë për të dale në dritë.

Ketó që rrëfeva më lart më bëjnë të besonj se të folët e Arbërisë ka qënë dhe duhet të këtë qënë kurdoherë, në mos dhe prej shumë shekëllash, të pakën që katrë a pêsë qint vjete tëhu-si një gjuhë e gjallë dhe ndoshta edhe pakë praktike.

Dy gjëra ua kanë munguarë për t'i dhënë hov të math dhe shpirt të shëndoshë gjuhës s'ënë: një qeveri kombiare, dhe një kishë autoqefale. Ketó të dy fuqitë, administrate dhe kisha, janë që kanë një nevojë të përditëshme të gjuhësë, që mprojnë mësimin dhe zgjojnë nevojat.

Duke na munguarë këtë, gjuha ka qënë pakë me të vërtet si një luks, si një dëfrim i hollë i shpirtit dhe i ndjenjave, të lumtur akoma ne pse kemi pasurë stërgjyshër që kanë mundurë të ngrihenë pakë përmbi qarkun lëndor dhe kafshor të jetësë plot ashprësi dhe të materialiste të tyre.

Thoshnim më lart që padyshim shumë prej shkrimevet të prindvet t'anë janë treture dhe kanë humburë. Po ç' do të bejmë për të ruajturë ata që dhe s'janë çdukurë dot gjer më sot?

Do të dalë vallë no një i pasur, no një mprojtsë i letravet dhe i letrarëvet, që të këtë trimerinë sa të marrë në mprojte të tij editimin rishtazi te libravet të bëra të ralla dhe të pagjetshme, dhe të dorëshkrimevet të ruajturë prej një fati shumë të mëshirshmë, po që janë kurdoherë në rrezik të humbjesë prej mykut, zjarit, dhëmbi të miu ose: dores' së njeriut?

“Ne Elbasan gjeta atëhere disa njerzë tregëtare dhe një grua, të cilët edhe shkruanin me shkonjat e vjetra të Elbasanit. Mirret vesh këta ishin pleq, dhe gruaja më plakë akoma. Në shtëpin' e Papa Gjorgjit u-njofta me nje Kallugjer 80 vjeç, të quajtur Partheni, të Manastirit Shën Gjon, me ndihmën e të cilit fshehtazi vajta gjer në Manastir, dhe atje, prapa altarit të Kishës, gjeta një arkë të vjetrë e të shkallmuar, në të cilën gjeta shumë doreshkrime, prej të cilevet mjerisht m'u-desht vetëm disa copëra fshehtazi të marr. Ç' u bënë të tjerët dorëshkrime? Pyeta përpara disa vjetëve kur qeshë në Elbasan; më thane në Manastir, se, as ata vetë nuk e dinë të këtë pasur atje dorëshkrime...

“Gjeta dhe do dorëshkrime të një mësonjësi, Dimitri Andrea Pina, i cili, përpara disa vjeteve, kishte vdekurë në një moshë prej 27 vjetsh. Ky shkruante me alfabetin e Frashërit, po edhe me alfabetin e vjetrë

të Elbasanit. Pina ka përkthyerë disa biseda kishe, do copëza prej klasikëvet latin. Disa këngë kishe prej greqishtesë; ka një pjesë të gramatikës shqipe më dialektin e Elbasanit dhe një cope të një fjaluri shqip. Unë këta fragmente i ruanj, dhe dëshëronj që t'i shtyp një here... .

“Në mes të tjerëve dorëshkrime gjeta në Elbasan edhe një fletë më të motshme, të shkruarë me alfabetin e Elbasanit, faqe 55 dhe 56, d.m.th se ka qënë një dorëshkrim mjaft i math dhe i shkruarë fort bukur. Kallugjeri më thoshte se, ky dorëshkrim i kësaj flete do të jetë padyshim a po i Thodhërit vetë, a po i igumenit të Manastirit Shën Gjoni, nxënësit të Thodherit.

“Kam disa dorëshkrime, këngë kishe, të përkthyerë prej greqishtesë, më tri reshta: i pari resht është shkruarë greqishtja e motshme, i dyti resht me greqishten e re, dhe i treti resht është përkthimi i këtyre me shkrojljat e vjetra të Elbasanit. Duke i studjuarë këtë, gjeta se i ngjan shumë dorëshkrimi i greqishtes së re shkrimit të vjetër të Elbasanit. E kështu m’erth për dore të shkruajë përmbi këtë çështje në të përkohëshmen e madhe të Akademisë së Diturivet, të Vjenësë “Anzeiger der phiIosph. histor. Classe der Akademie der Wissenschaften. Wien, Jahrgang 1901, Nr. IX. Faqe 39” duke i rrëzuarë të tëra teoritë e përparëshme, dhe duke thënë se, alfabeti i vjetër i Elbasanit është alfabeti greqisht kursif të shekullit XVIII, i stilizuarë individualisht. Më duketë se ky mendim është i pranuarë kudó në radhët e të diturvet”.

Pyetmë të birin e tij, Z. Hafëz Said, sot imam në Lesh, mbi shkrimet t’et, dhe pati mirësinë të na japë këta shpiegime:

“Hafëz Ali Ylqyni (vdekurë më 1913) ka, për veç mevludit:

1-Një abetare shqip (me germa arabishte);

2-Një libré të imituarë prej Tuhfe-i-Vehbije, në vjershë, me fraze dhe fjalë tyrqisht shqip.

3-Fjalori shqip-tyrqisht qënka 133 faqesh, me 41 ose 42 fjalë, në çdo faqe (total 5500 fjalë).

4-Fjalori tyrqisht-shqip paskësh 435 faqe, në secilën 41 ose 42 fjalë, që, kështu japin një total afëro 18,000 fjalësh. Po i japim këta përshkrime nga frika se mos çdukenë një ditë doreshkrimetë dhe humbet edhe kujtimi i tyre.

▪ **Intervista** ▪

Erzen **KOPERAJ**

**NE NUK SHKOJMË KONTRA RRYMËS,
POR NUK LAMË AS TË NA MARRË RRYMA PËRPARA...**

- *Intervistë me poetin dhe studiuesin dr. Primo Shllaku, mbi gegnishten dhe letërsinë e shkrueme në këtë dialekt.*

Në këtë intervistë¹ poeti dhe studiuesi dr. Primo Shllaku ndan me publikun disa qëndrime sistematike të tij përgjatë gjithë kohës, lidhur me domosdoshmërinë e mbrojtjes së vlerave të gegnishtes, dialekt që i ka rezistue kohës dhe ndalimeve që u diktuen së fundmi edhe prej regjimit komunist. Në këtë dialekt, vëren Shllaku, janë shkruar kryeveprat e mëdha të letërsisë dhe shkrimit shqip, prej Buzukut, Budit, Bardhit e Bogdanit e deri te Fishta, Mjeda, Migjeni, Koliqi e ndër ma të afërtit Camaj e Zorba. Simbas Shllakut përderisa monumenti që ka krijuar gjuha e njësueme, letërsia e realizmit socialistka ra, atëherë ka vend me e ripa edhe çështjen e saj. Fakti që sot shkruhet e botohet në gegnisht asht një arritje e madhe, por që nuk mjafton për me i dhanë asaj vendin që i takon. Simbas Shllakut, përkrahësit e gegnishtes nuk janë përçarës të askujt, por kërkojnë me lidhë fijen e këputuna të kulturës shqipe... Ma e pakta që mund të kërkohet asht përfshimja e saj në programet shkollore

¹ Kjo intervistë asht e njajta e dhanë prej dr. Primo Shllakut në emisionin “Tonight” drejtue prej redaktorit të revistës tonë dr. Erzen Koperaj, në kanalin televiziv lokal *Star Plus*.

me u studiue edhe si instrument për me analizue autorët e mdhaj që shkruen në gegnisht. Gegnishtja, simbas poetit e studiuesit dr. Primo Shllakut, po jeton moshën e saj të rehabilitimit, qoftë si tingëllim, qoftë si rikthim e ristudim i atyre vlerave që i ishin mohú.

- **Z. Shllaku, pse dialekti gegë ka nevojë të mbrohet dhe lëvrohet, pse e keni kthyer në një mision mbrojtjen e gegnishtes dhe vlerave të saj?**

Gegnishtja nuk ka pushu së lavruemi, nuk ka pushu së foluni, nuk ka pushu së zhvilluemi, gjithnji në bashkëpunim edhe me koinenë dhe dialektin toskë. Ne ndodhemi sot në një situatë gjuhësore shumë fluide, nuk jemi mâ nën trysninë e presionin e kazanit të viteve '72-'90, ndodhemi në një terren lirie relative, por të mjaftueshme për t'i siguru sejcilit afirmimin e identitetit të tij gjuhësor dhe kjo nuk asht pak: një arritje reale që njerëzit e kanë shfrytëzue dhe materializue me veprat e tyre. Një pjesë e madhe e njerëzve që nuk na duen ne, njerëzve që merremi me punët e gegnishtes, që shkruejmë në gegnisht, që insistojmë e që kërkujmë rilidhjen e epokave atje ku janë këputë, që kërkujmë rilidhjen e fillit të këputun, sipas shprehjes lapidare të Martin Camajit, është fakti se mundohen të na paraqesin sikur ne i shkojmë kundër rrymës, kjo nuk asht e vërtetë, ne nuk i shkojmë kontra rrymës, por nuk lamë as të na marrë rryma përpara. Koshienca e madhe e koinesë gege, e kryedialektit gegë, e letrarishtes gege e gegnishtes letrare asht ma e fortë se 18 vjetët e furrës së Kongresit të Drejtshkrimit, sepse gegnishtja niset prej errësinave të kohës, vjen e ndërton qytetin e madh të librave të katër B-ve (Buzukut, Budit, Bardhit e Bogdanit), vjen përmes një traditet që ka kalu situata edhe mâ të vështira se ajo e periudhës komuniste, dhe prandaj ne e kemi kaq të lehtë, e prandaj kjo asht kaq dëshpruese për ithtarët e së kundërtës. Ata nuk e kuptojnë se gegnishtja bashkë me tosknishten kanë kalu nëpër Skilen dhe Karibden e 500 vjetëve të Perandorisë Osmane, e cila ka mbajtur një qëndrim negativ ndaj shqipes. Dhe papritmas regjimi komunist mban të njëjtin qëndrim negativ ndaj gegnishtes, në një kohë kur gegnishtja ishte çerdhja e madhe me vezët e mëdha dhe zogjtë e mëdhej e shqipet e mëdha të një produkti letrar të pashoq në gjithë arealin shqiptar. Sepse shqipja veriore, përveç Zef Jubanit dhe Pashko Vasës, kolosët e vet i ka pasë vendali, kanë ndejt këtu ata, nuk kanë qenë emigrantë. Kuptohet se kanë zhvillu një sistem

rranjësor dhe kanë thith vlagën e madhe të gjuhës popullore e cila në të gjitha rastet asht burimi i energjisë dhe i forcës shprehëse gjuhësore. Fishta i lutej provincialit të fretënve “Mos më transferoni!”, në kohën kur ishte në Hot, sepse ishte tue bâ veprën e vet, sepse vepra e tij ka lindë aty ku flitet për përmbajtjen e asaj vepret. Vepra e Fishtës asht e para vepër aktuale, e para herë kur shqiptarët e aktualizojnë historinë, për herë të parë në një vepër rilindase nuk flitet për Motin e Madh, për Skënderbeun, por flitet për varre të freskëta, plagë që kullojnë, për flamur të grisun, të një ngjarjeje që kishte pak ditë që kishte ndodhë. Në mënyrë figurative, Fishta asht ndoshta i pari reporter i kronikës shqiptare në letërsi. Pra kemi një letërsi të freskët, prandaj ajo letërsi ngjiti. Vetëm fenomenologjitë e prumjeve të gegnishtes po t’i përmendim, shofim se e gjithë letërsia shqipe “ka dalë mbi ujë” me ngjyrën e gegnishtes, mjafton t’i rreshtojmë: romani i parë, kthesa e parë policentrike me Migjenin, mrekuillia e Ndre Mjedës, që e ktheu shqipen si një gjuhë operash. Dhe papritmas na vjen një Androkli Kostallari, inkompetent (e kam fjalën në formimin e tij, ai ishte specialist në morfologji, fjalëformim dhe një specialist i tillë nuk ka tagër të vendosë në çështje e probleme që i takojnë sociolinguistikës) që merr përsipër formimin e gjuhës së përbashkët. I vetmi njeri që mund ta merrte përsipër një detyrë të tillë, për gjuhën e përbashkët, jo për këtë që na kanë lanë, ishte E.Çabej. Por Çabej u tërhoq, nuk deshti me e marrë përsipër atë punë. Fatkeqësia e madhe e jona asht se ne jemi popull mitologjik, edhe në atë kohë thuhej se Çabej nuk ka dashtë, se nuk ka qenë dakord. Jo, jo, kanë qenë dakord të gjithë. Mund ta kishte lanë me shkrim, ta shifshim të gjithë që ai s’ka qenë për këtë gjuhë të përbashkët. Nuk amnistoj asnji njeri. Asht bâ një padrejtësi e madhe prej të gjithëve, pamvarësisht se ça kanë mendu në thellësi. Na kemi nevojë për aktin. Shkencëtari duhet të jetë trim, nuk ka shkencëtar frikacak. Shkenca asht provë e virtytit, nuk asht provë e konformizmit.

- **Megjithatë duket sikur sot ky kapitull quhet i mbyllur. Ka prej atyre të cilët e pranojnë se ka qenë një diktat i ushtruar dhe i motivuar politikisht, por që nuk mund të rikthehet më për diskutim.**

Kjo asht pjesa absurde e kësaj historie. Demokracia, epoke e re, njeriu mendues vjen me korigju. Edhe komunistat erdhën si korigjues,

ata banë reforma, si reforma agrare etj. por t'gjithë e dimë sesi shkoi drejtimi i tyre. Pas përmbysjes së atij sistemi, filluen ndryshimet në ekonomi, u kthye prona private, në politikë, u bënë zgjedhje pluraliste. Nuk e di pse kritika u ndal para gjuhës. Apo sepse "fitimtarët" e Luftës së Dytë Botnore e donin një kryekështjellë, e kjo kryekështjellë ishte gjuha. Gjuha asht një fenomen që zhvillohet shpejt, më shpejt madje se t'gjitha format e tjera. Gjuha, asht një fenomen gjithmonë në ndryshim, po të matet, (sepse ka metoda shkencore që e masin gjuhën, edhe brenda muejit lind një fjalë e re, një idiomë e re, që mund të jetojë 100 vjet, ikën ajo e vjen një tjetër) shofim se nuk asht një fakt i kryem. Prandaj gjuha e njësueme nuk mund të përjashtojë potencialet e mëdha të kombit, sepse "ne kemi qenë fitimtarët" e një lufte që sot e kësaj ditet ka dritë-hijet e veta, e cila e ka vù shoqinë shqiptare përpara një pyetjet t' madhe: mirë se çlirimtarët na çlirun, po ne, kush do t'na çlirojë nga çlirimtarët? Kemi një riardhje të mendësive të asaj kohe, kemi një rritje të arrogancës dhe një lloj analogjie të frikshme, me cungime e krasitje të lirive, po mundohen të na mbyllin gojën. Nuk jemi larg kësaj prespektive. Kambëngul në këtë pikë, nuk ka ndodhun asnjë fakt i kryem. Monumenti që ka kriju gjuha letrare e njësueme e Kostallarit dhe shkolla gjuhësore marksist-leniniste e Tiranës asht letërsia e realizmit socialist, letërsi që ka ra e gjitha, asht rrëzú tashma. Atëherë pse duhet ta mbrojmë ne? A duhet ta mbrojmë se kështu dojnë vllaznit tonë të Jugut? Këtë s' duhet ta bajmë edhe për të mirën e tyre.

- **Zakonisht thuhet se beteja gjuhësore u fitua edhe prej letërsisë së shkruar në standard, me emra të tillë si Kadare, Agolli etj.**

Gegnishtja po jeton moshën e saj të rehabilitimit, ajo po rehabilitohet qoftë si tingëllim, qoftë si rikthim e ristudim i atyre vlerave që i ishin mohú. Vetë absurdi i diktaturave asht se krijon diga, krijon pragje që mandej shpërthejnë me forcë. Kishin mbetë figura t'mdhaja të pazbulueme si Fishta, Camaj, Koliqi etj. që erdhën si meteorë, erdhën e ranë si gurë të mdháj në mes të fushës. Mbetëm të shtangun, sa pati prej atyne që fillun me pyet si asht e mundun që s' kemi ndi për ta. Ata aty kanë qenë, por përkatësia gege i bante të ishin rreptësisht të ndalúm. Këtë surprizë të madhe nuk e pësún vetëm ne gegët. Kush kishte arritë me e lexu Camajn para viteve '90? Gegnishtja erdhi me emra të fuqishëm prap', me emra të ri dhe emra të vjetër por që nuk njifeshin nga brezat.

Kur u pa për shembull, se letërsia e Camajt ishte një letërsi autentike, një letërsi e pastër e kulluet dhe nuk kishte brenda saj përpjekjet për të siguruar vetes një licencë, por ishte një letërsi e përjetshme, eterne, sikurse nuk ishte e tillë letërsia e Ismail Kadaresë, i cili (sipas tij, se sipas meje jo) ishte detyrues me paguar “the tolls”, me ndezë një qiri për djallin për me mujt me folë për engjëllin, gjë që unë nuk e besoj. Personalisht, e shof letërsinë e Kadaresë si një letërsi me dashni pa fund për komunizmin dhe elitat komuniste. Ai iu rikthye edhe një herë veprave të veta, hoqi këto pjesë, por mbetet një letërsi e arrnueme. Ne që kemi punë me letërsi në aulat me studenta, e shofim qartë se të rritë nuk kanë anji interes për problemet e luftës së ftohtë në letërsi, atyne i pëlqen lirija e jetës, dashunia, problemet e vetëdijes për me zbulu vetveten, autorë si Markezi. Kam përshtypjen se rinisë shqiptare sot as nuk i shijon e as nuk i intereson vepra të tilla të Kadaresë si “Dimri i madh”, me subjekte të tilla me Enver Hoxhën që na paska një hall të madh e që një djalë që aty vendoset si personazhi kryesor nuk i tregon të shoqes se pse rrinte deri vonë ndërkohë që kjo e fundit kujtonte se ky e tradhtonte, subjekte që sot janë pa kuptim, s’transmetojnë më asgjë, një letërsi e shpulpume, si i thojmë ne “s’ka ma lang hiç”. Asht e pakuptimtë që ne t’presim që kjo t’jetë letërsia jonë më e mirë? Jo, kjo as nuk asht as letërsia e s’ardhmes e as letërsia e vijimësisë. Nuk asht dhe nuk mund të jetë! Ai (Kadare) nëse asht i zoti me shkrú gjëna të bukra në liri, le t’shkruejn, por unë jam dakord me kritikët e tij që thojnë se Kadare e ka problem me shkrú në liri. Në liri ai nuk ka arritë me tejkalu vetveten e asaj çfarë ka shkrú në diktaturë. Gëgnishtja i ka forcat e mëdha, me autor si Zef Zorba, vepra e të cilit asht një përgjigje e fortë ndaj atyne që thojnë “mâ mirë kët’letërsi të realizmit socialist apo mos të kishim hiç”. Po, mâ mirë të mos e kishim, ta kishim ndër “sepete”, sepse i kanë shërby atij regjimi që ishte çnjerëzore, që ishte kundër shoqnisë shqiptare, kundër zhvillimit e që na la kaq mbrapa. Gëgnishtja, letërsia e saj e pati hovin e madh, se erdhi si alternativë, si një model i ri, si një qendrim i pastër, i qartë i ndershmënisë intelektuale. E gjitha kjo e futi moralisht në eklips galerinë e t’mdhajve, e deshëve të realizmit socialist. Gjithë këtyne që “i rriti partia” mundena me i thanë: mirë se ishit të detyruem me shkrú për regjimin, por ta mbanit edhe nga një vepër në sirtar, të fshehun, vepër të mendimeve tueja t’plota, ashtu siç paska bâ Zorba. Në kët’ mënyrë, gëgnishtja solli një model të ri, t’artit t’ përjetshëm, që e kishte sjellë herë mbas heret në historinë e kulturës

shqiptare, një model që nuk zhduket edhe kur kujtojnë se e kanë zhbâ. Vitaliteti i gegnishtes nuk krahasohet me vitalitetin e toskënishtes. Po t'i kishte ndodhë toskënishtes, ajo që i ka ndodhë gegnishtes, autorët toskë nuk do t'kishin shkrú mâ. Por asht pikërisht impulsi i madh i shpirtit shqiptar për me kapërcy gjithmonë errsinat, me mbyllë sytë edhe me ecë pa ditë se ku po shkon, dhe pikërisht ata që ecin e nuk e dijnë se ku shkojnë, çuditërisht, (kjo asht dhe metafizika dhe transhendenca e historisë dhe e kulturës) ata ecin gjithmonë përpara dhe jo ato që ndjekin "busullën". Z. Zorba ka shkruar 60 - 70 poezi, një vepër "minimale", por asht shembulli absolut se ka pasë një dimension lirije njeriu edhe n'atë periudhë, por kët' dimension nuk e kanë pasur të gjithë, sidomos s'e kanë pasë këta të realizmit socialist, prandaj këtu mund t'fillojmë debatin intelektual.

Pas viteve '90, kena një gegnishte që po lavrohet çdo ditë, janë mbi 200 autorë që e shkrujnë e botojnë, tue fillú prej librash prej 4800 faqe (shkru nga bába jem) e deri tek njerëz që kanë shkrú një libër me kujtime. Prandaj theksoj se gegnishtja k'to 30 vjet ka hy n'fazën e rehabilitimit të saj. Këtu, kur flasim për gegnishten, duhet pasë parasysh se përfshijmë edhe Kosovën. Rehabilitimin e gegnishtes nuk e shof vetëm tek kangët me tekstet e tyre, ku gegnishtja asht bâ modë, por kryesisht te letërsia e kultivúme. Kisha me sjellë si shembull Ledia Dushin, e cila asht një nga poetet mâ misterioze. Ajo ka një lidhje metafizike me letërsinë, me poezinë, me fjalën, me Zotin, me muzikën, me barokun, ajo asht një univers më vete. Gegnishtja që përdor aq harmonike, sepse ne nuk kërkojmë gjuhën, asht vetë mendimi, shpërthimi që aq i domosdoshëm në poezi, në shkrim që e gjen formën e vet në mënyrë t' natyrshme. Kur themi gjuhën e nanës, nuk kemi parasysh gjuhën e nanës shkodrane, nanës mirditore etj. na kena parasysh ekspresionin e parë, kur mendimi lidhet me tingujt e gjuhës tande, vertikaltetin e parë kur mendimi lidhet me tingujt, e ky asht një proces shumë mistik që ndodh tek ne në mënyrë krejt natyrale. Aty asht bukurija e mrekullisë së krijimit, e tue qenë se asht në nivele subkoshience, dora e askujt nuk mund të mbërrijë atje. Nëse dora jonë prek atje, në subkoshiecë, atëherë ato krijime nuk janë mâ poezi. Te gegnishtja që flen brenda nesh asht ajo furra apo laboratoriu ku piqet një varg, që ne nuk e komandojmë dot, dhe aftësija jeme si krijues asht me e regjistrué dhe ajo bahet send jashtë meje. Si në rastin e Fishtës, edhe vorrin e tij e shkatërrunen, por vargjet e tij jetojnë sot, t'ftojné me i lexú.

Gegnishtja asht po aq sa e vjetër po aq dhe aktuale, kontinuiteti i saj asht i pashembullt. Asht një prej treguesve të mdhaj të rezistencës së gjuhës shqipe. Kjo asht dhe lavdia mâ e madhe e gjuhës tonë, ka arritë me rezistu. Por në një ditë nandori (në nandor kanë ndodhë t'tana "mrekullinat" tona), çohemi dhe thojmë se do ta kpusim këtë trugun e madh (i madh, sepse trugu i gegnishtes asht ma i madh se trugu i toskënishtes, ka qenë gjithmonë si nga ana e popullsisë që e flet ashtu dhe nga ana e volumit letrar). Gegnishtja asht e madhe, gjigande dhe rezistente, kaloi dhe lëngatën e komunizmit. Erdhi Ledia Dushi, që për mú asht "distilât" i letërsisë, i krahasueshëm me cilëndo letërsi në botë.

- A ndiheni i vetëm përballë mbrojtësve të standardit, pasi ata kanë institucionet përkrah?

Unë e shoh se gegnishtja ka dalë në breg. Na kemi kërkú që me mujt me shkrú dhe botú. Kjo nuk asht pak, por as nuk asht e gjitha. Na po mundohena ta emancipojmë dhe të kalojmë letërsinë, sepse gegnishtja aty asht, jeton pa nevojën tonë. Nuk ndihena t'vetëm, jo vetëm tash, por edhe n'kohën kur rrezikojë t'përfundojshe në burg. Ne nuk jena përçarësit, na jena për hapjen e gjuhës dhe jo për mbylljen e saj. Ata janë të ngulun në atë pozicion që prej 1972. Por kena dhe lajme të mira, Akademia e Shkencave, për të cilën kam pasë shumë kritika, ndonjiherë i kam quejtë edhe akademykë, se u banë tanë me "pampers", nuk lëvizte kurgjâ, kanë futë një valë të re studiuesish, ndër ta edhe Ardian Ndreca, i cili asht po kaq i ekspozúm për gegnishten. Unë jam për hapjen, pasi kjo asht shpija jonë, kjo asht gjuha jonë dhe pas njiqind apo njiqind e pesëdhjetë vjetësh do të konvergojmë përfundimisht. Por do t'konvergojmë për shkak të shkaqeve e fenomeneve sociale, kulturore e shpirtnore, si rritje të psikosintezës kombëtare, do t'shifet sesi do t'shkojë puna me Kosovën, do t'krijohen ekuilibra të mdhaj e të rí që do t'na vendosin e na projektojnë kulturalisht në t'njejtir raporte që kena fizikisht. E këtu nuk shof asgjâ t'keqe.

- Si mund të arrihet një afrim sa më i madh i dialekteve, cila do t'ishte rruga më e shëndetshme për të afirmuar gegnishten dhe autorët e saj?

Janë dy faktor; së pari krijuesit dhe së dyti receptuesit, pra sa

promovohet kjo letërsi e shkruar në gegnishte. Asht fakt se për këtë letërsi ka kërkesë dhe interes. Ajo që na mungon sot për sot asht dashamirësia e shtetit, që nuk asht as toskë as gegë, por asht shqiptar. Na kena kërku në shumë rezoluta mbështetjen edhe të institucioneve, por nuk na asht dhanë. Sot shof një ngjallje të alergjive gegofobike. Shteti duhet ta fusë gegnishten në shkolla, të rrënjosen elementet e gegnishtes, në mënyrë që t'i lexojmë dhe t'i shijojmë gjithë autorët gegë, sepse në fund të fundit janë trashigimni e të gjithëve, pasuni e mbarë kombit. Na kena nevojë për me ekzistú si një pluralitet gjuhësor e etnografik, sepse kështu zhvillohemi natyrshëm. Na nuk jena përçarës.

▪ Arkeologji ▪

Helidon SOKOLI

**LISI. TIPOLOGJIA E FORTIFIKIMIT TË TIJ,
NË PERIU DHËN ANTIKE**

Themelimi i Lisit/ Lissus/ Alessio

Në interlandin malor e fushor të Lissusit, banuar nga pirustët dhe abrejtë në shek.VII-V p. Kr. u krijuan premiset për formimin e qelizave shtetërore. Në vitin 385 p.Kr. Dionizi i Sirakuzës për të siguruar gjirin e detit Jon dhe lundrimin në Epir ngriti disa qytete brigjeve të Adriatikut. Në këtë periudhë ai dërgoi kolonë dhe themeloi qytetin e Lisit/ Lissus/ Alessio/ Lezhë. Dionisi e qarkoi këtë qytet të ri me një mur rrethues që dallohej si nga më të fuqishmit, i ngjashëm me qytetet e Greqisë së lashtë. Fortesa e ndërtuar nga Dionisi i Sirakuzës përfshinte qytetin e sotëm që shtrihet pranë lumit Drin si dhe pjesën kodrinore.

Si rezultat i zhvillimit të kësaj qendre protourbane, u formësua në të njëjtin vend një qendër e re qytetare që në burimet historike të kohës fillon e përmendet si Lis/Lissos/Lisson/Lissum¹. Formën e plotë Lisi e mori aty nga fundi i shek.IV p.Kr. Lisi si një nga qytetet e rëndësishme bregdetare të mbretërisë Ardiae shërbente si pikë nisje për flotën ushtarake. Si qyteti i Lisit, ashtu dhe fortifikimi i tij me i hershëm,

¹ S. Islami. *Lindja dhe zhvillimi i jetës qytetare në Iliri*. Iliria II. 1972.

Akrolisi përmenden për herë të parë në burimet historike nga Polibi². Qyteti i Lisit bie në duart e Filipit V të Maqedonisë në 213 pr.K³ në zbatim të planeve të tij për të krijuar një linjë bazash detare në bregdetin e Adriatikut. Lisi, si një qendër rezistence përmendet nga Polibi dhe Tit Livius edhe për periudhën ilire, gjatë mbretërimit të Gentit⁴.

Disa dyshime mbi themeluesin e qytetit

Dyshimet për themelimin e qytetit nga Dionisi i Sirakuzes janë hedhur që në shek. XVIII nga autori Lucius sipas të cilit me Lissos duhet të kuptojmë qytetin e Issos në ishullin Hvar⁵. Mendimi i tij u përkrah më vonë edhe nga shume autorë të tjerë⁶ por pati dhe shumë autorë që e kundërshtuan këtë mendim, si: Hecquard⁷, Praschniker-Schober⁸. (Fig.1)

Një burim shterues mbi themelimin e qytetit të Lisit duhet të merret Diodori i Sicilisë⁹ i cili ishte bashkëkohës me Jul Cezarin dhe Augustin. Ky autor është i pari që shkruan se Dioni plak, tiran i Sirakuzës, gjatë fushatës së tij për kolonizimin e bregdetit të Adriatikut, kishte dërguar kolonë dhe kishte themeluar Lisin, në vitin 385 pr.K. Të dhënat e autorëve antik që përmendëm janë me interes për njohjen e historisë së qytetit të Lisit. Megjithatë duhet nënvizuar se këto burime janë të pjesshme, nga autorë grekë ose romakë dhe të njëanshme në disa raste. Është interesant fakti që një autor i njohur antik si Skylaksi, nuk e përmend në veprën e tij, shkruar në 335 pr.K, qytetin e Lisit.

Zbulimet arkeologjike dhe shtrirja e qytetit

Kuadri i plotë historik i themelimit të qytetit arrihet vetëm nëpërmjet

² Polibi. Historitë. Burime të zgjedhura historike. Vëlimi 1. 1965.

³ Polibi, po aty.

⁴ Tit Livi. Themelimi i Romës. LXIV. Burime të zgjedhura historike. 1967.

⁵ Lucius. De Regno Dalmatae et Chratiae, Amstelodami. 1688.

⁶ Cattalinichm, Mullerus. Geographi Graeci Minores. Paris, 1855

⁷ H. Hecquard. Historie et description de la Haute Albanie. Paris, 1857.

⁸ Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro. Wien, 1919

⁹ Diodor. Biblioteka historike, L.XV.13.4 Burime të zgjedhura.

zbulimeve arkeologjike që në qytetin e Lezhës kanë filluar që në fund të viteve '60 të shekullit të kaluar dhe që mbështesin plotësisht tezën e themelimit të Lisit në gjenezë si një koloni helene. Kësaj teze i vjen në ndihmë dhe studimi i stilit, dhe mënyrës së punimit të linjës fortifikuese të qytetit.

Lisi është i shtrirë në një terren kodrinoro-fushor dhe zë një sipërfaqe 20 ha. Ai fillonte që në pjesën e rrafshët të kodrës, pjesa protourbane e tij, dhe zbriste drejt territorit fushor deri në breg të lumit. Nisur nga përshtatja me këtë terren, qyteti u zhvillua përafërsisht në zonën e sipërme, e vendosur në majën e kodrës, zona e mesme e shtrirë në pjesën e shpateve të kodrës, zona e ulët që përkon me pjesën fushore rrëzë kodrës dhe zona breglumore.

Planimetria e qytetit të Lisit u zhvillua në përshtatje të terrenit, zhvillimit urban, por dhe nevojës për vetëmbrojtje. Ajo përbëhet nga një sistem muresh në formë unaze të trefishtë. Pjesa e rrafshët mbi qytet, përpara akropolit, ishte e qarkuar në formë rrethi me një tjetër linjë muri transversal. Rrethi i jashtëm i mureve ka afërsisht një perimetër prej 2200 m ngritur në të njëjtën kohë (Fig.2). Muri rrethues ka një trashësi mesatare 3.50 m dhe pjesa brendshme e tyre është e mbushur me gurë të vegjël, kryesisht të thyer për këtë qëllim. Teknika e ndërtimit të murit i përgjan sistemit të kuadronëve, sidomos në mënyrën e ngritjes së kullave të cilat kryesisht kanë formën këndrejtë dhe gjerësi të frontit deri në 10 m, dhe sipas pozicionit se ku janë ndërtuar, dalin para murit rrethues nga 2 deri në 8 m. Fortifikimi mesjetar, i cili ngrihet në pjesën më të lartë të akropolit antik është i ngritur mbi muret e vjetra, dhe në pjesën në afërsi të portës perëndimore mesjetare, janë ruajtur ende fragmente antike. Deri në ditët tona kanë ardhur të ruajtura mirë 11 porta nga të cilat 2 janë në pjesën e sipërme, 6 në pjesën e mesme të qytetit dhe 3 porta në pjesën e poshtme dhe breg-lumore. Një nga portat me monumentale, është ajo që gjindet në pjesën e sipërme, në anën jugore të fortifikimit që njihet ndryshe edhe si Porta e Gaviarit. Ajo është e gjerë 4 m dhe mbrohet nga një kullë e ndërtuar jashtë murit. Nga kjo portë sot ruhet, pragu, blloqet mbështetëse të kasës dhe kanatave si dhe blloku në mes të pragut që shërbente për mbylljen e portës.

Mbishkrimet latine

Pikërisht këtu janë zbuluar dhe dy mbishkrime latine, i pari në koridorin e Portës së Gaviarit që flet për rindërtimin e portës dhe të kullës në të djathtë të saj si dhe një mbishkrim i dytë pak metra më tutje që flet për rindërtimin e murit¹⁰.

Duke ju referuar këtyre mbishkrimeve marrim vesh se rindërtimi i mureve, kullave dhe portave bëhej me vendim të këshillit të qytetit nën kujdesin e magjistratit romak L.Gaviarit. (Fig.3-5)




Fig.1. Planimetri e Lisit.Praschniker-Schober.1919

¹⁰ Dy mbishkrime nga qyteti Ilir i Lisit. Iliria,1982.



Fig.2 Planimetri e Lisit.K. Zhegu. 1980

Mbrojtja e qytetit antik

Mbrojtja e këtij qyteti antik ishte e organizuar në atë mënyrë që muri rrethues perimetral të përfshinte 4 zonat ku shtrihet qyteti. Muri rrethues i Lisit është i përforcuar me kulla, të cilat janë të ndërtuara për mbrojtjen e portave të qytetit, dhe të kurtinave të murit. Hyrjet, duke respektuar funksionin, ishin të mbrojtura me kulla. Ato në përgjithësi kanë planimetri në formë katrore dhe ngrihen mbi lartësinë e mureve në vëllime prizmatike. Lartësia e tyre shkonte nga 10-12 m. ndërsa muri rrethues arrinte lartësinë deri në 8 m. Teknika e ndërtimit të linjës mbrojtëse të Lisit ka të bëjë shumë me përbërjen e formacionit shkëmbor, përpunimin paraprak të gurëve, gdhendja, skuadrimit i tyre dhe përsosmëria e vendosjes në muraturë. Nga ana tipologjike, muret rrethuese të Lisit janë të tipit poligonal por ndeshim dhe atë drejtkëndor. Në periudhën romake, rëndësi urbanistike mori zhvillimi dhe mbrojtja e akropolit. Rrethimi i tij me një linjë muri të veçantë, kishte për qëllim sigurimin e shtabit dhe funksionarëve romakë. Sipërfaqja e banuar e

akropolit të fortifikuar rezulton më e vogël se sipërfaqja që zinte rrethimi i vendbanimit protourban.

Në sistemin mbrojtës të qytetit kodrinor, rol vendimtar luan muri perëndimor ku janë ndërtuar kulla e hyrje të reja. Në anën e brendshme të murit perëndimor janë ndërtuar edhe të ndara njëkthinshe me përmasa 4 x 7 m. Deri tani janë të dokumentuar 35 të kësaj tipologjie.

Qyteti i poshtëm që përkon dhe me zonën breglumore ka hyrjen kryesore të tij nga ana jugore. Ajo ka një fazë të dytë rindërtimi në periudhën e parë të pushtimit romak, dhe këtë e shohim në ringritjen më lart të kalldrëmit që mbulonte gjithë koridorin. Një portë e dytë ruhet në pjesën perëndimore ku sot ruhen në lartësinë e dy rreshtave gurë, ku mbi të cilët vendoseshin kasat dhe dyert e portës. Nisur nga stili i ndërtimit dhe duke u mbështetur dhe në mbishkrimet e zbuluara (gjithsejt 4) mund të konkludojmë se rindërtimi i sistemit mbrojtës të Lisit përfundoi aty rreth fundit të shek.I pr.K.

Lissum në antikitetin e vonë

Në antikitetin e vonë, Lisi bënte pjesë në provincën e Prevalit me qendër Scodren. Në këtë periudhë e ndeshim me emrin Lissum¹¹. Ky qytet pësoi fatin e shumë qyteteve të tjera që u bastisën dhe u dogjën nga dyndjet barbare dhe pikërisht ky rrezik në Ilirik bëri që shumë prej këtyre qyteteve të përforconin mbrojtjen e tyre. Për një rindërtim të sistemit mbrojtës të qytetit në këtë periudhë dëshmojnë qartë disa fragmente muresh që ruhen në pjesën e sipërme të kodrës së akropolit antik. Këto gjurmë muresh bënin pjesë në fortifikimin e ndërtuar me mbetjet e akropolit antik. Këto fragmente muresh dallojnë nga ndërtimet e mëparshme si nga teknika e ndërtimit ashtu dhe nga materiali i përdorur për ndërtim, por dhe nga planimetria e kullave. Mund të themi me bindje se në antikitetin e vonë mbi rrënojat e akropolit antik u ringrit një kështjellë e vogël që siguronte qytetin nga dyndjet barbare. Rimëkëmbja e qytetit duhet të ketë ndodhur në shek.VI.

Në burimet historike të periudhës në fjalë, Stefan Bizantini e përmend me emrin Lissos, ndërsa Prokopi i Cesaresë i cili përmend të gjitha rindërtimet e Justinianit, Lisin nuk e përmend fare. Nëse do ti

¹¹ Tabula Puntegeriana.

referohemi Hieroklitit¹²ai na sjell informacion mbi organizimin në Ilirik në shek.VI dhe e përmend Lisin si një nga qendrat më të fortifikuara të provincës së Prevalis. Në këtë kohë qyteti ishte përqendruar përreth portit lumor, zonës kodrinore dhe pjesës më të lartë të kodrës, mbi akropolin antik.




Fig. 3




Fig. 4

¹² Hierokli. Synecdemus. Burime të zgjedhura.f.465.




Fig. 5



Fig.6. Punime restauruese në muret rrethuese, pjesa kodrinore. 2016

▪ **Trashëgimi kulturore, arkitekturë** ▪

Ledian **BREGASI**

**ARKITEKTURA VERNAKULARE DHE PEIZAZHI
KULTUROR I ZONËS SË SHKODRËS**

-Morfologjitë e vendbanimeve historike dhe tipologjitë e banesave.

Mbi përkufizimin e tipologjisë arkitektonike

Para se të përshkruajmë tipologjitë e banesave në zonën e Shkodrës, është e nevojshme të kemi një kuptim të përbashkët për përkufizimin e "tipologjisë" duke qenë një temë e vazhdueshme në kërkimin arkitektonik, ku heraherës ka patur debate të tepruara mbi tipologjinë dhe raste të tjera ku tipologjia është trajtuar si çështje dytësore. Në këtë tekst ku trajtohen ndërtesat vernakulare dhe historike, tipologjia kthehet në një mjet të dobishëm për të kuptuar dhe përshkruar arkitekturën. Tipologjia mund të kthehet gjithashtu në një mjet projektimi. Ajo është e dobishme për krijimin e variacioneve, varianteve dhe kombinimeve të tipologjive historike. Në rastin e veçantë kulturor dhe në kushtet historike të rajonit verior të Shkodrës, tipologjia arkitekturore nuk duhet kuptuar si një rregull i ngurtë dhe i ngrirë për krijimin e hapësirës.

Rrënja e fjalës tipologji vjen nga *typos* në greqisht dhe *typus* latinisht, që do të thotë shtypje e dukshme e bërë nga një goditje ose vulë. Pra, tipologjia arkitektonike mund të konsiderohet prania fizike e idesë së një hapësire. Ideja e hapësirës është në këtë rast kujtesa kolektive e

kulturës që jeton dhe zhvillohet në një territor. Kujtesa është shtresëzimi i nevojave, arsyeve dhe njohurive teknike të ndërtimit, i cili transmetohet përmes brezave, duke u përshtatur, përmirësuar dhe evoluar. Kjo lloj hapësire ideale, për shkak të origjinës së saj spontane dhe për faktin që ekziston në nivelin e ideve, lejon shumëfishime dhe interpretime. Është shumë e rëndësishme të kuptohet që produktet e idesë tipologjike nuk janë kopje të sakta të vetvetes, por hapësira fizike që kanë të përbashkët një ide.

Tipologjia mjet për ruajtjen e kujtesës historike

Në këtë tekst, *arkitektura vernaculare* është hulumtuar dhe përshkruar përmes idesë së hapësirës që qëndron pas saj. Në këtë mënyrë lejohen papërsosmëritë, variacionet dhe risitë. Përmes kësaj qasjeje, tipologjia bëhet një mjet për ruajtjen e kujtesës historike, jo si një dogmë e paluajtshme, por si një ideal që mund të manifestojë praninë e tij fizike edhe në kushte bashkëkohore, duke lejuar variacione të projektit dhe shfaqjen e tipeve të reja. Edhe pse kjo qasje mund të duket në pamjen e parë si e vetëkuptueshme dhe e zakonshme, peizazhi ynë është banuar në ditët e sotme me ndërtesa që mundohen të imitojnë pamjen e jashtme të arkitekturave historike, pa kuptuar formën ideale që qëndron në kujtesën e përbashkët të një tipologjie të veçantë. Për këtë arsye, kjo punë duhet kuptuar si një hulumtim mbi peizazhin historik të rajonit verior të Shkodrës, i pa interesuar në riprodhimin e "bukurisë" së tij, por duke synuar të eksplorojë mënyra bashkëkohore të banimit në rajon, bazuar në përvojën e përbashkët historike.

Të kuptuarit se lidhja midis peizazhit, kulturës dhe arkitekturës është një sistem ndërveprues i mekanizmave komplekse të *feedback*-ut do të thotë të merret parasysh fakti që një numër i madh i elementeve të ndërvarur duhet të analizohen në mënyrë që të kemi një pasqyrë më të qartë të mënyrës se si perceptohet dhe konceptohet hapësira në territorin e rajonit të Shkodrës. Procesi i analizës së arkitekturës vernakulare të këtij rajoni ka për qëllim të kuptojë arsyet e shfaqjes së mënyrave të ngjashme të banimit në zona të ndryshme të rajonit pa nevojën e një autoriteti qendror që vendos për një "stil" arkitektural zyrtar që duhet të ndiqet kur ndërtohet një banesë. Modelet hapësinore dhe ato të sjelljes të vëzhguara në rajonin e Shkodrës janë të lidhura ngushtë me fenomenet

kulturore dhe territoriale.

Më tej do të ndërmerret një ekskursus i tipologjive të banesave tradicionale në Shqipëri duke u përqëndruar në veçoritë specifike të arkitekturës mbizotëruese në rajonin e Shkodrës. Sidoqoftë, kjo analizë është e kufizuar në qëllimin e këtij artikulli dhe nuk mund të jetë shteruese për arritjet kulturore dhe larminë e një prej rajoneve më të rëndësishme shqiptare.

Të banosh, të jesh i vendosur në paqe, do të thotë të qëndrosh në paqe brenda sferës së lirë që mbron çdo send në natyrën e tij. Karakteri themelor i vendbanimit është ky kursim dhe ruajtje. Ai përhapet në të gjithë shtrirjen e banesës. Ajo shtrirje na zbulon vetveten, sapo reflektojmë se qenia njerëzore konsiston në të banuar dhe, në të vërtetë, të banuarit në kuptimin e qëndrimit dhe të vdekurit në Tokë.

Building Dwelling Thinking by Martin Heidegger from Poetry, Language, Thought, përkthyer në Anglisht nga Albert Hofstadter, Harper Colophon Books, New York, 1971.

Qasja tipologjike në projektimin arkitektonik

Qasja tipologjike në projektimin arkitektonik është mjet që duhet të përdoret me vetëdije të përshtatshme. Kur përdoret pa kujdes mund të bëhet një burg i ngurtë që ngrin arkitekturën dhe nuk lejon risi, ose në raste më të këqija mund të krijojë kopje të përbindshme të së kaluarës që veshin vetëm pamjen fizike të ndërtesës historike, duke harruar kuptimin më të thellë që arkitektura ka sjellë në secilën periudhë historike. Përshkrimet e mëposhtme të projektimit bazohen në një qasje operative ndaj tipologjisë, duke u bazuar në punën e studiuesve të arkitekturës si Aldo Rossi dhe Peter Eisenman. Tipologjitë bazë të strehimit janë ato të pranishme në territoret e veriut të Shqipërisë dhe ato të organizuara dhe të kataloguara nga Emin Riza në *Qyteti dhe Banesa Qytetare Shqiptare Shek. XV-XIX*, botuar nga “Dita 2000”, Tiranë 2009.

Tipologjitë historike konsiderohen si ideja që një komunitet ndan mbi banesat. Është dija e përbashkët që brez pas brezi ka evoluar. Kështu që, puna e tanishme do të përpiqet të ndërtojë mbi këtë njohuri duke besuar se kuptimi i tipologjive historike nuk ka të bëjë me pamjen e ndërtesës sesa me idenë e organizimit të hapësirës.

Shtëpia e zjarrit

“Shtëpia e zjarrit” është tipologjia më e arkaike dhe e thjeshtë e banesës së pranishme në territorin shqiptar. Bazohet në praninë e vatrës si qendra e aktivitetit të banimit. Variacioni historik në këtë tipologji ka qenë shtimi i një dhome për miqtë dhe një hauri ose hapësire për bagëtinë në një ose dy nivele. Interpretimet e mëvonshme bashkëkohore propozojnë vatrën e zjarrit si qendrën e një kasolleje të thjeshtë si në rastet e ndërtimeve malore të përshtatshme për turizëm. Variantet e mëtejshme prezantojnë çdo herë një oxhak, dhoma miqsh dhe hapësira pune në një ose dy nivele. Në modelet më të përparuar ndërtesa mund të jetë një bujtinë e vogël me një minimarket të bashkangjitur. Përndryshe, përmes kësaj tipologjie mund të organizohet një bujtinë e vogël me reception.

Shtëpia me hajat

“Shtëpia me hajat” karakterizohet nga prania e tre "shiritave" funksionale paralele. Në më të brendshmen ndodhet zona shërbyese e shtëpisë. Shiriti i mesëm pret hapësirat e ndërtuara si dhoma kryesore. Këto dhoma nuk janë të lidhura me njëra-tjetrën por arrihen drejtpërdrejt nga hajati. Shiriti më i jashtëm i quajtur “hajat” është i mbuluar por i hapur nga njëra anë. “Hajati” u përdor historikisht si hapësirë ndërmjetësimi midis kopshtit dhe shtëpisë duke u trajtuar si një hapësirë pune dhe jetese gjatë sezonit të nxehtë. Organizimi me tre shirita sjell një seri potencialesh interesante, të cilat janë mundësia për të pasur njësi banimi të ngjitura, por të pavarura, qasja e të cilave është nga e njëjta anë, duke lejuar që të ketë një pjesë të mbrapme, ku të organizohen zonat e shërbimit. Ky organizim lejon një përsëritje të panumërt të njësive në drejtimin transversal. Faza fillestare e eksplorimit të pavetëdijshëm të potencialeve të kësaj tipologjie është dukshme në ndërtesat e ulëta të shërbimit të vendosura përgjatë rrugëve kryesore të rajonit. Potencialet e ofruara nga organizimi me tre shirita mund të eksploroohen duke propozuar struktura të vogla të ngjashme me motele, me dhoma të pavarura, të cilat mund të shtohen gradualisht në të ardhmen pas rritjes së mundshme të kërkesës për hapësirë shtesë.

Kulla

“Kulla” është një nga tipologjitë më të njohura të banesave të rajonit të Shqipërisë Veriore. Mund të konsiderohet si një evolucion itipologjisë së shtëpisë së zjarrit. Ashtu si në shtëpinë e zjarrit dhe në shtesat dhe ndryshimet e saj të njëpasnjëshme, mund të vërehen tre lloje kryesore të dhomave. Vetë “shtëpia e zjarrit” ku kryhen aktivitetet kryesore ditore si gatimi; “dhoma e miqve” që është pjesa më përfaqësuese dhe e kuruar e shtëpisë; “hauri” që përdoret si vend depozitimi ose si hapësira ku do të ruhet bagëtia gjatë stinës së ftohtë. Ndryshe nga “shtëpia e zjarrit” që parashikon një organizim horizontal të hapësirave, kulla karakterizohet nga grumbullimi i tre hapësirave njëra mbi tjetrën duke filluar me “haurin” i cili ka një vazhdimësi të drejtpërdrejtë me tokën dhe duke vazhduar lart me “shtëpinë e zjarrit” dhe “dhomën e miqve”. Variacionet bashkëkohore të kësaj tipologjie propozojnë një organizim më konvencional të një bujtine që ka në katin përdhe kuzhinën ndërsa në katin e sipërm pret një dhomë ndeje dhe përmyllet në katin e fundit me një “dhomë gjumi”. Variantet e ndryshme propozojnë tre garsoniere të pavarura të vendosura në tre nivele dhe kombinime të ndryshme të dyapartamenteve të vogla, të organizuara në një ose dy kate secila.

Edhe pse “Shtëpia e zjarrit” me lartësi të dyfishtë nuk është një tipologji shumë e zakonshme në Shqipërinë Veriore, ajo është e pranishme në zona të tjera të vendit dhe lejon një numër variantesh shumë interesante që mund të jenë të dobishme në rastet e ndërtimit të arkitekturave më të mëdha hoteliere. Ajo bazohet në një ngulm të përfaqësuar nga një “shtëpi zjarri” me dy kate lartësi në anët e së cilës mund të shtohen dhoma gjumi dhe funksione të tjera. Pjesa më e madhe e aktivitetit të shtëpisë është e organizuar në këtë hapësirë të përbashkët ndërsa dhomat mund të shtohen në një, dy, tre apo edhe në të katër anët duke e kthyer “shtëpinë e zjarrit” në një oborr të brendshëm. Këto karakteristika mund të eksplorojnë në projekte që propozojnë hotele të vogla dhe të mesme në një numër të madh konfigurimesh të mundshme.

Shtëpia me çardak

“Shtëpia me çardak” paraqet një tipologji strehimi më të zgjedhur dhe më të sofistikuar. Ajo ishte përfaqësimi i një familje të pasur që

ka mundësinë të ketë kohë të lirë për të kaluar në shoqëri në një lozhë të hapur dhe të ngritur. Ky organizim hapësinor lejon të projektohen arkitektura që karakterizohen nga një fasadë më e hapur dhe publike ku organizohen shumica e veprimtarive të përbashkëta. Kjo lejon që në nivelin e tokës të kemi një lloj organizimi të ngjashëm me hajatin, me dhoma me hyrje të pavarura. Kjo tipologji lejon gjithashtu një hibridizim shumë interesant me “shtëpinë e zjarrit” me dy lartësi. Ky hibrid është i organizuar rreth një oborri qendror dhe hapet në njërin anë ndaj mjedisit përreth përmes çardakut.

Ledian **BREGASI**

NGULIMI DHE NDËRTIMI SIPAS TRADITËS

-Arkitektura bashkëkohore që respekton traditën dhe gabimet e zakonshme që duhen shmangur në projektim dhe ndërtim-

Detyra e vështirë e projektimit dhe gabimet e zakonshme

Detyra e të projektuarit në një kontekst të fortë peizazhi kulturor nuk është e lehtë. Aq më tepër në rastet kur kërkohet respektimi i tipologjive tradicionale, roli i arkitektit fiton një rëndësi të veçantë. Vetëdija e rolit të arkitektit bëhet thelbësore kur përballet me këto zgjedhje të projektit. Shpesh projektuesit, duke pretenduar të ripërdorin tipologjitë historike, bien në gabimin e kopjimit të disa pjesëve sipërfaqësore të ndërtesës, duke humbur arsyet e vërteta prapa tipareve fizike të një shtëpie historike. Pra, jo rrallë, ne vihem përballë organizimeve shumë të përgjithshme të hapësirës, të maskuar nga jashtësi ndërtesë historike. Këto gabime mund të kategorizohen në dy grupe kryesore: organizimi i pavetëdijshëm i hapësirave të ndryshme që nuk shfrytëzon mundësinë për të eksploruar dhe evoluar tipologjitë historike; imitimi i pamjes së jashtme të ndërtesave historike që pa patur lidhje me teknikat historike të ndërtimit, duke ulur rolin e fasadës në një dekorim të thjeshtë.

Marrëdhëniet e ndërsjellta kulturë-peizazh-prodhim hapësinor

Kur i qasemi shprehjes arkitektonike të një territori të caktuar, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet marrëdhënies së ndërsjelltë midis kulturës, peizazhit dhe prodhimit hapësinor. Këto tri aspekte ndikojnë njëra-tjetrën në mënyra që tejkalojnë marrëdhëniet e njëanshme shkak-

pasojë. Në këtë mënyrë, arkitektura vernakulare ndikohet nga kultura e banorëve të një territori dhe kultura ndikohet nga fizikaliteti i peizazhit të të njëjtit territor. Edhe e anasjellta është gjithashtu e vërtetë pasi mënyra se si banohet në një shtëpi ndikon në strukturën e shoqërisë dhe kulturën që shfaqet nga kjo shoqëri. Dhe duke qenë se peizazhi është një interpretim kulturor dhe përfaqësim i veçorive fizike të një territori, ai mund të konsiderohet i ndikuar nga mënyra e banimit të territorit.

Morfologjia e vendbanimeve dhe lidhja me tipologjitë e strehimit

Mund të jetë e dobishme në këtë pikë të përshekruajmë morfologjinë e vendbanimeve dhe lidhjen e saj me tipologjitë e strehimit. Qyteti i Shkodrës është vendbanimi më i madh urban i rajonit. Morfologjia urbane e qytetit është mjaft komplekse dhe është rezultat i arsyeve historike, kulturore, klimatike dhe gjeografike. Në qytet mund të gjenden lagje të ndërtuara gjatë 50 viteve të fundit që ndjekin disa parime të lëvizjeve moderniste dhe funksionaliste në arkitekturë. Në të njëjtën kohë dhe afër këtyre lagjeve mund të gjenden inde urbane të ndërtuara historikisht duke ndjekur parimet e vetorganizimit që rezultojnë në vendbanime organike.

Duke shkuar në veri, terreni bëhet më i thyer dhe toka bujqësore gjithmonë e më e rrallë. Në këto kushte vendbanimet urbane janë më të vogla, më pak të dendura dhe më të shpërndara. Për shkak të këtyre kushteve, morfologjia e këtyre vendbanimeve ndikohet kryesisht nga terreni dhe infrastruktura. Vendbanimet zakonisht zhvillohen përgjatë rrugëve kryesore që depërtojnë në lugina. Këto vendbanime tregojnë karakteristika lineare me mungesë të centraliteteve. Në raste të tjera, vendbanimet zhvillohen në tarraca pas terrenit dhe parcelave të vogla të tokës së punëshme.

Është e rëndësishme të kuptohet që ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis peizazhit, veprimtarive ekonomike në një territor, strukturës shoqërore dhe morfologjisë së vendbanimeve. Terreni i pjerrët i rajonit në veri të qytetit të Shkodrës lejon veprimtari bujqësore në shkallë shumë të vogël, kështu që, historikisht, aktiviteti kryesor ekonomik i këtij rajoni ka qenë i lidhur me blegtorinë. Për këtë arsye, lëvizja sezonale midis kullotave malore gjatë dimrit dhe fushave e kullotave verore, ka qenë një mënyrë e zakonshme e ngulitjes në territor. Aktiviteti ekonomik në shkallë të vogël ndikon edhe në strukturën

historike të familjeve dhe rrjedhimisht në lindjen e vendbanimeve. Blegtorja e gjedhëve, ndryshe nga bujqësia në shkallë të gjerë, nuk lejon zhvillimin e familjeve të mëdha dhe klaneve. Çiftet e reja shpesh ishin të detyruara të shpërnguleshin nga prindërit, duke kërkuar parcela të reja të punueshme toke dhe kullota. Ky model i organizimit ekonomik lejonte vetëm vendbanime në shkallë të vogël, kryesisht pjesë e së njëjtës familje ose fisi të vogël. Këta faktorë kanë ndikuar pa diskutim edhe tipologjitë e strehimit.

Nëse nuk i konsiderojmë vendbanimet përgjatë kreshtave, një fazë e mëvonshme e ngulitjes në territor, veçanërisht në rastet e luginave, janë vendbanimet në krah të kodrës. Pasi territori të eksplorohet dhe kontrollohet përmes kreshtave, një vend më i përshtatshëm mund të zgjidhet për një vendbanim më të madh dhe më të dendur. Vendndodhja në krah të kodrës është zgjedhur për shkak të morfologjisë së terrenit, afërsisë dhe disponueshmërisë së burimeve ujore dhe pranisë e aksesit në tokë bujqësore. Është e zakonshme që në këto raste të kemi një lidhje ortogonale dhe të lashtë të vendbanimit në kodrës me rrugën e kreshtës. Në këtë mënyrë vendbanimi në krah të kodrës i shtrirë në një rrip horizontal, zhvillohet midis fundit të luginës dhe majës së kreshtës. Në këtë pozicion, banorët mund të shmangin afërsinë e drejtpërdrejtë të lumit me rreziqet e paparashikueshmërisë së ujit alpin dhe ligatinave jo të shëndetshme, por ende të jenë afër rrugëve të tregtisë dhe tokës së punueshme. Ashtu si në rastin e luginave të lumenjve Kir dhe Shalë, vendbanimet janë vazhdimisht të vendosura dhe të lidhura në pothuajse të njëjtin nivel midis nivelit të lumit dhe lartësisë së kreshtës. Morfologjia e vendbanimeve të tilla karakterizohet nga rrafshimi i arave të vogla që krijojnë tarraca të organizuara në mënyrë lineare përgjatë rrugës kryesore të cilat mbahen nga mure të thatë guri. Tipologjitë e ndërtesave që gjenden kryesisht në vendbanimin në krah të kodrës janë disa nga më arkaikët. Kulla, shtëpia e zjarrit dhe më rrallë shtëpia me hajat mund të gjenden në vendbanime të tilla edhe pse kullat gjendet më rrallë se në rastet e vendbanimeve në kreshta. Në morfologjinë në krah të kodrës, shtëpia me çardak fillon të dallohet si një tipologji e re banimi. Kjo është një shenjë se dendësia më e lartë e këtyre vendbanimeve dhe përdorimi më efikas i burimeve bujqësore lejojnë fuqizimin e aktiviteteve ekonomike. Në këto kushte, tipologjitë më të përparuara të strehimit fillojnë të shfaqen.

Në këtë këndvështrim, mënyra e përshkimit të territorit sjell pasoja të

drejtpërdrejta në mënyrën e ngulimit dhe kështu me radhë në mënyrën e kultivimit dhe banimit të këtij territori. Peizazhi mund të kuptohet, përshkruhet dhe ruhet duke përshkruar këto seri aktivitetesh që veprojnë në territor.

Peizazhi i rajonit verior të Shkodrës është një entitet kulturor i veçantë që duhet vlerësuar dhe pasuruar me vëmendje të veçantë. Është rezultat i ndërveprimit historik të kushteve gjeografike, agjentëve klimatikë dhe veprimtarisë njerëzore. Marrëdhënia tepër e thjeshtuar shkak-pasojë nuk mund të përdoret për të përshkruar realitetin kompleks të këtij peizazhi kulturor, kështu që çdo ndërhyrje e ardhshme do të duhet të marrë parasysh jo vetëm elementët fizikë, por edhe rrjetin e ndërvarësisë së aktiviteteve që ndodhin në territor. Sidoqoftë, ky peizazh do të duhet të mbrohet, por jo të ngrijë romantikisht në kohë, kështu që nevojiten ndërhyrje të vazhdueshme dhe përmirësime.

Për shkak të gjerësisë së rajonit, përgjithësimet janë të rrezikshme, por në këtë tekst konceptet e peizazhit dhe tipologjisë trajtohen dhe lidhen me kuptimin e tyre më të hapur. Siç përshkruhet më parë, peizazhi kuptohet si një produkt kulturor i bashkëveprimit njerëzor me habitatin. Ashtu edhe tipologjia e ndërtimit është pra jo një plan i ngurtë, por siç e përshkruan Aldo Rossi, një shprehje logjike që qëndron para formës dhe që e përbën atë. Tipologjia kuptohet si arritjet kulturore të një shoqërie të caktuar në organizimin e hapësirës.

Tipologjitë e ndërtesave të zonës mund të konsiderohen pjesë e peizazhit kulturor që duhet të ruhet. Siç u përmend më parë, me tipologji nuk nënkuptohet thjesht pamja e ndërtesës, por ideja organizative që mban në unitet pjesët e ndryshme të arkitekturës. Për këtë arsye, modelet e reja arkitekturore mund të jenë variacione të tipologjive historike shqiptare që mund të kenë interpretime bashkëkohore. Në këtë mënyrë tipologjitë arkitekturore historike mund të jenë baza për shfaqjen e risive të paparashikueshme.

Materialiteti i ndërtimeve

Elementi i dytë që duhet të merret parasysh në ndërhyrjet në të ardhmen është materialiteti i ndërtesave. Materialitet do të quajmë materialet lokale të ndërtimit, si: guri natyror dhe druri, por më e rëndësishmja praninë fizike të arkitekturës dhe praninë e saj ndërmjetësuese mes

territorit dhe banorëve të saj. Një shembull i marrëdhënies tradicionale midis peizazhit kulturor dhe strehimit mund të shihet në luginat e rajonit verior të Shkodrës ku parcelat bujqësore janë prerë nga terreni i pjerrët i luginës duke formuar tarraca. Prania e arave të punueshme, të vogla dhe të sheshta në afërsi të vendbanimeve është një karakteristikë e peizazhit kulturor të zonës. Këto parcela zakonisht gjenden rreth dhjetë metra mbi nivelin e ujit të lumit dhe afër rrugës kryesore lidhëse. Ato janë një prani e vazhdueshme vizuale gjatë udhëtimit nëpër luginë. Këto tarraca mbillen kryesisht me perime e të lashtat, kryesisht misër. Peizazhi nuk është antropizuar vetëm nga horizontaliteti rrafshues i tarracave, por edhe nga teknika e tyre e ndërtimit. Terreni i prerë është i konturuar me mure mbajtëse. Muret janë ndërtuar nga elementi ndërtimor më i bollshëm i pranishëm në kontekst. Blloqet gëlqerore janë përdorur kryesisht në këtë rast. Me forcën e rëndesës, gurët e prerë mund të mbajnë tokën dhe të krijojnë një peizazh të ri. Materiali i gurit përdoret gjithashtu në këtë zonë për ndërtimin e rrethojave të gurta që kufizojnë pronësinë e tokës. Guri, duke qenë materiali i qëndrueshëm i marrë drejtpërdrejt nga konteksti, arrin të ndryshojë dhe bashkojë e peizazhin nga i cili nxirret. Bllokut prej guri do të jetë një nga materialet që do të përdoret vazhdueshëm në ndërtim dhe një nga elementët karakterizues të peizazhit.

Një tjetër material ndërtimi natyror është druri vendas. Në të njëjtën mënyrë që guri përdoret për të mbajtur terrenin dhe për të përcaktuar kufijtë e pronave, degë të vogla pemësh e thupra gërshetohen për krijimin e strukturave dhe mureve mbështetëse. Degët e gërshetuara që krijojnë gardhe e porta, të shoqëruara me strukturat prej guri janë përdorur gjerësisht për kontrollin dhe modifikimin e natyrës. Peizazhi kështu i formuar rezulton si një rikombinim i materialeve natyrore, të nxjerra, të punuara dhe të kombinuara nga shtresimi historik i kulturës njerëzore. Në këtë mënyrë, peizazhi bëhet terren i përbashkët dhe dëshmi historike e bashkëveprimit të forcave natyrore dhe antropike.

Si përfundim, dhënia e vëmendjes së duhur lidhjes midis kontekstit fizik dhe tipologjisë së ndërtesës, si dhe kujdesi mbi potencialet shprehëse të materialitetit që rrjedhin nga teknikat e ndërtimit do të shmangë kopjen e thjeshtë, duke lejuar zhvillimin e mëtejshëm të tipologjive historike të strehimit.

▪ Letërsi ▪

**Shkodra si frymëzim poetik në poezinë e Shirokës,
Koliqit, Pipës dhe Camajt**

Filip **SHIROKA**

SHKO DALLËNDRYSHË!...

*Tu vedrai lontane arene
Nuovi monti e nuovi mari,
Salutando in tua favela,
Pellegrina rondinella.*

T. Grossi¹

Udha e mbarë, se erdh prendvera,
shko dallëndryshë tue fluturue,
prej Misirit n'dhena tjera
fusha e male tue kërkue;
n'Shqypni shko, pra, fluturim,
shko në Shkodër, n'gjytet tim!

¹ Ti do të shohësh të largëtat ranishte,
Male të rinj dhe të rejtat dete,
Në përshëndetjen tënde përrallore,
Mërgimtare dallëndyshe.

(Si në këtë rast, dhe më poshtë, të gjitha fragmentet nga autorë të huaj janë dhënë në shqip në një përkthim të lirë nga Skënder Vila).

Shndet prej mejet të m'i falesh
saj' shpis' vjetër ku jam le,
me ato vende rreth t'përfalesh
ku kam shkue kohën e re;
atje shko, pra, fluturim,
fal me shndet gjytetit tim!

Shko n'at shkollën ku jam msue
Me shokë t'mi, shokt e fmnisë,
Shko n'at Kishë ku kam urue
T'parën Uratë Perendisë,
atje shko, pra fluturim
fal me shndet gjytetit tim!

Me ato male, me ato kodra,
Me ato pronje rreth t'përfalesh;
N'ato fusha qi m'ka Shkodra,
të lulzue, aty t'ndalesh,
tue këndue me ambëlçim:
fal me shndet gjytetin tim!

T'mujshë edh' un me fluturue,
dojsh' edhe un me u nisë me ty,
dojshë n'Shkodër me kalue,
m'e pa prap at vend me sy!...
Por... ti shko atje flutrim
e ti qajma fatin tim!...

Dhe kur t' mrrish në Fushë t' Rrmajit,²
dallndyshë ulu me pushue;
kam dy vorre n'at vend t' vajit,
t'nans e t'babs qi m'kan mjerue:
qaj me za t'përmallshëm shqim
nji kangë tanden gjith vajtim!...

Ka shum kohë qi s'jam n'Shqypni
n'ato vorre me vajtue,
ti dallndryshë, veshun në zi,
ti aty pra qaj për mue,
me nj'at za t'përmallshëm shqim,
kangën tande për vajtim!

1898

² Në Shkodër, në Fushë të Rmajit, janë vorret e Latinve (shënim i autorit)

MALEVE TË SHKODRËS

*Combien j'ai douce souvenance
Du joli lieu de ma naissance!*

Chateaubriand³

Gjithherë n' mend u kam, malet e dashtnue,
e zemra e ime n' dhena t' hueja keq lengon;
tridhetë vjet të gjata, o male, kam kalue,
tridhetë vjet qi zemra e ime po u dishron!

Po, gjithherë u kujtoj!... N' at kohë kur predojnë
hyjt, edhe kur dielli malet i praron!
'Dhe kur zogjt nër gema t' lisave këndojnë
kangen aq t' bukur, qi na përmallon!...

Po, gjithherë u kujtoj!... Me u sosë kur t' jet nisun
dita, dhe kur dielli mbas malit kalon;
kur hana e bukur, si nuse e stolisun,
del, e me dritë t' sajën Shkodrën e zbardhon!...

Oh! gjithherë u kujtoj!... Kur nisë me dalë vera,
Mal' e çuka e kodra kand e kand lulzon,
kur vjen vapa e gushtit edhe kur at hera
vjen vjeshta e bekueme qi me pemë na gzon!...

³ Sa kujtim të ambël kam /Nga e bukura vendlindja ime!

Po, gjithherë u kujtoj!... Dimni kur afrohet,
e kur n'votër teme zjarrmi flakuron;
tham: n'Shkodër me borë tash mal e kodër mblohet,
fryjnë me duhi ernat e uji akullon!...

Dhe natën kur bota n'gjumë asht tue pushue,
Shkoj me fjetë, por mendja atje fluturon;
Se n'andërr u shof, o vendet e dashtnue,
E prej mallit zemra e ime gjak loton!...

1922

Ernest **KOLIQI**

SHKODRA NË PRILL

O Shkodër, do t'jësh âmbël tue lulzue
nên drit t'prendver's qi derdhet mbi heshtije
t'lulishtave ku gjetht lshojn' pak sa hije
e lulivilja porsa nis' me ersue.

Kush endet nëpër qytet, tue u përshkue
N'vetmín e érshme t'udhave do t'ndije
Vajzat kah kndojn' mbas mureve n'kopshtije
tash qi n'gjergjef jasht' dalin me punue.

Nji qoshe kopshti dij ku gjithmonë ulet
t'qindis 'i vazj' nën një bajam e lulet
i bien mbi pun'sa her' qi fladi i lot.

E tue shkund' kryet prej fletzave nga 'i here
përgjon mos rreh një dorë e njohun n'derë...
por hesht gjithkrah prendvera e ajo prët kot!

SHKODRA NË MËNGJES

Këndojn' sbashku n'mëngjes pes' kumbonare,
këndojn' n'ajrí mbi Shkodër ende fjetë:
mbi Maranaj qet vetllen kureshtare
agimi e hjedh n'liqê sýnin e qetë.

Përhap' lajmin e zgjimit rrezja e pare e
t'parat përshndetje dridhen n'heshtí t'letë,
e shpjet n'at lavdí dielli, qi e vesh' fare,
Shkodra kumbon me zâne, zhurmë e jetë.

E ai diell prendvere i rí shprazet n'shtëpija,
Udha e lulishta, tue ngjall' ngjyra e shkndija,
tue mbshtjell' gjithshka si një tis ari, i hollë:

skâj në skâj si lum gzimi tue rrëshqitë
n'sýt e vashave qeshë, e mbush' me dritë
kaçurrelat e tyne kur shkojn' n'shkollë.

SHKODRA NË ZHEG

E zhegu jetën vjen edh'e shafitë
e krejt qyteti disi kalamendet;
heshtin pirajkat, heshtin avlimendet,
e n'at heshtí mbretnon e bardha dritë.

Veç ndonji çekerker pusi tue kërsitë
ndëgjohet hove hove e 'i hap qi endet
vetmitar n'zheg, msa flêjn' njerzit e sendet,
edhe kadalkadal' vjen tu' u avitë.

Oh, shqetija fmijnore, n'mosh' t'prarueme!
Nana na vête n'zheg, né fmijt, me fjetë
Për t'i dhân' me gjum' t'on', pak pushim shpís...

Por na sa ndiejshim ngjat at hap, n'të shtrueme
s'na zênte vendi: rrijshim t'paqetë,
pse at hap e ndiqte britma e hallvaxhís!

SHKODRA NË MBRÂMJE

Sa âmbël n' mbrâmje shqimet drita e diellit
qi bie kadalkadalë andej kah Ana
e Malit tue lân mbrapa ngjyrat t' tâna:
zambakë ar vjollza e fletza drandofillit.

E n' at zjarrm lulesh, ndez' ndër skâje t' qiellit
vizaton Rozafati gurt vigâna,
e nëpër hyj qi kallën n' qiellt e gjaâna
del si vetull hyjneshe hâna e prillit.

Prej Maranajt zbret nata (nga erdh dita)
Për me fik' ngjyrat qi pat falun drita.
E Shkodra n' hije pak nga pak, qe, humë.

Minaret përmbi têt, t' bardha n' ajrî,
Sogje qiellore duken qi e ruejn' n' gjumë
Kur flên nên hyj qi ai mblojn' qiellt unjî.

NATË SHKODRANE

Por n' mes të prillit plot me kângë â nata
e nëpër Shkodër mbar' derdhet hareja
prendverore e n'lulishta t'rij e t'reja
shregullash lozin tue kndue valle t'gjata.

(Për tý m'merr malli, vash', qi fatin pata
n'shregull me lkund' e m'thae, tu' u dá: "Prap eja!"
por s't'erdha e mâ s'të pash... Larg nga atdheja
s'mund t'vij as në kët prill, plot me krajata...).

Kur afër dritet shpërdahet shoqnija
e s'kndon mâ kush pse lodh' jan' t'tân' prej gzimit,
a dridhet vetëm udh's t'fshâmt e qemaleve?

Ambël mbas qejfit kuj kthen lodh' ke shpija
sýt e përgjumshëm ia puth drita e agimit
qi si vllâ lilash çelet maje maleve!

Arshi **PIPA**

SHKODRA

O Shkodër, prallë e lashtë e pakufishme,
ku fiken shekujt tue t'këndue te djepi,
mandej te vorri, kangen e lavdishme
perandore të shojtun heu sa shkrepri!

Kur delshin nga liqeni i qartë anizat
t'lehta porsì nga çerdhja zogjt e ujit!
Valvitej flamuri mbi t'arta shtizat
e larg pushteti i yt i shkodte t'huejtit!

O nanë ilire! Hyjnore si Zane
ujnash ishte Rozafa atherë kur gjîn
muroi pa shum ankime përmbi kodër!

E qumshti e gjaku përnjiheri rinë
themelet e tua! për lumnin, o Shkodër
e kshtjellit ngrehun mbi një zëmër nane!

II

O vala e Drinit, ti madhnin tregona
t'asaj qi Zojë qe mbi shoqet e smira,
tregò sa gjaku i ngjei valat e dlira
ndër luftat e pareshtuna e sa frona

mbretënsh u-rrokullisën nga dëshira
t'falisuna kur deshtën trojet tona
me prekun e qortueshëm brodh jehona
anash gjith dheut prej malevet të lira!

Prej gjinit t'Ohrit ku Sentona kishte
banesat e nënujshme e te liqeni
tjetër ku Galateja erdh nga Heleni

djepin për me i kërkue Yllit ferishte,
prej lugjevet t'Metojës ku e amshueme
rrin bora e i ep ushqim lumit binjak,

o Drin, ndër valat tua brohorija
e mbarë një fisi ndalej kur lavdija
shkëlqei te Rozafati përmi prak!

III

Ma vonë ma vonë t' u-turbullue ty uji,
kur vala e jote bajti lundra t'reja,
kur përmbi altarin e atdheut i hueji
dhunoi nën thëmër çka shëjtne pat beja.

O vaj! E kot kunorë, o Shkodër, t'hishme
t'endin ty malet kur jetim asht djepi
qi pat përkundun fatet e lavdishme
kur çveshun gjethsh asht lari i yt plepi!

E sot, sot çka teproi nga fara e moçme?
Sot koha jote e meritueshme asht nata:
mundesh me qá pa droje se korite!

Për ty vajton liqeni e Buena e ngrata
e ledhet e tua, o Shkodër, vorret e tua,
shpoti e hidhun e namit t'nji dite!

Martin **CAMAJ**

ATY SI TASH PARA SE ME ARDHË FISET

Aty si tash para se me ardhë fiset ishe
me tambël në plasaritjen e currave
e me themele në ujin e njelmë.
Të dhanë vetëm një emën: Shkodra.
E të thirrën qytet me kunora
e të hodhën përkrye gur e hekurat e para.

U zgjove e përgjakun sa herë
e u kqyre në pasqyrën tande.
Me emën grueje u lave ndër ujna
t'lumejve dhe ndeje me petka të reja
në shkamb
e ndritun ballë diellit mbi fusha.

▪ Kritikë letrare ▪

Andreas DUSHI

**TË JESH I HUMBUR, FATI I PERSONAZHIT SHQIPTAR
TË TRANZICIONIT**

Fati i letërsisë shqipe pas vitit 1990 që përkon me rënien e sistemit komunist, ishte tejet i paqartë. Ngjante sikur udhët po ngatërroheshin duke bashkuar realizmin e domosdoshëm si të vetmen mënyrë që një pjesë e shkrimtarëve njihnin me ikjet e skajshme prej tij si dëshirë për të luftuar artistikisht sistemin, shpesh pa ndjekur ndonjë stil të qëndrueshëm.

Një ndër ata që *dëshmuuan se ishte e mundshme të kapërcehej gjendja e krizës së romanit shqiptar pas rënies së realizmit socialist*¹ ishte edhe shkrimtari Fatos Kongoli. Në këtë shkrim, do të analizojmë shkurtimisht një ndër veprat e tij më të njohura, të parën të botuar pas rënies së regjimit komunist, romanin *I humburi*.

Fatos Kongoli

I lindur më 1944 në Elbasan, Fatos Kongoli studioi për matematikë pjesërisht në Pekin dhe pjesën tjetër, në Tiranë. Thuajse gjithë jetën punoi si gazetar letrar dhe redaktor në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”. Pas rënies së realizmit socialist, në programet shkollore deri në vitin 2018, studiohej përkrah Ismail Kadarese, si shkrimtari i dytë më i përkthyer dhe përfaqësues i letërsisë moderne shqipe². Ka fituar një sërë çmimesh,

¹ Dr. Arben Prendi. *Letërsi shqipe bashkëkohore*. Fiorentia, fq. 120.

² Deri në vitin 2018, nxënësit e gjimnazeve profilizoheshin sipas një lënde në të cilën thelloheshin. Lënda “Letërsi e thelluar” në vitin III trajtonte Ismail Kadarenë dhe

brenda dhe jashtë vendit si dhe ka botuar me dhjetra romane, së fundmi edhe romanin “Gënjeshtarët e vegjël”.

Para pak vitesh pësoi një traumë shëndetësore, nga e cila u ringrit duke e quajtur veten si të ringjallur. Herë pas here, ai është i pranishëm në media me mendime rreth temave të ndryshme, sidomos ato që lidhen me letërsinë dhe shoqërinë e tranzicionit.

Leximet e romanit “I humburi”

Romani “I humburi” shtjellon raportin e njeriut me tranzicionin. Ky shtjellim vishet me tisin e hollë të mungesës së vetëbesimit, nxitur nga faktorë të jashtëm që mbrojnë personazhin kyresor të romanit, emri i të cilit jepet, por edhe sikur të mos jepej, asgjë nuk do të ndryshonte në fabulën, subjektin dhe linjën rrëfimore të tij.

Thesar Lumi, personazhi thujse *anonim* i romanit përfaqëson raportin e dy botëve të njeriut dhe mënyrën se si ato lidhen njëra me tjetrën.

Në leximin horizontal të veprës, vëmë re pasqyrimin e shoqërisë shqiptare para dhe gjatë tranzicionit: Romani ‘I humburi’ është një pasqyrë e qartë dhe tronditëse e jetës së shoqërisë shqiptare në regjimin autoritar, tiranik, e deri edhe jonjerëzor në Shqipërinë komuniste. Më shumë se një tregim për një shoqëri të caktuar, ky rrëfim ilustron se si funksionon një shoqëri e cila ekzistencën e saj e bazon në frikë dhe bindje, një analizë e tillë vlen për të gjitha kohërat e për të gjitha shoqëritë.

Pushteti dhe mekanizmat e tij janë të pranishëm në një formë apo në një tjetër, herë më të drejtpërdrejtë, e herë i fshehur nëpërmjet mekanizmave mbrojtës. Në leximin vertikal të veprës, shohim heroin “e ri” në romanin shqiptar. Nëse deri në vitet ’90 kishim heronj me armë, punëtorë të dalluar apo ndihmues të regjimit, tani “I humburi” *bën personazh njeriun e skajuar, të persekutuar, të dhunuar, njeriun e dobët që nëpërballje me dhunën e shtetit thyhet dhe bie në dëshpërim, në vaakum, dhe jepet sistematikisht pas pijes dhe meditimit, për ta mbytur sadopak këtë dëshpërim dhe ankth prej të cilit nuk arrin të shpëtojë*³.

Fatos Kongolin si dy përfaqësuesit e letërsisë moderne shqipe.

³ Dr. Arben Prendi, *Letërsi shqipe bashkëkohore*, Fiorentia, f. 124.

Sigurisht, kjo ndarje leximesh bëhet vetëm për efekt studimor, pasi një lexues i kulturuar të dy *tipet* e leximeve i ka të njëkohshme...

Humbja

Sikurse e vërejtëm që në krye të herës, udha ku heroi kthehet në *të humbur* fillon me humbjen e vetëbesimit. Shkërmoqja e imazhit të babait, shtyllës në të cilën ai mendonte se do të mund të mbështetej gjithnjë, është *dinamiti* që hedh në erë vetëbesimin e tij:

“Të nesërmen, ai më shoqëroi për në zyrën e drejtorit. Ta dija se do t’i përulej në atëmënyrë, nuk do t’i kisha treguar asgjë. Do të kisha pranuar të rrihesha dhjetë herë në ditë, vetëm për të mos e parë në sytë e tim eti frikën”⁴.

Fillimi i dhunës së vazhdueshme, bashkë me humbjen e besimit në *busullën* në të cilën kishte vendosur shpresat, hedhin themelet ku ngrihen bazat e *së ardhmes* brenda kontureve të romanit e cila jashtë tyre, kthehet në të shkuar.

Pastaj, gjithçka duket sikur ndjek një vijë të përpiktë në plotësimin e rrethit vicioz të absurdit: 1. Sari do të hakmerret pasi Xhoda (drejtori) e dhunon, ndaj helmon qenin e vajzës së Xhodës të quajtur Vilma; 2. zbulon se është i përndjekur, ngaqë ka dikë të arratisur; 3. e ndajnë nga miku i tij më i mirë pasi atë e internojnë bashkë me familje; 4. historia e vetme e dashurisë, ajo me Sonjën, ndërpritet; 5. miqësia me Vilmën duket sikur “rikthehet”, por edhe ajo ndërpritet dhunshëm pasi që kjo e fundit, pas përdhunimit nga Fagu, vetëvritet.

Pra, në një moment, duket sikur gjithçka do të shkojë mirë, deri kur ngjarjet pësojnë një thyerje duke formuar parabola me kulm në absurd dhe shtrirje horizontale e vertikale në realitet.

Në fund të rrëfimit, simbolika e varrit është shumë domethënëse dhe e fuqishme. Vendi i parë që viziton Thesar Lumi pas vendimit për të mos u larguar në Itali, janë varrezat. E ç’ kuptim ka të ikësh në një vend tjetër, qoftë ai edhe vendi më i zhvilluar, kur në fund do të përfundosh me një gur mbi kokë. Varret janë të njëjta kudo, si në Itali dhe Shqipëri. Ata që largohen, janë ata që nuk e kanë kuptuar se janë të vdekshëm. Ata sillen me jetën sikur të jenë të përjetshëm. Ata mund të ndryshojnë vetëm vendin ku jetojnë, por jo edhe raportin e tyre me shoqërinë dhe

⁴ Fatos Kongoli, I humburi, Dituria, f.12.

autoritetin. Ata nuk do jenë të lirë, as në vendin fqinj. Liria e tyre do të jetë vetëm fizike. Varri është simboli i kotësisë së jetës, varri është pamundësia e njeriut për të menduar për të jetuarit. □do përpjekje e bashkëvendasve të Thesar Lumit për të kapur lirinë përballë varrit, e humb kuptimin.⁵

“Humbja” dhe “përhumbja” e personazhit kryesor është e motivuar aq sa tingëllon e besueshme se secili person që kalon nëpër një përvojë të tillë jetësore, ku njeriu pengohet në çdo hap të realizimit të tij si qenie, ku ai vetë, miqtë, të dashurit, të dashurat, bien sistematikisht viktimë e dhunës që prodhon situata sociale ideologjike e regjimit, nuk mund të jetë ndryshe vetëm një “i humbur”, i thyer në thelbin e tij shpirtëror dhe psikik⁶.

Rrëfimi

“Kur vura re praninë e Sonjës, më ndodhi diçka e ngjashme me atë që i ndodh njënjeriu, i cili ka qëndruar gjatë në errësi në një mjedis të panjohur dhe befas hapen dritat”⁷. Personazhi kryesor rrëfen në vetë të parë. Fati i tij është praktikisht, fati i shumë bashkëkombësve të tij, ndaj gjithkush që lexon tekstin e romanit, në mos në një pjesë, në një tjetër, medoemos gjen veten apo dikë që njeh. Shpesh, rrëfimi letrar, ngjan si lexim që autori i bën lexuesit, ndaj vepra merr karakter *universal*.

Nisur nga rëndësia kompozicionale dhe kuptimore që ka personazhi, pozicionimi i rrëfimit në vetë të parë, që çon drejt monologut, mund të themi se në fakt është një roman i personazhit kryesor.

Përshkrimi dhe portretizimi i personazheve është i detajuar dhe bëhet për secilin prej tyre, madje vijon të ruhet skema ku personazhi kryesor është në qendër dhe të tjerët rrotull tij, edhe për shkak se ai vetë tregon historinë e jetës së tij, duke e portretizuar vetë veten⁸.

“Ajo ka qenë mbrëmja jonë e fundit. Asnjëherë më pas nuk u bëmë të tre. Ka qenë edhe mbrëmja e fundit që fjeta me Sonjën. Thuhet se po ta dijë njeriu çastin e vdekjes, e hap varrin me duart e veta. As Ladi, as Sonja nuk e dinin ç’i priste. Për këtë jam i sigurt. Ata mund ta dinin ç’i

⁵ Ardiana Batusha, “I humburi: Rrëfim mbi një të çmendur”, “Virtual Sophist”, 22.02.2017.

⁶ Dr. Arben Prendi, *Letërsi shqipe bashkëkohore*, Fiorentia, f. 125.

⁷ Fatos Kongoli, *I humburi*, Dituria, fq. 55.

⁸ Dr. Arben Prendi, *Letërsi shqipe bashkëkohore*, Fiorentia, f. 122.

priste, aq sa ç'mund ta dija unë se ajo ishte mbrëmja jonë e fundit dhe se atë natë do të flija me Sonjën për herë të fundit"⁹.

Në fillim, *i humburi* dëshiron të jetë gjithnjë në qendër pasi që humbjen e vetëbesimit e kthen në egoizëm. Kur kupton mosekzistencën e mundësisë për t'u vetërealizuar, është indiferent karshi çdo gjëje dhe me një qetësi gati prej të marri, e lë jetën t'i rrjedhë si ujë përroi mespërmes gishtave.

Koha

Në vepër, përveç *digresionit tematik*, vëmë re edhe një *digresion kohor*. Vepra fillon në të tashmen, ku merret një vendim për të mos u larguar, por arsyeja përse ky vendim merret, duhet kërkuar në të shkuarën. Prandaj, me një lloj *turieles*, autori futet thellë brenda personazhit, arrin deri në atë kohë kur ky i fundit ishte fëmijë dhe që aty, mbivendos shtresa rrëfimore të prirura drejt së tashmes. Pra, jeta e Thesar Lumit fillon të rrëfhet në vegjëli me zhgënjimin e parë dhe merr fund në maturi, me zhgënjimin e pafund.

E kaluara është dominuese në tetëmbëdhjetë kapituj, ndërsa e tashmja në pesë kapituj, pra

është vetëm momenti për të reflektuar mbi të kaluarën. E tashmja përcaktohet herë pashere si: "Mars 1991", ndërsa e kaluara përfshin afërsisht gjithë jetën afro dyzet vjeçare të personazhit kryesor, të jetuar nën regjimin komunist¹⁰.

Letërsia dhe realiteti

Vepra në fjalë është një rrëfim i tipit *realist*, i qetë, i shtruar, që i bindet logjikës dhe kronologjisë së veprimit¹¹ 14 e cila mbart refleksione komplekse mbi jetën e individit dhe shoqërisë shqiptare në dy kohë. Karakterizimi i jetës së Thesar Lumit nga zhgënjimet dhe pamundësia e realizimit ndërthuret me situatën e panjohur të tranzicionit duke e çuar njeriun shqiptar në hone labirintesh, pa rrugëdalje. Ndaj, nëse periudhën për të cilën flet vepra e marrim në *kontekst romanor* me personazhe shqiptarët, *i humburi Thesar Lumi* do të ishte përfaqësuesi më i denjë i tyre.

⁹ Fatos Kongoli, *I humburi*, Dituria, f. 89.

¹⁰ Dr. Arben Prendi, *Letërsi shqipe bashkëkohore*, Fiorentia, f. 122

¹¹ Po aty

Arben PRENDI

“BOTËT E SHMANGURA” NË NOVELAT E M. CAMAJT

Në të gjithë veprën letrare të M. Camajt, bota shqiptare është temë thelbësore. E tillë shfaqet edhe tek tregimi e novela. Duke përballur kujtimet dhe imazhet nga vendlindja e traditave të vjetra zakonore e morale, prej nga është larguar, me botën e qyteteve moderne evropiane ku jeton, autori realizon rrëfime artistike të cilat komunikojnë në sajë të ndërthurjeve komplekse mes asaj çka ka mbledhur nga realitetet njerëzore dhe saj çka projektton artistikisht.

Objekt i këtij teksti është shqyrtimi i këtyre ndërthurjeve në novelat: “Pishtarët e natës”, “Shkundullima”, “Rrunggaja në mars”, “Katundi me gjuhë të fshehtë”, “Gjon Gazulli”.

Viset e Shqipërisë së Veriut dhe arbëreshët e Italisë

Novelat: “Pishtarët e natës”, “Shkundullima”, “Rrunggaja në mars”, “Katundi me gjuhë të fshehtë”, “Gjon Gazulli”, u botuan në vëllimin me proza “Shkundullima”, në Romë në vitin 1981. Siç shprehet autori në këmishën e botimit: *“Këto proza paraqesin dy ambiente: i pari lidhet me atmosferën e disa viseve të Shqipnisë së Veriut ku thellësia e bjeshkëve ndahet nga qafa malesh prej fushave të gjana; ndërsa në copat “Shkundullima” dhe “Katundi me gjuhë të fshehtë” pasqyrohen brigjet bregdetare të Italisë së Jugut, treva ku jetojnë arbëreshët e lashtë. Edhe “Gjon Gazulli” anon nga ky ambient. Ngjyra të përbashkëta janë kataklizmat natyrore si shkundullima (tërmeti), rrunggaja apo rrëzuemja*

e borës që trandin një vend, ashtu si dhe vdekja ose prania e saj: mbarë këto dukuni i ndërrojnë faqe dheut e shoqnisë". Sikurse edhe në poezi edhe në këto proza të Camajt gjejmë temën e përhershme të Shqipërisë dhe shqiptarit, madje të dy skajeve të saj, që janë në shekuj vatra të ndezura të lashtësisë së kombit: malësitë e thella e të pakalueshme të Veriut dhe vendbanimi i ri i arbëreshëve, të mërguar për shkak të pushtimit osman, nga Mesjeta, në Italinë e Jugut. Baroni Franc Nopça sheh tek malësorët e Veriut shqiptarët origjinalë të cilët të paktën nga Mesjeta, për shkak të pushtimit osman u detyruan të shtyhen thellë e më thellë nëpër luginat malore të cilat ishin të pakalueshme për pushtuesin. Por siç shprehet me të drejtë studiuesi Sh. Sinani, Camaj e ka zëvendësuar Shqipërinë me vendlindjen, zgjodhi të merrej me atdheun duke iu referuar vazhdimisht pjesës për të tërën, vendlindjes për Shqipërinë, një metonimi krejt origjinale¹. Atë çfarë mbetet e kërkon pastaj tek një botë tjetër po aq e panjohur, bota e arbëreshëve të vendosur, që pas vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, apo edhe në prag të pushtimit osman, në Italinë e Jugut.

Obsesion i Camajt është malësori i Veriut, jeta e tij e veçuar nga bota, në një gjendje parake deri edhe primitive, por të paprekur nga zhvillimi urban; parake e primitive por origjinale dhe e sinqertë e painfektuar nga hipokrizia dhe teknologjia. Me siguri ky obsesion lidhet me fëmijërinë dhe rininë e autorit, të kaluara në territore të këtilla ku legjendat ishin temë e zakonshme e bisedave të përditshme. Referenca me historinë është periferike dhe e parëndësishme. Siç vëren studiuesi Sh. Sinani: "Zbulimi i botëve të panjohura, i ishujve të etnikumit tradicional, i vendlindjes ende të paprekur prej zhvillimeve moderne, është qëllim parësor në veprën e Camajt. Botët e shmangura janë qëllim i Camajt edhe kur shkruan për arbëreshët apo për Gazullët e kohës humaniste. Ai përpiqet të zbulojë njeriun e vjetër shqiptar, përkundër njeriut të ri që kërkonte letërsia e realizmit socialist, por pa bërë polemika historiko-letrare me askënd"². Pra "botët e shmangura" janë malësitë e thella të Veriut dhe ato të arbëreshëve të vendosur në Itali prej pesë shekujsh. Këto botë janë dëshmia e fundit e Shqipërisë (Arbërisë) së vjetër dhe për çudi atje jeta vijon duke lënë anash Shqipërinë e re dhe krejtësisht pa lidhje me të. Por në këto botë të shmangura ruhet ende identiteti

¹ Sinani, Sh. "Në kërkim të rrënjëve të të parëve", Camaj, M. Vepra, vëllimi i tretë. Onufri 2010, f. 11.

² Sinani, Sh. "Në kërkim të rrënjëve të të parëve", Camaj, M. Vepra, vëllimi i tretë. Onufri 2010, f. 11.

i shqiptarit të përjetshëm që nuk e thyen as rrungajat e jetës, natyra e ashpër, pushtimet dhe as ideologjitë. Të jetë mungesa e atdheut në të tashmen që e shtyn autorin në të kaluarën e kujtimeve, por edhe të tregimeve gojore të përcjella brez pas brezi bashkë me traditën tjetër gojore?! Edhe kështu mund të ketë ndodhur. Sikurse edhe në veprën poetike edhe tek novelat autori ringjall kohët mitike, atdheun e vjetër dhe shmang atdheun socialist të bashkëkohësisë, me të cilin nuk ka asnjë marrëdhënie përveç literaturës që vjen prej tij.

Jeta në fqinjësi me qeniet mitologjike dhe anash qytetërimit modern

Kështu tek proza “Pishtarët e natës” kemi disa skena të jetës së hershme deri parake, por origjinale nga jeta e dikurshme e malësive të thella ku njeriu jeton i rrethuar nga malet dhe sheh vetëm kupën e qiellës dhe e ndien veten si bisha e egër, përballë malit e pyllit ku banojnë qenie mitike si orët e zanat. Nika, personazhi kryesor, ndahet nga vëllezërit e tij me të cilët grindej pa shkak, pastaj edhe nga familja e tij, për të jetuar më vete në një kasolle në fund të luginës, të quajtur Fundinë, ku e siguron vetëm jetesën për vete e për familjen, në një dimension ahistorik dhe të pakohë. Ai kërkon dhe gjen një botë të vetën prej njeriu vetmitar në përballje me natyrën e ashpër dhe me kontakte të pakta me njerëzit e tjerë. Dhe nuk i shkon kurrë mendja të ikë nga *mbretëria* e vet, ku jeta fitohet duke luftuar pa pushim me natyrën e egër. Të jetuarit në luginën e ashpër malore ai e konsideron si fatin e tij të jetës, të cilit nuk sheh asnjë arsye t’i shmanget.

Motivi i gjuetisë së ndaluar

Tregimi për travajet e jetës së Nikës takohet në disa motive me këngën popullore legjendare: “Mbet një nanë me di jetima”. Motivin e grindjes mes vëllezërve dhe atë të gjuetisë së ndaluar, e gjejmë në të dy krijimet. Në këngën popullore vëllezërit megjithëse e ama i ka porositur të mos shkojnë për gjueti në mal, sepse babai i tyre kishte shkuar dhe nuk ishte kthyer, ata nuk e përfillin këshillën e saj dhe pasi ndeshin në Zanën e bukur që u shfaqet në formën e një nuseje të bukur,

grinden se cili do ta marrë për vete dhe njëri vret tjetrin dhe më pas edhe veten. (Motivi i grindjes mes vëllezërve dhe xhelozisë e kemi edhe në Bibël, Dhjata e Vjetër. Kaini për shkak të xhelozisë ndaj Abelit që ka të gjithë vëmendjen e prindërve, e vret atë). Ndërsa në këtë rrëfim Nika mendonte se vëllezërit i bënin gjithmonë padrejtësi dhe vdes në vetmi i kënaqur se e kishte realizuar qëllimin e jetës së tij: kultivimin e Fundinës, tokës së egër dhe blerjen e tokës tjetër që u lë trashëgim djemve të tij. Ai ikën nga vëllezërit, madje edhe nga familja e tij dhe ia kushton kohën dhe forcat kultivimit të një toke të egër duke jetuar i vetëm në një kasolle, larg shtëpisë. Ai shkon duke humbur aftësinë e të komunikuarit me të tjerët madje mendon se ata vetëm duan ta pengojnë me bisedat e tyre. Ai nuk i vret vëllezërit e tij biologjikë por vret kafshët e gjallesat e egra që përkon me motivin e gjuetisë së ndaluar në këngën popullore. Madje tek ai është i rrënjësuar besimi se vdekja do t'i vijë nga qeniet mitike që mbrojnë natyrën e egër.

“Vllamëria” me botën e egër

Motivi i gjuetisë së ndaluar, del edhe këtu si shenjë e botës parake. Nika, malësori kreshnik e vetmitar thuhet se ka punë me Orë e Zana, ka vrarë kaq shumë shpendë dhe kafshë, me të cilët është në një farë mënyre i “vllaznuem”, saqë vdekja sipas besimit të lashtë do t'i vijë si ndëshkim për këtë: “si gjuemja e vetimës për së kthjelltit apo humbja në bjeshkë pa shej, pa dukë”.³ Në mal gjaku i Nikës përziehej me gjakun e kafshëve të vrara, të cilat përpiqeshin të shpëtonin nga kurthat: “Përziemja e gjakut të vet me atë të egërsinës i kujtonte vëllamjen, doken e vjetër simbas të cilës dy vetje, përmes gjakut të përziem në venë që e pinin mandej, vllaznoheshin përjetë. Ai që e vret vëllathin, gjakun e vet, kryen, simbas dokes, dhunën ma të madhe të botës!”⁴.

Imazhet që ringjall autori i përkasin një bote parake, pagane, sepse vërtetë shenjohej koha përmes përmendjes së turkut që sundon në fusha prej pesëqind vjetësh por nuk përmendet asnjëherë Zoti si fuqi supreme, as prifti dhe asnjë element nga feja e krishterë. Edhe atëherë kur flitet për disa fetarë që vijnë në luginë për të përcjellë të vdekurit, tregohet si për diçka të parëndësishme. Përkundrazi mbizotëron botëkuptimi

³ Camaj, M. Vepra, vëllimi i tretë. Onufri 2010, f. 97.

⁴ F. 96.

mitologjik, me besime në Orë, Zana, Shtojzovalle, shpirtën femnorë, deri edhe me përmendjen e një Zoti të erës, apo të figurës së katallanit me një sy që jeton në shpellë me një grua të grabitur me dhunë. Vetë personazhi kryesor vuan nga brenga se të qenit gjuetar nuk miratohet prej zotave dhe qenieve mitike të luginës dhe se ato një ditë do të hakmerren ndaj tij. Madje edhe kur pranë kasolles së tij nuk kalojnë më as udhëtarët që kanë humbur rrugën atë e mundon bestytia se ndoshta në kafshët dhe shpendët që ka vvarë asaj stine mund të ketë qenë edhe shpirti i ndonjë udhëtari që kishte vdekur rrugëhumbur në mal. “... a mos ishte fshehtë mbrenda atyne shpendëve fryma e ndonjë udhëtari që kishte lanë jetën, i humbun në bjeshkë? E ndiente veten fajtor si t’i kishte vra ata njerëz me dorë të vet”⁵.

Është i njëjti mentalitet mitik i hasur në këngën legjendare të vëllavrasjes: “Met ni nanë me dy jetima”; gjuetia e ndaluar në vendin e ndaluar ndëshkohet me vdekje. Madje edhe këtu kemi elemente të vëllavrasjes: Nika e konsideron përzierjen e gjakut të tij me atë të bishave të egra si pasojë e gjakosjeve dhe gërvishtjeve prej kthetrave të tyre si “vëllamëri”, ritual i vllazërimit të dy personave përmes pirjes së gjakut. Pra, vrasjet e kafshëve të egra për mentalitetin mitik janë vrasje të “vëllezërve” të vet. Nika vdes duke përjetuar një brengë ku mbizotëron vrasja e ndërgjegjes, por edhe frika nga ndëshkimi prej qenieve mitologjike që mbrojnë natyrën dhe kafshët e egra. Me lëkurët e çmuara të këtyre kafshëve ai ka fituar monedha ari me të cilat blen toka të reja në luginë, për djemtë e tij. Pra, ai nuk ka vvarë kafshë të egra thjeshtë për të mundur urinë, por për të fituar pasuri prej tyre çka e përforcon edhe më tej ndjenjën e fajit. Në këngën popullore vëllai e vret vëllanë për t’u martuar me vashën e bukur, e cila na kishte qenë Zana që zanonte ata që cënonin hapësirën e saj, ndërsa këtu Nika vret “vëllathit” e tij për t’u shitur lëkurat dhe ndëshkohet nga qeniet mitike që i mbrojnë ato, pavarësisht se vdekja e tij mund të jetë edhe pasojë e ndonjë infektimi nga ndonjë sëmundje e kafshëve të egra të marrë nga gërvishtjet e tyre.

Larg qytetërimit modern, por brenda traditës shumëshekullore

I veshur me një lëkurë deleje të tymosur, me shputa të leshta e opangë lope Nika çon një jetë të ashpër i vetëm në mes të natyrës po aq të ashpër duke u njësuar me të aq sa edhe ai vetë duket si qenie e egër. Kaq është i

⁵ F. 102.

lidhur me vendin e tij sa nuk arrin ta kuptojë dhe ta pranojë se si dikush një ditë prej ditësh pa pasur ndonjë hall të madh, largohet nga vendi i tij. Ai nuk ka dalë kurrë prej dheut të tij dhe nuk e shkon ndër mend që të humbasë kohën kot duke shkuar deri në Shkodër, megjithëse i kandet me marrë vesh për dhenat e largëta dhe për yjet. Fundina, toka për të cilën rropatet malësori është edhe një tokë tabu sipas bestytive të vjetra: “Fundina qenka tokë rrabe, që nuk jep fryt, sepse qenkej dhë i shituem rrëfeje dhe i zanun prej shpirtësh të gjinisë femnore, nga Orë e Zana”⁶. Dhe vetë Nika ndërsa shkëputet nga familja e tij bëhet pjesë e Fundinës, madje plotësues i qenieve mitologjike të saj: “Fliste ashtu sikur Nika të ishte Zoti i ernave, atje nalt, mbi Gurra, te Maja e Çilkokut e se papritmas mund të zbriste me kokrrën e rrëfesë në dorë, apo si fryma e shndërrueme në shtërgatë, jo me përtrollë një anë jete, por me vu në vend të vet çdo gja që të bijtë s’e kishin vu përfije”⁷. Madje malësorët flasin se kasollen e tij e vizitojnë gra të veshura në mëndafsh të bardhë që mund të jenë Zanat, të cilat si gra që janë kanë nevojë për një mashkull të pashëm e të vetmuar si Nika.

Në karakterin e Nikës kemi të skicuar dy rrafshë: rrafshin mitik dhe atë etiko-moral. Rrafshin mitik e cilësuam më sipër ndërsa në rrafshin etiko-moral tek Nika kemi tipin individualist të malësorit që ka vështirësi në shprehjen e mendimeve, por ka një projekt të qartë për mbijetesën familjes së tij: punën e vazhdueshme në përpjekje për ta fituar jetesën në luftë me natyrën. Ai jeton në një mjedis patriarkal dhe është prodhim i traditës zakonore shqiptare të Veriut. Megjithëse zgjedh të jetojë shumicën e kohës i vetmuar, ai ushtron autoritetin e tij mbi familjen kryesisht përmes fjalës, në raportin me djemtë e tij dhe me gruan por edhe përmes dhunës në raportin me të shoqen. Ndërkohë sipas kësaj tradite detyra e tij e përrjetshme është të kujdesohet për çdo të mirë dhe nevojë të familjes së tij deri në vetmohim. Autoriteti i tij patriarkal është i njëjtë me atë që përcakton Kanuni i Lek Dukagjinit apo tradita tjetër zakonore. Ai nuk lakmon pushtet, as të mira materiale vetëm për vete por në radhë të parë për familjen e tij. Me punën e jetës së tij prej vetmitari ai arrin të sigurojë tokë të mjaftueshme për djemtë e tij. Ky është qëllimi kryesor i kësaj jete: sigurimi i vazhdimësisë dhe trashigimisë.

Me veprimet, përmasat fizike por edhe me botëkuptimin ai ngjan të jetë trashigimtar i kreshnikëve të maleve: trupi i tij është i mbushur me

⁶ Camaj, M. Vepra, vëllimi i tretë. Onufri 2010, f. 25.

⁷ Po aty, f. 28.

shenjat e plagëve nga rrëzimet nëpër shkrepë dhe betejave me kafshët e egra. Vërtetë ai bënte jetën e vetmitarit por me një qëllim të përcaktuar mirë, djemve të tij t'u lërë trashëgim tokë të mjaftueshme për jetuar. Madje në këtë projekt ua kalon edhe vëllezërve të tij që e mbajnë veten më të mençëm dhe më të gojës se ai. Në vitet e fundit të jetës ai e përtërin përmes të shoqes, Lenës, lidhjen me familjen. E vetmja lidhje me botën është gruaja e tij Lena e cila ndër netët pa hënë me një pishë të ndezur në dorë bënte rrugën nga shtëpia e djemve tek kasollja e gurtë e burrit të saj gjysëm të egër... Nika nga ana tjetër po ashtu me pishën e ndezur i del para në gjysëm të rrugës dhe këta janë “pishtarët e natës”... Nga kjo përtritje do të lindin edhe djali i fundit të cilin ai nuk do ta shohë por simbas traditës do të mbajë emrin e tij. Nika vdes dhe sipas besimeve të vjetra pagane, vdekja e tij është hakmarrja e qenieve mitologjike për shkak të zanatit të tij: gjuetisë, e cila ka vra shumë kafshë të egra. Edhe i vdekur ai kapet pas tokës “E kthyen për së mbari dhe panë se në grushtat e ngrimë e në gojë shtrëngonte dhé. Në tokën e re shihej lavra e përpushjeve si të egërsinës së rame në kurthë. “Me gojë e paska kafshue dhenë! - Vërejtji Marku thatas. – Ndoshta prej dhimbës së madhe”⁸.

Natyra dhe mjedisi i ashpër zakonor e pengojnë përparimin kulturor të malësisë

Vijim i të njëjtit obsesion, i zhbirimit e ringjalljes së “botëve të shmangura” është edhe novela “Rrunga në mars”. Jeta patriarkale në malësinë e largët që në dimër i mbyllen të gjitha rrugët e shtigjet nga bora e madhe. Legjenda dhe e vërteta kapërthehen me njëra-tjetrën në këtë mjedis dhe bëhen pjesë e jetës së përditshme në katundin e vogël buzë lumit, bri malit. Por skena e vendlindjes në këtë novelë bëhet më idilike, përmes linjës së dashurisë ndërmjet Jerës dhe Dakut, dy të rinjtë, katundet e të cilëve i ndante një mal në mes. Të rinjtë për nëntë muaj ndjekin shkollën në qytet dhe për pushime kthehen në vendlindje. Nëse bora i zë në katundin e tyre ata mund ta humbin vitin shkollor. Në këtë botë të izoluar qytetnimi ka filluar të ndërhyjë, por pa e përmbysur atë. Pra, skenat e jetës së këtushme janë më “moderne” se tek novela “Pishtarët e natës” sepse në malësi ka zënë vend interesimi për shkollën dhe dijen e librave të shkruar. Jera dhe Daku janë fëmijë malësorësh që

⁸ F.105.

ndjekin shkollën në qytet por janë të detyruar të jetojnë sipas rregullave të traditës zakonore, megjithëse në fshehtësi ata i kundërvihen asaj duke u takuar herë pas herë larg syrit të etërve të tyre. Edhe ata vetë janë prodhim i këtij mjedisi, çka shihet në karakterin e tyre të rezervuar, në pamundësinë për t'i artikuluar ndjenjat e tyre lirisht. (Edhe në këtë novelë mbizotërojnë skena të jetës familjare të malësive dhe e botës së tyre morale e zakonore. Në këto skena njeriu megjithëse i izoluar të shumtën e kohës nga pjesa tjetër e botës ka ndërtuar botën e tij dhe jeton historinë e tij të thjeshtë të ekzistencës në shmang të rrëmetit të botës moderne, me luftëra, popullatë shumëmilionëshe, teknologji e komoditete të skajshme).

Jera gëzon disa liri të veçanta që u mungojnë vajzave të tjera të malësisë. Për shkak se në familje mungojnë djemtë, asaj i njihet liria e një djali. Pra ajo është një projekcion i burrneshës që haset edhe në traditën zakonore: femrës e cila refuzon të martohet për ndonjë arsye madhore sidomos në familjet pa trashëgimtar meshkuj dhe qëndron në familjen e saj duke u veshur dhe përshtatur me jetën e burrave, duke marrë pjesë në kuvendet e tyre, duke pirë duhan etj. Ajo gëzon në këtë kuadër edhe privilegjin e shkollimit në qytet, gjë e cila u lejohej zakonisht vetëm djemve. Veçanërisht tek Daku ngre krye modeli i mashkullit patriarkal që vjen nga tradita. Ai e quan Jerën si femrën e tij, dhe ajo nuk duhet të guxojë të mendojë për mashkull tjetër, madje edhe nëse ajo nuk do të pranojë të jetë e tija ai mendon ta rrëmbejë, siç kanë bërë tradicionalisht meshkujt e fisit të tij. Mungon edhe këtu referenca me atdheun si njësi e gjerë territoriale, gjuhësore e kulturore, por kuptohet se ky është atdheu i këtyre njerëzve ishullorë, që shohin malet rrotull dhe yjet në qiell kur nata është e kthjellët. Këtu jetohet sipas traditave të vjetra dhe mënyra e jetesës është po ajo e paraardhësve të tyre, koha lëviz ngadalë dhe pa sjellë ndryshime të rëndësishme. I vetmi ndryshim kulturor është dërgimi i rrallë i ndonjë të riu apo të reje në shkollë në qytet. Jera nga fshati i saj dhe Daku nga fshati matanë qafës së malit janë dy të rinjtë fatlumë që u jepet mundësia të shkojnë në shkollë, por edhe të gëzojnë diçka nga ndjenjat e ndërsjella të cilat megjithatë, sikurse jepet në novelë, nuk do të kenë një finalizim sepse në një farë mënyre ato janë edhe një përjashtim në këtë mjedis të ashpër. Atë që nuk e bën rrethi njerëzor i tyre, e bën natyra me egërsinë e saj. Rrungaja e borës në mars ia merr jetën Dakut gjatë përpyekjes së tij për të shkuar në shkollë duke kaluar qafën e malit të mbuluar nga bora. Simbolikisht izolimi por edhe

natyra e ashpër, mungesa e rrugëve të komunikimit e ka penguar edhe përparimin shpirtëror e arsimor të këtyre njerëzve deri aty sa Dakun e etur për shkollën e dijen, e vret orteku i borës, ndërsa po tentonte të kalonte qafën e malit. Rrunggaja e marsit dënon me vdekje dëshirën për komunikim dhe për arsim, por edhe feksjet e një ere të re në jetën e të rinjve të dy katundeve që ngriheshin në dy faqet e përkundërta të njëjtë mal; të erës së marrëdhënieve dashurore në një vend ku kjo ishte e pothuaj e pamundur për shkak të ashpërsisë së traditës zakonore. Por Daku vdes dhe Jera vetëm e merr me mend se çfarë ka ndodhur ndaj shtyn motet me kujtimin e tij pa biseduar me askënd për ndjenjat e vujtjet e saj.

Rrjedhat e qytetërimit modern rrezikojnë të gllabërojnë komunitetet e kulturat e vogla

Duket se Camajt i kanë interesuar shumë “botët e shmangura”, njeriu në skaje të qytetërimit, komunitetet e izoluar nga natyra, por edhe nga rrjedhat e jetës moderne. Mund ta shohim këtë edhe si një lloj çlirimi estetik e shpirtëror të shkrimtarit nga pengi i ikjes prej vendlindjes dhe larg njerëzve “që flasin si unë”. Edhe në novelën “Shkundullima” na del nga një qasje tjetër kjo temë. Këtu autori i qaset jetës së katundit arbëresh në Italinë e Jugut, në të cilin më shpejt mbrrin Vitoi (personazhi kryesor) me makinë, sesa telegrami që ai ka dërguar para se të nisej. Katundi arbëresh ku kanë mbetur vetëm të moshuarit që pinë kafe ekspres në lokalin e vetëm është një botë në zhdukje, madje brenda tij ndjehet “diçka si kufomë qeni në prishje”⁹. Vitoi, me profesion inxhinier mendon se mund të bëjë diçka, qoftë edhe për egoizëm, të shpëtojë shtëpinë e vjetër të babait nga shkatërrimi, por kjo rezulton një dështim, një përpjekje e kotë përballë rrënimit të katundit arbëresh: askush nuk mund të dalin kundër rrjedhës së kohës dhe tendencave të zhvillimeve ekonomike të qytetërimit modern: Në moshë të pjekur Vitoi, bën plane të ndërtojë ura dhe rrugë të përshtatshme në katundin e tij të izoluar nga bota, me qëllim që ai të hyjë në rrjedhën e komunikimit të ekonomisë moderne, meqenëse deti nuk është shumë larg dhe përmes urave rruga mund të shkurtohet shumë. Kështu katundi arbëresh mund të përfshihet me prodhimet e veta në ekonominë e turizmit, e cila do të

⁹ Po aty, f. 119.

sjellë zhvillim të tij e jo braktisje. Por plani i tij shihet me dyshim dhe armiqësi prej banorëve të cilët i pranojnë me vështirësi gjërat e reja ose i mohojnë ato kategorikisht. Pikërisht kur gjërat fillojnë të marrin për mbarë dhe një pjesë e banorëve mbështetin planet e tij për ta futur katundin në rrjedhën e jetës moderne, ndodh diçka fatale: shkundullima, tërmeti i cili rrafshon pothuaj gjithçka. Shkundullima rrënon ëndrrat dhe planet e Vitoit si inxhinier dhe si burrë i dashuruar me Ntonian. Si inxhinier i duhet të merret me rrënojat dhe me organizimin e punës për sistemimin e të mbijetuarve, si burrë ai mbetet pa Ntonian, e cila duke pa rrënimin e katundit dhe e pikëllueme për vdekjen e mëndeshës së saj, u largua pa lënë asnjë njoftim. Edhe këtu natyra është një pengesë e pakapërcyeshme, e cila sjell aq mjerim edhe në kohën moderne, por në rrafshin simbolik vetë rrjedhat e qytetërimit modern janë si tërmetet, ato rrezikojnë të shkatërrojnë çdo gjë të vjetër, të gllabërojnë komunitetet e kulturat e vogla me një kafshatë. Vitoi mbas një qëndrimi rreth tetë mujor në katundin e lindjes detyrohet të ikë duke prerë të gjitha lidhjet me vendin e vet, i cili mbas rindërtimit nuk do të ketë asgja të përbashkët me katundin e dikurshëm. *Shkundullima* edhe këtu rrezikon të shembë përfundimisht çdo gjurmë me rrënjët e vendlindjes dhe kulturës së vet dhe të shuajë çdo përpjekje për të riparuar apo shpëtuar diçka prej saj.

Kërkimi i identitetit gjuhësor e kulturor mbi të cilin është shtrirë mbretëria e vdekjes

Me temën arbëreshe dhe një botë në zhytur në harrim, drejt zhdukjes, lidhen edhe novelat “Katundi me gjuhë të fshehtë” dhe “Gjon Gazulli”. Tek “Katundi me gjuhë të fshehtë” vendasit i thonë vazhdimisht një vizitori që vjen për pushime në katundin e tyre buzë detit, se sipër në anë të malit është një katund tjetër, ku flitet gjuha e tij. Ky njeri bëhet kureshtar dhe shkon ta vizitojë këtë vend të shkretë, në të cilin takon vetëm një person, një vejushë, të cilën e kishte njohur në rini gjatë studimeve universitare. *Njeriu i huej* e pyet gruen e quajtur Flora, se si është ajo gjuhë për të cilën i kishin thënë se flitet në katundin e saj, të cilën ai e mendon si gjuhën e tij. Flora flet në këtë gjuhë e cila tingëllon e çuditshme dhe e pakuptueshme, si një gjuhë e vdekur në një vend të vdekur ku nuk banon askush dhe nuk hapet asnjë portë. I hueji nuk e kupton këtë gjuhë të të parëve të tij. Ai kthehet prapë pas tri vitesh për

pushime në të njëjtin katund dhe mëson prej vendasve se katundi që ai ngulte këmbë se e kishte vizituar nuk ekzistonte në asnjë hartë, por në vend të tij ishte një varrezë e madhe në të cilën katundet e dikurshme varrosnin të afërmit e tyre: “Po grueja?” E pyeti i hueji. “Mordja!-ia priti plaku. – Ju keni kalue atje një mbasdite në shoqinë e mordjes”¹⁰. Në novelën në fjalë narrativa nxjerr në pah kërkimin e identitetit gjuhësor e kulturor, i cili rezultoi i humbur përfundimisht, sepse mbi të është shtrirë mbretëria e vdekjes.

Ky kërkim i identitetit të humbur vijon edhe në novelën “Gjon Gazulli” që ka në qendër figurën e humanistit shqiptar Gjon Gazulli e cila evokon Arbërinë e mesjetës por edhe shkëlqimin e plejadës së humanistëve shqiptarë në mesin e humanistëve italianë. Gjon Gazulli i zhytur në botën e ideve e shkon jetën në rrekje për t’ia gjetur fundin idesë dhe mendimit ndërsa i përhihet kujtimi i vendit të të parëve të tij, qoftë edhe në trajtën e një kënge në gjuhën e tij e cila zhduket sakaq: Filozof dhe njohës e shumë gjuhëve të huaja “Gjon Gazullit, tri dit para se të mbyllte sytë përgjithmonë, i erdhi dëshira me recitue vetmevete vargje popullore në gjuhën amëtare. U ndal tue thanë se shqipja mund të përdorej për t’u marrë vesh me vëllezën e miq shqiptarë, por jo si mjet poetik, mirakandës.”¹¹. Mund të dallojmë një ngjashmëri të qartë këtu mes humanistit dhe vetë autorit M. Camaj, kur thuhet se humanisti Gjon Gazulli *vdiq në terr të shumë çështjeve, pa mundë me i zgjidhë as mbas një jete prore në ikje prej njerëzve e vendeve, por edhe prej vetvetes ngase gjallnoi mes dy botnave*¹².

Edhe Camaj gjallnoi ndërmjet dy botëve e kulturave, asaj të Evropës perëndimore dhe asaj të vendlindjes së tij, ndaj në këto novela sikurse edhe në veprën tjetër letrare ai nuk pushon së rrëfyeri, së reflektuari për botën shqiptare. Kryesisht për botën jo bashkëkohore, por atë të së kaluarës, atë të periferisë, (malësitë e Veriut) atë të rrezikuar me zhdukje (botën arbëreshe). Shqipëria bashkëkohëse e socializmit nuk ekziston në këto novela. Shqetësimi dhe pengi i autorit është Shqipëria e përjetshme, gjuha dhe kultura shqipe, kulturat e vogla përballë rrezikut të asimilimit nga kulturat e mëdha, kërkimi i identitetit dhe rrënjëve të këtij identiteti kryesisht kulturor dhe i pikëpyetjeve të tjera ekzistenciale për shqiptarin.

¹⁰ Po aty, f. 294.

¹¹ Po aty, f. 341.

¹² Po aty, f. 341.

Alfred ÇAPALIKU

“KRITIKA” E ARSHI PIPËS

Në vitin e trazuar 1944, poeti dhe kritikë Arshi Pipa qe autor i dy ngjarjeve të spikatura kulturore në kryeqytet: i librit me vjersha “Lundërtarë” dhe i revistës elitare “Kritika”. Si poet ai e shoqëroi vëllimin në vargje me një parathënie model, ndërsa si kritik i parapriu revistës së drejtuar prej tij, me një manifest që i përzgjedhur tingëllon çuditërisht edhe si një dekalog, me postulatet:

- N’art e ndër letra kritika asht baza e çdo ndërtimi të sigurtë.
- Kritika asht shenji i mendjes së pjekun.
- Kritikë spjegon misterin e veprës.
- Ka soje soje shijesh: ajo e holla, e sakta ndeshet shumë rrallë.
- Kush ban kritikë letrare asht pra ma pare artist se logjik.
- Mund të thomi se nuk ka ende një kritikë shqipe.
- Duket luks, por kritika asht një nevojë.
- Dy detyra i bijnë kritikës shqipe: me vlerësue traditën dhe me ndjekë hap për hap prodhimin e kohës.
- Objektiviteti asht kushti i pare i çdo kritike. Por kritika letrare-trill i poezisë ka edhe një kusht: ajo bahet edhe me simpati.
- Si me i pajtue kto dy anët kaq të kundërta? Kjo asht mjeshtria e kritikut t’aftë¹.

Vrojtimi kritik i thekur vihet re edhe tek shkrimet e mëparshme të Pipës*, ndër organe të ndryshme të shtypit, por edhe në revistën “Kritika” arrihet në një platformë të mirëfilltë estetike.

E rëndësishme është se ajo nuk mbeti thjesht partiturë teorike, por

u luajt nga një *violinë e parë* (Arshiu) në tre tonalitete (artikuj kritikë, studime problemore, ese) tek shkrimet: 1. “Mall e Brengë”. 2. “Israelitë e Filistinë”. 3. “Bariu i popullit” (Noli). 4. “Faik Konica”. 5. “Mbi përkëthimet”. 6. “Përkthime nga klasikët botnorë-Goethe. “Tri kangë nga Fausti”. 7. “Dy libra mbi KOsovën”. 8. “Gramatika e pabotueme e Kamardës”. 9. “Biblioteka – Muzeum e Tiranës”. 10. “Historija e dhimbshme e “Shpirtit të ri” (Migjeni).

Po aq e rëndësishme është se platforma në trajtë manifesti e Pipës u luajt në harmoni variacionesh edhe nga *violinat* e tjera të orkestrës: Pashko Gjeçi, Mitrush Kuteli, Henrik Laca, dr. Besim Qorri, Myzafer Xhaxhiu, Planait Istrati, prof. Selman Riza, A. Delvina e bashkëpunëtorë të tjerë të çmuar (me iniciale dhe pseudonime), të cilët i bëjnë jehonë revistës, përmes studimeve cilësore mbi Mjedën, Gurakuqin, mitologjinë, shqipërimet, shkencën, artin, jetën kulturore.

Studiuesi Robert Elsie në kronologjinë sintezë prej 16 faqesh të letërsisë shqiptare shenjon edhe datën 27 mars 1944, të daljes nga shtypi në revistën “Kritika” të Arshi Pipës².

Me katër numrat, përndryshe me 160 faqet e saj, e përmuajshmja letrare e Arshi Pipës ndikoi në kulturën shqiptare të kohës, duke u bërë përcjellëse e vlerave të njëmendta artistike dhe njëkohësisht duke shërbyer si etalon i kritikës së specializuar.

“Mendimi kritik sidomos në fillim të viteve ’40, arriti të njohë rolin e vet dhe të përvijojë përmasat e punës e punës që duhej të kryente”, nënvizon studiuesi Ali Xhiku, mbështetur në prirjen e Pipës. “Nuk mund të kuptojmë kurrë një vepër arti po nuk kuptuem ma pare artistin. Për kte kritika duhet të jetë medomos historike”³.

E hapur ndaj interesimeve filozofike, estetike, folkloristike, historike, revista prestigjoze u largua nga recensionimi dhe e vuri mbi baza shkencore kritikën: si diskutim mbi letërsinë e një teksti apo vendosjen e tij në brendësinë e një perspektive historike.

“Qindrimi i kritikës përpara veprës artistike asht si aj i një shtegtari përpara një pallati magjik. Jo i knaqun me soditë së jashtmi, shtegtari don me hy mbrendë”⁴.

Veçanërisht në studimet – ese për Nolin dhe për Migjenin, Pipa u bën analizë vlerave të brendshme, vetiake, thelbësore të tekstit, duke përcjellë si kulturolog vlerat reale, të cilat paraqiten edhe si vlera kombëtare.

Përgjithësisht kritika letrare e Pipës shpalos një veprimtari

intelektuale, që merret me shqyrtimin e një vepre arti, për të dalluar ndërtimin, prejardhjen dhe vlerën e saj estetike.

Nga pikëpamja metodologjike, kritika e Pipës ndërthur disa metoda të intepretimit të veprës letrare: mënyrat e nevojshme, që përballë një teksti të veçantë ilustrojnë strukturën dhe vlerat: duke ndihmuar kësisoj lexuesin e zakonshëm të kuptojë më mirë, duke e stërvitur me një formë të ngritur e të zgjedhur leximi.

Kjo ishte mjaft për vitin aspak komod 1944. Vetëm 24 vjeçar, Arshi Pipa në të ardhmen do ta mprehte edhe më tepër penën e kritikut seroz, pavarësisht nga privacionet; ashtu siç do t'i tendoste edhe më shumë telat e shpirtit poetik.

“Pra, Arshi Pipa i mbeti besnik deri në fund pikëpamjes së tij të formuar nga idealizmi i Vicos dhe i Bergsonit, i Spinozës dhe i filozofëve të mëdhenj, që studioi në vitet e tij të rinisë”⁵.

Tepër saktë, studiuesi dhe poeti Myftar Gjana e ka perifrazuar Arshi Pipën, si stoiku i rrallë i letrave shqipe.

Burimet:

1. Pipa, Arshi: “Shpirti kritik”. Rev. “Kritika”. Tiranë. Nr.1/1944, f.1-5.
*Më parë kritikë letrar Arshi Pipa kishte botuar:
“Fishta”: “Njeriu dhe vepra”. Botim i posaçëm në përvjetorin e parë të vdekjes së Fishtës. “Shkëndija”. Tiranë, 1941.
“Për një kritikë letrare”. Rev. “Shkëndija”. Tiranë. Nr.2/1941, fq.50-61.
“Art e moral e vetëdije letrare”. Rev. “Shkëndija”. Tiranë. Nr.5-6/1941, fq.198-203.
“Bergson”: Metafizika e poetit”. Rev. “Fryma”. Shkodër. Nr.1/1944, fq.117-122.
2. Elsie, Robert: “Histori e letërsisë shqiptare”. Tiranë-Pejë, 1997, fq.494.
3. Xhiku, Ali: “Letërsia shqipe si polifoni”. Tiranë, 2004, f.33.
4. Pipa, Arshi: Art. cit. f.3.
5. Gjana, Myftar: “Arshi Pipa ose stoiku i rrallë i letrave shqipe”. Gaz. “Drita”, Tiranë, 22 maj 2005, f.4.

▪ Teatër ▪

Gëzim PUKA

“KJO NUK ËSHTË PËR TË QESHUR!”

(refleksione për dramën “Tre vetë në një varkë” të Stefan Çapalikut)

Një reflektim i thellë për të kaluarën nën regjimin komunist

“Kjo nuk është për të qeshur!”- më vjen në formë psherëtime nga zotëria i ulur përbri meje në sallën e mbushur të teatrit “Migjeni” të Shkodrës. Është premiera e shfaqjes “Tre vetë në një varkë (pa llogaritë Nik Prel Mujën)”, drama më e fundit e shkruar dhe e vënë në skenë nga dramaturgu dhe regjisori Stefan Çapaliku. E njoh këtë spektator, është një bashkëqytetar që më duket se i përket pikërisht asaj shtrese të persekutuarish, të cilët kjo dramë i ka në qendër të saj. Tematika e regjimit të shkuar diktatorial duket se nuk ka përfunduar së dhëni kuptim dhe ndjeshmëri të lartë për lexuesin dhe spektatorin shkodran. Intuitivisht S. Çapaliku e ka vënë re se nuk e kemi bërë akoma një reflektim të thellë për atë që e kaluam, ndaj dramat, si dhe romanet e tij më të fundit na e kanë rifreskuar kujtesën për një periudhë të errët nga e cila nuk po shkëputemi dot.

Më duket se brenda meje gjëmon zhurma e përroit të ndërgjegjes së vrarë. Më duket se e dëgjoj monologun e heshtur të spektatorit përkrah meje, që zhvillohet njëkohësisht me dialogun e personazheve në skenë. Në teatër po ndodh rishfaqja e kujtesës. Në skenë është forca e së shkuarës. Zotëria ka lot në sy. Ia dalloj shkëlqimin e tyre edhe pse është errësirë. Sytë e tij lotojnë gjatë gjithë shfaqjes, pasi ai po sheh kalvarin e vet. Është një moment kur dialogu keqkuptohet në sallë, e ndodh shpesh të shpërthejnë disa të qeshura bezdisëse, ndërsa zotëria përkrah meje vijon të thotë si me vete: “Kjo nuk është për të qeshur!”.

Nëna me tre djem që kanë shumë ëndrra. Ëndrrat dashurore. Ëndrra

për studim. Ëndrra për jetesë më të mirë. Ëndrra për liri lëvizjeje. Në këtë shtëpi mbahet edhe një thi (derr), i cili rritet për ushqim. Dëshira për energji. Frymëzimi vjen nga një fakt i njëmendësisë diktatoriale dhe nga një paratekst letrar.

Intertekstualiteti

Që në titull na kujtohet romani humoristik “Tre veta në një barkë (pa përmendur Qenin!” të Jerome K. Jerome. Dhe në fakt në dramë e kemi edhe qenin. Ai është, Nik Prel Muja, arketip i shërbëtorit të regjimeve. Mjetet shprehëse skenike, breshëritë, vetëtimat na e sjellin më së miri këtë atmosferë të mungesës së lirisë. Tre djemtë e shtëpisë bijnë dakord të arratisen, duke lidhur dhe shndërruar në një varkë tri koshere bletësh. Dekonspirimi i planit vjen nga Nik Prel Muja. Plani i arratisjes dështon. Djemtë arrestohen.

Më pas sperancat apo shpresat e varura të skenës mbi kokat e djemve, shndërrohen në çengela burgu. Kosheret e bletëve, si flatra të sjella përmes një koreografie të spikatur, shndërrohennë barra të rënda mbi shpinë.

Teatri i konvencionit

Pjesa e parë e dramës është serioze. Ajo është veç dhembje. Na ofrohet teatër i konvencionit, teatër i *sikurit*. Kapele të varura në boshllëk, trupi gjykues në boshllëk. Hetues dhe prokurorë në një personazh, që është arketipi i diktaturave, i pallogaritshmi Nik Prel Muja. Vijon monologu i nënës së çmendur nga dhembja e shprehur përmes fjalëve: “Unë i dua kafshët...”, por Nik Prel Muja, si simbol në dramë, e tejklon Qenin e ndërmendur si kafshë besnike të romanit nga është marrë titulli. Simboli devijon si domethënie në këtë dramë ku kafshëria njerëzore shkon pertej çdo imagjinareje. Vjen përsëritja e dialogëve dhe monologëve në burg, si tercina danteske. “*Omne trinum perfectum est*”¹, siç thonë latinët, vjen prishet e shkallmohet nga ndërhyrjet e të tjerëve. Këtu nuk thuhet asgjë e re. Burgologji, temë e rrahur si në prozë, ashtu dhe në dramë. Karakteret, tre vëllezërit kanë ngecur brenda trekëndëshit dogmatik: mësim – punë – kalitje, që është skenikisht qelia e tyre me tri dërrasa në formë trekëndore. Në fakt është një copë Shkodre, që nuk u bë kurrë pjesë e sloganeve të propagandës.

¹ Çdo trinitet është i përsosur

Parodizim i dukurive të tranzicionit

Pjesa e dytë është një kthesë në formën e një ironie të skajshme në stil. Parodizim i një tranzicioni, humor i zi. “Dështimi në liri”, -do e quante një filozof i qytetit tonë. “Çfarë është ky vend ku ndryshojnë vetëm kohët, por jo njerëzit?!” – shprehet njëri nga tre vëllezërit. Tmerr i pafund. Nik Prel Muja, avokati që po intervistohet në televizion për shpërblimin e të përndjekurve politikë. Intervista ndërmjetësohet nga një gazetar me probleme të dukshme të nyjetimit të fjalës. Është mediumi i fjalës së lirë në kushtet dëshpërimisht tragjike. Loja vijon, rolet janë ndryshuar: hetues, prokurorë, gjykatës dhe së fundmi avokat është vetëm Nik Prel Muja, i pallogaritshmi, qeni që duhej të ishte besnik, por që në të vërtetë veç kafshon. Media që nuk artikulon mirë, vjen si shpoti ndaj medias lustër dhe të pasinqertë. Bullizmi mediatik përcillet përmes një televizioni me sipar, shenjë skenike me mjaft ngjyrim, për të treguar se një televizion me sipar, është një televizion “i teatralizuar” dhe në këtë kontekst, një skenë me sipar të hapur gjatë gjithë shfaqjes, është një ngjyrim cinik. Rreshtohen nga avokati të gjitha kriteret që duhen për përfitimin e shpërblimit të persekutimit. Nga ajo listë e gjatë kërkesash tre vëllezërit, tre beqarë të plakur dhe të atrofizuar, mbërrijnë të shënojnë veç njërin prej tyre, “dëshminë e vdekjes”.

“Unë nuk i dua paratë e tyre...” thërret njëri nga vëllezërit. Avokati në televizion është vrasja e shpresës për vazhdimësi. Nuk ka perspektivizëm të një ideali të lirisë. Tranzicioni jep vetëm një zgjidhje, ikjen. Ideali i ikjes shenjohej apo aktualizohet edhe nga kostumet e bashkëkohësisë. Barka e Noes, e krijuar me koshere bletësh, mbart tashmë tre lundërtarë që ikin drejt stacionit të fundit të gjallimit të tyre, të shoqëruar me një gjëmim vapori, si vajtim ironik.

E vërteta artistike dhe ajo historike

Dritat e sallës ndizen, spektatorët ngrihen në këmbë dhe duartrokasin. Spektatori përbri meje duartroket si i mpirë. Nga pas më vjen një tjetër pëshpëritje: “Është histori e vërtetë... Më duket se ky zotnia përpara, është njëri nga personazhet”. Kësaj here mpirja më kaplon duart, ndaj nuk jam më në gjendje të mbaj ritmin e duartrokitjeve. Ngutem të dal nga teatri. Tek dera është një çift të rinjsh. Vajza i thotë djalit: “Ç’na

solle në këtë vend?! Të gjithë pleq ishin.”

Pasi thitha ajrin e freskët të muzgut, nisa të ndërmend se nuk ka kurth më interesant dhe më intrigues se teatri. Ka ca kohë që nuk shkruaj më për të, edhe pse shfaqje shoh vazhdimisht. Opinioni i ngritur: “S’ka kritikë”, ka rritur zërin brenda meje: “Ç’mundohesh kot, o qyqar!”

Kësaj herë ma ndriçoi mendjen edhe mendimi i një kritiku të teatrit italian, që e lexova tani së fundi: “Si kritik dhe lexues vuaj nga një kufizim i tmerrshëm. Lexoj dhe çoj në shtëpi vetëm delet e tufës sime. Ndërmjetësoj për të tjerët dhe çoj në shtëpi vetëm ato tekste që i kam më familjarë dhe që më kanë tërhequr në mënyrë të tillë, që nuk i harroj dot.”²

Veprën e S. Çapalikut e përcjell prej disa vjetësh. E ndërsa përtyppja me mend “Tre vetë në një varkë (pa llogaritë Nik Prel Mujën)”, m’u rifreskua ideja se vlera e një shfaqjeje nuk është gjë tjetër, veçse shprehja e cilësisë së lidhjes me kujtesën e atij që e ka parë shfaqjen.

Dikush duhet ta përshkruajë këtë lidhje. Duhet që dikush ta dëshmojë me shkrim mendimin e tij, pa e veshur me objektivitetin, që gjithmonë është i dyshimtë. Simpatia për zotninë - personazh më nxiti t’i qasem rishtas letrës së bardhë, duke kërkuar një vështrim thjesht personal mbi këtë shfaqje, por edhe me një lloj tendencioziteti ndaj çiftit që doli duke u tallur nga teatri. Kush merret me shkrime për teatrin e ka kuptuar se ndodhet në një pozicion të vështirë, që nënkupton një lloj tërheqjeje nga koncepti i komunitetit të publikut, si një komunitet i padiferencuar. Shfaqja ma riorcoi mendimin se ka vetëm spektatorë të veçantë. Duartrokitësit e zjarrtë të një shfaqjeje të tillë më krijojnë idenë se ka akoma spektatorë që ndërveprojnë me dramën. Ato më të mekurit duket se me zor mbahen brenda skemave teatrore, kurse ata që ia mbathin drejt daljes, më ngjan se kanë urgjenca të tjera estetike dhe pranojnë veç kafshimet e mjeteve alternative të komunikimit.

Kështu që për të parë “Tre vetë në një varkë (pa llogaritë Nik Prel Mujën)” të Stefan Çapalikut kemi mbetur tre lloje spektatorësh në këtë barkën e teatrit, pa llogaritur... (politikanët për shembull).

² Garboli, C – Pianura proibita, Adelphi, Milano, 2002, p. 166-167.

▪ **Muzikologji** ▪

Ridvan **KARAKAÇI**

**KONTRIBUTI I MJESHTRIT LUAN BOROVA NË
NDRYSHIMET QË PËSOI “AHENGU SHKODRAN” NË
GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XX**

Hyrje

Në historinë e gjatë mbi 200 vjeçare të zhvillimit, formimit, jetës së gjallë artistike që vazhdon të bëjë pa reshtur, për këngën *aheng* shkodrane kanë kontribuar e vazhdojnë të kontribuojnë dhjetëra e qindra bartës në fushën e krijimit, interpretimit, formacioneve të shumëllojshme që e shoqërojnë këngën aheng, instrumentistë, orkestrues, drejtues artistikë etj. Secila periudhë e zhvillimit pati karakteristikat e veta, kontribuan artistë amatorë apo të kualifikuar, që kurdoherë e ngritën në nivele te reja estetike e artistike këngën *aheng*. Në këtë shkrim, do të përcjell rolin e rëndësishëm të një prej figurave më të çmuara, që kontribuoi në ridimensionimin e vlerave estetike e artistike të këngës *aheng* në vitet 1980-2003, muzikantit të shquar Luan Borova (1957-2002).

Kënga *aheng* shkodrane është një pjesë e rëndësishme e korpusit të këngës qytetare shkodrane. Kontributi i Luan Borovës në muzikë është shumë më i gjerë, ai lidhet me këngën qytetare shkodrane, këngën e Shqipërisë së Mesme, këngën kosovare e me këngën argëtuese shqiptare etj.

1. Luan Borova: solist, drejtues formacioni i ansamblit orkestral, orkestrues, udhëheqës artistik, organizator, kompozitor dhe mësues i palodhur me këngëtarët dhe instrumentistët

Luan Borova është muzikanti që ridimensionoi thellë këngën e *ahengut* shkodran, duke përfshirë të gjithë komponentët artistikë e muzikorë, që e përbëjnë atë, si solist, drejtues i formacioneve orkestrale, orkestrues, udhëheqës artistik, organizator, kompozitor dhe mësues i shkëlqyer e i pa lodhur me këngëtarët e instrumentistët. Siç dihet, *kënga aheng*, deri në fund të viteve 1950, në përgjithësi luhej e këndohej për qejf, në oda të mëdha, çardakë, oborre, bahçe, në dasma apo festa të tjera intime, dhe në bazë të një kodi të përcaktuar muzikor.

Në fund të viteve 1950, me krijimin e të sektorit muzikor pranë teatrit “Migjeni”, me drejtues të parë artistik muzikantin Mark Kaftalli, kënga *aheng* fillon edhe një jetë artistike të pavarur në skena, e gradualisht në radion lokale, tv kombëtare, në arena më të mëdha si: pallate sporti apo stadione. Kjo do të ishte një përgjegjësi më e madhe ndaj shkodranëve e shqiptarëve. Pas daljes në skenë, problemi i vetëm për jetën e *këngës aheng* mbetej pasurimi dhe zhvillimi i kësaj tradite nëpërmjet krijimit të formacioneve të shumëllojshme, përpunimeve të reja dhe interpretimeve në skenë. Emocionalisht e profesionalisht, kënga aheng kishte nevojë për nivele të reja estetike e artistike. Duhej të identifikonte shpirtin e vërtetë shkodran në mjedise të njohura e të panjohura. Por, në shumë raste ato filluan edhe si zëvendësime të krijimtarisë ideologjike të kohës. U krijua një lidhje më e ngushtë emocionale midis këngëve e dashmirësve të saj, duke u mbështetur edhe në përvojën e muzikantëve të shquar të kësaj kohe si: Mark Kaftalli, Xhavit Ujkani, Nazmi Lishi, Fatbardh Luga etj. Në vitet ‘80 do të shpërthejë me tërë madhështinë e tij muzikanti Luan Borova.

Deri në moshën 14 vjeçare nuk ndoqi shkollë të arsimit muzikor profesional. Mësoi fizarmonikë në mënyrë autodidakte. Më pas u arsimua në shkollën artistike “Prekë Jakova” në vitet 1971-1975 në trombone. Në vitet 1976-1979 kreu studimet e larta për trombone në Institutin e Lartë të Arteve. Virtuoz në fizarmonikë, i shkëlqyer në trombon, luante shumë mirë në piano dhe i formuar në disiplinat muzikore, hyri në vitin 1979 në jetën artistike të qytetit si drejtues i sektorit të muzikës në teatrin “Migjeni”.

Në lojën e fizarmonikës ishte virtuoz i klasit të vecantë, më brilanti i tërë kohërave në Shkodër. Zotëronte teknikë të jashtëzakonshme, ndjesi të thellë. Për të realizuar tingëllime të reja në shoqërimin orkestral të këngës aheng, ai bashkëpunoi me instrumentistët më të shquar të qytetit. Insistonte në punën e tij që çdo part muzikor i këngës, çdo këngë të ishte e studiuar dhe e përvetësuar përmendësh, dhe vetëm atëherë fillonte puna e veçantë në grup. Zotëronte aftësi për të përcaktuar me saktësi të

madhe tempin e këngës, shkallën e duhur të tingëllimit të orkestrës për çdo këngë, nuancat, dinamikat e ekspresivitetin dinamik. Ngulmonte tek fraza muzikore që të ishte e natyrshme e skicuar, e qartë. Si mjete artistike atij i shërbenin mënyra të ndryshme si: forcimi apo ngadalësimi i tingullit, luhatjet e vogla të tempit apo zgjatja e disa tingujve në varësi të natyrës emocionale të tipit të këngës. Me ëmbëlsi të rrallë të lidhte frazën që mbaronte me atë që fillonte, herë duke shpejtuar e herë duke e ngadalësuar lëvizjet e tyre, duke e mbushur me ngjyra e emocione që rrjedhin në mënyrë origjinale nga vetë kënga.

Evolucioni i ndjeshëm që pati kënga aheng shkodrane është i lidhur me punën e tij si orkestrues. “Orkestracionin e kam konsideruar si shpirtin e këngës”, pohonte Luani, e, gjithnjë kam pëlqyer tingullin e gjallë. Mendimi ka qenë se kënga që të eci përpara, krahas pohimit duhet edhe të mohojë diçka nga e kaluara e saj”. Ai pasuroi teknikën dhe mundësinë shprehëse të çdo instrumenti, shfrytëzoi regjistrat në varësi të ndjenjës e emocionit. Vlerësoi te çdo instrumentist regjistrat më të plotë e të hijshëm. Këngët e orkestruara nga Luani vijnë më të zhvilluara, fjalori artistik më i pasur se sa vetë muzika popullore. Vlerësonte tonalitetin si shprehje emocionale të këngës dhe për këngëtarin. Ai ripërtëriu shumë këngë aheng që vuanin endenga influenza orientale. Gjithnjë evidentoi violinën si bartëse të melodisë dhe roli që kishte ky instrument në origjinalitetin e melodisë. Tek violina ai gjente vibraton, mënyrën e realizimit të zbukurimeve që kënga i kishte në melodi. Përdorimi i kitarave elektrike dhe i një perkursioni më të gjallë, shtoi interesin ndaj ritmeve dinamike e siguroi një harmoni mbështetëse. Krahas formacioneve tradicionale, ai përdori edhe instrumenta të tjerë, që nuk ishin të lidhur direkt me këngën aheng si: oboe, flauti, tromba, saksu etj, me qëllim për të pasuruar tingëllimin e brendshëm. Fizarmonika e tij luante herë si solist në mbështetje të melodisë, e herë kishte natyrë improvizuese, e herë ishte në mbështetje të harmonisë klasike. Mbeti deri në fund tipi i artistit me laps në dorë.

2. Luani dhe këngëtarët: bashkëpunimi

Ardhja e Luanit rriti influencën e tij tek këngëtarët. Shpesh në biseda shprehej: “nga përvoja mësova se në shumë interpretime të ndryshme, përmbajtja emocionale e një kënge fitonte nuance e ngjyra të ndryshme. Prandaj jam përpjekur të ruaj fizionominë e çdo këngëtarit, duke patur në vëmendje timbrin, regjistrat, ngjyrën, temperamentin e në veçanti tonalitetin e këngës.” Në bashkëpunim me të, shumë këngëtarë u bënë

individualitete të spikatura edhe në shkallë kombëtare si: Sh. Alushi, F. e N. Gjergji, B. Qamili, M. Laze, M.çanga, E Kuqani. V. Zefi, B. Alibali, E. Jubani, V. Luka, A. Bala, grupi ``Karajfilat që ka Shkodra`` etj.

Bashkëpunimi i ngushtë me Bik Ndojën solli dukshëm një trajtim të ri të *jares* shkodrane. Deri atëherë pjesa e parë e *jares* ishte konceptuar si ankim, me nuanca sentimentale e dhimbje nga të gjithë muzikantët. Ajo mori një trajtim të ri e u pasurua në ngjyrat e një pathosi shprehës e emocional, duke na dhënë një model të përkryer të saj.

Bashkëpunimi me këngëtarin popullor Shyqyri Alushi erdhi në një moment të rëndësishëm për rritjen e nivelit artistik të tij, i vlerësuar për cilësitë vokale e për mënyrën tradicionale të interpretimit të këngës. I vetmi tenor lirik ekspresiv, që këndonte këngën aheng. Ky bashkëpunim solli një kulturë më të gjërë vokale e trajtim të frazës apo ngjyra më të pasura vokale.

Këngët e zgjedhura e të orkestruara për Bujar Qamilin e kanë tërhequr gjithnjë dëgjuesin shqiptar, sepse sollën tek ai ndjenja e përfytyrime, që i referohen psikologjisë e botës shpirtërore të tyre, ku në harmoni të plotë ndjehet jeta qytetare.

Në bashkëpunimin me Myfarete Lazen, kënga fitoi më shumë shprehje rinore e intelektuale. Ndërsa bashkëpunimi me këngëtarët M. çanga, A. Bala, V. Zefi e sollën këngën aheng më me thjeshtësi, spontanitet, ashtu siç gjendet tek vetë kënga. U ruajt natyra popullore e këngës. Në vitin 1999 ka punuar si udhëheqës artistik në Ansamblin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve.

3. Mbyllje

Në 23 vite të aktivitetit artistik si profesionist, ai na shfaqti bindshëm elemente të spikatura novatore në këngën aheng, por jo vetëm ruajti përfaqësimin e spikatur muzikor të qytetit, por e bëri atë më cilësore, autentike, duke sjellë një dialogim më të gjallë me shoqërinë. Luani synoi dhe realizoi që këngët aheng të depërtonin më fort tek dëgjuesi, e të pëlqeshin më shumë.

Fondi i tij muzikor përmbledh dhjetëra e qindra këngë të drejtuara prej tij, të punuara e të ripunuara në disa variante. Ky fond shkon deri në 600 këngë. Në një shkrim të gazetës ``Shekulli``, të datës 16 Korrik 2002, Ferdinand Deda (Artist i Merituar), do të bënte këtë vlerësim për të: „me aq sa e njoh unë Luanin, muzikantin e shkëlqyer, ai është me përmasa botërore në aspektin e interpretimit që zotëronte në fizarmonikë

si dhe njohjes së muzikës popullore, veçanërisht asaj shkodrane. Ai ishte njeri me të dhëna të spikatura, meditativ, punëtor, modest, megjithatë madhështor.”

Bibliografia:

1. F. Bala. *Kënga dhe Këngëtarët Shkodranë*. Lezhë: Fishta, 2014.
2. I. Alibali. *Në Shkodër të Gjithë Këndojnë*. Shkodër: Idromeno, 2006.
3. N. Topçia. *Ehengu Shkodran*. Shkodër: 2011.
4. R. Karakaçi. *Portret Muzikor- Luan Borova*. Shkodër: Idromeno, 2005.
5. T. Zadeja, T. Daija. *250 Këngë Shkodrane*. Shkodër: Idromeno, 2002.
6. Gazeta ``Shekulli``. 16 Korrik 2002.

▪ Skena të jetës universitare ▪

**KOHA PËR T’U KTHYER UNIVERSITETEVE TË DREJTËN
PËR PRANIMET E STUDENTËVE TË RINJ, SI PJESË E
AUTONOMISË UNIVERSITARE**

Pas eksperimentit katër vjeçar që zbatoi Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve duke vendosur notën mesatare si kriterin kryesor në pranimet e studentëve të rinj në universitete ka ardhur koha që të bëhet një studim mbi suksesin apo dështimin e këtij kriteri. Të gjitha të dhënat tregojnë se vendosja e këtij kriteri ka qenë arbitrare dhe i pakonsultuar me universitetet dhe si rezultat në vend të cilësisë së pretenduar ka sjellë: mohim të së drejtës për arsimim të qindra të rinjve shqiptarë, largim masiv të tyre drejt universiteteve të rajonit Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi por edhe universiteteve evropiane apo amerikane. Pra suksesi i kësaj reforme rezulton të jetë vënia në rrezik e ekzistencës së degëve të klasifikuara si “Mësuesi” por edhe i degëve të tjera.

Nëse kjo reformë çon drejt vënies në rrezik të programeve të studimit identitare dhe kombëtare të universiteteve publike, kjo do të jetë reforma më antikombëtare në arsimin e lartë, që nga hapja e universitetit të parë shqiptar. Ndaj ka ardhur koha që qeveria t’ua rikthejë të drejtën e përvetësuar universiteteve publike dhe private. Kjo e drejtë është një nga elementet bazë të autonomisë universitare e njohur edhe nga ligji i IAL-ve, për më tepër e zbatuar në të gjitha universitetet evropiane.

Nisur nga dështimi i këtij kriteri dhe gjendja e krijuar në universitetet publike, Asambleja e Përgjithshme e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në mbledhjen e saj më 04.03.2020 me votim unanim të të gjithë anëtarëve të pranishëm (mbështetur në vendimet me shkrim

të Asambleve të Fakulteteve të Shkencave Shoqërore dt. 17.02.2020, të Shkencave të Edukimit dt. 17.02. 2020 dhe të Gjuhëve të Huaja dt.14.02.2020) i ka kërkuar Ministrisë së Arsimit përmes një letrë zyrtare me dt. 5. 03.2020, që: “Kriteret dhe nota mesatare për pranimet e reja, në të gjitha ciklet dhe në të gjitha degët të konsiderohen si pjesë e autonomisë universitare”. Asambleja e Universitetit të Shkodrës përmes letrave zyrtare dhe deklaratave publike për mediat i kërkon qeverisë dialog për çështjen e mësipërme, dialog deri më tani i refuzuar në mënyrë të pakuptimtë. Është koha që Konferenca e Rektorëve dhe IAL-të të kërkojnë me vendosmëri rikthimin e të drejtës së mësipërme.

Pas eksperimentit katër vjeçar që zbatoi Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve duke vendosur notën mesatare si kriterin kryesor në pranimet e studentëve të rinj në universitete ka ardhur koha që të bëhet një studim mbi suksesin apo dështimin e këtij kriteri. Të gjitha të dhënat tregojnë se vendosja e këtij kriteri ka qenë arbitrare dhe i pakonsultuar me universitetet dhe si rezultat në vend të cilësisë së pretenduar ka sjellë: mohim të së drejtës për arsimim të qindra të rinjve shqiptarë, largim masiv të tyre drejt universiteteve të rajonit Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi por edhe universiteteve evropiane apo amerikane. Pra sukcesi i kësaj reforme rezulton të jetë rrezikimi i ekzistencës së degëve të klasifikuara po arbitrarisht si “Mësuesi” por edhe i degëve të tjera. Sigurisht Ministria e Arsimit, si në rastin e vendosjes së kriterit të notës mesatare ashtu edhe tani pas disa vitesh nuk ka bërë publik ndonjë studim që dëshmon, fillimisht dobinë e vendosjes së këtij kriteri dhe tani suksesin apo dështimin e tij. Vendosja e këtij kriteri është bërë vetëm duke u nisur nga një paragjykim i procesit të konkurseve të pranimit në universitetet publike, si proces që nxiste korrupsionin. Në vend që qeveria të forconte cilësinë e këtij procesi i njohu vetes të drejtën për të vendosur notën mesatare si kriterin bazë të pranimit të studentëve të rinj në universitete, në të gjitha degët, madje edhe në degën e mjekësisë apo degë të tjera që përthithin studentë me rezultate të larta. Dhe këtë kriter ajo e ka vendosur kohë e pa kohë, pa u konsultuar dhe pa marrë parasysh interesat dhe dëmet që u shkaktohen universiteteve dhe të interesuarve për të ndjekur studimet e larta në vendin tonë. Bie fjala, përveçse është arbitrare, qeveria e ka zbatuar këtë kriter me efekt prapaveprues, çka nuk është normale. Nota mesatare deklarohet në qershor për ata që kanë nisur studimet në shkollën e mesme para tre vitesh. Normalisht vendimet dhe ligjet nuk mund të kenë efekt prapaveprues. Në këtë rast

nota mesatare e nxjerrë në qershor duhet të ketë vlerë për ata që vitin e ardhshëm hyjnë në klasën e dhjetë dhe jo për ata që po përfundojnë klasën e dymbëdhjetë. Jo vetëm kaq, por nota mesatare gjatë këtyre viteve ka ndryshuar vit pas viti, por edhe vetë brenda IAL-ve ajo ndryshon sipas degëve të studimit. Për të njëjtën të drejtë, arsimin e lartë, zbatohen kritere të ndryshme.

Edhe vetë ligji 80/2015 i IAL-ve neni 25 pika 8, shprehet: *"Departamenti propozon kriteret e pranimi të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore"*. Pjesa e parë e këtij neni i jep departamentit kompetencën dhe autonominë e kritereve, ndërsa neni 74 pika 1 kundërshton nenin 25 duke ia lënë Kryeministrisë kompetencën e kritereve, çka do të thotë se ka kontradiktë brenda vetë ligjit dhe kjo pastaj interpretohet sipas vullnetit të atij që është më lart në piramidë. Kur kriterin kryesor e vendos qeveria atëherë çfarë autonomie u mbetet universiteteve?! Gjithashtu ne mendojmë se një ligj apo një nen i caktuar i ligjit nëse në një shoqëri demokratike prodhon rezultate negative, si ato që kemi përmendur, ai duhet ndryshuar me një më të mirë. Vetëm në vendet diktatoriale ligjet e këqija nuk vihen në dyshim dhe duhen zbatuar pavarësisht nga pasojat që sjellin.

“Nota mesatare” si kriter për pranimin në universitete është fiktive dhe përjashtuese

Vendosja e notës mesatare është përjashtuese dhe ka lënë jashtë të drejtës për arsimin e lartë një numër shumë të madh nxënësish, të cilët u janë drejtuar shteteve të tjera fqinje, apo evropiane. Këta studentë (të përjashtuar tek ne) atje ku studiojnë dalin me rezultate të mira dhe shumë të mira. Të mos harrojmë, se shumë shpejt këtyre studentëve u bashkangjiten edhe vëllezërit e motrat e tyre, bashkë me familjarët, duke e përkeqësuar edhe më tej plagën e madhe të braktisjes së vendit, e cila po çon në shpopullimin e Shqipërisë Veriore, por edhe të krejt atdheut. Vendosja e kriterit të notës mesatare nuk zbatohet në Evropë (studentët testohen nga universitetet me konkurse publike), dhe as në vendet e Rajonit. Të njëjtët studentë shkojnë në Kosovë, marrin një diplomë për mësuesi, kthehen në Shqipëri dhe punësohen si mësues nëpërmjet ekuivalentimit të diplomës. Nëse mbarojnë me nota të larta,

mund të punësohen edhe lektorë në universitete, edhe pse tek ne nga kriteri i notës mesatare ata janë përjashtuar.

Justifikimi se duam “arsimtarë cilësorë” që ndikoi për rritjen e mesatares për pranimet në degët “Mësuesi”, nuk përbën ndonjë argument sepse profesionistë cilësorë duam për të gjitha fushat e dijes dhe shkencës. Rasti më i qartë i ndryshimit të barazisë për të drejtën e arsimit të lartë, është rasti i vjetshëm kur qeveria, pasi ishte deklaruar nota mesatare dhe procesi i regjistrimeve ishte në fazën e fundit, ndërhyri dhe ndryshoi notën mesatare për disa degë të tjera. Shumë mirë bëri, sepse do t’u mohohet e drejta e studimeve të larta dhjetëra të rinjve, por në fakt kjo tregon mungesën e seriozitetit dhe përdorimin e këtij kriteri në mënyrë klienteliste, sipas interesit dhe dëshirës së qeverisë. Në rastin më të keq, por më të drejtë nota mesatare për pranimet në universitete mund të ishte ose e njëjtë për të gjitha degët ose për të shmangur diskriminimet dhe cënimin e autonomisë universitare e drejta për të vendosur kritere në pranimet e reja t’u rikthehet universiteteve të cilat janë qendra të dijes kulturës dhe kapaciteteve më të mira shkencore dhe profesionale që ka vendi, dhe si të tilla ato janë në gjendje ta organizojnë këtë proces në mënyrë të pavarur dhe dinjitoze.

Nëse Ministria kërkon të bëjë modifikime në stafin e mësuesisë së shkollave të mesme apo nëntëvjeçare, kjo është rruga e gabuar për ta arritur. Ky veprim po prodhon efekte negative, sepse prindërit për të përmirësuar mesataren e shkollës së mesme të fëmijëve të tyre, po i heqin nga shkollat e mesme publike dhe po i dërgojnë në ato private. Maturantët shpesh fitojnë nota fiktive për të kapur patjetër mesataren, por nuk arrijnë të marrin provimet e viteve të para në universitet. Gjithashtu, siç e dimë të gjithë, ndryshe është cilësia e nxënësve në shkollat e qyteteve kryesore dhe ndryshe ajo në shkollat e fshatrave apo të periferive. Pra mesatarja, nga kriteri cilësorë përkthehet në kriteri abuzimi, sepse rezulton se nxënësit që e kanë siguruar lehtësisht notën mesatare në shkolla private, apo në shkollat publike të periferive, të jenë në fakt fitues fiktivë të së drejtës për të hyrë në universitete. Ndërkohë nxënësit që në shkollën e mesme kanë prirje dhe aftësi të dëshmuara për një grup lëndësh, por nuk kanë të njëjtat prirje dhe aftësi për një grup tjetër, humbasin të drejtën e studimit në atë profil ku vërtetë mund t’i zhvillojnë këto prirje dhe aftësi, sepse nota mesatare nuk i lejon, siç po ndodh sidomos në degët “Mësuesi”, në të cilat mesatarja ka ardhur duke u rritur vit pas viti. Studentë me mesatare të lartë nuk fitojnë në degë

të tilla si “Mjekësi” në Universitetin e Tiranës, por fitojnë konkurset e pranimit në këtë degë, në universitetet evropiane. Gjithashtu studentë që nuk fitojnë të drejtën e studimit në Universitetin e Shkodrës në “Gjuhë shqipe dhe letërsi”, “Bio-Kimi”, në “Histori”, “Gjeografi”, “Italianistikë”, “Gjermanistikë” etj. mund t’i ndjekin lirisht studimet në universitetet evropiane. Paradoks i madh i prodhuar nga nota mesatare e vendosur nga qeveria shqiptare!

Kritere arbitrare, klasifikime arbitrarë

Disa programe studimi, arbitrarisht dhe kundër vetë ligjit të Arsimit të Lartë, u klasifikuan nga Ministria e Arsimit si degë “Mësuesi” që në nivelin e parë të studimeve “Bachelor” kur në realitet studimi në këto degë të siguron një diplomë të formimit të përgjithshëm, por jo diplomë “Mësuesie” sepse me këtë diplomë nuk mund të punësohesh mësues dhe gjithashtu nuk je i detyruar që nivelin e dytë të studimeve “Master” ta ndjekësh patjetër për mësues, por mund ta ndjekësh edhe në ndonjë profil tjetër të fushës. Ndërkaq me diplomën “Bachelor” mund të punësohesh në administratën publike apo private që lidhet me fushën përkatëse, por në asnjë rast mësues. Edhe në këtë rast nuk ka ndonjë studim të bërë publik, pse është e nevojshme të ketë në disa degë një mesatare dhe në disa të tjera një tjetër, më të lartë. Shto këtu, se disa degë të klasifikuara “Mësuesi” në nivelin “Bachelor” kanë edhe “Master Shkencor” që formon specialistë në disiplina e fusha të tjera.

Qeveria dhe tregu i punës kanë mundësinë të përzgjedhin për punësim sipas cilësisë së të diplomuarve

Kërkesa për cilësi është pjesë e universitetit dhe ai e realizon këtë detyrë në mënyrë të kënaqshme. Në përfundim të studimeve dalin studentë shumë cilësorë, mesatarë dhe të dobët, në të gjitha degët. Këtu misioni i universitetit është i kryer. Tregu apo qeveria ka mundësinë që të përzgjedhë atëherë nga këto kategori për të punësuar, sipas kriterit të aftësisë dhe cilësisë, atë me mesatare më të lartë dhe me kualifikime të tjera, siç është edhe provimi i licencës së profesionit.

Pra, këtu bie edhe “miti i cilësisë” së kuadrove të ardhshëm, sepse qeveria (apo punëdhënësit privatë) përmes ligjeve dhe rregulloreve që përcaktojnë kriteret për punësimin, gjithmonë kanë mundësinë që të përzgjedhin ndërmjet atyre që përfundojnë studimet universitare, kandidatët më cilësorë, që kanë përfunduar me rezultate të larta studimet, që kanë kualifikime dhe aftësi të tjera shtesë etj., pavarësisht se sa e kanë pasur mesataren në arsimin parauniversitar. Kjo gjë është plotësisht e mundur. Pra, çështja e cilësisë është e garantuar edhe kështu dhe nuk është aspak e garantuar nëse nxënësi hyn në universitet me notën tetë dhe del si student me notën mesatare gjashtë. Në përfundim të procesit cilësia varet nga MASR-ja sepse ajo ka edhe të drejtën e provimit për liçensën e profesionit, si filtër përfundimtar për tregun e punës.

Cikle studimi të stërzgjatura dhe me kosto të lartë

Cikli i studimeve për degët e klasifikuara si “Mësuesi” është dekurajues për maturanët me notë mesatare të lartë, të cilët preferojnë të zgjedhin degë të tjera me cikël më të shkurtër, ose me perspektivë për një profesion, i cili do t’u sigurojë të ardhura më të larta. Kandidati për mësues në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” por edhe në universitetet e tjera duhet të kryejë 3 vite “Bachelor” +2 vite “Master Profesional”+ provimin e gjuhës së huaj të çertifikuar nga kompani private + 1 vit praktikë + provimin shtetëror për liçensën e profesionit. Kjo kohë e gjatë shoqërohet me një faturë të kripur financiare, me radhën e gjatë nëpër portale, duke pritur punësimin dhe nëse ia del të mbijetojë gjatë kësaj periudhe, arsimtari i ri është i demotivuar, kur ballafaqohet me pagën prej afro 350 euro. Ka edhe një paradoks tjetër që duhet rregulluar: Nëse studenti fiton vetëm diplomën “Master Shkencor” ai nuk arrin të punësohet mësues, duhet të kryejë edhe “Master Profesional”. Në këtë rast diploma “Master shkencor” përmes dhënies provim të vetëm disa lëndëve të karakterit profesional, duhet të ekuivalentohet me diplomën “Master Profesional” në rast se mbajtësi i saj dëshiron të konkurojë për t’u punësuar si arsimtar, por aktualisht kjo nuk është e mundur. Një maturan me mesatare të lartë sigurisht do të kërkojë të studiojë në një degë më frytdhënëse dhe më të shpërblyer sesa ajo që e bën arsimtar. Madje me këtë nivel ai e ka të sigurtë se do të fitojë një të drejtë

studimi në cilindo universitet evropian, por edhe të fitojë një mbështetje me bursë ekonomike apo përfitime të tjera që tek ne nuk ekzistojnë. Kandidati i projektuar me notë mesatare të lartë për të vijuar studimet në programet e studimit “Mësuesi” sapo të shohë llogarinë e mësipërme është automatikisht i demotivuar për të hyrë në këtë program studimi. Është koha të hiqet dorë edhe nga miti i periudhës socialiste që e shihte mësuesin si i gjithëdijshmi i botës. Pa dashur ta nënçojmë aspak, mësuesi nuk është shkencëtar, siç pretendojmë ta bëjmë me gjithë këtë periudhë të mbingarkuar me studime, provime, kualifikime, gjuhë të huaja në program e gjuhë të huaja të çertifikuara nga kompani private etj. Mësuesi i mirë është një zbatues i mirë i njohurive të fituara nga studimet universitare, zbatues i mirë i programit të lëndëve të profilit përkatës, i njohurive të paraqitura në tekstin përkatës të lëndës dhe në Librin e mësuesit. Mësues të mirë ka diplomuar Universiteti i Shkodrës edhe kur ka qenë Institut Pedagogjik dy vjeçar apo tre apo katër vjeçarë. Pra, duhet parë mundësia e shkurtimit të kohës së përgatitjes së mësuesve dhe e kostonë së këtyre studimeve. Një propozim është shkurtimi i kësaj kohe nga 3+2 në 3+1 duke përfshirë brenda strukturës së programit mësimor edhe periudhën një vjeçare të stazhit. Pra, shkurtim i kohës me dy vite, një vit akademik dhe një vit stazh në terren. Duke hequr ndërkaq edhe detyrimin për dhënien e provimit me pagesë për gjuhën e huaj tek kompanitë private, për shkak se gjuha e huaj mund të jetë pjesë e programit studimor në nivelin “Bachelor” por edhe “Master profesional”.

Nota mesatare shkak dhe pasojë për vijimin e “rrjedhjes së trurit”

Vendosja e pragut të notës mesatare në kushtet që kemi përmendur më sipër, është duke vënë në rrezik edhe ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional” veçanërisht në degët e klasifikuara si “Mësuesi”. Për shkak të rënies drastike të regjistrimeve në nivelin “Bachelor” do të ketë pak ose aspak kandidatë për t’u regjistruar në këtë nivel studimi. Ndërkaq këto ditë nga shtypi mësojmë se edhe për pranimet në “Master Profesional” Ministria parashikon të vendosë kritere të reja, përsëri pa u konsultuar me universitetet. Pra, shqetësimi i të gjithë pedagogëve të universitetit tonë por edhe të universiteteve të tjera publike, është

fati i programeve të tyre të studimit, që sigurisht është edhe shqetësim i ligjshëm për vënien në rrezik edhe të vendit të punës, për të cilin kanë investuar dhe sakrifikuar gjithë jetën, aftësitë e tyre, duke besuar se ia vlen t'i shërbejnë më mirë vendit të tyre se sa një vendi tjetër. Ne mendojmë se Shqipëria nuk e ka luksin që të vijojë të eksportojë studentë, infermierë, mjekë dhe tani, me vënien në rrezik të shumë degëve të studimit, edhe pedagogë me kapacitete të larta shkencore dhe profesionale të cilët do të jenë të detyruar, që pas shumë vitesh punë e kontribute të shohin mundësinë e largimit nga vendi, për të mbijetuar. Të mos harrojmë se në disa universitete evropiane dhe amerikane, ka programe studimi dhe departamente që mbajnë të hapura me fondet e qeverive të tyre, edhe me pak studentë, programe studimi që lidhen me historinë, kulturën, gjuhën dhe letërsinë shqiptare.

Në universitetin tonë veçanërisht në degët e klasifikuara si “Mësuesi” numri i regjistrimeve ka rënë në minimumin e vet historik, që nga hapja e Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës (1957). I njëjti fenomen po ndodh në të gjitha universitetet publike në Shqipëri. Rënia e numrit të regjistrimeve është e ndjeshme edhe në degët e tjera krahasuar me katër vite më parë. Ne e shohim çështjen e notës mesatare si shkakun kryesor të kësaj rënieje dhe prandaj kërkojmë ose rikthimin e të drejtës së pranimeve të të gjitha degëve dhe cikleve të studimit tek universiteti ose gjetjen nga ana e qeverisë, në bashkëpunim me universitetet, të një zgjidhjeje më të dobishme se sa kjo që ekziston apo ajo që kërkojmë ne, për përmirësimin e kësaj gjendjeje. Pra, një dialog me qeverinë për këtë çështje është i kërkuar dhe i mirëpritur. Në këtë dialog duhet të jenë pjesëmarrës si palë të interesuara direkt, të gjitha universitetet publike dhe private, ndaj sjellim në vëmendjen e tyre gjetjen e mundësive për ta nxitur këtë dialog sa nuk është vonë, për të mirën e shoqërisë shqiptare dhe të ardhmen e arsimit të lartë në vendin tonë.

Prof.as.dr. Arben Prendi

*Fakulteti i Shkencave Shoqërore
(Anëtar i Senatit Akademik)*

Dr. Senada Reçi

*Fakulteti Juridik
(Anëtare e Senatit Akademik)*

Prof.as. dr. Violeta Alushi

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Dr. Phd. Arben Bushgjoka

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Dr. Peter Saraçi

Fakulteti Ekonomik

Dr. Artan Kalaja

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

▪ Personalitete të shqueme të artit e kulturës ▪

Ridvan KARAKAÇI

**RAMADAN SOKOLI,
KRIJUES I NJË TRADITE STUDIMORE**

-Puna dhe vepra e profesor Ramadan Sokolit është e përmasave të jashtëzakonshme në fushën e etnomuzikologjisë dhe muzikologjisë shqiptare. Si ish- student i tij në vitet '70 të shek.20-të, jam përpjekur me modesti të përshkruaj disa ndjenja e përshtypje nga njohjet e mia me të.

Profili i një studiuesi erudit

Emri i studiuesit Ramadan Sokoli(1920-2008), muzikolog, etnomuzikolog, kompozitor dhe pedagog është i njohur mirë në ambientet e kulturës dhe të artit shqiptar. Ai prej kohësh ishte bërë personifikimi i tipareve më të mira të studiuesit, shkencëtarit e krijuesit muzikor në Shqipëri. Vepra e tij nuk mund të ndahet nga sukseset e kulturës dhe artit shqiptar. Ai ishte një njeri me dijeni të gjithanshme, i mprehtë dhe me ndjenja të holla. Kultura e tij e gjerë del jashtë kufijve të artit muzikor. I dalluar për dije enciklopedike, ai tregoi interes në veçanti për çështjet e jetës shpirtërore të shoqërisë shqiptare. Për sa i përket intelektit, karakterit, temperamentit dhe origjinalitetit në punë, ai është dalluar në mënyrë të theksuar në ambientet e studiuesve dhe muzikantëve. Natyrë e kthjellët, bujare, plot pasion e kërkues, një njeri i pasionuar me mendime produktive dhe vrojtime depërtuese të një studiuesi e artisti të madh.

E gjithë vepra e tij shumëdimensionale mban vulën e tipareve të tij karakteristike, është refleks i personalitetit të tij stoik dhe krenar. Rruga e gjatë e jetës dhe veprimtarisë së tij, dëshmon për natyrën kërkuese, për punën këmbëngulëse dhe për vlerësimin e madh që ka për traditat e

pasura kulturore-artistike shqiptare.

Vijues i traditave patriotike dhe artistike të Sokolajve

Lindi në vitin 1920, në Shkodër, në lagjen ``Dërgut``, në një nga familjet më të njohura të traditës dhe qytetarisë shkodrane e shqiptare, atë të Sokolëve. Nipi i Hodo Sokolit, patriot i shquar shkodran i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Së bashku me dy vëllezërit, Brahimin dhe Hodon, kanë qenë të burgosur politik në sistemin komunist. Trashëgoi shpirtin dhe mendësinë e një patrioti, dashurinë për vendin, kulturën dhe artin.

Siç dihet, studimet e larta i kreu në Akademinë e Arteve në Firenze, Itali, për kompozicion e flaut në vitet '40 të shekullit të 20-të. Krahas studimeve specifike muzikore, gradualisht veprimtaria e tij do të marrë përmasa të reja, veçanërisht në fund të viteve '50 në fusha hulumtuese e shkencore, ku nga vitet '60, etnomuzikologjia e muzikologjia do të bëhen të parat në punën e tij. Nxitje për këtë ndryshim thelbësor u bënë ekspeditat e rëndësishme hulumtuese etnomuzikologjike si: ekspedita shqiptaro-gjermane në vitin 1957 dhe ajo shqiptaro-rumune e vitit 1958. Këto dy ekspedita hulumtuese shenjua ndryshimin e madh për jetën dhe veprimtarinë studimore-shkencore etnomuzikologjike të Sokolit.

Punimet e para studimore mbi traditën

Punimet e para serioze në këtë fushë i përkasin pikërisht këtyre viteve që lidhen me materialet folklorike të eksploruara nga dy ekspeditat, si: ``Mbi Disa çështje të Folklorit Muzikor`` dhe ``Prozodia dhe Metrika Jonë Popullore``, të cilat na dëshmojnë se tashmë profesor Ramadani vendosi t'i kushtojë me mish e me shpirt studimeve mbi traditat tona muzikore. Për mbi 40 vite përkushtimi në këto dy fusha si etnomuzikologjia dhe muzikologjia e bënë atë një ndër figurat më të ndritura të albanologjisë shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të

Në vitet në vazhdim ai do të plotësojë korpusin e studimeve me vepra madhore si: ``Folklori Muzikor Shqiptar`` (morfologjia), ``Veglat Muzikore të Popullit Shqiptar``, ``Vallet dhe Muzika e të Parëve Tanë``, ``Figura të Ndritura``, ``Gjurmë Folklorike``, Këngë Patriotike``, ``16 Shekuj`` etj. Deri në vitin 1974, kur doli në pension ka qenë pedagog në Liceun Artistik ``Jordan Misja`` ku ka dhënë mësim në instrumentin e flautit dhe për herë të parë në Shqipëri lëndën *Folklor Muzikor*.

Ramadan Sokoli, si muzikolog është mjaft i njohur edhe jashtë vendit. Ka marrë pjesë si lektor në universitete të ndryshme të Evropës apo në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare si: Gjermani, Zvicër, Turqi, Itali, Greqi, Sllovaki etj. Në vitin 2002, Presidenti i Shqipërisë e nderon me titullin ``Mjeshtër i Madh i Punës``, në vitin 2020 i është akorduar titulli ``Nderi i Kombit``, ndërsa në vitin 2006 Bashkia e Shkodrës i akordon titullin ``Qytetar Nderi`` ndërkohë një ndër rrugët e qytetit mban emrin e tij.

Vepra me rëndësi themelore në studimet mbi kulturën shqiptare

Që në punimin e parë ``Prozodia dhe Metrika Jonë Popullore`` tërheq edhe vëmendjen e figurave të kulturës shqiptare. Vlerësohet nga Gjergj Zheji se: ``punimi në fjalë është një ndër përpjekjet e sukseshmet e më serioze gjer më sot për të depërtuar nëpërmjet muzikologjisë në botën e pasur dhe të shumanshme të vargëzimit popullor``. ``Folklori Muzikor Shqiptar`` (morfologjia) është vepra e parë dhe e plotë etnomuzikologjike shqiptare. Një vepër e sistemuar dhe klasifikuar, në të cilën përmes shembujve e ilustrimeve të këngës sonë popullore, në mënyrë të integruar trajtohen elementet muzikore dhe poetike. ``Gjurmë Shqiptare`` është një triptik i përbërë nga 3 studime: ``Shfaqjet Popullore``, ``Valle Popullore`` dhe ``Veglat Muzikore``. Secili studim mund të qëndrojë më vete, por së bashku ato mund të merren si një e tërë, sepse i lidh një aspekt: gurra e popullit. Vetëm një njohës i thellë i fushave të lartpërmendura, siç ishte profesor Ramadani, mund të rrokte një problematikë kaq të gjerë dhe të thellë.

Profesor Vehbi Bala e ka vlerësuar me të drejtë veprën ``Gjumë Folklorike`` si fryt i një pune të gjatë kërkimore e studimore. ``Të qëmtosh`` shkruan V. Bala, ``të zbulosh, të studiosh e të përgjithësosh në këtë fushë të paanë është vërtet një punë e mundimshme që dëshmon për këmbëngulje të rrallë e për metodologji të sigurtë``. Në fushën e muzikologjisë, libri ``16 Shekuj`` është i pazakonshëm. I ndarë në nëntë kapituj paraqet një studim të veçantë, qoftë për një personazh të vetëm krijues, qoftë për një grup individësh krijues arti e kulture që janë pjesë e historisë së kulturës së popullit shqiptar. Ai trajton mbi 40 figura të shquara që përfshin që nga N. Dardani, J. Kukuzeli e deri tek A. Moisiu e F. Noli. Do ta mbyll me një vlerësim të shkëlqyer të R. Munishit ku thotë se: ``16 shekujt e Ramadan Sokolit nuk mund të lënë pa theksuar se në mbështetje të organizimit dhe të mbarështrimit të lëndës do të thoshim se i ngjan shkrimit të një vepre enciklopedike me të dhëna të

shumta për secilin veprimtar. Veprës ia shton vlerën sidomos qëndrimi i autorit që të mos kufizohet në të dhënat e një apo dy fushave, por sjell në të çdo gjë që i del përpara si dëshmi për jetën dhe veprimtarinë e krijuesit. Pikërisht për këtë arsye kjo vepër shënon një kontribut me vlerë të lartë në shkencat albanologjike`.

Referencat janë marrë nga:

Munishi, Rexhep. "Probleme Etno-Muzikologjike" Prishtinë, Instituti Albanologjik, 1997.

Willy KAMSI

NINO SARAÇI - jeta e një artisti shkodran

Tradita artistike e Shkodrës

Në të gjitha kohët Shkodra ka pasë dftue se u dallonte prej qyteteve të tjera të Shqipnisë. Në këtë qytet u zhvilluen për herë të parë artet, letërsia, shkencat e sporti në Shqipni, në një perfëtyrim me të vertetë prenimor, gjâ që e dallon si në Shqipni ashtu edhe jashtë saj. Kjo për hir të thirrjes së saj kah Prendimi, kah kultura prenimore, tue e bâ prá të rrezatonte rrjedhimisht edhe dritë të veten.

Muzika, në veçanti, pati një zhvillim në shêj. Qysh me ardhjen e dirigjentit Giovanni Canale prej Napolit, me ftesë të Argjipeshkvisë Katolike të Shkodrës, e me Palokë Kurtin, që qe trashëguesi i tij, tue themelue banda, muzika mori përmasa të tilla sa me u bâ shprehje e jetës kulturore e shoqnore të qytetit. Në tê patën marrë pjesë muzikanta prej shtresave të ndryshme, të dashnuem me artin e që, në formë krejt vullnetare, i jepshin gjallni jetës së qytetit, tue e sjellë Shkodrën të barasohej në këtë lamë me qytetet e njoftuna prenimore, ashtu si pat thanë një studiues i cili, aty kah fundi i shekullit XIX, e kishte vizitue Shkodrën. N'atë kohë, si edhe natyrisht mâ vonë, nuk pati familje në të cilën pjestarë të saj të mos i bijshin një vegle muzikore. Aq kishte depërtue muzika në zemrën e çdo shkodrani sa quhej ky qytet Napoli i Shqipnisë, mbasi kudo ndihej gazi e kanga që, kurdoherë, shpërthejshin prej zemrës së secilit qytetar.

Familja Saraçi

Në këtë kontekst hyn një ndër familjet e vjetra shkodrane si ishte ajo e Gjokë Saraçit, gjyshit të Gjonit, i njoftun ky i fundit, në rrethin e vet familjar e shoqnor, më fort me emnin Nino. Simbas traditës kishte trashiguar emnin e gjyshit. I ati, Sandër, kishte krye shkollën tregtare të Etënve Jezuitë. Atë shkollë që mbeti në kujtesën kombtare si Kolegja Saveriane. Ishte një shkollë që kishte marrë një drejtim tregtar, mbasi kështu ishte dishiri i prindëve të nxanësave, që këta të baheshin të aftë për me drejtue e me vijue, me një përgatitje të shëndoshtë, rrugën e ndjekun prej tyre, tue i krijue familjes një jetesë të sigurtë. Gjatë kësaj periudhe Sandri mori pjesë edhe në bandën e qytetit si klarinetist. Familja Saraçi ruen ende sot e këso dite klarinetën e përdorun prej Sandrit. Me përfundimin e studimeve pranë Kolegjes së Jezuitëve do t'i vijonte, gjithnjë në atë profil, në Vjenë t'Austrisë.

Arti dhe muzika kanë qenë një pjesë e randësishme e jetës së familjes Saraçi. Edhe halla e Ninos, Adelaide Saraçi (Muzhani) ishte piktoresh autodidakte, punimet e së cilës u vlerësuen në një rasë në një konkurs mbi pikturën.

Sandri, për një periudhë u mor me politikë, tue qenë deputet i Shkodrës, sekretar i përgjithshëm dhe më vonë Ministër i Punëve Botore (1922-1939). Me pushtimin e Shqipnisë prej Italisë në vjetin 1939, i ofrohet nga autoritetet e kohës marrja pjesë në qeveri, por refuzon. Për me shmangë ndonji ngjarje të papëlqyeshme largohet përkohësisht nga Shqipëria. Në këtë periudhë prej disa muejsh, ndërsa ai gjindej në Romë, familja e tij e përbame prej së shoqes, Zinë, dhe Ninos të vogël shkoi në Bari (Itali) pranë familjes së t'atit të Zinës, tregtarit të përmendun shkodran Pjetër Ndoc Daragjati¹.

Përgatitja e muzikantit të ri Nino Saraçi

Këtu e ndiejmë për detyrë të kujtojmë se mësuesja e parë për piano e Ninos ka qenë vetë e ama, Zina. Kjo, ende vajzë, tue qenë me familjen e vet në Romë, kishte ndjekë Konservatorin për piano. Studimet e saja

¹ Në lidhje me jetën dhe punën e tij të shifet: Willy Kamsi, Pjetër Ndoc Daragjati pioneri i tregtisë italo-shqiptare. Në: "Phoenix", Shkodër, VIII/2004, nr.1-6 (39), ff.91-103 me fot.

kishin vijue për 9 vjet. Prandej ajo, përveç përgatitjes të shëndoshë artistike, kishte në dorë të gjithë atë literaturë, si dhe partiturat e kompozitorëve më të përmendun, që do t'i shërbejshin edhe Ninos për të gjithë jetën e tij artistike, tue u bâ kështu një ndër pianistët e përmendun të botës muzikore shqiptare.

Gjatë pushtimit italian, në Radio-Tirana punonte si dirigjent një emër i njoftun për Tiranën e asaj kohe. Ky ishte italian, mjeshtri Mario Ettore, i cili do të bahej edhe mësues i Ninos deri kur, bashkë me italianë të tjerë, largohet përfundimisht drejt Atdheut të vet. Kështu që Ninoja do t'i vijonte studimet e veta tue ndjekë mësimet e pianos, prej vjetit 1945 deri më 1948 me pianistin e njohun Tonin Guraziu.

Mbas pushtimit italo-gjerman erdh pushtimi komunist i Shqipnisë me të gjitha rrjedhimet e tija. Erdhi me pushkatime në masë, me internime të familjeve të pafajshme, tue përfshi gra, fëmijë e pleq të dërguem në kampe përqendrimi e deri kampe çfarosjeje, gjâ që kurrnjherë kishte ndodhë në Shqipni. Por regjimi i vendosun po zbatonte me besnikë programet e direktivat e dhanuna prej udhëzuesve e komanduesve të tij, serbëve e rusëve, anmiqve shekullorë të kombit shqiptar. Ishin direktiva antikombëtare të frymëzue me prej diktatorit gjeorgjan, Stalinit.

Ketë rrugë pat ndjekë, pa ju shmangë kurrfare, diktatori tjetër, kriminel i luftës dhe i mbasluftës, Enver Hoxha. I njajti fat, ndër të tjera, i ndodhi edhe familjes së Sandër Saraçit. Edhe kësaj i erdhi prà rradha që të dëbohej nga Tirana. Rrjedhimisht edhe Ninoja i vogël e pësoi, tue e përjashtue prej shkollë si pjesëtar i një familjeje “së prekun” - kështu thohet n'atë kohë – politikisht, Ninos dymbëdhetëvjeçar, si “bir Ministri”, nuk ju lejue prà vijimi i shkollës. Arsye e këtij dëbimi ishte edhe aktiviteti politik i t'et gjatë viteve të mbretënisë s' Ahmet Zogut.

Ndonse Sandri nuk u burgos kurrnjherë, nuk i shpëtoi internimit për 4 vjet në Fier. Aty qe dërgue për me punue në ndërtimin e kanalit Levan-Fier. Bashkë me të ishin personalitetet më në shëj të inteligjencës shkodrane.

Karriera artistike dhe përndjekjet e regjimit komunist

Me përgatitjen që kishte si nga e ama, ashtu edhe nga mjeshtri Mario Ettore, Tonin Guraziu e në fund Ida Melgushi, Ninoja qe i aftë me nisë jetën e vet artistike. Së pari e morën si koncertmaestër në Shtëpinë

e Kulturës në Shkodër përkrah kompozitorit dhe dirigjentit Prengë Jakova. Aty punoi për disa vjet, prej shtatorit 1954 deri në 1957, me një rrogë qesharake prej 100 lekësh të asaj kohe. Nuk kufizohet vetëm te puna e koncertmaestrit, por jep plot recitale si solist, shoqnon kangëtarë e instrumentistë të ndryshëm. Madjë, kur nisin të duken veprat e para madhore të kompozueme nga autorë shkodranë, e me këtë rasë opereta “Lejlaja” e Tish Daisë, përgatit solistët dhe korin.

Aftësia e tij prej artisti nuk mbeti pa rá në sý. Profesor Mustafa Krantja ban që t’i pranohet kërkesa për qendrim definitiv në kryeqytet, punë tejet e vështirë në rrethana të tjera, dhe në shtatorin e vitit 1957 nis punën në Teatrin e Operas dhe Baletit në Tiranë. Kështu që muji me punue me të gjithë aftësitë e tija në përgatitjen e solistëve të operave “Traviata”, “Cavalleria rusticana”, “Berberi i Seviljes”, etj. me pedagogun rus V. Garjaçkin.

Kjo punë nuk zgjati shumë. Me 1958 me “urdhër nga lart” Dega Ushtarake e Shkodrës i sekuestron letërnjoftimin, pa të cilin nuk do kishte mâ mundësi të lëviste drejt Tiranës. Të mos harrojmë se letrat e njoftimit në regjim komunist kishin vlerën e një pasaporte të vërtetë, por jo për me shkue jashta shtetit. Këto ishin “pasaporta” të vërteta për me u çvendosë nga një qytet në tjetrin mbrenda kufijve të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. E gjithë kjo, për Ninon bahej – mbasi mbeti madjë pa punë deri në maj të atij vjeti – për me e detyrue të rrinte në Shkodër, tue qenë se nevojitej si koncertmaestër për solistët dhe korin me rasën e përgatitjes për shfaqje të operes “Mrika” të Preng Jakovës. Përveç punës së koncertmaestrit i kushtohet edhe fagotit. Kjo ndodh mbasi në Orkestrën Simfonike të Shkodrës mungonte një instrumentist i tillë.

Vumja në skenë e operes “Mrika” solli që, prej dhjetorit të po atij vjeti e deri në prill të vjetit 1959, të mbesë përsëri pa punë.

Në këtë kohë ndodh një kthesë në jetën e tij artistike. Nga koncertmaestër të kthehet në pianist, në tavernën e hotel “Dajtit” në Tiranë. Aty, nën drejtimin e Muharrem Murthit, merr pjesë në grupin muzikor që shoqnonte pritjet për ambasadat, delegacionet e hueja etj. Endë sot ka persona, të ardhun n’atë kohë në Shqipni nga jashtë, që kujtojnë muzikën e shkëlqyeshme të pianistit. Por njëkohësisht, prej 1959 deri më 1962, e marrin përsëri koncertmaestër në Teatrin e Operas dhe Baletit e pedagog në Shkollën Teatrale. Kryen inçizimet në Radio-Tirana si solist e pianist i orkestrave të kohës, nën drejtimin e K.

Kotes, N. Uçit, Ll. Morekës. Megjithatë nuk rrin pa vijue punën e vet kualifikuese dhe fillon studimet në Konservatorin e Tiranës.

Periudha që po përshkruajmë del e frytshme për sa i përket kontributit që i jep jetës artistike të Vendit. Në Teatrin e Operas dhe Baletit përgatit solistët për tetë opera dhe, ajo që është për t'u vû në dukje, dhe që ka me qenë pasqyra e pjekunisë së tij të mâtejshme në lamën e artit muzikor, kanë me qenë kompozimet e para të muzikës së lehtë. Me tekst të përkthyesit të njohun Robert Shvarc kemi kangët “Për ty” dhe “O mos harro”. Kjo e dyta paraqitet për Festivalin e parë të Kangës, por, si ndodhi edhe për kompozime të tjera të Ninos, nuk pranohet. Për këtë Festival nuk qe miratue as kanga “Ti në pranverë” me tekst të Zef Lekajt, e kompozueme në vjetin 1962.

Arrestime dhe persekutime të reja

Vijnë prap kohë t'errta. Në prill të vjetit 1962 arrestohet në Teatrin e Operas dhe Baletit për agjitacion, propagandë dhe veprimtari anmiqsore (që i kapshin Nenet 73/1 e 117 të Kodit Penal). Akuza, Ninoja kishte shkruar në ambientet e Teatrit parulla kundër “udhëheqësve” të kohës. Akuza ishte krejt e pabazë, por në kohën e komunizmit me akuza të tilla parashiheshin 10-25 vjet burg e, pse jo, deri dënimi me vdekje, i cili gjindej në themel të të ashtuqejtunit Kod Penal, si masë e skâjshme ndër mâ se 35 nene të tij, dhe që pëlqej së tepërmi prej “drejtësisë” komuniste.

Mbas 70 ditësh në Hetuesinë e Tiranës, mbasi në ambientet e Teatrit ishin përsëritë parullat, ndërsa Ninoja ishte endë i arrestuem, lirohet për mungesë provash dhe përsëri dëbohet në drejtim të Shkodrës. Kjo periudhë paraburgimi nuk shenjohet kund, e prandej për shtetin shqiptar nuk del i arrestuem. Dhe kjo shifet nga dëshmia penale e Ninos lëshue prej Sekretarisë së Gjykatës së Tiranës në tetorin e po atij vjeti.

Mbasi kthehet në Shkodër s'i mbetë tjetër veçse të vijojë pumën e vet dhe, në Estradën e rrethit të këtij qyteti punon si pianist, kurse si koncertmaestër në Shtëpinë e Kulturës. Përsëri përpiqet të afirmohet në kryeqytet dhe, në nandorin e vjetit 1962, me Prengë Jakovën përgatit Festivalin e Parë të Kangës në Shqipni. Njikohësisht është iniciator dhe organizues i Festivalit të Parë të Kangës së Pionerit.

I vjen radha Festivalit të Dytë, Ninoja përsëri vëhet në lëvizje tue

paraqitë dy kompozime për konkurim. Por, si ishte bâ zakon, edhe këto nuk u miratuan. Kangët ishin: “Stina e rinisë” me tekst të Zef Lekajt dhe “Beqari dhe viti i ri” me tekst të Tano Banushit. Kurse kanga “Në skaj të rrugës” me tekst po të Tano Banushit, dhe e këndueme nga Sandër Bianku, fiton çmimin e tretë po atë vit në Festivalin “Kanga e punës në Shkodër”. Në vjetët 1963 e 1964 vijuen kompozime të tjera, që përbânë një varg kangësh për Estradën e Shkodrës. Dhe qenë: “Në një ekspeditë” me tekst të Çesk Zadejës, “Ballkoni i ri” dhe “Tango n’bregdet”, të dyja me tekst të Tano Banushit, kurse me tekst e muzikë të vetë Ninos “Muzika dhe ti”.

Vijojnë ndërkaq edhe përpjekjet për me marrë pjesë në festivale të Tiranës. Po përsëri, në vjetin 1964, kanga “Pranvera erdhi përsëri” me tekst të Tuni Papuçiut nuk qe pranue për Festivalin e Parë të Pionerit të Tiranës. Në Shkodër puna shkon mâ mirë dhe kanga “Kalorësi i vogël” me tekst të Sandër Gerës merr pjesë në Festivalin e Dytë të Pionerit të Shkodrës dhe e këndojnë Justina Alia e Nikoleta Shoshi, kangëtare të reja, që mâ vonë me zanet e tyne do të baheshin të njohuna në shfaqjet e ndryshme të Estradës së Shkodrës.

Por, mbi çdo krijimtari, si ishte në “rregullat” e regjimit komunist, rrinte si orrl “kritika” e ashpër dhe “revolucionare” e funksionarëve të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, që në organin e tyne të përmujshëm “Nëntori” shpreheshin me gjithë dufin e tyne kundër guximtarëve që i shkëlshin ato “rregulla”. Në mënyrë të pashmangshme kjo ndodhi edhe për kangën “Kalorësi i vogël”. Posa mori fund Festivali, kjo kangë u bâ objekt i një kritike të fortë në faqet e “Nëntorit”. Autor ishte Nikolla Zoraqi. Simbas tij, kjo kangë “anon më shumë nga karakteri i estradës sesa nga kënga shqiptare, nga kënga qytetare për masat dhe nga kënga korale”. Kritikohet pra fakti se kanga nuk përmbante motive popullore, si ishte e detyrueshme n’atë kohë, tue vû njikohësisht në shenjestër harmoninë dhe arrangjimet “e komplikuara”, simbas autorit të artikullit.

Megjithatë Ninoja, kambëngulës në punën e vet krijuese, mbërrin me e krye kompozimin e një operete për fëmijë, “Ne jemi vetëm por kemi shokë me mija”, me libret të Gjovalin Çarkaxhisë. Opereta përbahet nga 12 numra të ndamë në tri pjesë dhe një epilog. Premiera u dha në Shkodër me 5 prill 1964 dhe u ekzekutue nga nxanësit e shkollës “7 Nëntori”, në një konkurs të shkollave të qytetit. Suksesi qe i menjihershëm, dhe kjo operetë vijoi të shfaqej jo mâ pak se tetë herë.

Këtu kemi një ndërpreme të veprimtarisë së tij krijuese e pianistike, sepse që thirrë ushtar. Simbas ligjëve të kohës, djetim e vetëm me prindë në ngarkim (të cilësuem pa ndihmës) nuk e kishin detyrimin e shërbimit ushtarak. Madje kufini më i skajshëm ishte mosha e 29 vjetëve. Por për Ninon nuk vlente kjo dispozitë, tue qenë gjithmonë në evidencë biografia e tij. Kështu që detyrohet të fillojë shërbimin në prak të 29 vjetëve, tue lanë edhe prindët vetëm e tue mos pasë madje këta as pension. Ata që ishin ne biografi të keqe nuk e kishin privilegjin të bájshin një shërbim ushtarak të rregullt, si çdo qytetar tjetër, por ishin të detyruem ta bájshin në brigadat e punës.

Arma e Xhenios ne ushtrinë e viteve komuniste ishte kamp pune për “të prekurit” politikisht. Punohej për bonifikim tokësh e në bujqësi. Këtë psoi edhe Ninoja. Në një peridhë që përfshihej midis vjetëve 1965 deri më 1967, punoi së pari në Dushk të Lushnjës e më vonë në Fier e në Sarandë. Për hir të aftësive të tija, gjatë kësaj kohe Ninoja ngarkohet të punojë edhe në Shtëpinë e Kulturës së Fierit, me orkestrime e përgatitje solistash.

Mbasi kreu edhe këtë detyrë, kthehet në Shkodër e caktohet puntor mirëmbajtjeje në NISH Lëkurë-Këpuca ku ban punën e disenjatorit, por megjithatë njëheri bashkëpunon me Shtëpinë e Kulturës si koncermaestër.

Në këtë kohë njihet me Diana Berkin, ekonomiste n’atë fabrikë, martohet me të në vjetin 1970 dhe u lindin dy fëmijë, Andi dhe Ira, përkatësisht me 1971 e 1976. Po në vjetin 1970, në një takim të mbajtur në Korçë, luen me sukses një koncert të Grieg-ut.

Nga vjeti 1971 deri në vjetin 1991 punon fillimisht si mësues pianoje dhe më vonë koncertmaestër në Shkollën e Mesme Artistike “Prengë Jakova” në Shkodër, mbasi iu ngarkue kjo punë tue pasë qenë praktikisht i vetmi pianist e kompozitor profesionist në Shkodër, dhe ndër të paktët në Shqipni. Po mos t’ishin këto veçori, sa për biografinë “e keqe”, do kishte punue në punë krahu e jo në arsim.

Në vitet ’80 (1982, 1983 etj.) Ninoja merr pjesë, bashkë me mësues e nxanës të Shkollës së Muzikës, në Takimin Kombëtar të Kangëtarëve Lirike në Korçë. Në vjetin 1983 (me 21 dhjetor) një përmbledhje e veprimtarive të Takimit transmetohet nga TVSH. Po në këto vite, tue ju njoftë profesionaliteti, merr pjesë në komisionet për konkurset e pranimit në Institutin e Lartë të Arteve.

I pavlerësuem dhe iurvejuem

Por përsëri rreth tij sjellet hijeja e zezë e Sigurimit, dhe gjithë përfundon me arrestimin e tij të dytë. Për disa ditë e shef veten të izoluem në një burg në Veri-Lindje të Shqipnisë. Gjatë kësaj kohe merret në pyetje me akuzën e zakonshme: agjitacion e propagandë. Dhe gjithë kjo kishte lidhje me kryemjen e shërbimit ushtarak, të cilin si dihej e kishte krye gati njëzet vjet më përpara. Ninoja me kambëngulje nuk pranon asnjë nga akuzat dhe përfundimisht detyrohen ta lirojnë. Kështu që kthehet edhe një herë në Shkodër. Por do vërejtë se edhe ky burgim i shkurtë nuk del në certifikaten penale.

Edhe pse profesionaliteti i Ninos njifet dhe pranohej në të gjitha ambientet artistike shqiptare, vijon të ndikojë në të prejdardhja familjare, kështu që nuk gëzon ato privilegje e lehtësime që regjimi komunist kishte parapa për shkrimtarët e artistët. Tue qenë se Ninoja nuk ishte anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve ndodhi të mos gëzonte ato leje krijimtarie, orari të reduktuem, pianoje në shtëpi, autorizimesh për orendi shtëpiake apo për zgjanim banimi që ishin një prerogativë e antarëve të Lidhjes. Njiheri ndodhte që, pushteti komunist, tue ngulë kambë në luftën e klasave, të punonte për veçimin e atyne që kishin vlera artistike dhe kulturore, kështu që, me ndonji përjashtim të rrallë, deri emni i Nino Saraçit nuk shkruhej në afishe, reklama, fletë-palosje si dhe nuk paraqitej nga prezantuesit e koncerteve ose recitaleve.

Gjatë viteve të karrierës artistike, Ninoja ndiehej i pavlerësuem. Jo vetëm kaq, por edhe pengohej, sidomos nga kolegë muzikantë të lidhun me regjimin komunist, të cilët ishin madje edhe të paaftë ose mediokër, partia komuniste i nderonte me tituj “Artist i merituar” apo “Artist i Popullit”, e kjo bahej për hir të anëtarësimit në parti apo thjesht për servilizmin që kishin dftue tue përkrahë e tue u dftue aktivë në zbatimin e “iniciativave revolucionare” të saja ose edhe tue spiunue shokët e vet.

Megjithëse, nga ana informale, vlerësoheshin aftësia dhe korrektësia e Ninos, kërkesat apo ankesat e tija nuk merreshin parasysh, madje, nga sekretarët e partisë ose nga Seksioni i Arsimit përcillej me fraza të përgjithshme si: “Mos i jep rëndësi”, “Kemi harruar”, “Herën tjetër e ke rradhën ti” etj, etj.

Vlerësimi nga profesionistët e fushës

Ndonse i përndjekun në forma të ndryshme pati ngushllimin e dashnisë, nderimit dhe vlerësimit që kishin për të muzikantët më të mëdhaj shqiptarë si P. Jakova, M. Kraja, M. Krantja etj., deri te më të rijtë, nxanësit e pianos e të kantos si dhe të atyne që ka shoqënuë si pianist për 21 vjet me rradhë në konkurset e Institutit të Lartë të Arteve në Tiranë. Midis artistëve të huej me të cilët ka pasë të përpjekun profesional ose i ka shoqënuë në piano, kemi emna si Tito Schipa, T. Gusajeva, Ingeborg Nerius, Aleksandër Vargoliq, Tinko Stançeff, Andrea Preger, Agop Vartarian, Ljudevid Pap etj.

Dý vlerësime, në pikëpamje artistike, qenë shprehë për të, nga Tito Schipa e nga Prengë Jakova.

Tito Schipa, njeni ndër dy tenorët më të mëdhaj e të përmendun italian, tjetri tue qenë Beniamino Gigli, i njohun me Ninon në vitet '60 në Tiranë, pat thanë se, sikur të shoqënohej në *tournee* me piano nga Ninoja, do ta kishte ndie veten të ri edhe një herë.

Prengë Jakova, aq e ka vlersue talentin e Ninos, sa për vumjen në skenë të operës së parë shqiptare “Mrika”, kishte ngulë kambë tue vù si kusht të domosdoshëm kthimin e tij patjetër në Shkodër. Kjo ndodhte në vjetin 1958.

Kompozimet

Po qe se i japim një shikim karrierës 40-vjeçare të Nino Saraçit do të vërejmë se ka kompozue:

- Rreth 20 kangë për fëmijë.
- Rreth 20 kangë të muzikës së lehtë.
- 2 koncerte për piano dhe orkestër, vlerësue pozitivisht nga artistë si: Albert Paparisto, Tish Daija, Tonin Harapi, Gjon Simoni, Ferdinand Deda. Megjithatë mbetën të pabotueme.
 - 9 prelude për piano.
 - 1 tokatë për piano.
 - 6 fuga për piano.
 - 6 miniatura për piano.
 - 3 sonatina për piano.
 - Pjesë të ndryshme për fëmijë misid të cilave edhe disa kangë

djepi me motive popullore nga Shkodra, Labëria dhe Kolonja.

Vetëm prej rreshtimit të këtyne veprave origjinale, fryt i një peme shumëvjeçare, kemi parasysh aktivitetin e zhvilluem prej Nino Saraçit gjatë një karriere 40-vjeçare. Mjerisht, sepse pa tematikë politike, të gjitha këto vepra mbetën të pabotueme. Përveç krijimtarisë së tij artistike, do të përmendim një mori shoqnimesh në pianofortë për kangë e pjesë instrumentale kompozitorësh të ndryshëm.

Nji veçanti e jetës artistike të Ninos, përveç pianos, asht edhe prirja e tij për pikturë. Jo vetëm kaq, por ka edhe një déll poetik, tue vjershue përveçse shqip dhe italisht, tue tregue me këtë edhe një talent të posaçëm që rridhte në një pjesë nga cilësitë vetjake, por edhe nga ambienti familjar në të cilin u rrit, e që ndikoi se tepërmi në formimin e tij. Nji gjâ, që i ka pàs ra në sÿ kujdo që pat të përpkun me të, ishte kultura e tij e gjanë, kulturë që rrokte të gjitha sferat e artit e të dijes.

Së fundi mund të thomi që, megjithë lanien e qellimshme në hije, Ninoja u njifte e u vlerësonte shumë si prej rretheve artistike ashtu edhe prej popullit të thjeshtë e artdashës, jo vetëm në Shkodër e Tiranë, por në të gjitha Shqipninë.

Presionet e ndryshme që Nino Saraçi pësoi gjatë jetës, në mënyrë indirekte e çuen drejt vdekjes së papritun prej infarkt, në Shkodër, në mëngjesin e 7 dhjetorit 1999, në një moshë sot endë të ré të 63 vjetëve, tue pasë lè në Tiranë me 14 prill 1936.

▪ Bibliofili ▪

Olimpia **KAKARRIQI**
Valbona **BERDICA**

NJË JETË NË TEMPULLIN E BIBLIOTEKËS

- Veprimtaria studimore e kulturore e Gjovalin Çunit -

Figura e Gjovalin Çunit, ish-drejtorit të bibliotekës publike “Marin Barleti” është e lidhur pandashmërisht me librin, me bibliotekën, me studimin, me veprimtaritë e shumta shkencore, artistike e intelektuale, të zhvilluara gjatë viteve të karrierës së tij jo vetëm në ambientet e bibliotekave, por edhe në institucione të tjera të kulturës. Si specialist në fushën e bibliotekonomisë, për shumë vite drejtoi jo vetëm bibliotekën e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, por edhe bibliotekën publike “Marin Barleti”, derisa doli edhe në pension.

Aktiviteti jetësor dhe kulturor

Ai lindi në qytetin e Shkodrës, me 8 maj të vitit 1952. Shkollën fillore dhe atë të mesme i kreu në qytetin e lindjes dhe më pas ndoqi studimet e larta në degën histori-geografi pranë Institutit të Lartë Pedagogjik po në Shkodër. Më pas ndoqi shkollën e bibliotekonomisë pranë Bibliotekës Kombëtare në Tiranë dhe frekuentoi rregullisht të gjitha trajnimet e zhvilluara nga kjo bibliotekë. Që në fëmijëri u edukua me dashurinë për librat, për bibliotekat, për dijen e kulturën e gjerë që zotëronte qyteti me traditën e hershme. Në fillimet e punës së tij kreu me përkushtim profesionin e mësuesit të historisë e gjeografisë në disa shkolla të fshatit e të qytetit, për të vazhduar më pas si drejtues i dy bibliotekave shumë të rëndësishme të qytetit. Po çfarë do të thotë të drejtosh një bibliotekë dhe

njëkohësisht të jesh aktiv në dhënien e mendimit profesional, novator e kritik, në shumë konferenca e periodikë kombëtarë dhe më gjerë?

Siç e dimë të gjithë, bibliotekat janë institucione ku gjendet e grumbulluar dija e kultura mbarënjëzore, ndaj dhe quhen Tempuj të Dijes. Misioni i tyre është të shpërndajnë informacionin e grumbulluar, të klasifikuar e të sistemuar tek përdoruesit. Por ky mision mbështetet tek qëllimet dhe objektivat të cilat përcaktojnë mbarëvajtjen dhe suksesin e bibliotekës. Dhe është drejtuesi i këtij institucioni që menaxhon të gjitha strukturat dhe veprimtaritë e saj. Për vite me radhë, Gjovalini me një profesionalizëm të spikatur drejtoi bibliotekat, duke bashkërenduar të gjitha proceset e detyrave të ngarkuara në sektorët e pasurimit, të katalogimit, të shërbimeve referuese, të huazimit etj. Ai i ofroi asistencë e konsulencë çdo punonjësi duke dhënë eksperiencën personale, i ofroi mbështetje çdo studiuesi me referencat e duhura, çdo studenti apo përdoruesi të thjeshtë duke e transformuar bibliotekën në një qendër të rëndësishme informacioni, “urë komunikimi në mes dijës dhe përdoruesit”, një vend të dashur e mikpritës për të gjithë. Ai e konceptonte bibliotekën si bibliotekë e dyerve të hapura, në të cilën forcohen dhe demokratizohen marrëdhëniet në mes shërbimit dhe përdoruesve të saj.

Aktivitetet e shumta janë pjesë e pandarë e çdo biblioteke, por veçanërisht të një biblioteke publike. Promovimi i librave, rrethet letrare, ekspozitat librore, festivali letrar i Shkodrës, takimet me shkrimtarë e intelektualë të shquar e shumë veprimtari të tjera moderoheshin nga i palodhuri, Gjovalin Çuni.

Bibliotekat janë organizma në zhvillim, ato ndryshojnë me zhvillimin e teknologjisë dhe të informacionit. Dhe ja ku e shohim atë edhe si nismëtar të digjitalizimit të kopjeve me vlerë të bibliotekës. E fillon digjitimim e materialeve me një skaner të thjeshtë, që kërkonte shumë mund e përpjekje. Me një punë këmbëngulëse, duke u mbështetur edhe nga stafi i bibliotekës arrin ta rendisë bibliotekën “Marin Barleti” në pararojë të të gjitha bibliotekave publike në rang kombëtar. Merr pjesë në disa projekte jashtë Shqipërisë, ku përfaqëson bibliotekën me arritjet në fushën e digjitalizimit të fondit të vjetër.

Nuk e shkëputi asnjëherë punën si drejtues me punën si studiues. Ai hulumtoi në arkiva duke paraqitur dokumente, fakte e dorëshkrime të panjohura më parë. Mori pjesë në shumë konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendi, botoi shumë artikuj shkencorë në fushën e albanologjisë, letërsisë, bibliotekonomisë e të kulturës shqiptare. Ndaj për të bërë një njohje nga afër të shkrimeve, publikimeve, bashkëpunimeve të tij shërben edhe bibliografia e mëposhtëme:

Bibliografi e botimeve, kumtesave, artikujve etj.

Botime

Botime të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi": 1957 – 2002, 2003

- Bibliografi e artikujve të Buletinit Shkencor të USH "Luigj Gurakuqi": 1964-2004, 2006.
- Pjetër Gjoka, 52 vjet në skenë: monografi, 2009.

Përgatiti për botim

- Udha e festivalit të kangës për fëmijë, 2012
- Studime etnologjike të Shqipërisë s'Epërme : (përmbledhje artikujsh), 2017.
- At Shtjefën Gjeçovi: (konferencë shkencore), 2015.

Parathënie librash

- Shkodra e baballarëve, 2002
- Humori shkodran, Gjush Sheldija, 2002.

Redaktor letrar

- Nëpër gjurmët e Fishtës / Kolec Çefa. - Botime françeskane, 2003
- Letërkëmbim: (1947 - 1958) / Mustafa Kruja, Paulin Margjoka, 2006
- Për fiset, ligjet e zakonet e ballkanasve / E. Durham, Ferit Hafizi, 2009
- Fjalor Enciklopedik i hapësirës shkodrane, vol. A-K; L-Zh. /Z. Dibra, 2015
- Dhuratë dhe angazhim: pas stuhisë komuniste: pasqyrë historike e Kryedioqezës Shkodër-Pult dhe famullive: monografi, 2016.

Anëtar redaksie dhe drejtues revistash kulturore

“Phoenix”, “Rrezja Jonë”, “Illyricum”, “Informacion”, (Rev. informative e U.Sh. “Luigj Gurakuqi”, “Gegnia” (revistë kulturore), Biblioteka “Marin Barleti”, Gazetar korrespondent pranë gazetës “Koha Javore”, të shqiptarëve në Mal të Zi.

Veprimtari muzeale

Hartimi i linjës së historisë shqiptare në Muzeun Dioqezan, Shkodër.

Pjesës marrje në konferenca shkencore

1. Vështrim mbi të drejtën zakonore shqiptare / Gjovalin Çuni
Qendra “Drejtësi dhe Paqe” Kanuni dhe ligji, 1999
2. Vështrim panoramik mbi françeskanizmin e veprën atdhetare në
Shqipni / Gjovalin Çuni
Simpoziumi: At Marin Sirdani, 2003
3. “Historiku i librit në Shkodër deri në vitin 1944” / Gjovalin Çuni
“Shkodra në shekuj”. Vëllimi IV, 2004
4. “Kontributi i bibliografëve shkodranë në themelimin e bibliografisë
kombëtare” / Gjovalin Çuni
“Shkodra në shekuj” Vëllimi II, 2005
5. “Studim mbi bibliotekën e Arshi Pipës” / Gjovalin Çuni
Sesion shkencor. “Arshi Pipa. Jeta dhe vepra”, 2005
6. Në gjurmë të një letërkëmbimi / Gjovalin Çuni
Shoqata “Dukagjini” Dukagjini në rrjedhat e historisë, 2006
8. “Lufta e Shkodrës në dritën e dokumentave të pabotuara” / Gjovalin
Çuni
USH. “L. Gurakuqi”. Maj, 2007.
“Vështrim mbi rrethimin e Shkodrës, 1912-1913”
9. “Doktrina sociale e Kishës në veprat e At Anton Harapit” / Gjovalin
Çuni
Arqipeshkvia Metropolitane e Shkodrës, Shkodër, 21 prill 2008
(Instituti i Studimeve Politike “Alcide De Gasperi”)
10. “**Aspekte kulturore** të ndërtuara pranë Katedrales (kompanitë
fetare, shoqatat, shtypi, veprimtaritë e ndryshme)” / Gjovalin Çuni

Takim studimor me rastin e përkujtimit të 150-vjetorit të bekimit të gurit të parë të Katedrales së Shën Shtjefnit – Shkodër

11. Vështrim mbi bibliotekën Arshi Pipa / Gjovalin Çuni
Muzeu Historik. Kumtari 9. Arshi Pipa dhe vepra e tij, 2009
12. Kontributi i bibliografëve shkodranë në bibliografinë kombëtare
/ Gjovalin Çuni
Muzeu Historik. “Shkodra ndër shekuj” : vol. 2, 2006
13. Fondet albanologjike në bibliotekat e Shkodrës / Gjovalin Çuni
U.Sh. “Luigj Gurakuqi. Albanologu i shquar austriak Nobert Jokli
(1877-1942) (Studime shqiptare 12)

14. Filip Fishta gjurmues i historisë shqiptare në arkivat dhe bibliotekat e Europës.
U.Sh. “Luigj Gurakuqi. Autorët e trevës së Veriut... në vështrim gjuhësor dhe historik & 100-vjetorit i botimit “Te Ura e Rrzhanicës e Atë Gjergj Fishtës. (Studime shqiptare 14)
15. Lahuta e Malcisë në gazetën Tomorri. Gjovalin Çuni
U.Sh. “Luigj Gurakuqi”. Fishta poeti dhe mendimtari kombëtar, (Studime shqiptare 18)
16. “Roli i Fishtës në shtypin e kohës”. Gjovalin Çuni, E. Ramadani.
U.Sh. “Luigj Gurakuqi”, 2011
17. Cikël diskutimesh kushtuar 100 vjetorit të Pavarsisë titulluar “Për Fe dhe Atdhe”
Arqipeshkvia Metropolitane e Shkodrës, Shkodër, 14 mars 2012
18. “Doke dhe zakone në krahinat e Shkodrës” / Gjovalin Çuni
Komisioni “Drejtësi dhe Paqë” & Konrad Adenauer Stiftung
“Tourism in Shkoder – Pros and cons”. Shkodër, 30 mars 2012
19. Kontributi i Fishtës në publikimin e revistës “Hylli i Dritës” (personeli ndihmës), 2013
U.Sh. “Luigj Gurakuqi”. 100 vjetori i revistës “Hylli i Dritës” (Studime shqiptare 22)
20. “Fiamuri i Arbërit” i De Radës për revistën “Drita” të Shoqërisë së Stambollit / Gezim Puka, Gjovalin Çuni
U.Sh. “Luigj Gurakuqi”. 200 vjet me De Radën, 2013 (Studime shqiptare 23)
21. “Misët e komisisë shqipe dhe albanologët e huaj” / Gezim Puka, Gjovalin Çuni
“Komisia letrare shqipe 100-vjet më pas dhe mendimi albanologjik”, 2019
(Studime shqiptare 27)

Botime në periodikë

22. In memoriam At Zef Pllumi. “Dashunia për librin “krim kundër shtetit” / Gjovalin Çuni
Poezi të At Zef Pllumi, prej vëllimit poetik të panjohun me titull “Pllakata” / Gjovalin Çuni
Hylli i Dritës, nr.1 /2008.

23. Gjurmë të bibliotekës së At Gjergj Fishtës në bibliotekën “Marin Barleti” / Gjovalin Çuni, Fatmira Lekiqi, Hylli i Dritës, nr.1/2016.
24. Arkivi franceskan në bibliotekën “Marin Barleti” / Gjovalin Çuni. Shejzat, nr. 3-4, 2017
25. Intervistë më Willy Kamsin / Gjovalin Çuni. Gegnia, nr.1, 2016
26. Kontribut per datën e saktë të themelimit të Bibliotekës Kombëtare. Gegnia, nr.2, 2016
27. Në gjurmë të një letërkëmbimi / Gjovalin Çuni. Gegnia, nr.4, 2017
28. Kultura islame në kontekstin e periodikëve shqiptarë / Gjovalin Çuni. Gegnia, nr. 6, 2018
29. Willy Kamsi. Një jetë kushtuar librit / Gjovalin Çuni. Gegnia, nr. 7, 2018
30. Skedë biografike dhe autoriale për Marin Barletin / Gjovalin Çuni. Gegnia, nr. 10, 2019
31. Djelmnia katolike shqiptare në mërgim pj. I / Gjovalin Çuni. Kumbona e së Diellës, nr. 3, 1999
32. Djelmnia katolike shqiptare në mërgim pj. II / Gjovalin Çuni. Kumbona e së Diellës nr. 5, 1999
33. Një Papë për kohë të reja (përshtatje nga italishtja) / Gjovalin Çuni Kumbona e së Diellës, nr.8, 1999.
34. Një famullitar bëhet Ipeshkvi i të gjithë Botës (përsht.nga ital.) / Gjovalin Çuni Kumbona e së Diellës, nr.10, 1999
35. Pio X dhe modernizmi (përsht.nga ital.) / Gjovalin Çuni Kumbona e së Diellës, nr.12, 1999.
36. Gjon Pali II mbushi 80-vjet / Gjovalin Çuni Kumbona e së Diellës, nr.5-6/2000.
37. Prof. Simon Pepa u nda nga ne / Gjovalin Çuni Kumbona e së Diellës, nr.5-6, 2000.

Pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare

1. II ORDINARY ASSEMBLY of FIAC- Buenos Aires, September 11-14th 1997
In dialogue with God, in the Church, with the world and culture 2005.
2. Metting. Progetto Interreg III A di Cooperazione Interbibliotecario italo-albanese “Bibliodoc- Inn”. Tirana, Biblioteca dell’ Accademia

delle Scienze, 11 novembre 2005

Biblioteka Publike “Marin Baleti”, Shkodër. Gjovalin Çuni

3. E dhathta shqiptare drejt Shqipërisë Etnike, Klinë 11-12 dhjetor 2005.
 - “Atë Jakob Marlekaj, personalitet i kulturës kombëtare” / Gjovalin Çuni, 2006.
4. Metting. Progetto Interreg III A di Cooperazione Interbibliotecario italo-albanese “Bibliodoc- Inn”. Tirana, Elbasan, 24-25 novembre 2006.
 - “Il circolo di discussione” / Gjovalin Çuni. 2008
5. Politica & Cultura. Bari, 13- 21 settembre, 2008
6. Hadriaticum. “Un progetto per gli archivi”. 2-3 aprile 2008: Incotro transnazionale, Gulianova (Bari)
 - “Uno sguardo sull’archivistica albanese” / Gjovalin Çuni
7. “Kalimera poetike”. Ulqin, 10 gusht 2008
 - “Letërsia e integritet” / Gjovalin Çuni. 2009
8. Biblioteca
 - Dodicesimo workshop della Teca del Mediterraneo: “La memoria potenza del futuro”, 26.06.2009
 - “Patrimonio librario nel fondo albanologico della biblioteca “Marin Barleti” / Gjovalin Çuni. 2011.
9. Sub-progetto VATRA per il dialogo interculturale tra Italia e Balcani Biblioteca centrale della Regione siciliana “Alberto Bombace”. Palermo 4-7 maj
 - Intervengo / Gjovalin Çuni
10. “Il sogno italiano”, Otranto, 19-21 maj, 2011
 - “Il mercato librario in Albania dopo gli anni’90” / Gjovalin Çuni
11. The Department of Medieval Studies at CEU Institut, Realienkunde, Austrian Accademy of Sciences the University of Elbasan. Third international “Muhu Workshop”. Flight and Emigration in Medieval Space and Mind. Gryka e Valbonës (Albania), August 20-22, 2011
 - Nuovi studi albanologici nella Scutari veneziana / Gjovalin Çuni
12. “Letërsia shqiptare, gjuha dhe përkthimi. Projekti: “Dva jezika jedna knjga” (Dy gjuhë një libër), Universiteti i Shkodrës “Luigj

- Gurakuqi”, Shqipëri dhe OJQ Prostory nga Podgorica, Mal i Zi,
 “Mundësi të reja në fushën e bashkëpunimit ndërbibliotekar” / Gjovalin Çuni

Pjesëmarrje në Konferenca shkencore jashtë Shqipërisë

13. II ORDINARY ASSEMBLY of FIAC- Buenos Aires, In dialogue with God, in the Church, with the world and culture, 2003
 14. E djathta shqiptare..... Forcat nacionale shqiptare shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1945. Prizren, 2005
 “Veprimtaria antikomuniste e vëllezërve Pipa” / Gjovalin Çuni
 15. Shoqata “Don Gjon Buzuku” Kraja ne veçantitë shestanase në rrjedhë të shekujve. Ulqin, 2011
 “Shkaqet dhe pasojat e braktisjes së Krajës” / Gjovalin Çuni
 16. BKU e Kosovës dhe B.K. e Shqipërisë, Prishtinë, nëntor 2007
 “Biblioteka dhe kujtesa kombëtare”
 “Fondet albanologjike në bibliotekat e Shkodrës” / Gjovalin Çuni

Shumanshmëria e temave dhe trajtesave

Ligjëratat në konferenca dhe artikujt e botuar në revistat e në të përkohshmet kulturore-artistike, janë gjithnjë tërheqëse, interesante e me vlera sociale, etike e kulturore. Ato sjellin të vërteta të fshehura në arkiva e në shkrime të autorëve më në zë të kulturës shqiptare. Bibliografia, bibliotekat, shkrimtarë të njohur e të panjohur, ngjarje historike, çështje të rëndësishme të shoqërisë, personalitete të kulturës, personalitete fetare, artikujt përkujtimorë janë objekti i studimeve dhe shkrimeve të autorit.

Kështu, ai evidenton dhe vlerëson kontributin e bibliografëve shkodranë në themelimin e bibliografisë shqiptare, përshkruan me dokumente historikun e librit në Shkodër, deri në vitin 1944, na sjell një vështrim nga biblioteka e Arshi Pipës, paraqet fondet albanologjike të bibliotekave të qytetit të Shkodrës, kontribuon në përcaktimin e datës së saktë të themelimit të Bibliotekës Kombëtare, na sjell të dhëna për gjurmët e bibliotekës së At Gjergj Fishtës në Bibliotekën “Marin

Barleti”.

Një vend të rëndësishëm zë studimi i disa figurave e personaliteteve të kulturës dhe veprave të tyre, si: At Gjergj Fishta, Arshi Pipa, At Zef Pllumi, At Anton Harapi, Jeronim De Rada, Mustafa Kruja, Willy Kamsi.

Duke pasur një formim edhe prej historiani, ai trajton: “Luftën e Shkodrës (1912-1913), në dritën e dokumentave të pabotuara”, “Shkaqet dhe pasojat e braktisjes së Krajës”, “Vështrim mbi të drejtën zakonore shqiptare”, “Doke dhe zakone në krahinat e Shkodrës”.

Të veçanta janë trajtesat për “Misët e Komisës shqipe dhe albanologët e huaj”, “Letërsia e integritit”, “Aspekte kulturore të ndërtuara pranë Katedrales”.

Në shkrimin “Dashunia për librin, “krim kundër shtetit”, shtjellohet puna e madhe e françeskanëve për pasurimin e bibliotekës me kopje të çmuara dhe paradoksi i viteve pas 1945. Përshkruhet dëshira e At Zef Pllumit për ringritjen e bibliotekës françeskane dhe në fund Gjovalini shkruan: “Padri, rrijoj vetëm me tregue veprën e njatyne që diqën e qindruen si njerëz, e asht detyrë e jona të tregojmë veprën e françeskajve tregimtarë, por edhe punëtorë të rindërtimit, fatkeqsisht të asaj që ishte, por jo vetëm asaj...”

“Në gjurmët e një letërkëmbimi” gjejmë epistolarin e At Luigj Marlekës me Ernest Koliqin, të dy intelektualëve të shquar të kulturës shqiptare. Bashkëpunimi i tyre është modeli i njerëzve të ditur që punojnë e veprojnë në shërbim të gjuhës, letërsisë e kulturës kombëtare.

Në studimin “Kontributi i bibliografëve shkodranë në themelimin e bibliografisë shqiptare”, prof. Gjovalini pasi bën një shikim retrospektiv të bibliografisë si shkencë ndihmëse e të gjitha shkencave të tjera, ndalet në trashëgiminë bibliografike të figurave që bënë emër në historinë e bibliografisë kombëtare si: Jup Kastrati, Palokë Daka, Willy Kamsi, Islam Dizdari e shumë shkodranë të tjerë.

Studimi “Kontribut për datën e saktë të themelimit të bibliotekës kombëtare” është një homazh për professor Karl Gurakuqin, një nga themeluesit e kësaj biblioteke, njeriut që të tanë jetën e vuni në shërbim të arsimit kombëtar dhe gjuhësisë shqiptare, në veri dhe në jug të Shqipërisë, por edhe midis arbëreshëve të Siçilisë dhe Kalabrisë.

“Gjuha e përbashkët shqipe dhe gegënishtja”, intervistë me studiuesin Willy Kamsi, është një bisedë intelektuale në mes dy specialistëve të bibliotekës, në mes dy studiuesve ku njëri drejton pyetje thelbësore e

tjetri përgjigjet me bagazhin e madh kulturor e intelektual. Mesazhet e kësaj interviste janë të shumta, duke filluar nga dialektet e shqipes që janë pasuri gjuhësore, dialogut ndërkulturor, mirëkuptimit e paqes, të drejtave të njeriut dhe ëndrrës për të qenë pjesë e pandarë e Evropës.

Në mbyllje, mund të themi me plot gojë, se veprimtaria studimore e Gjovalin Çunit është një kontribut i shtuar në studimet e fushës së albanologjisë dhe fatmirësisht është ende një veprimtari në vijimësi. Ai është një shembull frymëzues për të gjithë specialistët e bibliotekave të qytetit të Shkodrës dhe të mbarë Shqipërisë. Eksperienca e tij na mëson se nuk mjafton asnjëherë puna që bëjmë në bibliotekë, nëse nuk shoqërohet me pasionin dhe dashurinë për librin.

▪ Tradita të pushtetit lokal ▪

Gëzim JUKA

**KRYETARËT E PUSHTETIT VENDOR NË SHKODËR
NË PERIUDHËN 1912-2020**

Shkodra është një qytet që fillesat i ka rreth shekullit të III para Krishtit. Që nga kjo kohë e deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë, qyteti i Shkodrës ka krijuar një traditë të pasur në administrimin e qeverisjes vendore sipas rrethanave dhe zhvillimeve të ndryshme historike.

Në shtetin shqiptar, mbas fitimit të pavarësisë më 28 nëntor 1912, qeverisja vendore është emërtuar: *Katundari*, *Perlimtare*, *Bashki*, *Komiteti i Rrethit* etj. Në periudha të ndryshme historike kryetari i bashkisë është zgjedhur me vota, por ka patur raste kur është emëruar. Në të gjitha rastet kontakti dhe varësia me qeverinë ishte nëpërmjet Ministrisë së Brendshme. Ndërsa Këshilli i Bashkisë në të gjitha periudhat është zgjedhur me votim. Në periudhën e viteve 1945 – 1990 ka një dublim kompetencash mes Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit dhe Kryetarit të Këshillit Popullor të qytetit i cili njihej me emërimin Kryetari i Qytetit. Meqë sot së paku, nga shtrirja territoriale Bashkia ngjason me Komitetin Ekzekutiv të Rrethit e marrim të pranueshme vazhdimësinë historike.

Ky punim mbulon periudhen e shtetit të pavarur shqiptar. Referencat janë nga dokumente të Arkivit Qendror Shtetëror, shtypi i kohës në vite, Fletorja Zyrtare etj.

Periudha e parë: 1912-1944**Muharrem Gjylbegu, 28 nëntor 1912 – mars 1916.**

Muharrem Gjylbegu e ka filluar detyrën në vitin 1908, kohë në të cilën Shkodra ishte nën administrimin e perandorisë turke. Ai caktohet kryetari i parë i Bashkisë së Shkodrës, më 28 nëntor 1912. I ra detyra e vështirë e përballimit të problemeve të krijuara gjatë rrethimit të Shkodrës nga Mali i Zi si dhe koordinimi i marrëdhënieve me guvernatorët e shumtë të periudhës. Muharrem Gjylbegu së bashku me drejtuesin e forcave ndërkombëtare në Shkodër, kolonelin De Philips, më 28 nëntor 1913, ngriti Flamurin Shqiptar në ballkonin e Bashkisë. Kjo në 1- vjetorin e shpalljes së Pavarësisë. Zotni Gjylbegu qëndroi derisa erdhën në Shkodër forcat Austro-Hungareze, të cilat organizuan zgjedhje e reja për kryetarin dhe këshillin.

Musa Juka, mars 1916-mars 1920-maj 1924

Ardhja e forcave austro-hungareze në kuadër të Luftës së Parë Botërore u shoqërua me ndryshime administrative. I gjithë territori shqiptar ku ishin prezent austro-hungarezët u organizua si një shtet ku kryeqendër ishte Shkodra. Ngazgjedhjet për pushtetin lokal doli kryetar Musa Juka, i cili e vazhdoi mandatin edhe pas largimit të austro-hungarezve në tetor të vitit 1918 deri në zgjedhjet e vitit 1920. Ndërsa u rizgjedh në votimet e marsit të vitit 1920 dhe qëndroi në këtë detyrë deri më datën 31 maj 1924

Muhamet Gjyrezi, 10 qershor 1924-24 dhjetor 1924

Në periudhën që në histori është emërtuar si “Revolucioni i Qershorit”, “Lëvizja e Qershorit” ose “Grusht shteti i qershorit 1924” qeveria që erdhi në pushtet me Fan Nolin emëroi në krye të bashkisë së Shkodrës Muhamet Gjyrezin, i cili u largua me ardhjen e asaj që quhet “Triumf i Legalitetit” më 24 dhjetor 1924.

Kolë Mjeda, 24 dhjetor 1924-maj 1925

Kolë Mjeda ishte zëvendëskryetar Bashkie nga radhët e “Triumfi i Legalitetit” gjer në 17 maj 1925 kur u zgjedh deputet.

Mehmet Shpuza, maj 1925 – tetor 1927

Qëndroi si kryetar Bashkie për një kohë të gjatë në periudhën e

Republikës së Parë. Dha dorëheqje për arsye moshe dhe problemeve me shëndetin.

Qamil Pepa, tetor 1927- maj 1928

Qamil Pepa ishte drejtor i korrespondencës në Ministrinë e Brendshme. Ai ishte zëvendëskryetar pasi detyrën në Tiranë vazhdoi ta kryejë. Më 19 maj 1928 dha dorëheqje nga detyra e Zëvendëskryetarit të Bashkisë Shkodër.

Zyhdi Karagjozi, maj – gusht 1928

Edhe ky qëndroi një kohë të shkurtër. Më 19 gusht 1928 njoftohet që Kryetari i Bashkisë Shkodër Zyhdi Karagjozi u thirr në Tiranë për t'u caktuar në një detyrë tjetër me gradim. Ky ishte kryetari i fundit i periudhës së Republikës së Parë, 1925-1928.

Rustem Ymeri, gusht 1928 – maj 1929

Ishte kryetari i parë i Bashkisë Shkodër, në fillim të Monarkisë. Qëndroi gjer në maj të vitit 1929. Në periudhën janar 1931–mars 1933 rikthehet në Shkodër. Në 28 mars 1933 transferohet po me këtë detyrë në Bashkinë e Korçës në vend të Tef Naraçit që kaloi në Vlorë.

Izet Dibra (Shatku), maj 1929 – mars 1930

Më 18 maj 1929 njoftohet në shtypin e kohës që u emërua Kryetar Bashkie në Shkodër Izet Dibra i quajtur edhe Shatku. U largua me 16 mars 1930 pasi emërohet Ministër i Botoreve.

Zejnel Prodani, qershor 1930-janar 1931

Zëvendësoi në detyrën e Kryetarit të Bashkisë Izet Dibrën. Me 29 janar 1930 u largua me detyrë Prefekt i Dibrës.

Në periudhën mars 1933-gusht 1937 rikthehet në Shkodër. Në gusht të vitit 1933 mungoi një muaj për arsye private dhe u zëvendësua nga Kryetari Këshillit të Bashkisë Ndoc Çoba. Në nëntor 1935 kreu edhe detyrën e zëvendësprefektit.

Ndoc Çoba, gusht 1937 – qershor 1939.

Më 25 gusht 1937 Ndoc Çoba emërohet kryetar Bashkie i Shkodrës. Me këtë rast mbylli gazetën “Zani i Shkodrës” ku ishte drejtues dhe pronar. Pushtimi italian i 7 prillit 1939 e gjeti në krye të detyrës. Me

shkresë zyrtare të Kryeministrisë dhe Mëkambësisë më 23 qershor 1939 shkarkohet Ndoc Çoba dhe shpërndahet Këshilli i Bashkisë Shkodërese nuk i përshtaten realitetit të ri politik.

Mark Kakarriqi, qershor 1939 – qershor 1942

U emërua me 23 qershor 1939 dhe qëndroi gjer më datën 9 qershor 1942 prej ngakaloi anëtar i Këshillit Qëndror të Ekonomisë Korporative.

Zef Shiroka, qershor 1942-shkurt 1943

Zef Shiroka në shkurt 1943 u emërua Ministër i Industrisë.

Loro Suma, prill 1943 – gusht 1944

Në prill 1943 me dekret Mëkambësuer Loro Suma emërohet Kryetar i Bashkisë Shkodër. Loro Suma qëndroi në detyrë edhe pas kapitullimit të Italisë në 9 shtator 1943 duke luajtur një rol të madh në veprimet e Bashkisë Shkodër në rishpallje të Pavarësisë në tetor 1943. Kryetari i Bashkisë Shkodër vdiq papritur në detyrë nga një goditje në zemër. Në varrimin e tij morën pjesë autoritetet dhe një shumicë e popullit. Megjithëse i shtymë në moshë punonte me vullnet në kryemjen e detyrës. Me vdekjen e tij prej gjinit të Shkodrës zhduket një burrë i ndershëm i një dere fisnike. Ky është njoftim i gazetës” Bashkimi i Kombit” më 4 gusht 1944.

Zef Gjeta, shtator- tetor 1944

Zef Gjeta u emërua zëvendëskryetar Bashkie duke mbajtur edhe detyrën në Ministri të Brendshme. Për arsye të situatës së turbullt në prag të kalimit të ushtrisë gjermane që po largohej nga Shqipëria më 23 tetor 1944, me propozim të qeverisë dhe Dekret të Këshillit të Naltë (Regjenca) të gjitha pushtetet vendore në Prefekturën Shkodër i kaluan një grupimi që u quajt Komisar i Jashtëzakonshëm ku bënë pjesë: Sulço beg Bushati, Mark Gjon Marku, Abdullah Kazazi, Ndoc Çoba, Pjetër Deda, Musa Gjylbegu, Naum Plevneshi. Këto janë autoriteti i vazhdimit të shtetit gjer në 29 nëntor 1944.

Periudha e dytë: 1945-1990

Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist organizimi i shtetit në mbarë Shqipërinë, por edhe në Shkodër, ka ndryshime me organizimin e mëparshëm. Pushteti vendor që do pasqyrohet ka ardhur në vite duke u ristrukturuar gjër në 1990 duke u emërtuar sipas ndarjes territoriale.

Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër (Qyteti Shkodër, Komunat Bushat, Obot, Postrribë, Pulaj, Vau i Dejës)

Dhimitër Bojaxhi, viti 1945.

Shyqyri Hafizi, viti 1946.

Fejzi Mesi, viti 1947.

Komiteti Ekzekutiv i Qytetit Shkodër (krijohet në 1947)

Qamil Gavoçi, viti 1947.

Komiteti Ekzekutiv i Rrethit Shkodër

Qamil Gavoçi, 1949-1952;

Tonin Jakova, 1952-1955;

Rifat Dedja, korrik 1955-gusht 1957;

Mhill Doçi, shtator 1957-tetor 1959;

Shyqyri Hafizi, (vazhdon kryetari i qytetit)

Bilal Parruca, tetor 1959-tetor 1961;

Mhill Doçi, tetor 1961-nëntor 1962;

Bilal Parruca, dhjetor 1962-prill 1966;

Pjetër Kosta, prill 1966 –tetor 1966;

Luigj Shala, Kryetar i qytetit 1960 vazhdim;

Bilal Parruca, tetor 1966 – dhjetor 1974;

Agime Kapisyzi, Kryetare qytetit 1967 – vazhdim;

Hilmi Nurja, Kryetar i Qytetit 1970 –vazhdim;

Sulejman Bushati, janar 1975 – maj 1980;

Lefter Goga, maj 1980 – shtator 1982;

Nesip Ibrahim, shtator 1982 – korrik 1985;

Skender Dema, korrik 1985 – shkurt 1986;

Faik Cinaj, shkurt 1986 – maj 1987;

Bujar Bedalli, maj 1987 – gusht 1989;

Idriz Behri, Kryetar i Qytetit 1981 – vazhdim;

Ismet Priku, Kryetar i Qytetit 1983 – vazhdim;
 Bashkim Sykja, gusht 1989 – korrik 1990;
 Terezina Marubi, korrik 1990 – gusht 1991;
 Agim Dardha, Kryetar i Qytetit 1986 – vazhdim.

Kryetarët e Komitetit Ekzekutiv të Rrethit emëroheshin nga Këshilli i Ministravendërsa Kryetarët e Këshillit Popullor të Qytetit (Kryetari i Qytetit) votoheshin çdo tre vite ku qëllonte edhe përsëritej e njëjta kandidaturë.

Periudha e tretë: 1990–2020

Me ndryshimet politike pas rënies së regjimit komunist ka edhe ndryshime të strukturave dhe institucioneve shtetërore.

Në këtë periudhë, në legjislacionin e pushtetit vendor, rikthehet emërtimi “Kryetari i Bashkisë” dhe kemi këta drejtues:

Ali Spahija, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist – gusht 1991 – mars 1992;

Xhavit Dibra, Kryetar i qytetit nga maj 1989 – gusht 1991;

Gjovalin Jaku, Kryetar i qytetit gusht 1991 – korrik 1992;

Fatos Gjyrezi, Kryetar i Komitetit Ekzekutiv – prill 1992 – korrik 1992;

Me këtë rast hiqet detyra e Kryetarit të Komitetit si i qytetit ashtu dhe errethit.

Me reformën administrative në vitin 1992 krijohen dy njësi të qeverisjes vendore:

Këshilli i Rrethit dhe Bashkia.

Këshilli i Rrethit, drejtues ndër vite:

Ali Kazazi, 1992-1996;

Mehdi Shabani, 1996;

Lorenc Mosi, 1996-2000.

Me reformën administrative në vitin 2000 shkrihet Këshilli i Rrethit dhe krijohet Këshilli i Qarkut që administron një territor më të gjerë dhe ka këta drejtues:

Këshilli i Qarkut:

Lorenc Mosi, 2000-2003;

Lorenc Luka, 2003-2007;

Gjovalin Kolombi, 2007-2011;

Maxhid Cungu, 2011-2015;

Greta Bardeli, 2015-2019;

Hilmi Lakti, 2019 - ne vazhdim.

Kryetarët e Bashkisë:

Filip Guraziu, korrik 1992 - tetor 1996;

Bahri Boriçi, tetor 1996 - tetor 2000;

Ormir Rusi, tetor 2000 - tetor 2003;

Artan Haxhi, tetor 2003 - shkurt 2007;

Lorenc Luka, shkurt 2007 - maj 2011 - qershor 2015 (dy mandate);

Voltana Ademi, qershor 2015 – në vazhdim.

▪ Filateli ▪

Besnik FISHTA

**ANDREA SKANJETI,
HARTUES I KATALOGUT TË PARË SHQIPTAR TË PULLAVE**

Andrea Skanjeti, “Artist i Popullit”, njihet në Shkodër për krijimtarinë e tij në një numër të pazakontë shkrimesh. Në enciklopedinë Wikipedia në internet, veprimtaria e tij e përgjithshme artistike, përmbledhet në krijimtari teatrale: 22 drama, komedi, melodrama, skeçe estrade etj.; 27 pjesë teatrale të përkthyer dhe të adaptuara; 8 pjesë për teatër kukullash; në regjisorë: rreth 75 pjesë teatrale shqiptare dhe të huaja të vëna në skenë, nga të cilat 20 me aktorët e teatrit “Migjeni” të Shkodrës; 20 platforma regjisoriale; 30 pjesë teatrale me grupe diletante të klubeve dhe shoqërive të ndryshme, të Shtëpisë së Kulturës Shkodër, qendrat e punës, Shtëpinë e Pionierit, shkollat etj. Nga krijimtaria artistike në prozë veçohen rreth 45 tregime dhe novela, shumica të botuara në revistat e kohës, kryesisht para dhe gjatë luftës. Autorit i përkasin edhe

studimi “100 vjet teatër në Shkodër 1879-1979”, botuar në vitin 2002; përmbledhja me anekdota “4000 vjet nga urtësia botërore” botuar në vitin 2006, si dhe *Fjalori Italisht-Shqip* i pabotuar ende.

Një punë e panjohur për publikun

Këto të dhëna më kthyen prapa në kohë, pasi konstatova mungesën e njohjes nga publiku të një dimensionit tjetër në veprimtarinë krijuese të Skanjetit. Ai ishte i pari në Shqipëri që hartoi “Katalogun e Pullave Postare Shqiptare”, sipas të gjitha kriterëve shkencore dhe didaktike që kërkohen në këtë lloj veprash. Vepër kjo e lënë në dorëshkrim dhe, për fat të keq, e pabotuar.

Unë kisha dëgjuar për këtë katalog që në moshë të re, në vitet ‘70-të. Në bisedat që im atë bënte me kolegët e tij filatelistë, përmendej ky fakt. Më pas nuk e harrova asnjëherë këtë dëshmi dhe në këto vitet e fundit më tundonte dëshira të zbuloja nëse pas pothuaj 50 vitesh ekzistonte ende kjo vepër unike në llojin e saj. Interesimi, kërkimi dhe intuita më ofruan rezultat pozitiv, duke gjetur vendin ku mjeshtri e kishte lënë për ruajtje. Në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë, pas një kërkimi me pikësynim dhe durim, arrita ta kem para syve të mi këtë libër që unë e vlerësoj të jashtëzakonshëm. Së bashku me librin edhe një autobiografi e gjatë. Që të dyja origjinale, të shkruara me makinë shkrimi dhe të firmosura nga vetë mjeshtri Andrea Skanjeti. Aty në sallën e studimit në Arkivin Qendror të Shtetit, me emocion dhe kureshtje të veçantë shfletova faqet e këtij libri. Më ra në sy gjenialiteti i këtij njeriu. Ishte një libër i jashtëzakonshëm, i shkruar me një profesionalizëm të admirueshëm, që po të mos isha i njohur për autorësinë dhe natyrisht dhe gjuhën tonë shqipe të shkruar, do të mendoja se kam në duar produktin e ndonjë autori të huaj, të njohur në këtë fushë. Pata kaluar në duar dhe konsultuar katalogë të ndryshëm, të tillë si katalogu i famshëm gjerman “Michel”, ai italian “Sasson”, ai anglez “Stanley Gibbons”, por dhe shumë i preferuari për kolektionistët shqiptarë, ai francez, “Yvert et Tellier”. Pothuaj çdo vit filatelistët shkodranë porositnin katalogë të rinj të pullave. Ky ishte pasioni i tyre. Madje mund të themi se me këtë pasion, në ato kohë ato u bënë “fatlum dhe të privilegjuar”, pasi arrinin atë që të tjerët e lakmonin, kontaktin me botën përtej kufijve. Pikërisht ato pulla poste të vogla, me plot ngjyra, herë me kafshë e bimë, herë

me sport dhe herë të tjera me piktura e figura nga më të ndryshmet, përbënin produktin e vetëm të asaj bote të huaj dhe që në veçanti për ne të rinjtë ishte iluzore dhe mjaft enigmatike. Çuditërisht dhe duhet thënë dhe fatmirësisht, diktatura, me instrumentet e saj të censurës, nuk arriti asnjëherë të pengonte mbushjen me pulla të çdo shteti e kontinenti të albumeve të bukura të filatelistëve. Kjo në të gjithë Shqipërinë dhe veçanërisht në Shkodër.

Çfarë e bën të veçantë këtë libër?

Së pari, për të krijuar dhe shkruar një katalog të pullave postare shqiptare, në çdo ndërmarrje të tillë, patjetër duhej të plotësoheshin disa cilësi, të cilat duhet të ishin prezente të gjitha së bashku njëherësh. Dhe te Skanjeti cilësi të tilla ekzistonin, sepse, së pari, Skanjeti kishte një koleksion vetjak shumë të mirë dhe të plotë të pullave shqiptare, i mbledhur me pasion dhe i studiuar nga ai vetë në mënyrë të imtësishme. Natyrisht, ky koleksion, por edhe ata të kolegëve të tij koleksionistë ishin domosdoshmëri për të dalluar dhe për të evidentuar çdo të dhënë teknike të çdo emetimi shqiptar të pullave. Së dyti, ai, sipas të dhënave, zotëronte vullnetin, seriozitetin, kulturën e shumanshme dhe sidomos njohjen e disa gjuhëve të huaja. Këto vlera, për arritjen e një qëllimi të tillë, kërkohen në studime të këtij lloji në nivele optimale. Për të kuptuar madhësinë e këtij punimi, duhet të analizojmë mundësitë që ofronte shoqëria shqiptare për një vepër të tillë jo të zakonshme. Dukevështruar zhvillimin e sotëm dhe duke e krahasuar me kushtet kur shkruhej libri, diferencat janë të mëdha në aspektin material e teknik. Studiuesit sot zotërojnë mjetet audiovizive të informimit, lundrimin dhe kërkimin në internet, literaturë të pakufizuar, që hyn në vend ose që mund të porositet jashtë vendit, pajisjet ndihmëse, si kompjuterët dhe programet e tyre të shumta, printerat dhe skanerët etj. Sot të tillë katalogë punohen nga grupe profesionistësh ose zyra e kompani të specializuara dhe që kanë eksperiencë deri në 150-vjeçare. Dhe, për sa i përket hapësirës sociale-politike po ashtu, ndryshimi është akoma më i thellë. Mjafton të përmendim argumentin më thelbësor. Sot jo thjesht nuk ka imponim për frymë të caktuar ideologjike, por sot, në procesin e krijimit, kemi prezencën absolute të lirisë së mendimit e të shprehjes, të kërkimit dhe të punës së konsultuar në grup.

Struktura e katalogut në plot 111 faqe është e plotë, e menduar mirë dhe tërheqëse. Ka dy pjesë kryesore. Pjesa e parë me titull “Njoftime” përmban njohuri të domosdoshme dhe themelore për çdo koleksionist të pullave postare ose dhe admirues të tyre. Në 15 faqe, përveç të treguarit të çelësit të përdorimit të katalogut, përkufizohen, formulohen, shpjegohen dhe interpretohet leksiku filatelik. Për herë të parë në literaturën shqiptare filatelike shtjellohen koncepte të tilla si: tipat e koleksioneve, tipat e emetimeve, sistemet e prodhimit, klubet filatelike, vulat e vulosjet, para dhe pasvulosjet, mbishtypjet, filigrama, dhëmbëzat e jodhëmbëzat, pullat e pjesëtuara, gabimet në pulla, pullat e rralla, datat e qarkullimit, tirazhet, falsifikimet dhe llojet e saj etj. Mendoj që nëpërmjet kësaj pjesë të parë Skanjeti, veç të tjerave, arrin të plotësojë edhe një pikësynim të tij, t’i japë katalogut të tij imazh shqiptar, duke e treguar qartë që nuk është një imitacion i katalogëve të huaj. Kjo i jep librit të tij një vlerë që dhe sot, pas pothuaj 60 viteve, mbart të dhëna tejet interesante për komunitetin filatelik, por dhe dashamirët e tij.

Në pjesën e dytë të katalogut jepen të gjitha të dhënat teknike të pullave Kjo pjesë ka disa nënpjesë. Në nënpjesën e parë pasqyrohen të tëra emetimet zyrtare të Postës Shqiptare, duke u pasqyruar data e emetimit, tirazhi, ngjyrat, çmimi nominal, falsifikimet e mundshme etj. Interesante është që krahas renditjes së tij, Skanjeti vendos dhe renditjen e dy katalogëve të huaj më të përdorur në atë kohë, “Michel” dhe “Yvert et Tellier”. Kjo përbën dhe një tjetër individualitet të katalogut të tij. Më pas, në nënpjesë të tjera trajtohen të ndara, Pullat Taksë; Emisionet e qyteteve të ndryshme (me jetë të shkurtër), si: Shqipëria Mesme (Posta Esadit), Shkodër, Tepelenë (Posta ushtarake), Vlorë, Elbasan dhe taksat e tyre. Veçori e Katalogut “Skanjeti” është katalogimi i pullave të shteteve të huaja që qarkulluan në Shqipëri me mbishtypje të ndryshme, si ALBANIA, DURAZZO (në Durrës), SCUTARI (në Shkodër), VALONA (në Vlorë), SASENO (në Ishullin e Sazanit). Në nënpjesën e fundit përshkruan dhe pullat jozyrtare të Modianos, emisionin e Elbasanit, emisionin e Vlorës, të shtypur në Greqi, dhe të Republikës së Mirditës të vitit 1921, duke evidentuar në çdo rast karakteristikat konkrete të emisioneve. Duke nënvizuar, së fundi, se të gjitha këto emetime jozyrtare nuk kanë fare vlera filatelike.

A do të ishte me interes të botohet sot vepra në dorëshkrim e Andrea Skanjetit?

Po! Sepse, së pari ajo është dëshmi e rrallë e përpjekjeve, në një kohë dhe në momente tashmë të njohura si të vështira. Ajo pasqyron një formë të qëndrësës intelektuale dhe qytetare për të ruajtur kontaktet, qoftë dhe të jo të drejtpërdrejta, me kulturën perëndimore, duke mënjanuar me zgjuarsia presionin e fuqishëm shtetëror për izolimin kulturor të vendit. Është e njohur që fushave të ndryshme të artit dhe të kulturës, si letërsia, kinematografia, muzika, teatri, piktura etj. u ishte ndërprerë çdo lidhje me botën e jashtme. Filatelia dhe zhvillimi i saj mundën ta shmangin me sukses këtë izolim.

Së dyti, grupet e interesuara të koleksionistëve dhe filatelistëve do të kuptojnë që në vitet 60-të e 70-të, në veçanti në Shkodër, ishte formuar një traditë e konsoliduar në koleksionimin e pullave postare, e cila brezit më pas i shërbeu si përvojë, dhe duke pasur fatin të mos fillojë nga zero në këtë fushë të rëndësishme të kulturës sonë. Ato vite në Shkodër, Klubi Filatelik pati krijuar një anëtarësi në numër të madh, aktiviteti i të cilëve që mjaft i gjerë dhe i organizuar, me veprimtari konkrete të larmishme, me ekspozita e sesione shkencore filatelike periodike, në një mënyrë të ngjashme me ato që bëheshin në vendet europiane.

Së treti, koleksionistët, edhe sot pas kaq shumë vitesh, te ky katalog do të gjenin të pasqyruara koncepte, formulime, njohuri nga kultura filatelike, të patrajtuara në botime deri më sot, ose edhe përgjigje për shumë nga pyetjet që mund t'u lindin nga universi i koleksionizmit.

Së fundi, botimi i “Katalogut të parë të Pullave të Postës” me një financim modest, për bibliotekat e Shkodrës, veçanërisht të bibliotekës “Marin Barleti”, dhe për institucionet, veçanërisht të Muzeut Historik të qytetit, do të krijonte mundësinë që të kenë në inventarin e tyre këtë libër krejtësisht të veçantë, të lënë trashëgim nga një personalitet i shquar dhe me cilësitë më të larta qytetare shkodrane, siç ishte Andrea Skanjeti.

Disa nga pjesët e Katalogut

Në faqen e parë, me firmën e tij tregon autencitetin e librit.

- 91 -

FULLA TË SHITESHVE TË BUNJA NË SHQIPARI

SH Q I P K N J A

1907 ^{shitetor} ~~1 shkurt~~ 1 shkurt S.S.P. postash italiane të vitit 1907 me shirityp:

ALBANIA
10 PARA 10

Fr.	Vv.	Shih.		
1	10L	1	blertë.....sh 5p.	10 PARA 10
2	19L	2	portokalli..... sh 20 s.f.....	30 PARA 30
3	20L	3	shitetor..... sh 25 s.	40 PARA 40

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

1907

4	43A	2	blertë.....sh 5 s.(30.3.1907).....	10 PARA 10
5	44	1	trëndafil.....sh 10 s.(1.11.1907).....	20 PARA 20
6	45	5	vjelje.....sh 50 sh(1.11.1907).....	80 PARA 80

Seria Tr.1-5 seria komplet 5 vlera 45 para

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

U. V. S. S. P.

1909-11 ^{1 mars} ~~1 shkurt~~ 1 shkurt S.S.P. postash italiane të vitit 1909-11 me shirityp:

BURASO
10 PARA 10 4 FIANTRE 4

7	59	7	blertë ..sh 5 sh.....	10 PARA 10
8	60	8	trëndafil.....sh 10 sh.....	20 PARA 20
9	61	5	blertë-sh .. sh 15 sh.....	30 PARA 30
10	62	10	shitetor..... sh 25 sh.....	1 FIANTRE 1
11	63	11	vjelje.....sh 50 sh.....	2 FIANTRE 2
12	64	12	shitet-blertë sh 1 s.....	4 FIANTRE 4
13	65	13	shitet-trëndafil, sh 5 s.	20 FIANTRE 20
14	66	14	shitet-trëndafil, sh 10 s.	40 FIANTRE 40

Nr.7-14 seria komplet vlera 8 fiantre 67 para 50

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

S. S. P. S. S. P.

1909-13 ^{1 mars} ~~1 shkurt~~ 1 shkurt S.S.P. postash italiane të vitit 1909-11 me shirityp:

SHQIPARI SHQIPARI
si Albania si ALBANIA
10 PARA 10 4 FIANTRE 4

15	66A	31	shitetor.....sh 2 sh.....	4 PARA 4
16	91	15	blertë ..sh 5 sh.....	10 PARA 10
17	92	16	trëndafil..... sh 10 sh.....	20 PARA 20
18	93	17	blertë-sh .. sh 15 sh.....	30 PARA 30
19	94	18	shitetor..... sh 25 sh.....	1 FIANTRE 1
20	95	19	vjelje..... sh 50 sh.....	2 FIANTRE 2
21	96	20	shitet-blertë sh 1 s.	4 FIANTRE 4
22	97	21	shitet-trëndafil sh 5 s.	20 FIANTRE 20
23	98	22	shitet-trëndafil .. sh 10 s.	40 FIANTRE 40

Nr.9-22 seria komplet 9 vlera 27 para 64 sh.

Një nga faqet e Katalogut, në të cilën vrojtohet analiza që i bën pullës së emetuar nga shtetet e huaja dhe që qarkulluan në vendin tonë në fillim të shekullit XX.

▪ **Enciklopedi** ▪

Zenepe **DIBRA**

**LUFTËTARË DHE PERSONALITETE TË HAPËSIRËS
SHKODRANE NË KRAH
TË GJERGJ KASTRIOTIT -SKËNDERBEUT**

- Heroi në veprat e autorëve shkodranë -

Kujtimi për Skënderbeun mbeti i gjallë në shekuj në kujtesën e shkodranëve. Luftërat e tij për çlirim kombëtar ku spikati burrëria, guximi dhe patriotizmi, forma e lartë e organizmit të fisnikëve shqiptarë në një ushtri efikase, të shpejtë dhe të përgatitur për të përballuar çdo betejë si dhe aftësia për të bashkuar në një qëllim të vetëm çdo krahinë, zonë të shqiptarëve, por edhe intuita e lartë edhe në diplomaci për të shfrytëzuar edhe faktorin e jashtëm, do të bënte që ai të mbetej kurdoherë jo vetëm si burim frymëzimi, por edhe si udhërrëfyes në luftërat e mëtejshme që do të vazhdonin edhe pas vdekjes së tij; jo vetëm kundër turqve, por edhe të armiqve të tjerë që guxuan të prekin trojet tona. Bëmat e Skënderbeut, që për 25 vjet u rezistoi ushtrive osmane, mbetën në kujtesën e shkodranëve, të cilët do të luftonin me heroizëm në mbrojtjen e Shkodrës, në rrethimin e parë të saj më 1474, (6 vjet pas vdekjes së Skënderbeut), ku arritën ta mbrojnë qytetin kështjellë, por edhe më 1479, kur, tamam si bijtë e Skënderbeut, treguan një heroizëm të paparë deri në rënien e qytetit, ndoshta edhe për disa rrethana që nuk ishin në duart e tyre. Midis mbrojtësve të Shkodrës rronte fryma e heroit, Gjergj Kastriotit -Skënderbeut, duke mos qëndruar prapa nga burrat edhe gratë dhe vajzat. Marin Barleti, shkruan se mbas betejave fitimtare ushtarët shprehnin gëzimin e tyre “*me këngë, me shaka e me lojna të ndryshme*”. Por edhe atje ku shkuan shkodranët dhe drishtjanët, pas

emigrimit biblik në Itali, ku gjetën një atdhe ty dytë, nuk do ta harronin kurrë lavdinë e heroit, duke e përjetësuar në veprat e intelektualëve që studiuuan atje, si M. Barleti, M. Beçikemi, familja së Engjëllorëve etj. Edhe tek populli që mbeti në trojet e hapësirës shkodrane ai do të përjetësohej në studime, në letërsi, folklor, muzikë, punime artizanale etj.

A. Bashkëluftëtarë të Skënderbeut në luftërat dhe veprimtari diplomatike (1,2,3,4, 5,6,7, 8)

Janë shumë luftëtarë të shquar të hapësirës shkodrane që kanë qenë në krah të heroit në luftërat e tij çlirimtare kundër osmanëve, duke vlerësuar kontributin e tij kombëtar.

Në luftën shqiptaro-venedikase të vitit 1447-1448, e cila u zhvillua kundër Venedikut për marrjen e kështjellës së Danjës (D□jës) që ishte nën zotërimin e Venedikut, iu bashkuan shumë luftëtarë të hapësirës shkodrane. Për të mbështetur veprimet luftarake shqiptarët ndërtuan një kështjellë mbi gërmadhat e Ballecit, rrëzë malit të Maranajit. Kalimi i ushtrisë shqiptare në thellësi të zotërimeve veneciane u përkrah nga vendasit që shpërthyen në kryengritje dhe u bashkuan me forcat shqiptare. Për këtë Venediku u detyrua të bënte paqe me Skënderbeun më 04.10.1448, në fushimin e ushtrisë shqiptare. Por luftëtarët e hapësirës shkodrane do ta vazhdonin luftën edhe pas vdekjes së Skënderbeut ku në betejën afër lumit Kir, më 17 janar 1478, pikërisht në ditën e vdekjes së Skënderbeut, ato të udhëhequr nga Lek Dukagjini do të thyenin forcat osmane të komanduara nga Ahmet Pasha. Duke shfrytëzuar vdekjen e heroit, turqit menduan se do ta pushtonin lehtë vendin, për t'u përgatitur drejt Veriut, me përparësi pushtimin e Shkodrës, por beteja më 1474, do të përfundonte me fitoren e shqiptarëve. M. Barleti në veprën e tij "Rrethimi i Shkodrës", *'De obsidione Scodrensi'*, (botuar në Venezia më 10 janar 1504 dhe i ribotuar i përkthyer nga Henrik Lacaj më 1962, tregon nuk ishte e rastit që emri i Skënderbeut zihej në gojë disa herë midis mbrojtësve shkodranë që luftonin në mbrojtjen e Kalasë së Shkodrës, ku theksohet se një nga figurat më të shquara midis mbrojtësve, murgu Bartolome kishte qenë një nga bashkëluftëtarët e Skënderbeut, i cili për të mbajtur të ndezur entuziazmin në fitore u bënte thirrje shkodranëve të mos të dorëzoheshin **.(A.1, 2, 3)**

Kuvendi i Lezhës

Kuvendi Historik i Lezhës, të 2 marsit 1444, i organizuar nga Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, kishte si qëllim kryesor bashkimin e sa më shumë fisnikëve e principatave nga tokat që më parë në botën e krishtere ishin të njohura si toka të Perandorisë së Bizantit si dhe rimëkëmbjen e Mbretërisë së Arbrit. Në këtë kuvend, përfaqësuesit nga Lezha dhe Shkodra përbënin afro 66% (2/3) e të gjithë përfaqësuesve nga krahinat e tjera, dhe këto ishin: Pjetër Spani princi i malësisë së Shalës dhe Shoshit me të katër bijtë (Aleksin, Bozhidarin, Vruan dhe Mirkon), Gjergj Stres Balsha, kryezot i Misisë, krahinës midis Krujës dhe Lezhës, Nikollë e Pal Dukagjini, kryezotët e Dukagjinit, Lek Zaharia –kryezot i Danjës, Lek Dushmani –princi i Zadrimës, Stefan Cernojeviqi –princ i Malit të Zi, me dy djemtë e tij, Pal dhe Nikollë Dukagjini principata e të cilëve zgjatej nga Drini në Kosovë gjer në kufi të Serbisë. Ato jo vetëm që ishin pjesëmarrës të Besëlidhjes së Skënderbeut në Lezhë, ku mbështesin Lidhjen me 5000 ushtarë nga 15000 që kishte gjithsej Skënderbeu, por Pali do ta shoqëronte Skënderbeun në Krujë. Po kështu Lekë Zaharia kryezot i Danjës ishte një bashkëluftëtarët më të zotë të Skënderbeut.

Më 2 mars të vitit 1444, Skënderbeu mbajti në Katedralen e Shën Kollit të Lezhës, dikur kryeqendër e Dukagjinëve, asokohe nën sundimin e Venedikut, Kuvendin e Lezhës, i njohur si Lidhja e Shenjtë e Lezhës apo edhe Besëlidhja e Lezhës. Ky ishte i pari Kuvend Kombëtar i fisnikëve shqiptarë të shek. XV në të cilën morën pjesë Gjergj Arianiti, Pal Dukagjini, Andrea Topia, Lekë Dushmani, Pjetër Spani, Lekë Zaharia, Teodor Korona dhe Pal Stres Balsha. Lidhja e Lezhës ishte një aleancë politiko-ushtarake e cila zgjodhi Gjergj Kastriotin (Skënderbeun) si “kapiten i përgjithshëm i zotërve të Arbërisë” (capitano generale degli Signori d’Albania)(A. 4,5,6, 7)

Engjëllorët

Engjëllorëtishin familje bujarësh shqiptarë nga qyteti i Drishtit. Rridhnin nga familja Duzi apo Dushi e njohur që në shek. XV, që sipas burimeve të tyre, pas një lidhjeje martese me bijën e perandorit bizantin, përvetësuan mbiemrin e familjes perandorake Engjëlli. Pas pushtimit të Drishtit nga osmanët (1478) u vendosën në Venedik dhe krahina të tjera

të Italisë ku kishin një pozitë të dalluar në rrethet kishtare e intelektuale. Engjëllorët ruajtën në breza vetëdijen kombëtare dhe dëshirën për t'u kthyer në Shqipëri. Një nga vlerat në histori të kësaj familjeje është kontributi i pjesëtarëve të saj në luftërat e Skënderbeut.(B.1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9.)

Pal Andrea Engjëlli(1417-1470),

kryepeshkop i Durrësit, autor i *Formulës së Pagëzimit* më 1462, ishte mik, bashkëpunëtor dhe këshilltar i ngushtë i cili i ka shërbyer edhe si diplomat i Gjergj Kastriotit. Në kryeveprën e tij kushtuar Skënderbeut, Marin Barleti e vlerëson si *“burrë të pajisur me mendje shumë të lartë e me zotësi të rrallë në të folur (në gojtari), me dituri si askush dhe i vaditur në letërsinë e shenjtë dhe në letërsinë humane”*. Në vitet 60-të të shekullit XV, Pal Engjëlli, si diplomat e këshilltar për punët e jashtme i Skënderbeut, qe aktivizuar shumë. Ai e shoqëroi Skënderbeun në vizitën katërditore që bëri në Raguzë(Dubrovnik) dhe në Itali më 1461. Veprimtarinë, si diplomat e dëshmon edhe një marrëveshje me Republikën e Venedikut e datës 13 shtator 1465, në të cilën Pal Engjëlli nënshkruan *në emër të madhnueshmit Skënderbe*, si dhe konsultimet e shpeshta e të herëpashershme që bëri Skënderbeu me të, lidhur me marrëdhëniet me Venedikun;

Pjetër Andrea Engjëlli (1443-1511),

Vojvodë i Drishtit, lindi në qytetin e Drishtit dhe vdiq në Venedik. Ishte djali i dytë i Andreas dhe vëllai i Pal Andrea Engjëlliti cilipak para pushtimit osman vendoset në Venedik në v. 1478 e më vonë në Padova. Pjetri u dallua si udhëheqës ushtarak në ushtrinë e Skënderbeut. Në betejën e zhvilluar afër Ohrit më 1464, nën udhëheqjen e Skënderbeut, dallohet si komandant ushtarak kundër ushtrisë osmane. Mori pjesë në luftimet për mbrojtjen e Shkodrës më 1474 dhe të Drishtit më 1478. Largohet nga Drishti pak para pushtimit osman dhe vendoset në Venedik në v. 1478 e më vonë në Padova. Ndihmoi dhe nxiti Marin Barletin të shkruante dy veprat e tij madhore *“Rrethimi i Shkodrës”* dhe *“Historia e Skënderbeut”*. Barleti këtë veper ia dedikon pikërisht Pjetër Engjëllit, frymëzuesit të kësaj vepre.

B.Heroi kombëtar në veprat studimore të personaliteteve të hapësirës shkodrane

(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16,17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25)

Janë të parët shkodranët që do të shkruajnë për heroin duke e përfaqësuar denjësisht në veprat e tyre, në historiografi, letërsi, folklor, pikturë, artizanat etj. Një pasuri të madhe historiografike kanë lënë shkodranët e ikur në Itali, pas rënies së Shkodrës në duart e turqve, pas v. 1479, ndër të cilët: Dhimitër Frangu, Marin Barleti, Marin Beçikemi.

Dhimitër Frangu (1443-1525),

fisnik nga Drishti, kushëri dhe shoqërues i Pal Engjëllit, arkëtar, luftëtar e sekretar i Skënderbeut, (nga 1443 deri 1468, kur vdiq Gjergj Kastrioti), lindi në qytetin mesjetar të Drishtit. Shërbeu pranë Skënderbeut si funksionar i ngarkuar me problemet financiare dhe që një nga bashkëpunëtorët e ngushtë të tij, në luftëratqë Skënderbeubëri kundër turqve. Pas pushtimit të Shqipërisë nga osmanët (1478) Dh. Frangu u shpërngul nga Shqipëria dhe jetoi si famullitar për 40 vjet në një fshat Briana, në kufi me trevën e Padovës, shumë pranë lokalitetit të Sant' Angelo di Sala ku edhe vdiq.

Pasi hoqi dorë nga detyra e priftit, iu vu shkrimit të jetës së Skënderbeut në gjuhën latine.

Vepra “*Komentar për punët e turqve dhe të Zotit Gjergj Skenderbe, princ i Epirit*” u botua pas vdekjes në latinishten vulgare dhe njohu disa botime. Ky libër ka qenë i shkruar që në vitin 1480 në latinisht dhe i përkthyer më vonë në italishten mesjetare të asaj kohe. Vepra është botuar në vite të ndryshme, nga 1531-1610. Vepra njihej vetëm nga përkthimi italisht (Commentario del cose dei Turchi, et del S.Georgio Scanderbeg, principe di Epyrro”, Venedik 1539) dhe nga një përkthim tjetër po në atë gjuhë nga studiuesi, prifti italian, Giovanni Maria Bonardo (1584). Kjo vepër e v. 1584, botuar në Venecie, ruan edhe *portretin e vërtetë të Skënderbeut* Libri mban një shënim të rëndësishëm në parathënieën e tij, “...*Libër që asht shkruar latinisht me dorë prej Dhimitër Frangut, i cili ishte i pranishëm personalisht dhe i mirë informuem për të gjitha betejat e veprat e atij Princi*”. Në këtë botim jepet emri i autorit, Dhimitër Frangu. Siç shihet, titulli i veprës ka ndryshuar nga njëri përkthim në tjetrin, po ashtu dhe ribotimet kanë tituj të përafërt, por jo të njëjlojtë. Ky version i ri, përkthimi e botimi i

Bonardos, që është vlerësuar nga të gjithë studiuesit, si më i miri, më autentik se ai i vitit 1539. Në mesin e shekullit XVI u përkthye e u botua edhe në frëngjisht (Paris, 1544) dhe në anglisht (Londër, 1562). Në veprën për Skënderbeun, Dh. Frangu, sjell një varg të dhënash të reja për jetën e Skënderbeut, që nuk janë te Barleti. Vepra ka merita të veçanta si vepër origjinale, me të dhëna të reja, me datime më të sakta, me një qëndrim më realist në përshkrimin e betejave dhe të numrit të pjesëmarrësve në to etj., pra ajo konsiderohet një burim autentik i pavarur. Lek Pervizi, më 2012 e ka përkthyer veprën nga italishtja e vjetër, në dialektin gegë. (B.19, 20,27, 28)

Marin Barleti (rreth 1460-1512/13),

humanist i shquar, historian (i lindur në Shkodër), ka shkruar veprën “De obsidione Scodrensi” (“Rrethimi i Shkodrës”), Venedik 1504, ku jep historinë dramatike të luftës për jetë a vdekje të banorëve të qytetit të rrethuar për një vit nga osmanët. Në këtë vepër, gjatë përshkrimit heroik të luftës së shkodranëve, ku marrin pjesë edhe duke përmendur luftërat e tij për mbrojtjen e kështjellës së Krujës. Por ajo që do ta bënte figurën e parë dhe më të shquar të humanistëve shqiptarë do të jetë vepra madhore “Historia da vita et rebus gestis Scanderbegi”, (“Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut”), Romë, botuar midis 1508 dhe 1510, ku jep një histori të jetës dhe luftërave heroike që bëri hero i ynë kundër turqve. Ajo e paraqet autorin si një shkrimtar dhe historian humanist të nivelit të lartë. Në këtë vepër ai përpiket të ndërtojë kuadrin e saktë të jetës së heroit dhe me gjithë vështirësitë objektive për të siguruar burimet, jep njohuri të gjera për zhvillimin e shoqërisë shqiptare në shek. XV. Meritë e madhe e M. Barletit është se pas botimit të veprës së tij, një numër i madh veprash të historiografisë dhe letërsisë botërore mbështeten tek ajo. Kjo kryevepër njohu jo më pak se 16 botime deri në mesin e shek. XVI, ndër të cilat katër në latinisht, katër në gjermanisht, katër në italisht, një në portugalisht, një në polonisht, dy në spanjisht. Siç shprehet Aleks Buda në hyrje të veprës së J. Kastratit dhe K. Biçokut për *Bibliografinë e Skënderbeut, pas këtyre botimeve që e ruajtën integralisht, qoftë edhe në gjuhë të tjera origjinalin e Barletit, ajo u bë një mbështetje e fuqishme e gjithë historiografisë letrare në shekujt e mëvonshëm në vende të ndryshme europiane.*

M. Barleti bashkëpunoi, ishin edhe me bashkëkohësit e Skënderbeut, Pjetër Engjëlli, pjesëtar i familjes së madhe të Engjëllorëve nga Drishti,

me pozitë me rëndësi në ushtrinë e Skënderbeut dhe i vëllai Pal Engjëlli, kryepeshkop i Durrësit, dhe burrë shteti nën shërbimin e Skënderbeut, tregimet e të cilëve për luftërat e Skënderbeut dhe nxitjet e tyre të vazhdueshme, luajtën një rol në nxjerrjen në dritë të librit (“Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut”).

(A. 1, 2, B.11,12,13, 14, 15, 16)

Marin Beçikemi (1470-1526),

humanist shqiptar, pedagog, shkrimtar dhe kronist, i lindur në Shkodër. Megjithëse ishte 8 vjeç ai i përjetoi me dhimbje Rrethimin e Dytë të Shkodrës Shkodrës më 1478, ku humbi 26 vetë nga familja prej 30 vetash, përfshirë edhe të atin. I ati i Beçikemit si nëpunës i Serenismës, Republikës së Venedikut ka qënë një person aktiv në ngjarjet politike e ushtarake të Shqipërisë të paktën duke nisur nga vitit 1446 deri sa mbeti i vrarë në rrethimin e dytë të Shkodrës (1479). Studioi e dha mësim në Raguzë të Dalmacisë, në Breshja të Italisë së Veriut, dhe u shqua si profesor i retorikës në Universitetin e Padovës. La shkrime të ndryshme në gjuhën latine, shkrimet e tij u përdorën si tekste edhe në “Scuola degli Albanesi”,- ku për njëfarë kohe ishte dhe mësues. Me 1503 botoi në Venedik një “Panegjirik” me interes për historinë e Shkodrës dhe për dëshmitë që autori sjell mbi qëndresën e saj kundër osmanëve, në të dy rrethimet e viteve 1474 e 1478. Vepërza ka ndonjë të dhënë me interes edhe për Skënderbeun, si edhe për historinë e mëparshme të Shkodrës. Mendohet që zanafillat për shkrimin e historisë të Skënderbeut nga ana e Marin Beçikemit janë shumë të hershme e mund të konsiderohen fill pas botimit të Rrethimit të Shkodrës.(B.3,11,13,15)

Engjëllorët, përveç, si bashkëluftëtarë të luftërave kundër osmanëve si edhe bashkëpunëtor në fushën diplomatike u bënë edhe nxitës të studimit të historisë së tij, si Pjetër Andrea Engjëlli që ndihmoi dhe nxiti Marin Barletin të shkruante dy veprat e tij madhore “Rrethimi i Shkodrës” dhe “Historia e Skënderbeut”.(B.1, 2,3, 4, 5, 6, 7, 8, 9).

Pal Pjetër Engjëlli (-1573)

Historian humanist dhe klerik katolik. Pali ishte i biri i Pjetër Andrea Engjëllit. Ai gjeti dorëshkrimin në latinisht të Dhimitër Frangut, e përktheu në italisht dhe e botoi në Venedik më 1539 nën këtë titull: “*Comentario de le cose de’ Turchi, et del S. Georgio Scanderbeg, principe d’ Epyro*” (Komentari i të bëmave të Turqve dhe i Z. Gjergj

Skanderbegut, princ i Epirit). Vepra u botua pa emër të autorit, nuk dihet përse, dhe pa vend botimi (dihet se në Venedik). Veprës i bëri disa ndryshime, duke mbajtur një qëndrim më të hapur kritik kundër politikës së Venedikut ndaj Shqipërisë. Mund të quhet kështu bashkautor i asaj vepre, e cila deri më 1554, njohu disa ribotime në Venedik. Origjinali latinisht hyri në shek. XIX në British Museum. (B.3).

Frang Bardhi (1606-1643),

leksikografi i parë shqiptar, historian, folklorist dhe etnograf, klerik i lartë katolik, një nga autorët e letërsisë së vjetër shqiptare, i lindur në Kallmet të Zadrimës, botoi më 1636 në Venedik veprën “Georgius Castriotes Epirensis vulgo Scanderbeg, Epirotarum Princeps fortissimus ac invincitivimus”, (“Gjergj Kastrioti i Epirit, i quajtur përgjithësisht Skanderbeg, princ shumë trim dhe i pathyeshëm i shqiptarëve”), e quajtur “*Apologjia e Skënderbeut*”. Vepra në të vërtetë është një apologji (mbrojtje) që i bën autori Skënderbeut, si bir dhe hero i popullit shqiptar, prandaj edhe është quajtur *Apologjia e Skënderbeut*. Këtë veprë shkroi si polemikë për të hedhur poshtë mëtimin e pathemeltë të një peshkopi boshnjak bashkëkohës, që kishte dashur ta nxirrte Skënderbeun nga familja e tij dhe vendet e Bosnjës. Argumentet e përdorura nga F. Bardhi janë mbështetur në burime historiografike, arkivore e kronikale që njiheshin në atë kohë, duke mbajtur ndaj tyre edhe qëndrim kritik. Si një njohës dhe mbledhës i i traditës gojore popullore, për të vërtetuar shqiptarësinë e Skënderbeut, shfrytëzon me mjeshtëri të rrallë gojëdhënat dhe faktin që emri i Skënderbeut dhe kujtimi i tij rronin të gjallë në ndërgjegjen e popullit. (B. 19, 20)

Kontributi i autorëve shkodranë të periudhës së Rilindjes

Në historiografinë shqiptare një kontribut të vlefshëm japin autorët shkodranë të periudhës së Rilindjes, që shkruajnë për historinë e Shqipërisë, ndër të cilët një vend të rëndësishëm zënë historitë për Skënderbeun dhe luftërat e tij. Sprovën e parë bën shkodrani Pashko Vasa (1825-1892) me traktatin e vet historiko-politik “*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*”, botuar më 1879, që konsiderohet si vepra e parë historike e rilindasve. Serinë e teksteve shqipe, si tekstet e para të historiografisë e fillon Stefë Curani (1865-1941), lindur në Shkodër, me librin “*Të ndollunat e Shqypnis*” botuar me pseudonimin “*Nje gegë që don vendin e vet*” (1898), e cila është kryesisht një përshtataje

e mbështetur në ligjëratat e L. Taloçit, por që është e para histori e Shqipërisë, që nga lashtësia deri në kohën e re e botuar në gjuhën shqipe. Afro 1/5 e vëllimit të librit i kushtohet drejtpërdrejt vetëm jetës dhe veprës së Skënderbeut. Përshkrimi i figurës komplekse të Skënderbeut u bë që të jetë i kuptueshëm nga të gjithë. S. Curani në librin e tij e paraqet Skënderbeun jo vetëm si strateg ushtarak, largpamës por edhe si ligjvënës, burrë shteti, administrator, njeri dhe mendimtar i urtë.

Për figurën e Skënderbeut, në mënyrë të veçantë kontribute kanë dhënë klerikët katolikë të hapësirës shkodrane, të cilët kanë lënë një varg studimesh, si:

Dom Ndoc Nikaj(1864-1951)

boton në Bruksel "*Historia e Shqypnis*" të cilën e riboton të rishikuar në Shkodër më 1917.

ÁtMarin Sirdani (1885-1962),

klerik katolik, historian, mbledhës folklori, shkrimtar. Botoi veprën: "*Skënderbegu mbas gojëdhanash*" (1926), që konsiderohet kryevepra e tij, ku përmbloodhi mbetjet e fundit të kujtimeve popullore arbërore për Heroin e Kombit. Ka shkruar tek revistat "Hylli i Dritës" dhe "Leka" shkrime dhe studime , si "*Për çka fajësohet Skënderbegu*", (1935-1936) që u ribotua në Tiranë më 2001, "*Vorri i Skënderbegut*".

***Imzot Antonin Fishta (1902-1972)**

Klerik katolik, muzikant, historian dhe poet.Ka shkruar studimin historik "*Skanderbegu e françeskajt*"(1930).

Athanas Gega (Luc Preloka)(1904-1988),

klerik katolik, doktor i shkencave historike, atdhetar, antifashist, gazetar, i lindur në fshatin Buzë, Triesh, Malësi e Madhe, i lauruar në Luven të Belgjikës, doktoron me temën "L' Albanie et l' invasion torque au XV-esiecle". Vlerësimin më të madh kësaj vepre ia bëri Fan Noli, kur shkroi veprën e tij mbi Skënderbeun më 1949,**duke treguar se**A. Gega është arbërori i parë që u mor me historiografinë shqiptare dhe shkroi një monografi shkencore mbi Gjergj Katriotin Skënderbeun e cila ishte *ishte më e mbaruara që kishte parë dritën gjer në vitin 1949, si nga forma, nga lënda dhe nga baza dokumentare*. Është botuar nga EuroRilindja në Tiranë më 1995 dhe përsëritur në Tuz më 2003.

***Át Luigj Marlekaj (1906-2003),**

klerik katolik, profesor, historiograf i letërsisë, përkthyes, i lindur në Plan të Dukagjinit, më 1969, boton studimin: “*Scanderbeg nelle tradizioni popolari albanesi*”, (Skënderbeu në traditat popullore shqiptare). Duke hulumtuar mbi heroin tonë kombëtar, zbuloi një dorëshkrim mbi jetën e Gjergj Kastriotit në Bibliotekën Kombëtare të Firences, të titulluar “*Vita di Scanderbego*”(Jeta e Skënderbeut) që e botoi në Romë në vitin 1973.

Frano Imzot Illia(1918-1997),

klerik katolik, studiues, profesor (i lindur në Juban të Shkodrës) ka realizuar veprën e tij më të shquar “Kanuni i Skënderbeut”, botuar më 1993, për të cilën ai punoi në fshatrat e Shqipërisë Qendrore, Mat dhe Shkumbin, duke mbledhur, rreshtuar dhe kodifikuar njohuritë juridike të popullit të kësaj treve, doket e zakonet kanunore. Qëllimi kryesor ishte që në formën e një Kodi monumental të shënoheshin e të ruheshin jo vetëm zakone e norma juridike të vjetra, që lidheshin për emrin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, por njëkohësisht të viheshin në pah edhe tiparet e cilësitë themelore të psikologjisë e të shpirtit të shqiptarit. Ndryshe nga etnografët e tjerë, materialet e së drejtës zakonore, që Dom Frano Illia i grumbulloi, jo vetëm në krahinën e Kurbinit, por edhe në krahinat përreth Shqipërisë Qendrore, i pagëzoi me të drejtë me emrin: *Kanuni i Skënderbeut*, sepse Skënderbeu bëri disa ligje kanunore të veçanta për krahinat e veta dhe të ndikimit të vet

Vinçens Malaj (1928-2000),

klerik katolik, studiues dhe akademik nga hapësira shkodrane, i lindur në Ljarje të Krajës, ka bërë studime rreth figurës së Skënderbeut. Në dy vëllimete veprës “*Të dhana albanologjike. Folklor. Bibliografi. Histori. 1, 2, Ulqin-Tuz, 1999*, vlen të theksohet numri i madh i studimeve kushtuar Gjergj Kastriotit-Skanderbegut, që lidhen me përkujtimin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit tonë të madh. Qënë studime të cilat në *Atdhé kaluen pa u dijtë, kaluen në heshtje*, sikurse edhe gjithë veprimtaria kushtuar kësaj figure të madhe. Sidomos në vëllimin e parë studiohet Shqiptari i Madh në disa pamje, i krahasuar edhe në lidhje me veprën e personaliteteve të artit e të kulturës europiane

Midis të tjerave, At V. Malajt i përket merita e madhe e zbulimit të

veprave muzikore të realizuara nga të huajt për Skënderbeun. Kështu duke botuar studimin e tij në revisten “Shejzat”, ai jep të dhëna rreth gjetjes në Bibliotekën Kombëtare të Romës të një vepre të panjohur të Gjergj Kastriotit, operën “Scanderbeg”, me libretë të Antonio Salvit, botuar në Firence më 1718 dhe muzikë të kompozitorit të famshëm Antonio Vivaldi, luajtur për herë të parë në Firence më 22 janar 1718, në teatrin Pergola. Zbulimi i nënshtrohet një studimi të thellë, jo vetëm letrar e historik, por edhe një analize muzikore.

Një tjetër opera mbi Gjergj Kastriotin, është gjetur nga V.Malaj në Bibliotheque de l’Opera dhe në Bibliotekën Kombëtare të Parisit. Opera është e vitit 1735 me libret të autorëve La Mote - La Serre, dhe muzikantëve Rebel - Francuer. Ajo u luajt për herë të parë më 27 tetor 1735. Gjithnjë sipas shënimeve të Malaj-t, në njërën nga 33 shfaqjet e saj, në vitin 1763, ajo u shfaq në Chosy, Fontainebleau para mbretit Luigi XV dhe oborrtarëve të Versajës.(B.21,22,23)

Autorë të tjerë bashkëkohës për Skënderbeun

Cuk Simoni (1889-1968)

Gazetar dhe përkthyes, lindur në Shkodër, ishte një ndër esperantistët e parë shqiptarë, që hartoi dhe botoi më 1929, në këtë gjuhë të re, një histori të Skënderbeut me titull “*Skanderbeg heroo de Albanuio*” vepër që ka hyrë në fondin e klasikëve të esperantos dhe ruhet në bibliotekën e Holandës. Libri që sheh dritën e botimit i përkthyer së fundi në shqipe nga origjinali esperanto “Skanderbeg, Heroo de Albanujo” (Shkodër, Shtypshkroja Komtare, 1929), shënoi nga rrethi shqiptar i esperantistëve kontributin unikal për atë kohë që nuk është tejkualuar nga bashkëkohësit me ndonjë vlerë të përafërt.(B.19,26)

*** Lec Shllaku (1913-1998),**

gazetar dhe publicist, i lindur në Shkodër, emigrant në Itali dhe mbas 1958 ishte emigrant në Francë. Është autor i librit publicistik “*Skanderbeg*” me temë historike. Ka bërë përpjekje gati dyvjeçare duke ndërhyrë tek institucionet dhe personalitetet franceze, për t’i dhënë emrin e Skënderbeut një sheshi në Paris. Këto përpjekje u kurorëzuan me sukses në vitin 1980, ku pas vendimit të Këshillit Bashkiak të Parisi, sheshit që quhej ‘Villa Lumier’, iu dha emri i Skënderbeut.

Jup Kastrati(1924-2003),

filolog dhe bibliograf, profesor universitar, “Mësues i Popullit”(i lindur në Shkodër),në bashkautorësi me profesor Kasem Biçokun, kanë botuar më 1997 veprën “*Gjergj Kastrioti Skënderbeu, bibliografi 1454-1835*” ku jepen të gjithë autorët që kanë shkruar për Skënderbeun gjatë kësaj periudhe, përfshirë 365 vepra të botuara, 10 të pabotuara dhe 37 të dyshimta.

Ardian Ndreca(1969),

profesor universitar filozofie dhe publicist, më 2008 ka botuar veprën “*Kur Skënderbeu nuk asht historia e Skënderbeut*” (Tiranë 2008), një kontribut i shquar ky në diskutimin historiografik mbi heroin tonë kombëtar. Në këtë studim, prof. Ardian Ndreca ka bërë një analizë të hollësishme mbi linjat delikate të librit “Skënderbeu” të studiuesit zviceran Oliver Jens Schmitt.

Edhe në revistat e kohës, si “Hylli i dritës”, “Leka” që janë botuar në Shkodër deri më 1944, janë botuar shumë dokumenta të rëndësishëm për historinë mesjetare të Shqipërisë ku natyrisht Skënderbeu dhe lufta e tij 25 vjeçare kanë zënë artikujt të shumtë të këtyre revistave.

C. Heroi kombëtar në folklor dhe në veprat letrare të autorëve shkodranë

(1, 2, 3, 4, 5, 6)

Jehona e heroit në folklor

Janë shumë autorë shkodranë që kanë shkruar drama, poema, poezi për heroin tonë kombëtar, Skënderbeun. Në hapësirën shkodrane, kujtimi për Skënderbeun në folklorin e kësaj treve zë një vend të veçantë.Frang Bardhi shkruante më 1635 në fletët e fundit të *Fjalorit latinisht-shqip* se populli e kujton Skënderbeun gjithnjë plot nderim, madje nga vepra e tij me titull «*Gjergj Kastrioti Epirotas i quajtur zakonisht Skënderbe*», botuar në Venedik më 1636, mësojmë se edhe atëherë ekzistonte një folklor i pasur për Heroin tonë Kombëtar: «*Që nga koha e Skënderbeut gjer tani nuk ka kaluar aq kohë sa të jetë shlyer e harruar çdo kujtim i tij dhe i njerëzve të tij nga bashkëkombësit tanë*”. Më poshtë Frang Bardhi shton: «*Dhe vazhdimisht gjer në ditët*

*e sotme bashkëkombësit tanë flasin për të dhe këndojnë me zë të lartë trimëritë e tij nëpër gostitë». Këtë njoftim Frang Bardhi e përsërit më shkoqur në qershor 1637 në një relacion, ku, ndër të tjera, thotë për malësorët e Pukës: «Sipas zakonis të të moçëmve ndër gostitjet e veta në rrugë e në punë këndojnë me zë të naltë trimnitë e burrave të tyne të mëdhenj dhe sidomos të pathyeshmit zot Gjergj Kastriotit, të quajtur Skanderbeg». Kaq shumë u popullarizua emri i heroit sa nanat në ninulla që u këndonin fëmijëve, vargëzonin kohën e lavdishme të tij si : *Kenke nisun me punue, tue qindis me teherie/me tehri e fije arit/flamurin e shqiptarit/flamurin si a kenë motit, si ndër kohna t'Kastriotit.*” Më 1610 Marin Bici (1570-1624), kryepeshkop i Tivarit në një relacion, midis të tjerash, shkruante për Skënderbeun: «*U nda në shejë me shumë luftime të vlerata kundër turqve, të cilat të qituna në vargje këndohen prej gjithë shqiptarëve edhe në praninë e turqve*».*

Skënderbeu në dramaturgji

Shumë drama u vunë edhe në skenat e teatrove diletante të shoqërive të kohës, para vitit 1944. Dramat për Skënderbeun, të shfaqura në sallat e kinemave të qytetit të Shkodrës dhe sallat e teatrove të institucioneve sidomos ato katolike, u priten me një entuziazëm të paparë nga publiku shkodran, i cili kërkoi disa herë ripërsëritjen e këtyre shfaqjeve. Në skenat e teatrove dhe kinemave amatore entuziazmi dhe pathosi patriotik shumë herë bëri që shfaqjet të mbylleshin me brohoritjedhe duartrokitje frenetike. Po kështu shembull patriotik dhanë edhe shumë intelektualë, shkrimtarë, përkthyes, regjisorë që i shkruan dhe i vunë në skenë dramën me motive patriotike të kohës së Skënderbeut

Anton Xanoni(1862-1915),

Klerik katolik, shkrimtar, autor tekstesh shkollore, përkthyes, sociolog dhe psikolog, më 1914 shkruan dramën “*Skënderbeu*”, që u botua në Shkodër, më 1917, dy vjet pas vdekjes. Më 1927 vihet në skenë drama tjetër e tij “*Shpata eSkënderbeut*” ose “*Ballaban Pasha*”, ku dënohet trathëtia e Moisi Golemit. Kjo dramë me një sukses të jashtëzakonshëm u vue në skenë disa herë me autorë të ndryshëm. U shfaq më 1927, 1928, 1937, 1938, 1942, Ka shkruar edhe dramën “*Moisi Golemi*”, dramë me 5 akte, që u dha premierë më 1917.(C.1,2

Kolë Mirdita (Helenau) (1900-1936),

Shkrimtar dhe jurist, lindur në Shkodër, shkruan dramën “*Vdekja e Skënderbeut*” që shfaqet nga nxënësit e Kolegjit Saverian më 1916 dhe rishfaqet më 1917 me rastin e 450 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut;(C, 1,2)

Filip Fishta, (1904-1976),

gjuhëtar, studiues dhe profesor (lindur në Shkodër) shkruan dramën me një akt “*Skënderbeu dhe Kolë Malçi nga Skurraj*”, 1923, që trajton temën e lidhjes së ngushtë që kishte Skënderbeu me njerëzit e popullit në luftën kundër turqve. Kjo dramë u vue në skenë nga shoqëria teatrore “Shkodra”.(C, 1,2)



Pamje nga drama “*Andrra e 500 vjetëve*”, shfaqë në vitin 1937 nga amatorët e Shoqnisë Vllaznia”: Gjush Sheldija, Luigj Mjeda, Ndoc Deda, Brahim Duka, Marjan Skanjeti, Ndoc Prennushi, Adem Kastrati, Kolë Mirashi

Henrik Lacaj(1910-1991)

Humanist, përkthyes dhe leksikograf, lindur në Shkodër më 1937, shkruan dramën “*Kthimi i Skënderbeut*”. Në vitin 1962 përktheu mjeshhtërisht nga latinishtja veprën e M. Barletit “*Rrethimi i Shkodrës*” e cila u ribotua disa herë më 1967 dhe 1980. (C, 1,2)

Andrea Skanjeti, (1906-1992)

Shkrimtar, dramaturg dhe regjisor, lindur në Shkodër, shkruan më

1937 dramën “*Andrra e 500 vjetëve*”, dramë me tre akte interpretuar nga aktorë të shoqërisë “Vllaznia” dhe shfaqur më 1937 me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë. U shfaq edhe më 1938 dhe më vonë më 1959, me amatorë të vjetër të grupeve diletante.(C1,2)

Aleks Baçi

shkruan dramën “*Skënderbeu*”. U shfaq si premierë në vitin 1943 dhe u vue në skenë nga aktorët diletantë të shoqërisë “Antoniane”.(C,2)

Gjergj Fishta(1871-1940)

Shkrimtari, kleriku e shqiptari i madh, diti t’i himnizojë mrekullisht virtytet shqiptare, shenjat identifikuese nacionale, gjuhën shqipe, flamurin kombëtar, trimërinë, figurat nacionale, të cilat i personifikon përmes heroit kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, portreti i së cilit do të endet në mënyrë funksionale dhe domethënëse në gjithë veprën e tij letrare. Tek “*Nën hajat të Parrizit*” e ndërtuar mbi një bisedë imagjinare mes Shën Pjetrit, Skënderbeut dhe Djallit tregon parashikimin e hollë dhe aktual se çfarë ngjet edhe sot me Europen që Skënderbeu s’e ka njohur të tillë, duke përmendur edhe shprehjen se “*si djalli ka vajzë diplomacinë*” dhe kjo ka nanë Europën.

Vinçenc Prennushi (1885-1949)

Klerik katolik, poet, përkthyes dhe studiues, martir i fesë e i kombit, (i lindur në Shkodër) në vëllimin poetik “Gjeth e lule”, ka një poemth me titull “*Shpata eSkanderbegut*” ku heroi, edhe në varr nuk duron duke ndjerë mjerimin e madh, mizoritë e të huajve, vdekjet e tradhëtitë, e ngrihet nga varri. Ç’të shohë? “*N’ato fusha ku mbijshin zymbylat, / N’ato kroje ku zanat u kqyrshin, / Ndër zabele ku kndojshin bylbylat, / Sot kndon qyqja prej vorrit në vorr. / Ke ato hije ku tufat mrizojshin, / Ku jehonte veç vallja shqiptare. / N’gjithë at Eden desht dora tradhtare / T’mjellë morriza që ngrehen shatorr.* E duke shpresuar që shpata e Tij do të bjerë në duar të sigurta, gëzohet: “*N’gallnim rroftë shpata n’za e Skanderbeut*”. (D.1)

Ndre Mjeda(1866-1937)

Klerik katolik, poet, veprimtar patriot, studiues (i lindur në Shkodër) ka shkruar shumë poezi patriotike, ku evokohet lufta e lavdishme e Skënderbeut. Kështu në poemën “Liria”, në vargjet poetike ku tregohet

kryengritja e Malësisë Madhe, e vitit 1911, autori ngjall jo vetëm shpresën për liri por edhe frymëzimin për luftëra, duke përmendur me mjete dhe një aludim artistik frymën e re të heroit kombëtar Skënderbeu: *“mshehtas shetiti/ kësollë për kësollë e rreth buneve soditi/ frymë të re tuj shprazun gjithkund/ hija e Skanderbeut”*. Tek poezia *“Vorri i Skanderbeut”*, pasi i bën një elegji vdekjes së tij, shpreh besimin se luftën e përpykjen për liri edhe më tutje s’duhet ta ndalë asnjë shqiptar, gjë që e përsërit edhe tek poezia *“Bashkoniu”*(1902). Po kështu evokohet Skënderbeu tek poezia e Mahmud Pashës ku N.Mjeda gjithnjë në vazhden e Rilindjes, ngre lart figurën e heroit kombëtar, si simbol bashkimi dhe burim besimi në fitore. Tek poema *“Lisus”*(1921) ai jo vetëm që e përshkruan Lezhën si një vend të bekuar dhe heroik, por vlerësimin e madh e ka se aty pushojnë eshtrat e heroit të mbuluar me lavdi, frymëzim për vazhdimin e betejave. Kulmin për vlerësimin e figurës së heroi ai e arrin tek poezia *“Mikut P.Moreti”* i cili ka përkthyer në italisht poezinë e tij *“Vorri i Skanderbeut”*. (C.1,3)

Ernest Koliqi (1901-1975)

Shkrimtar, publicist, botues dhe professor universitar në Itali, i lindur në Shkodër, më 1924 shkruan poemën dramatike *“Kushtrimi i Skanderbeut”*. Në të shkruhet se *“shokvet të shoqnis s’Avni Rustemit, përvujtnisht auktori u a kushton kët libër të vogël”*. Libri mbetet një nga veprat e spikatura në morinë e veprave madhore mbi Skënderbeun, mes shumë syresh që u hartuan nga ajka e inteligjencës shqiptare në mbarë Shqipërinë e Epërme.

Ernest Koliqi ka një meritë të madhe, si kryeorganizatori i festimeve në Romë, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut në prill të vitit 1968. Ai ishte kujdesur që festimet me këtë rast, të ishin gjithëpërfshirëse dhe mbarëkombëtare. Ernest Koliqi thotë se për herë të parë në kryeqytetin Italian: *“Emni i Shqipnisë e i Kastriotit tingulloi si za burije....tue u përmend an’e kand emni i Shqipënisë”*. Me dhjetëra intelektualë të mërgatës politike shqiptare të pas luftës që morën pjesë në takimin e parë të diasporës shqiptare, të gjithë së bashku moren pjesë në ceremoninë fetare në Kishën e Madhe të Shën Pjetrit për të nderuar Heroin Kombëtar Gjergj Kastriotin. Në këtë rast Papa Pauli VI më 17 janar 1968, dërgon një letër drejtuar shqiptarëve, ku tërheq vërejtjen e botës mbarë mbi meritat në shekuj të popullit shqiptar. Letrën e ka përkthyer Ernest Koliqi (me pseudonimin Hilushi) me një mjeshtri

dhe stil të veçantë, në dialektin gegërisht. Me këtë rast ai i kushtoi një numër special të revistës “Shejzat” me të gjithë ceremonitë e organizuar me këtë rast. Në këtë numër i bën edhe një koment të veçantë letrës së Papa Pauli VI, dërguar shqiptarëve. Gjithashtu këtu janë botuar edhe kumtesat në simpoziumin e mbajtur në Prishtinë më 9-12 maj të 1968. (C, 1, 4,5,6)

D. Skënderbeu në veprat muzikore të autorëve shkodranë (1, 2) At Martin Gjoka (1890-1940)

është i pari kompozitor shqiptar që kompozoi simfoninë e parë shqiptare (në dy kohë), “*Dy lule mbi vorr të Skanderbegut*”, *Symphoni për Orkestër të Plotë* (1918&1922) – kështu shënohet, me shkrimin e autorit, në faqen e parë të partiturës së At Martin Gjokës. “Autori e ka quajtur këtë vepër “simfoni” për orkestër dhe gjykoj që është e tillë”, shprehet dirigjenti e etnomuzikologu i shquar Eno Koço, i pari që e ekzekutoi këtë vepër në vitet e fundit të diktaturës. Vepra në fjalë është një trajtim kompozicional romantik, i përzemërt, pse jo, nostalgjik, por edhe një tregim narrativ dhe epik mbi heroin legjendar. Gjoka zgjodhi një strukturë apo formë muzikore që të mund të komunikonte mesazhin e tij edhe me njerëzit e thjeshtë.

Tema e parë e simfonisë së Martin Gjokës përshkohet nga fryma romantike e meditative me një melodi sa të thjeshtë aq dhe mbresëlënëse. Tema e dytë, në mazhor, është e kthjellët e penetruese. Karakteri marcial (në formë marshi) i një teme të re jepet me ndjesi dramatike si për të evokuar epokën e Skënderbeut që do të vijojë me solon improvizuese të violinës të pasuar nga një tjetër episod hezitues drejt një Kode (Coda) marciale e dhënë këtë radhë në formën e një përmbylljeje tërë shpresë e vendosmëri. E bukura dhe e ndjera qëndron tek thjeshtësia e perceptimit muzikor ku dëshira për jetën e të ardhmen jepen pa pompozitet, pa ndonjë triumf a ekzaltim të jashtëm, por thjesht me mjete estetike e shprehëse muzikore. At Martin Gjoka, mund të thuhet me plot zë se “është krijuesi i një gjuhe muzikore specifike shqiptare e cila rrezatoi tek mjaft kompozitorë shkodranë, që të gjithë e dimë që kanë qenë në pararojë të artit muzikor shqiptar”.(D.1)

Prenkë Jakova (1917-1969),

kompozitor, “Artist i Popullit”, i lindur në Shkodër me rastin e 500 -vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar kompozon operën “*Gjergj*

Kastrioti - Skënderbeu” me libret të Ll. Siliqit e cila shfaqet në Teatrin e Operas dhe Baletit, nga trupa e këtij institucioni më 17 janar 1968.

Kanë kaluar 50 vite dhe kjo vepër, mbetet një ndër operat më mirë të muzikuara të teatrit lirik shqiptar. Me përmasat e saj madhështore dhe me kompleksitetin e personazheve, karaktereve e situatave, autori ka lartësuar frymën romantike e patriotike të parardhësve të tij shqiptarë në këtë gjini, duke e zëvendësuar dhe ngritur artistikisht me tonin epiko-heroik, që mbizotëron në opera.

Edhe pse vepra ishte e porositur “nga lart”, prishja e marrëdhënieve me Kampin e Lindjes dhe 6 shkurti i 1967, Revolucioni kulturor “alla kinezçe”, “vija e masave”, e të tjera dogma, nuk mund të pranonin një hero të nivelit evropian, që do t’i bënte hije kultit në rritje të diktatorit E. Hoxha. Fjalimi i mbajtur nga kryeministri i atëhershëm në mbledhjen solemne, vetëm një natë para shfaqjes së operas, e quajti Kastriotin pak më shumë se një feudal. Nga ana tjetër diskutimet rraskapitëse për aprovimin e veprës, - që kishin filluar një vit para shfaqjes, - për forcimin e “rolit të masave” tentonin të zbehnin me qëllim frymëmarrjen epokale e mbarë evropiane të figurës qendrore të operas, e për pasojë dhe të luftërave të shqiptarëve kundër ekspansionit osman. “Skënderbeu, udhëheqësi trim, i nderuar nga fqinjët dhe nga vetë Ati i Shenjtë, u kthye në një prijës të madh, të një vendi po aq të vogël” - shkruan kritiku Spiro Kalemli.

Por talenti i rrallë i kompozitorit, gjenialiteti i tij, megjithë ndërhyrjet, bëri që në vepër të ruhet e të pasqyrohet muzikalisht madhështia e epopesë së lavdishme të Arbërit, nën udhëheqjen e Skënderbeut. Udhëheqja e Partisë nuk u kënaq me kaq. Mjaftoi një artikull me katër shtylla në “Zërin e popullit” të nesërmen e shfaqjes, që opera të hiqet nga repertori i teatrit. Organet “Drita”, “Nëndori” heshtën, sepse artistët e vërtetë e të ndershëm e dinin se çfarë vlerash të vërteta kishte vepra.

U deshën gati 50 vite, saktësisht 49 vite, që opera të rishfaqej në vitin 2017, me rastin e 100 -vjetorit të lindjes së kompozitorit të madh shqiptar Prenkë Jakova. T.O.B kreu detyrën e vet dhe shfaqti përsëri operën kushtuar heroit tonë kombëtar me të cilin krenohemi e të cilin e nderon gjithë bota e qytetëruar.(D, 1)

Abdullah Grimci, (1919 -2018),

kompozitor, i lindur në Shkodër, ka kompozuar operën në dy akte “Bijtë e Skënderbeut”(D.2,3)

Çesk Zadeja, (1927-1997),

kompozitor, “Artist i Popullit”, profesor, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, personaliteti më i shquar në universin tonë muzikor mbarëkombëtar, njëri nga themeluesit e Institutit të Lartë të Arteve. I lindur në Shkodër, më 1952 ka kompozuar muzikën e filmit “*Skënderbeu*”, që u shfaq në kinematë e kryeqytetit dhe të Bashkimit Sovjetik më 1953. Në muzikën e këtij filmi ai përdori si lajtmotiv këngën e kompozitorit At Martin Gjoka: “*Kenkan mbushun malet me borë*”. Kolona zanore u vlerësua mbi gjithë komponentët e tjerë të filmit. Mbas 60 vitesh, më 2012, kanë mbërritur nga Moska (Rusia) partiturat origjinale të muzikës së filmit *Skënderbeu*, të Çesk Zadesë, që tani janë pronë familjes së tij, dhuruar me rastin e 85 -vjetorit të ditëlindjes së kompozitorit. Në filmin “*Skënderbeu*” një nga këngët më të bukura kushtuar atij, është kënduar nga “Artisti i Popullit”, basi me famë europiane, shkodrani Lukë Kaçaj. Vargjet e këngës pasurojnë fondin e këngëve për këtë figurë të madhe: “*Trim mbi trima ai Gjergj Kastrioti/Forcë të madhe që m’i dhënka Zoti, /S’e djeg flaka, as s’e djeg baroti/Sa shumë turq menjëherë ai i përllan.*(D.1, 2)

Ramadan Sokoli (1920-2008),

studiues i etnomuzikologjisë dhe i etno-organologjisë, kompozitor, profesor etj. I lindur në Shkodër dhe me një aktivitet të gjerë në fushat e mësipërme ai ka argumentuar shqiptarësinë e më shumë se 40 personaliteteve origjinë shqiptare, ndërsa më 1978 botoi studimin “*Figura e Skënderbeut në muzikë*”, një nga studimet më të thelluara në këtë drejtim.(D.2, 3)

E. Skënderbeu në veprat e piktorëve, filatelistëve dhe artizanëve shkodranë.

(1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8.)



Figurën e Skënderbeut-Gjergj Kastriotit e gjejmë të përjetësuar edhe në artet e tjera. Piktoret shkodranë janë shquar në linjën origjinale të paraqitjes së figurës së tij. Ndër të parët piktorë shqiptarë që pikturojnë Skënderbeun, është piktori i shquar shkodran Kolë Idromeno i cili realizon në fundin e shekullit XIX, tre portrete të ndryshëm me imazhin e heroit, kryesisht duke u mbështetur në modelin e gravurave evropiane. Idromeno në vitin 1887, në moshën 27 vjeçare, realizon pikturën "Portreti i Skënderbeut". Sipas studiuesit Ylli Drishti, vepra ka vlerë historike, sepse është një ndër veprat e pakta që i kushtohen kësaj figure të rëndësishme historike në fundin e shekullit të XIX. Në tipologjinë e zgjedhur nga piktori Idromeno, vërejmë se ai mbështetet në gravurat

e botuara në veprën e humanistit të madh të epokës, Marin Barleti, që sigurisht përpunohet dhe plotësohet me koloritin e tij të veçantë.(E, 1, 5)

Simon Rrota(1887-961),

komponon në vitet 1916-1917 tabllon origjinale “Skënderbeu në betejë”. (GA, Shkodër). 1917. Kjo pikturë është përdorur në filateli e stampuar në një nga pullat postare.(E,1,2)

Ndoc Martini (1880-1916),

piktor i shquar shkodran portretin e heroit e punoi në disa variante. Si kryevepër e punimeve të tij konsiderohet një portret i madh i Skënderbeut, i cili tërhoqi vëmendjen e shtypit por që u dogj në Panairin Ndërkombëtar të Stambollit (1913).(E, 1,2)

Andrea Kushi(1884 -1959)

realizoi portretin në profil të Skënderbeut me përkrenaren mbi krye e me veshje mbretërore në vitin 1927 (E.2)

Smajl Lulani(1933-2002), më 1968 realizon tabllon “Skënderbeu në betejë”.

Zef Kolombi (1907-1949) më 1927 apo 1937realizon pikturën “Skënderbeu në luftë me persët”.

Jakup Keraj(1933-1987)pikturon një tablo për Skënderbeun e cila emëtohet edhe në pullat postare.

Stefë Curani (1865-1941)

do të bënte një gjest patriotik në ruajtjen e pikturës “Skënderbeu” që mendohet se është vepër e piktorit Gentile Bellini, (dhuruar nga familja e bashkëshortes së tij austriake), duke mos pranuar ta shiste atë në një ekspozitë të hapur në Londër (1929) karshi ofertave të mëdha dhe duke mbajtur atë si pronë të familjes.(E.6, 7)



Kopje e portretit të realizuar nga Gentile Bellini, pronë e familjes Curani

Figura e Skënderbeut në pikturën evropiane

Është shumë interesante një tablo me diçiturën “*Lule për Skënderbeun*” e piktorit anglez Richard Caton Woodville (1856-1927) i cili ka bërë shumë piktura me temë shqiptare dhe shkodrane, ku përshkruhen vajza dhe grashkodrane që hedhin lule nga kështjella e Rozafës, në kujtim të heroit tonë.



*Richard Caton Woodville
“Lule për Skënderbeun”, të hedhura nga Kalaja
Rozafat nga vashat shkodrane*

Një kolazh që bashkon Skënderbeun me Vidin, është ideuar dhe zbatuar nga shoqëria atdhetaro-kulturore “Një tufë djelmni shkodrane”, kryetar i të cilës ishte fotografi shumë i njohur Kel Marubi (1870-

1940) i lindur në Shkodër. Këtu portreti i Skënderbeut është fotografuar nga një medalion i bërë në bazë të pikturës së përdorur edhe nga Vani Burda, fotografi njohur korçar nga Kolonia shqiptare e Bukureshti. Dy figurat i lidhin krahët e tejhapur të shqiptonjës me dy krerë e me yllin gjashtëcepësh sipër dhe fjalët “Besë e Bashkim”.(E.6,7)

Një kartolinë me portretin e Skënderbeut ka realizuar Kel Marubi, i cili fotografon një pikturë të heroit tonë ku bie në sy shpata e mbajtur me dorën e djathtë e me shikim në të kundërt të armës. Piktori e ka vizatuar atë pa përkrenaren, me një si diademë lulesh mbi kokë, por me shpatën në dorë. Kartolina është e kolanës “Kujtim nga Shqipëria” dhe shoqërohet me vargjet e njohura të Mihal Gramenos. (E.6, 7)

Atelieja “Marubi” në Shkodër hodhi në treg në fillim të shekullit XX një kartolinë, ku është fotografuar piktura e Skënderbeut nga piktori i njohur Theohar Gjini (1880–1956) duke kalëruar me shpatë në dorë. Në këtë fotografi, Marubi (Keli), na paraqet Skënderbeun luftëtar, në një çast beteje “duke ndjekur armikun” me armatimin e tij karakteristik. Merita e fotografit këtu qëndron në atë se ai krijon një kartolinë shumë atdhetare. Karakterin e theksuar patriotik kartolinës ia shton diçitura e fotos: “Rrnoftë Shqipëria” e më pas vargjet: “*Armiku ç’e hangri/e në kambë s’e la/ Deri në buzë të varrit/ Skander Beu s’ju nda*”.(E.6,7)

Pesë emisionet e para të filatelistë shqiptare të shtypur nga qeveria e Përkohshme e Vlorës, përveç emisionit të dytë kanë simbolet e shtetit shqiptar, Shqipen dykrenare. Hapin e parë të sigurtë Qeveria e Vlorës e bëri me serinë klasike të Skënderbeut. Figura e Skënderbeut është në profil dhe e futur brenda kontureve të një medalioni të rrethuar me dafina ku shkruhet “Skanderberg – Mbreti i Shqipëtarëve”. Shkodra e dha kontributin e saj në këtë shtypje sepse medalioni u dhurua nga familja e vjetër shkodrane Xhuxha (Gjinaj) me tradita patriotike dhe kulturore në fushën e filatelistë. Pullat me portretin e Skënderbeut u përdorën edhe për dy emisione lokale në Shkodër, që lidhen ngushtësisht me emrin e drejtorit të postës së këtij qyteti në atë kohë, Sadik Tiranën. Këto emisione (njëri përkujtimor dhe tjetri taksë) u emetuan më 19 mars 1915, me rastin e përvjetorit të parë të ditës së ngritjes së Flamurit në kështjellën e Shkodrës. Po në Shkodër, por tanimë katër vjet më vonë, në vitin 1919, u vu në qarkullim një tjetër emision me portretin e

Skënderbeut. Ai përbëhej vetëm nga një pullë dhe pikërisht nga vlera “1 GROSH” e mbishtypur me fjalët “SHKODËR 1919”. Pulla të emisionit të 1 dhjetorit 1913 apo të ndonjë tjetri nga emisionet e mësipërme, sidomos ato të 19 marsit 1915 u fiksuan edhe në disa karta postare, të cilat mund të ishin të thjeshta apo me përgjigje. Madje ka prej tyre që janë bërë shumë të rralla, siç janë për shembull zarfat apo kartat postare me gjashtë pulla të Skënderbeut të vulosura në postën e Shkodrës me “vulë ari”.

Seritë e Skënderbeut me vulë ari

Janë një rast tepër i veçantë dhe i rrallë që administrata e postës me në krye Sadik Tiranën punoi me përkushtim. Më 1 prill 1920 emisioneve për Skënderbeun u shtohet një seri e re me gjashtë vlefte. Pullat e kësaj serie u shtypën në Paris dhe janë të një formati relativisht të vogël (shumë pak pulla shqiptare janë emetuar në këtë format). Ato paraqesin një portret të Skënderbeut në profil, të fokusuar mbi një shqyt mbi shqiponjën dykrenore. Aty shkruhej fjala: “Shkodër”. Karakteristikë e saj është se në vitin 1921-1922 u emetua me syrsazhin fjala: “Besa”, në një kuadër në qendër, ku fjala “Besa” ishte një thirrje bashkimi për gegë e toskë, muslimanë dhe të krishterë si dikur në Kuvendin e Lezhës. (E.3, 4, 5, 6.)

Skënderbeu në veprat e artizanëve

Janë të shumtë artizanët shkodranë që portretin e Skënderbeut e kanë përjetësuar në punimet me dru, në pëlhura, punime në lëkura bagëtish, në suvenire të veçanta ku janë prodhuar me qindra kopje të figurës së heroit tonë kombëtar, dallohen Zija Karini, Zef Gjini, etj.

Gjergj Marena, emigrant shkodran me qëndrim në Modena, Itali, me iniciativën e tij ka koleksionuar objekte të ngjashme me ato që mund t’i kishte përdorur Skënderbeu. Ndërkohë ai ka bërë përjetësimin e figures së heroit dhe bashkëpunëtorëve të tij në medalione të posaçme. Të gjitha këto objekte janë punuar me mjeshtëri të lartë artistike nga specialistë të shquar të fushës. Revista e koleksionistëve italianë *Lame d’Autore* (Anno 14, luglio 2012, n* 56, ff. 64-66) i ka kushtuar një artikull të posaçëm Gj. Marenës për këtë lloj pasioni nën titullin: *Rilindin thikat e gjigandit Skënderbe*, ku paraqiten tre nga koleksionet e tij “*Shpatë e shkurtuar dhe stema e Skenderbeut*”, “*Thikat e Skënderbeut*” dhe

“Donika Kastrioti në pjatë prej druri ulliri”.(E.8)



Monumenti i Skënderbeut në Michigan

Monumenti i Skënderbeut i ndërtuar në mjediset e jashtme të Kishës së Shën Palit në Rochester Hills të Michiganit të Amerikës, është një kontribut i shqiptarëve që banojnë atje, por edhe veçanërisht i anëtarëve të komisionit të ngritur për këtë qëllim, që i përkasin kryesisht komunitetit shqiptar të hapësirës shkodrane, që nuk e shkëputën angazhimin e tyre për asnjë moment, deri në përfundimin e kësaj vepre, si: Gjergj Ivezaj, Pashko Gjokaj, Zef Përgega, Pjetër Berishaj, Altin Zaloshnja, Zef Berishaj, Zef Gjonaj, menaxheri i Qendrës Fran Ivezaj, Besnik Bezhi, Kanto Dushaj, Franz Llesh Grishaj, Julian Çefa, Martin Ulaj, Edvin Hoti, Malot Ivezaj, Lulash Palushaj, Ledio Veseli etj. Këta dhe të tjerë, ndihmuan pa u kursyer, duke punuar edhe vetë si dhe familjet e tyre. Monumenti u inaugurua me 24 shtator 2006, me pjesëmarrjen e Presidentit të Shqipërisë, Alfred Moisiu.(E.9)

BIBLIOGRAFIA

A. 1. Historia e Shqipërisë, Tiranë, 2002; 2. Marin Barleci “Rrethimi i Shkodrës”, 1982, Tiranë; 3. Filip Tusha, Pajtim Ribaj, “Beteja e Drinit”, “Beteja e Kirit”, FESH, Tiranë, 2008); 4. **Tonin Çobani** “Princi i përfolur Lekë Dukagjini”, <http://lezha.net>.5.Loro Gjeçi “Lidhjet historike të Lezhës me Shkodrën” Seminari i II Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër 1995; 6. Loro Gjeçi “Lidhjet historike të Lezhës me Shkodrën “ në shekujt XVI-XX”, Seminari i III Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 1998; 7. Loro Gjeçi “Lidhjet historike të Lezhës me Shkodrën “ në shekujt XVI-XX”, Seminari i IV Ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër, 2000; 8. Kujtim Dashi “Leksikoni i Lezhës” Tiranë, 2005.

B.1.Dr. Musa Ahmeti Dr. Etleva Lala, MILOSAO, 24.12.2009; 2.Dhimitër Shuteriqi, “*Ëngjëlli Pal Pjetër*“(shek.XV-XVI)-zë në FESH , vëll. I, Tiranë, 2008; 3. Luçia Nadin “*Shqiptarët në Venedik (Mërgim e integrim 1479-1552)*, 2008; 4. Mahir Domi “*Formula e pagëzimit*”; Tiranë 2008; 5. Injac Zamputi “*Studime historike*”, Nr. 2 1979; 6.Petrika Thëngjilli, “*Engjëllorët*”, FESH, Tiranë 2008; 7. Musa Ahmeti : Stema shqiptare e familjes fisnike të Engjëllorëve’, Agjensioni Flori Press, 29.7.2013; 8.Mikel Prendushi, “*Arqipeshkvi Pal Ëngjëlli (1417-1470), humanisti i shquar shqiptar dhe bashkëpunëtor i afërt i Skënderbeut*”, phonix-13-14; 9.Musa Ahmeti dhe Etleva Lala : *Statutet e Drishtit: Botohet i plotë dorëshkrimi i rrallë i 1468*”, ballkanweb, 26.042009; 10..Lek Pervizi: “Frangu s’tregon përralla për Skenderbeun-Kosova tek albemigrant; 12.09.2013; 11.Zenepe Dibra “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vëllimi I, Lezhë 2016; 12. Aleks Buda “Barleci Marin (Marinus Barletius rreth 1460-1512/1513), FESH, Tiranë, 2008, 13. Kasem Biçoku, Jup Kastrati “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”-Bibliografi 1454-1835, Tiranë, 1997; 14. Kasem Biçoku “*Portreti i Marin Barletit dhe shqiptimi i mbiemrit të tij*” Seminarii III Nderkombëtar “Shkodra në shekuj”, Shkodër, nëntor 1998; 15..Luçia Nadin “Shqiptarët në Venedik –Mërgim dhe integrim 1479-1552”, Tiranë, 2008; 16. Marin Barleti “*Rrethimi i Shkodrës*”;Tiranë, 1962; 17. Mikel Prendushi”Beçikemi Marin (1468-1526), FESH, Tiranë, 2008; 18. Gjovalin Shkurtaç dhe Enver Hysa “*Gjuha shqipe-Për të huajt dhe shqiptarët jashtë atdheut*”, Tiranë 2001;19. Lek Pervizi: “*Frangu s’tregon përralla për Skënderbeun-Kosova tek albemigrant; 12.09.2013; 20. Zenepe Dibra “Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane”, vëllimi I,II, Lezhë 2016, 2017; 21. Gjekë Gjonlekaj “Një intervistë me historianin Athanas Gegaj për Skënderbeun”, Zëri i Amerikës, 18 janar 1968; 22. Vinçenc Malaj, “*Të dhana albanologjike 2*”, Ulqin - Tuz, 1999; 23. Gjovalin Çuni, Radio Vatikani, 4.02.2018); 24. Vili Kamsi “*Promovimi i librave të At Vinçenc Malajt,*” 30 tetuer 1999, në Seminarin Ndërdioqezan Shqiptar.25. “*Shejza*” (Le Pleiadi) të Ernest Koliqit(1968, nr.1-2-3); 26. Gjon Stefa “*Oazi i artë i Gjuhadorit*”, 2011, Shkodër; 27. *Çështje të folklorit shqiptar, Tiranë, 1982,**

f.260-276; 28.Vladimir Misja “Figura e Skënderbeut në librin e Stefë Curanit , albanovaonline”, 16.02.2012;

C. 1. Zenepe Dibra “*Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane*”, vëllimi I,II, Lezhë 2016, 2017; 2.Andrea Skanjetit “*100 vjet teatër në Shkodër 1879-1979*(Kujtime), Tiranë, 2002; 3.Ndre Mjeda “*Vepra letrare*”Tiranë, 2002; 4. Fran Shkreli : *Post scriptum i “Samitit” të Diasporës 23 Nëntor*; Bota sot, 2016; 5. Musa Ahmeti “*500-vjetori i vdekjes së Skënderbeut. Ja letra e Papa Palit për shqiptarët*” *Shqiptarja.com (print) në 16 Gusht 2015*; 6.*Shejzat- le pleiadi XII-1968 -4-6*

D.1. *Analizë dhe mendime të muzikologut, Robert Prenushi, autor i monografisë së At Martin Gjokës*; 2.Zana Bihiku “*Tre breza të muzikantëve shkodranë*”, Revista “*Kuvendi*”, 1992; 3. Zenepe Dibra “*Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane*”, vëllimi I,II, Lezhë 2016, 2017

E. 1. Ylli Drishti:”*Zbulohet Skënderbeu i Kolë Idromenos*”), Gazeta shqiptare, 2002; 2. Ylli Drishti, Figura e Skënderbeut në artin pamor europian dhe atë shqiptar Kurator i ekspozitës, 22 korrik, 3. Thimi Nika *Skënderbeu në Filatelinë shqiptare*”-Kumtesë e mbajtur më 09.04.2005 në Zagreb të Kroacisë, në Simpoziumin për 600-vjetorin e Skënderbeut; 4.Angjelin Zojzi “*Pasqyrimi i Skënderbeut, Ahmet Zogut e Enver Hoxhës në filateli*”, Seminari i III Ndërkombëtar “*Shkodra në shekuj*”, 5.Gjush Daragjati “*Emri “Shkodra” dhe disa element shkodranë që zbukurojnë e vlerësojnë filatelinë shqiptare*”, Seminari IV Ndërkombëtar “*Shkodra në shekuj*”, Shkodër 2004; 6.Zenepe Dibra “*Fjalor enciklopedik i hapësirës shkodrane*”, vëllimi I,II, Lezhë 2016, 2017; 7. Qerim Vrioni “*Figura e Skënderbeut në fotografinë shqiptare*”, albanovaonline.com me 30.5.2007); 8. Ilia S. Karanxha: “*Rikrijimi i traditave kastriotiane nga shkodrani Marena*”, 23.11.2012; Shkodër 2000; 9. Pjetër JAKU (Revista “*Kuvendi*”) , 26 Shtator 2006.

▪ Shëndetësi ▪

Merzuk HOXHA

**VËSHTRIM MBI PËRHAPJEN E KOLERËS NË SHKODËR
GJATË SHEK. XIX, NË FILLIM TË SHEK. XX DHE SITUATA
EPIDEMIOLOGJIKE SOT**

Kolera është e njohur si një sëmundje tepër ngjitëse dhe vdekjeprurëse që i ka kushtuar shumë njerëzimit, me humbjen e miliona jetëve gjatë shekujve. Thuhet të jetë shfaqur për herë të parë në Indi, në shekullin VII. Studjuesit kanë përcaktuar tre stade të shfaqjes dhe të përhapjes së saj në botë.

- Stadi i parë, deri në vitin 1817 (në atë kohë shpërthimi i kolerës u vu re në Azi).

- Stadi i dytë, 1817-1926; në këtë periudhë kolera u përhap në vende të ndryshme të botës dhe u regjistruan 6 pandemi

I. 1817-1833, me përhapje në Azi, Afrikë, Europë.

II. 1826-1837, përhapet edhe në pellgun e detit Mesdhe.

III. 1846-1862, si e dyta.

IV. 1864-1875, si e dyta.

V. 1883-1896, Europë Afrikë Veriore, Amerikë, Azi.

VI. 1900-1926, Azi, Rusi, Gadishulli Ballkanik.

- Stadi i tretë, prej viti 1926.

Tek libri i Dr. Kërçikut “Zhvillimi i shëndetësisë në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XX” gjejmë një përshkrim mbi përhapjen e kolerës në Shkodër në shekullin XIX dhe XX. Të dhënat janë nxjerrë nga disa udhëtarë të huaj që kanë qenë edhe me funksione diplomatike,

ndonjëherë edhe mjekë dhe që i kanë trajtuar me kompetencë problemet shëndetsore. Kështu D. Urquart, përshkruan kolerën në Shkodër më 1831 gjatë rrethimit të Mustafa Pashës në kala. Mundet që kolera të jetë sjellë nga ushtria turke, që vinin nga vende të largëta, ku kishin marrë pjesë në luftime. J.Spencer, më 1853 jep të dhëna mbi epideminë e murtajes e të kolerës që u përhap në vitet 1845-1850.

Një burim shumë i rëndësishëm për historinë e shëndetsisë në Shkodër, janë regjistrat e Famullisë katolike të qytetit të Shkodrës ku gjinden të dhëna që pasqyrojnë jetën e gjithë qytetit, sidomos gjurmimin e fazave të ndryshme, më të mëdha e ka “*liber defunctorum*” (ai të vdekurve).

Epidemia që del në regjistra, më 1848 ka lidhje me shpërthimin e epidemisë në Ballkan. Ajo ka qenë e përhapur jo vetëm në qytet, por edhe në fshatra, si në Juban, etj.

Përhapja e kolerës koïncidon më vonë me luftën ruso-turke, ku morën pjesë edhe mjaft shqiptarë. Në vitin 1855, në librat kishtarë të fshatit Kukël, rezulton të ketë pasë kolerë (6 vdekje në muajin korrik). Në vitin 1867, regjistrohen 10 vdekje nga kolera në fshatin Shirokë.

Shfaqje epidemie të kolerës pati në vitin 1911, që i korrespondon ardhjes së ushtrisë turke të Shefqet Turgut Pashës, ku rregjistrohen shumë raste. Pleqtë e Shkodrës kujtojnë se të vdekurit nga kolera ose i krematonin ose i futnin në gropa të përbashkëta në Bardhej. Gjithashtu, përveç Shkodrës, në vitin 1911, ka pasë kolerë edhe në Obot, Shirokë.

Interes paraqet epidemia e kolerës në Shalë, që u shfaq në qershor të 1916-tës dhe vazhdoi deri në dhjetor, ku vdiqën 540 shaljanë: 108 vdekur në qershor, 343 në korrik, 41 në gusht, 11 në nëndor dhe 37 në dhjetor. Në Kir të Pultit, fillimi i kolerës u rregjistrua me 12 vdekje, kurse korriku pati 30 të tilla.

Në epideminë e vitit 1911, përshkruhen një sërë masash antiepidemike të marra për luftimin e sëmundjes, duke filluar që nga organizimi i punës; Valiu i Shkodrës urdhëroi pushtetin lokal, policinë e xhandarmërinë për zbatimin e përpiktë të masave antiepidemike dhe të udhëzimeve të mjekëve. Qyteti ishte ndarë në pesë zona, në krye të çdo zone u caktuan 2-3 mjekë civilë e ushtarakë. Në zonën e parë që përfshinte Perashin, Parrucën, etj. ishte i ngarkuar edhe Dr. Abdullah Mehmeti. Në zonën e katërt që përfshinte Tophanën, Dudasin, Ajasmën e Tepen ishte edhe Dr. Basri Qallimi, ndërsa në zonën e pestë, që përfshinte lagjet katolike, ishte edhe Dr. Gjon Saraçi. Të sëmurët kontrolloheshin rregullisht dhe

të vdekurit nuk lejoheshin që të varroseshin pa u parë nga mjeku i zonës. Rastet e shumta që njoftoheshin nga imamët, kryepleqtë e lagjeve apo nga vetë populli, vizitoheshin nga mjekët dhe, në qoftëse ata nuk ishin të sigurt për diagnozën e sëmundjes, atëherë bënin konsultime me mjekë të zonave të tjera. Të sëmurët dhe njerëzit e familjes izoloheheshin në shtëpitë e tyre. Teshat e të sëmurëve dezinfektoheshin nga ushtria me anën e pajisjeve dezinfektuese lëvizëse.

Ndër masat e tjera që u morën në vitin 1916, gjatë okupacionit austrohungarez, ishte edhe vaksinimi i popullatës së qytetit të Shkodrës. Mbas një periudhe të gjatë e qetë, në fillimin e viteve '70, rreziku i kolerës u paraqit përsëri në vedin tonë. Në ato vite masat për parandalimin e kolerës u përqëndruan në izolimin e plotë të vendit, me një rregjim të rreptë të kalimit të kufirit për udhëtarët që vinin nga shtete të infektuara nga kolera, duke bërë krahas observimit, edhe izolimin e tyre pesë ditore në spitalin karantinor të Hanit të Hotit. Gjithashtu u morën masa për vaksinimin e popullatës, me vaksinimin e popullatës, me vaksinën kundër kolerës, në fillim në kontigjente më të ekspozuara dhe më vonë duke u shtrirë në të gjithë popullatën.

Të dhënat epidemiologjike e klinike të këtyre viteve të fundit kanë përcaktuar se kolera tashmë është sëmundje beninjë, në mbi 90% të rasteve, madje nganjëherë ajo nuk dallohet nga çrregullimet e tjera diarreike. Nga ana tjetër mbartësit asimptomatikë janë të zakonshëm (të shpeshta). Përparime terapeutike të bazuara mbi rehidratimin në rrugë orale bëjnë të zbrësë përqindja e vdekshmërisë së kolerës në rreth 1 %.

Tashmë është e qartë se asgjë nuk mund të pengojë importimin e infeksionit, ndërsa është plotësisht e mundur të ndërpritet përhapja e tij në brendësi të territorit të një vendi të një vendi të caktuar, duke marrë masa përkatëse parandaluese.

Në shtator të vitit të kaluar (1994), në dy rrethe, (në Kuçovë e në Librazhd), u shfaqën rastet e para me kolerë, infeksion i importuar nga shtetet fqinjë. Ajo u përhap edhe në disa rrethe të tjera në afërsi të dy të parave, ndërsa Shkodra mbeti e pa prekur.

Mendoj se dy ishin shkaqet që penguan shfaqjen e kolerës në rrethin e Shkodrës:

1) Largësia dhe mungesa e lidhjeve jetësore me rrethet e Kuçovës e të Librazhdit.

2) Marrja e masave të forta për mbajtjen në klorinim të vazhdueshëm dhe me doza të rritura, të ujësjellësve në qytet e në fshat.

Me nocionet e reja epidemiologjike, vaksinimi, kemioprofilaksia masive dhe vendosja e kordonit sanitar, janë të pafuqishme për parandalimin dhe dominimin e shpërthimeve epidemike. Praktikisht, në situatën e vjetshme epidemiologjike për kolerën, nuk u aplikua asnjë nga këto. Vëmendja u përqëndrua tek sigurimi i ujit të pijshëm të klorinuar dhe rritja e kujdesit për higjenën personale të mjediseve.

Lidhur me vaksinimin, ka patur mjaft diskutime dhe përfundimisht është konkluduar se si në rastin e kolerës nuk është i këshillueshëm, bile mund të sjellë dëme në aspektin se largon vëmendjen e organeve shëndetësore e të popullatës nga marrja e masave të karakterit higjenik, që janë parësore në parandalimin e kësaj sëmundjeje.

▪ Recensione ▪Seit **MANSAKU****“SKICË HISTORIKE MBI MALIN E ZI SIPAS TRADITAVE
GOJORE SHQIPTARE” ME AUTOR PASHKO VASA**

Pashko Vasa (1825-1892), siç dihet, është një nga ideologët dhe veprimtarët e shquar të Rilindjes Kombëtare. Ai zhvilloi një veprimtari të shumanshme si atdhetar, poet e shkrimtar, historian e gjuhëtar, publicist, personalitet politik me kulturë të gjerë e me dhunti drejtuese. Punoi me përkushtim të rrallë për mëkëmbjen politike e kulturore të Shqipërisë, për formimin dhe forcimin e ndërgjegjjes kombëtare të shqiptarëve. Mësimet e para i mori në vendlindje, në Shkodër, dhe më pas punoi si sektretar në konsullatën britanike. Në vitin 1847 shkoi në Itali dhe mori pjesë në luftën për çlirimin e saj. Më vonë vajti në Stamboll dhe u përfshi në administratën osmane në të cilën ushtroi disa funksione të rëndësishme; arriti të bëhet guvernator i Libanit (1883-1892) ku edhe vdiq.

Bashkë me atdhetarë të tjerë të Rilindjes u përpoq për krijimin e një shoqërie për hapjen e shkrimit të gjuhës shqipe dhe krijimin e një alfabeti të përshtatshëm për shkrimin e saj. Ai qe një nga veprimtarët më aktivë të Shoqërisë së të shkruarit shkronja shqip (1897) dhe një nga figurat kryesore të Komitetit të Stambollit në vitet 1878-1882.

Në të gjitha detyrat që kreu, ka dëshmuar se ishte personalitet i përkushtuar ndaj atdheut dhe popullit të tij, drejtues me aftësi të veçanta dhe me karakter. Për karakterin dhe qëndrimin e tij atdhetar e burrëror është domethënës një episode veçantë që bën fjalë për marrëdhëniet e

tij me Perandorinë Osmane: Kur e kishte thirrur një here Sulltan Abdyl Hamiti dhe e kishte ftuar të shkonte të qeveriste krahinën e Kosovës në një kohë kur kjo kishte ngritur kry kundër sundimit osman, ai ishte përgjigjur : Madhëri, jam një funksionar i Perandorisë dhe bëj çmos t'i shërbej me përkushtim të sinqertë, por jam shqiptar, dhe nëse Madhëria juaj më detyron të shkoj atje, më shtrëngon të bëhem tradhtar: ose do të tradhtoj Perandorinë, ose do të tradhtoj vendin tim". Sulltani nuk nguli këmbë dhe e respektoi për këtë. (Gaetano Petrota, Populli, gjuha dhe Letërsia shqiptare, botimet ALMERA, 2008, f.283, përkthyer nga Qemal Velija prej botimit italisht: Popola, lingua e letteratura Albanese, Palermo, 1932).

Pashko Vasa është autor i disa veprave letrare, gjuhësore e historiko-politike. Në fushën e letërsisë, në vitin 1873 botoi në italisht një përmbledhje me vjersha me titullin *Rose e spine* "Trendafilja e gjemba". Nga fusha e poezisë meriton një vlerësim të veçantë poezia e mirënjohur "O moj Shqypni"! (1880).

Kjo poezi është një nga krijimet poetike më të frymëzuara të letërsisë së Rilindjes. Ajo u bë shumë e njohur dhe popullore për idetë dhe mesazhet e rëndësishme e përgjithësuese me frymë kombëtare dhe për vlerat artistike të saj. Përmes një kontrasti midis të kaluarës historike të lavdishme të Shqipërisë dhe gjendjes së mjeruar të saj në kohën e tij, autori synon t'i prekë në sedër shqiptarët dhe u bën thirrje të bashkohen dhe t'i dalin zot vendit të tyre. Poezia është një sintezë poetike e ideve të mëdha të lëvizjes kombëtare për pavarësi.

Në prozë autori na ka lënë romanin *Bardha e Temalit*, një nga romanet e para në letërsinë shqiptare, botuar së pari në frëngjisht (Paris, 1890) në të cilin përshkruhet mjedisi shqiptar në Shkodër në vitet '40 të shekullit XIX me doket e zakonet karakteristike të tij.

Nga fusha e gjuhësisë ka botuar në gjuhën frënge një *Gramatikë shqipe* për t'u përdorur nga ata që dëshirojnë të mësojnë këtë gjuhë pa ndihmën e një mësuesi, Londër, 1887 dhe *Alfabeti latin i zbatuar në gjuhën shqipe*, Stamboll, 1865, një broshurë prej 16 faqesh.

Me përmbajtje historike e politike janë veprat e botuara në frëngjisht: *La vérité sur l'Albanie et les Albanais*, Paris, 1879, përkthyer në disa gjuhë. Në gjuhën shqipe është përkthyer dhe shoqëruar në fund të çdo kreu me shënime dhe komente të gjera historike nga Mehdi Frashëri dhe botuar në shtypshkronjën "Tirana" në vitin 1935 me titullin "E vërteta mbi Shqipnin dhe Shqiptarët". Në vitin 1872 Pashko Vasa kishte

botuar gjithashtu në gjuhën frënge veprën *Esquisse historique sur le Monte-negro d'après les traditions de l'Albanie*, Constatinople, 1872, e cila po botohet, me sa dimë ne për herë të parë në gjuhën shqipe me titullin “Skicë historike mbi Malin e Zi sipas traditave gojore shqiptare”. Studiuesit që janë marrë me jetën dhe veprën e tij përmendin edhe një punim të Pashko Vasës që trajton zhvillimet politike në Bosnjë e Hercegovinë dhe problemet e pronësisë së tokës atje.

Libri *Skicë historike mbi Malin e zi sipas traditave gojore shqiptare*, siç pohon vetë autori, mbështetet në traditat popullore gojore shqiptare, sepse, sipas tij, “Malazetët dhe fqinjët e tyre shqiptar nuk kanë mundur t’u përcjellin pasardhësve kujtimin e bëmave të tyre me ndonjë formë tjetër, përveçse nëpërmjet traditave gojore”.

Malazetët dhe Shqiptarët, mendon ai, nuk kanë marrë kurrë mundimin të regjistrojnë ndeshjet që kanë bërë midis tyre. Kohët qenë shumë të vështira për këta dy popuj luftëtarë e trima dhe nuk patën mundësi të shpëtonin nga harresa për një kohë të gjatë dramet politike në të cilat kanë qenë aktorë. Ata e shikonin lavdinë e tyre në grykat e pushkëve. Për këto arsye, autori nuk pretendon të bëjë në këtë libër një paraqitje të plotë e sistematike të historisë së Malit të Zi, por synon të japë një skicë të thjeshtë të historisë së këtij vendi fqinj, duke shtrëtzuar traditat gojore të shqiptarëve: tregimet popullore, legjendat, gojëdhënat, këngët popullore që kanë përcjellë ngjarjet historike gjatë shekujve.

Autori vlerëson se në Shqipëri dhe në Mal të Zi legjendat e ruajtura përmes këngëve popullore janë vështruar si dokumente historike, prandaj ideja për t’i përdorur ato në një punim serioz nuk i është dukur aspak e çuditshme. Ne do të shtonim se traditat gojore popullore të përzgjedhura dhe të përdorura nga një historian e dijetar me kulturë të gjerë si Pashko Vasa, njohës i mirë dhe i drejtpërdrejtë i gjeografisë dhe i historisë së atyre viseve për të cilat shkruan dhe i Perandorisë Osmane që sundon mbi to, marrin vërtet vlerën e dëshmimeve historike. Përveç këtyre, një pjesë e ngjarjeve që përshkruhen në këtë vepër kanë ndodhur në shekullin XIX kur autori jetonte. Libri i kushtohet historisë së Malit të Zi, por siç dihet, fatet historike të popullsisë malazeze, për kohën kur shkruan autori i këtij libri, kanë qënë të ndërthurura me fatet e popullsisë shqiptare fqinje me të, sidomos, me popullsinë e qytetit të Shkodrës e të rrethinave të saj dhe të viseve të tjera shqiptare që sot ndodhen brenda kufijve të Malit të Zi. Madje në shumicën e ngjarjeve historike që trajtohen në të, marrin pjesë Malazetët dhe Shqiptarët.

Prandaj besojmë se botimi i këtij libri është me interes për historinë e të dy vendeve gjatë sundimit të Perandorisë Osmane.

Ka mjaft gjëra të përbashkëta në historinë e këtyre dy popujve në aspektin e përpjekjeve të tyre për të ruajtur pavarësinë dhe për t'u qeverisur sipas traditave, kanuneve e zakoneve të tyre. Sipas autorit, popullsia katolike e maleve të Shqipërisë, sidomos mirditorët, megjithëse politikisht iu nënshtruan Perandorisë Osmane, ata mundën të ruanin kanunet e tyre, zakonet e tyre, armët e tyre dhe mundësinë për t'u administruar sipas mënyrës së tyre.

Megjithatë, siç ka vënë në dukje autori, se një pjesë e popullsisë së viseve shqiptare, të Malit të Zi e të Bosnjes, për të ruajtur pavarësinë e tyre u tërhoqën në male, ku ishin të detyruar të përballonin vështirësi të shumta për të mbijetuar.

Në këtë botim Pashko Vasa u jep mjaft vend revoltave dhe kryengritjeve të popullsisë malazeze për pavarësi kundër sundimit osman dhe kundër agallarëve vendës, që në sistemin e feudave që kishin vendosur sunduesit, shfrytëzonin egërsisht popullsinë e varfër. Për periudhën për të cilën flet autori, pushtetin shpirtëror dhe laik në Mal të Zi e ushtronte Kryepeshkopi, Vlladika, i cili gëzonte prestigj të lartë fetar në popullsinë e krishterë të Malit të Zi. Këtë prestigj ai u përpoq ta përdorte për të forcuar lidhjet e tij, duke konsoliduar kështu pushtetin e tij, të cilin do ta përdorte për të organizuar qëndresën kundër sundimit osman dhe për të forcuar e zgjeruar kufijtë e Principatës së Malit të Zi. Në këtë përpjekje ai do të shkaktonte konflikte të vazhdueshme me sunduesit osmanë dhe me fqinjët. Në këto rrethana, krahas kryengritjeve antiosmane u krijuan edhe lëvizje e çeta komitësh që kryenin here pas here akte dhune e grabitje edhe në tokat e shqiptarëve. Këto akte të tepruara dhune, beson Pashko Vasa, kanë shkaktuar atë urrejtje që ka ekzistuar midis Malazezëve dhe Shqiptarëve, urrejtje që ka ekzistuar midis Malazezëve dhe Shqiptarëve, urrejtje që ka vijuar edhe më vonë përmes hakmarrjeve e vrasjeve nga të dyja palët. Nëse Malazezët, mendon ai, nuk do të kishin ushtruar kohë pas kohe akte grabitjeje në territorin e Shkodrës, Shqiptarët nuk do të kishin marrë kurrë armët kundër tyre. Por gjërat shkuan ndryshe dhe u derdh shumë gjak.

Një pjesë e librit u kushtohet sundimtarëve të qytetit të Shkodrës dhe rrethinave të saj, Bushatlinjve dhe pashallarëve të tjerë, karakteristikat e këtyre pashallarëve dhe marrëdhëniet e tyre, nga një anë me Portën e Lartë, dhe nga ana tjetër me Malazezët. Le t'ia lëmë lexuesit t'i mësojë

vetë këto ngjarje duke i lexuar librin.

Varianti në gjuhën frënge i këtij libri të Pashko Vasës ishte bërë i rrallë. Një kopje të fotokopjuar të këtij botimi pati mirësinë t'ia dhuronte Fondacionit "ALSAR" historiani dhe albanologu gjerman, Dr. Michael Schmidt-Neke, të cilin gjejmë rastin ta falënderojmë. Drejtuesi i Fondacionit ALSAR Z. Mehdi Gurra na sugjeroi ta përkthenim dhe mori përsipër botimin e tij. E falënderojmë për gatishmërinë që tregoi si për këtë, ashtu edhe për shumë botime të tjera nga fusha e studimeve albanologjike që ka ndërmarrë e realizuar.

Nexhmi **BUSHATI**

**“TIRANOPEDIA” - POEMË THUAJSE E PANJOHUR E
POETIT DESIDENT LUIGJ TONI**

(mbresa dhe vlerësime)

Në poemën e Luigj Tonit, (alias Resurgens) titulluar në një mënyrë origjinale “Tiranopedia” (pësimet e mësimet e tiranisë) të tërheqin vëmendjen tri pika referimi: - data prill 1992, -dy aforizmat (“Vëllai për vëllain, ujk”, “Gabimi asht njerëzor, kambëngulja në të, djallëzore”), - pseudonimi “Resurgens”, me të cilin nënshkruan poeti.

Prilli i 1991-shit, një vit para shkrimit të poemës, s’ mund të harrohej: qe rezultat shumë tragjik i një ndeshjeje për jetë a vdekje midis së vjetrës dhe së resë, midis genocidit të kuq dhe heroizmit mbarëpopullor; qe dhe premisë e fortë për një rrokullisje përfundimtare, një përvijim i asaj qëndërrohej gjysmë shekulli, i shpresës së shumëpritur për liri e drejtësi. Prilli i 1992-shit, rrjedhojë e 22 Marsit, ringjalli shpirtërat, ringjalli dhe “Resurgens”-in poet.

I lënduar poeti, pohon se “pendën iu pat dashtë me e thye qysh të re”, por ama ai s’hezion ta rrokë edhe një herë, paçka se e dëmtuar, e, ndonëse “fytyrë veshkun” e “lodhun gjymtyrësh”, për t’u radhitur në rreshtat e atyre zemërdlirëve që s’ njohin tërheqje, por i vijnë në ndihmë “Zojës së randë Shqipni” në këtë kohë udhëkryqesh, për t’ua kujtuar bijve të saj moralin e fabulës “Kecat dhe ujk”.

Poema mban datën: prill 1992, por vitet sollën “prille” të tjerë (e s’dimë dhe sa?!) e poema tingëllon e freskët, e kohës, për të mos thënë si gazetarët, e azhornuar. Del pyetja: Çfarë qe përcaktuese në këtë

mes? Sensibiliteti i poetit apo vizioni i nacionalistit të regjur? Sigurisht rysnia dhe idetë e stoikut vetëmohues e koherent, “fisnik e bujar” që preferoi “heshtjen e madhe” por të artë, si dhe devocioni ndaj idealeve të kahershme, i mprehën vështrimin dhe ia amplifikuan intuitën për parashikim në atë vetëizolim të gjatë të tij. Është ky tingëllim aktual i veprës që do t’ia rrisë asaj vlerat ideore e morale, duke ia shtuar shanset autorit që të jetë sa më i pranishëm ndër mendjet dhe zemrat e lexuesve në këto rrjedha ndjellakëqia për kombin e demokracinë.

Më lart cituam dy aforizma klasike: janë pikërisht ato që, në mënyrë sintetizuese, shprehin përmbajtjen e poemës, idetë kryesore të së cilës përçohen përmes kësaj tematike: ndeshtrashat e kombit gjatë shekujve, kalvari komunist, shembja e tiranisë dhe rrugët për t’ia ndërprerë restaurimin.

Tema e parë, kuptohet, zë pak vend; ajo qëndron më shumë si nëntemë e së dytës, pasi jepet dhe në formë digresioni e retrospektive.

Tema e dytë, tema kryesore, dallohet jo nga sasia e strofave, por nga shkrimi i papërmbajtur i poetit, një ortek ndjenjash ku vlon urrejtja e revolta e ku s’kursehet as ironia me sarkazmën. Një numër i madh mjetesh shprehëse të artit poetik është shfrytëzuar për të stigmatizuar tiraninë e tiranin si dhe lukuninë që e mbështeti me dhunë e me “hosanna”, me veprime antishqiptare e antihumane. Shpërthimi emocional i poetit është fare i përligjur, përderisa “të kuqtë” ia patën shitur atdheun të huajit, ndërsa, brenda, vendosen diktaturën.

Le të citojmë vargjet:

*“Tradhëti kombëtare, dhunë mbrenda shqiptare
Mbrenda apartheid, n’familje barrikada
Theror, terror, terrinë ma mesjetare
Inkuizicion e Linc e Torquemada-*

Ai do të lëshojë kujën:

“Heu, sa ra poshtë e nalta Shqiptari!”, sepse virtytet e bukura u përdhosën, sepse *“fisi shqiptar n’equin u kthye: në kuaj pune, skllevë e bujk-robë”*. Krahas burgjeve e kampeve, krahas holokaustit ndaj intelektualëve e klerit, u realizua edukimi i *“njeriut të ri: majmun, papagal, panegjirik, prejargë mbi pleh hoxhjet”*.

Dhe ja sendërgjuesit e kësaj tragjedie, ata s’janë anonimë:

*“Ligjërues t’paligj, byroistë, qendroristë,
polsekretarë, shtetarë, satrapë, cinikë,
urdhënues, terroristë, zbatues sadistë,
aparatchikë, kuadrovikë fanatikë,
spiunëreptilë, sigurimsa katilë,
hetues xhahilë, gjykatës xhebrailë”*

Më shumë se askush, në tehun e mllefrit dhe të shpotisë do të vihet kryearkitekti i piramidës, *“Tirani i Tiranës: nopran, katran, me rranjë si kthetra, me qelb si ciban-vasal kuisling i Miladin-Dushanit, Titos, Stalinit e Mao-Khanit”*, por, për ta denigruar si duhet, autori do të thërrasë në ndihmë edhe denominacione të tjera shkërbyese: *“Stalinth, Antikrisht, Zeus, Përbindsh, Molok, Luciferr, Satana, Saturn”*. Këtij miriapodi iu vunë në shërbim: “kuajKaligule, kuajTroje, lakejtë, epigonët, reformistët” që, krahas tentakuleve të tjera, e gjakosën popullin.

Pas këtyre tiradave demaskuese, vjen shqetësimi i poetit mbi qëndrimin e e shoqërisë shqiptare ndaj fajtorëve *“nyje gordiane”* e pazgjidhur e atëhershme dhe e sotme. Për autorin s’ka ekuivoke: ata që kanë përgjegjësi morale, le t’i vrasë ndërgjegjja, të deklarojnë *“mea culpa”*-n, të bëjnë katarsis-in dhe do të jenë të falur, ndonëse qenë *“qole të përbuzhme për aspra, sqimë, karrierë”* që *“t’Vërtetën vranë, vetëdija pa i vramë!”* Sa humanizëm buron nga shpirtgjerësia e poetit dhe e gjithë bashkëvuajtësve të tij që, ndonëse ua borën rininë, ua vranë ëndrrat, aspiratat, shpresat, nuk lypin hakmarrje! Ata të tjerët, vrasësit, kriminelët, ata s’duhet t’i shpëtojnë ligjit: Drejtësia duhet t’i thotë ndal *“Harresës”!*

Nama që lëshon ai, tingëllon si ulurimë dhe poetit i sillet ndërmend ai zemërimi i Fishtës, kur s’e pat kursyer as Perëndinë që *“gjuen me rrfe n’për pyje, lisat kot”*. Edhe pse fillimisht kërkon *“Kanosa e Nurenberg”*, ai mbetet human, sepse nuk predikon *“gjueti shtrigash”*.

Metastazat e komunizmit përpunojnë strategji të reja, taktika hileqare e me stratagemën e *“rinovimit”* të partive të shumta, duke manovruar me ngjyrat e ylberit, mundohen të krijojnë iluzione sa optike aq psikologjike, prandaj poeti mban qëndrim të prerë ndaj kësaj demagogjie mashtruese. Pezmi i tij është kaq intens, saqë për herë të parë, ai shprehet në numër njëjës: *“Barkun e drujtë s’e due midis partive!”*

Gjithashtu në emër dhe të brezit të vet, ai do të vendosë një vijë të

qartë demarkacioni midis dy gjymtyrëve të togfjalëshit: “bashkëvuajtës e bashkëfajtorë”, duke hedhur poshtë dhe falsitetin e parullës tinzare: ”Pajtimi kombëtar”.

Jo më kot, poeti preferoi pseudonimin “Resurgens”, ai nuk do vetëm të konstatojë, don dhe ringjalljen kudo, në të mirë të kombit e të shoqërisë, prandaj nuk rrëshqet në fatalizem, nuk ndryhet në vetvete, parashtron edhe rrugë zgjidhjeje, i beson dhe perspektivës, por me njëkusht: e udhëhequr nga parimet e mëdha të humanizmit (*Liri-Barazi-Vëllazërim*), e ardhmja duhet të mbështesë platformën e vet në katër kriteret e mëdha të jetës: “*mësuesja Histori, busulla Vërtetësi, ngrohtësia Dashuri, përmendorja Kujtesë.*”

Çdo shqiptar i vërtetë i bashkon urimet e veta me dëshirat e zjarra të autorit që këtij kombi t’i hapen shtigjet e progresit të plotë, që demokracia të mos mbetet një mirazh mashtrues, që termi “tirani” të arshivohet në skeda muzeumesh.

* * *

Poema është thellësisht politike, me një pathos të vërtetë atdhetar dhe tingëllon si një formë kushtrimi. Po ta vështronim vetëm nga këndi i përmbajtjes dhe i qëndrimit të poetit, s’do të ishte e tepërt ta quanim një pamflet “sui generis”. Poema nuk shquhet vetëm për ngjeshje idesh me theks të fortë demaskues e sinjalizues, për intensitet të fortë emocional, por ka dhe vlera të veçanta artistike dhe gjuhësore.

Poezia konceptohet nga autori sipas standarteve klasike, ndikim i kulturës së vetë atij. Këtë e dëshmon edhe ndërtimi i poemës, i strofave, i vargut si dhe elementet e shumta të huazuara nga mitologjia. Ajo është plot erudicion; në këtë drejtim duhet interpretuar dhe preferenca për ndërtimet e zhdrejta, për stilin e ngarkuar, për sistemin e figurave letrare dhe mjeteve të tjera shprehëse.

Ashtu si gjithë brezi i tij, autori, që në rini, është edukuar me vargjet e Fishtës e të Mjedës, prandaj dhe në këtë krijimtari s’mund t’i shmanget këtij tundimi poetik. Ai të kujton Fishtën, Mjedën, e pse jo, dhe Nolin, kur zgjedh 11-rrokshinmadhështor, kumbues e të pasur. Ndikimin e Fishtës e të Nolit e ndeshim jo vetëm kur huazon vargjet e tyre si ilustrim ideje, por dhe kur me vargje satirizuese kalon në sarkazëm. Poema është strofike, përmban 64 strofa; strofat janë 6-she, me skemën ABABCC, që të kujtojnë vargëzimin fishtjan. Flasin në këtë drejtim edhe veçori të

tjera të poezisë: përdorimi i enumeracionit, i aliteracionit, i shkallëzimit, i pyetjeve retorike dhe i apostrofave etj. si dhe i barbarizmave të shumta, veçanërisht i turqizmave që mbartin një ngarkesë të madhe ideo-emocionale (*xhahilë, xhebrailë, katilë, qole, bedel, tellall, asqerë, syrgjyn, jeniçer, kurban, hukubet, zullum, hat'ranë, bihe*). Krahas tyre ka të një natyre tjetër (*equin, neofitë, prozelitë, idoloklastë, mizoneistë, kostricion, karizmatikë etj.*). Në drejtim të pasurimit të gjuhës, poeti ka meritën të ketë krijuar një numër të madh neologjizmesh të guximshme (*hoxhjet, qendroristë, rinovizëm, orbitnue, pushtimtarë, byroistë, kuadrovikë etj.*)

Interes paraqesin kompozitat: *gjujdobët, kalTroje, kuajKaligulë, brrylfortë, mendimlire, shpirtmendorë, vetshtypje, vetrobnim, puthkamb'edorë, politbyroist, Satantundues, feudhumbës etj.* si dhe binomet: shpresa-andrra, dhëpër-lepur, haraç-pagesë, Miladin-Dushan, perëndim-lindje etj. Ndër dukuritë gjuhësore vlen të shënohet dhe përdorimi i gjërë i pjesores në rolin e mbiemrit, e ndeshur te poetët gegë (p.sh. kryqëzue, durue, urtësue, falë, vjelë, ngjeshë etj.) si dhe dyzimi i paskajores (me u dukë, me ardhë, me u bashkue – për të shfarosë, për të përdorë, për të dështue etj.)

I ndjeri poet tashmë nuk jeton më. U largua nga kjo jetë vite e vite më parë, por ndonëse me vonesë, *Resurgens-i* bën pjesë në sofrën e poezisë sonë të shëndoshë, sepse me verbin e tij të çiltërt e jopanegjirist, ai përcolli mesazhe të forta qytetare e humane, aq të domosdoshme në kohët që jetojmë.

Urojmë me përzemërsi që “kënga e tij të mos mbetet këngë mjellmeje, por të kthehet në këngë jetëgjatë laureshe”!

▪ In memoriam ▪

Erzen KOPERAJ

**VEPRA GJUHËSORE E PROF. DAVID LUKËS ARRITJE
DINJITOE NË FUSHËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
DHE GJUHËSISË HISTORIKE**

Korpusi i veprës së tij, i shtrirë në një periudhë 48 vjeçare (1972-2018) përfshin një punë voluminoze me mbi 5000 faqe, në fushën e gjuhësisë historike dhe në politikat gjuhësore, ku mund të përmenden njëzet vëllimet e veprës madhore “Studime gjuhësore”, 130 artikuj në revista të ndryshme shkencore, brenda dhe jashtë vendit, tekstet universitare “Fonetika historike e gjuhës shqipe”, “Historia e albanologjisë” si dhe “Studime për historinë e gjuhës shqipe”.

Skrupuloz për tu marrë shembull, dije ekslente në fushën e gjuhësisë, besnik i së vërtetës deri në ashpërsi, njeriu plot humor që nuk dorëzohej edhe në çastet më të vështira: ky ka qenë profesor David Luka për të gjithë ne që e kemi njohur si mësues¹ dhe studiues. Në këtë shkrim do të mundohemi që në vija të përgjithshme të japim disa prej kontributeve që prof. D. Luka ka sjellë me veprën e tij në fushën e gjuhësisë.

Studimet në fushën e gjuhësisë historike dhe në politikat gjuhësore

Studimet në fushën e gjuhësisë diakronike mbi gjuhën shqipe, që nga mesi i shekullit XX e deri në ditët e sotme, kanë njohur një zhvillim të dukshëm, ku pas Çabejt, bien në sy emra të tillë si Shaban Demiraj, Besim Bokshi, Idriz Ajeti, Koleç Topalli etj., por padyshim një vend

¹ Për kontributin e tij në fushën e arsimit do t'i akordohej titulli “Mësues i popullit”.

të veçantë në këtë varg autorësh të shquar zë edhe studiuesi i njohur shkodran, prof. dr. David Luka. Korpusi i veprës së tij, i shtrirë në një periudhë 48 vjeçare (1972-2018) përfshin një punë mbi 5000 faqe, ku mund të përmenden njëzet vëllimet “Studime gjuhësore”, 130 artikuj në revista të ndryshme shkencore, brenda dhe jashtë vendit, autor tekstesh universitare “Fonetika historike e gjuhës shqipe”, “Historia e albanologjisë”, si dhe “Studime për historinë e gjuhës shqipe” (botuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike. Tiranë, 2010). Studimet e D. Lukës mund t’i ndajmë në dy drejtime, së pari në fushën e gjuhësisë historike dhe së dyti, në politikën gjuhësore. Vetë studimet e tij në gjuhësinë historike mund t’i ndajmë sipas këtyre disiplinave: etimologji, fonetikë e gramatikë historike, histori e gjuhës shqipe dhe leksikografi historike. Etimologjia ka qenë një prej fushave të preferuara të tij. Katër vëllimet e tij të para “Studime gjuhësore”², që përfshijnë rreth 2000 faqe, paraqesin jo vetëm analiza gjuhësore në kërkim të burimit të fjalës, por mbi të gjitha një metodologji të re, duke shtuar kështu jo vetëm kontributin në rritjen e numrit të fjalëve të analizuar (saktësisht janë marrë në shqyrtim 3656 fjalë), por duke dhënë një metodë shkencore të kohës. Për prof. D.Lukën, etimologjia nuk është një disiplinë që rreket përmes disa rregullave fonetike të gjurmëve burimin më të hershëm të fjalës, ai në analizat e tij etimologjike merret jo vetëm me historinë e fjalës³, por dialektikën e zhvillimit të saj, rrethanat në të cilat ajo është formuar, kushtet që kanë përcaktuar ndërrimet e mundshme të pësuar në rrjedhën e kohës, si nga ana tingullore po ashtu edhe nga kuptimi, lidhjet që ajo ka me objektin apo konceptin a dukurinë të cilat etiketon. Përveç kësaj, nga ana tjetër, studiuesi Luka e ka analizuar edhe në marrëdhëniet brenda gjuhës, “*e vështruar fillimisht si pjesëtare e shtëpisë së vet*”⁴, duke nxjerrë në pah shtegun më të sigurtë që të shpie te burimi i fjalës. Kjo është edhe një prej tipareve më të dukshme në studimet e tij, këndvështrimi i dukurive gjuhësore në sistem, duke mos i analizuar fjalët apo zhvillimet që ato kanë pësuar në mënyrë të izoluar e fragmentare, sepse sipas prof. D.Lukës, “*..fjala nuk jeton e vetmuar, ajo*

² Përkatesisht “Studime gjuhësore I (kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe A-D), Shkodër, 1999; “Studime gjuhësore II (kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe DH-K), Shkodër, 2002; “Studime gjuhësore III (kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe L-P), Shkodër, 2003; “Studime gjuhësore IV (kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe Q-ZH), Shkodër, 2003.

³ E.Çabej, Studime etimologjike në fushë të shqipes, Vëll.I, f.53.

⁴ D.Luka, Studime gjuhësore, Vëll.XV, Shkoder, 2013, f.71.

u nënshtrohet jo vetëm rregullave morfologjike të gjuhës në njërën anë, por edhe vetë zhvillimit të saj, mentalitetit të atyre që e përdorin etj. Këtë proces e pasqyrojnë më së miri fjalët e huazuara, të cilat shqipja i ka me shumicë. Ato zakonisht e ruajnë kombësinë nga kanë ardhur, por në të njëjtën kohë marrin edhe nënshtetësinë shqiptare.”⁵, sepse sipas tij “natyrisht fjala nuk është një kategori shoqërore a filozofike që u nënshtrohet tërësisht e në mënyrë klasike ligjeve të dialektikës....Fjala krijohet në rrethana të caktuara, për shkaqe e prej shkaqeve të caktuara, por edhe shuhet në rrethana të caktuara, për shkaqe të caktuara, ajo humbet dhe nuk përdoret më, vendin e saj e zë një tjetër që në thelb mohon paraardhësen e saj”⁶. Prandaj, fjala duhet studiuar në historinë e saj, në zhvillimin e vet të pandalshëm në kohë e hapësirë. Detyra e etimologut është të përcaktojë tiparet e qenësishme të këtij zhvillimi.

Mbi etimologjinë e toponimit Shkodër

Një prej punimeve më interesante që kam veçuar në këtë shkrim është ai mbi etimologjinë e toponimit Shkodër, të cilin prof. D. Luka e paraqiti për herë të parë në punimet e Seminarit IV “Shkodra në shekuj”, më 1994. Duke qenë se emri i këtij qyteti vjen që nga antikiteti i hershëm, çështja e burimit të tij dhe nëse ky emër është zhvilluar sipas rregullave fonetike të shqipes, zë një vend të dorës së parë në historinë e gjuhës shqipe⁷ por edhe në argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve, nëse janë vendas apo të ardhur⁸. Pasi analizon zhvillimet e grupeve bashkëtingëllore /sk/ dhe /dr/ që përbëjnë në vazhdimësi toponimin Shkodër, prof. D.Luka arrin në përfundimin se emri i lashtë Shkodër ka kaluar në mënyrë të pandërprerë përmes gojës së shqipfolësve, ndërkohë që më i veçantë mbetet shpjegimi i burimit të këtij emri, për të cilin ka pasur mendime të ndryshme (*sh-kodër*, sipas J. G. Von Hahn; **sekh*-vend i thatë, sipas Koderitsch). Sipas D. Lukës, burimi i toponimit Shkodër me shumë mundësi vjen nga forma e apelativit shko-drin, pra

⁵ D.Luka, *Studime gjuhësore, Vëll.XV,Shkoder, 2013, f.71.*

⁶ D. Luka, “Studime gjuhësore I (kontribut për etimologjinë e gjuhës shqipe A-D), Shkodër, 1999, f.4-6.

⁷ Shaban Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe. Tiranë, 1999, f. 143–144.*

⁸ Joachim Matzinger, "Die Albaner als Nachkommen der Illyrer aus der Sicht der historischen Sprachwissenschaft". Në Schmitt, Oliver Jens; Frantz, Eva Anne (eds.). *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung.* Munich: Oldenbourg. 2009, f.22–24.

i quajtur si vendi “ku shkon Drini”, për shkak të pozicionit të qytetit. D. Luka gjen mbështetje të mendimit të tij edhe tek numizmatika, në monedhat ilire të antikitetit (mbretërimit të Gentit) shënohej *sco-drinon*, ndaras, çka sipas gjuhëtarit, vetë fjala *scodrinon* perceptohej nga folësit e asaj periudhe si e përbërë nga dy pjesë.

Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera

Në studimet mbi historinë e gjuhës shqipe kontributi i prof. D. Lukës fillon që në artikuj e parë të botuar prej tij në revistën shkencore “Studime filologjike”, Vëzhgime mbi toponomastikën ilire (1972), Mbi disa krahasime të prapashtesave të ilirishtes me ato të shqipes (1977) etj. të cilat patën jehonë dhe u vlerësuan në Institutin e Gjuhësisë në Tiranë, edhe pse gjuhëtari i ardhshëm do të vazhdonte sërish për vite të tëra si mësues në fshatrat e Mamurrasit. Këto artikuj pasohen me punime fundamentale, si : “Rreth problemit të vendit të formimit të gjuhës shqipe”, “Rreth kohës së formimit të gjuhës shqipe”, “Problemi i autoktonisë së shqiptarëve, çështje parimesh dhe metode”, “Rreth problemit të periodizimit të historisë së gjuhës shqipe”. Në këta artikuj vihet re qartë metoda argumentuese, duke u nisur nga faktet gjuhësore, sidomos nga dukuritë fonetike, të cilat janë më të shtrira në kohë, ndryshojnë shumë më ngadalë dhe sipas autorit, janë faktet më të qëndrueshme, ndërsa argumentet nga disiplinat e tjera shërbejnë për ta përforcuar idenë e parashtrua. Bazuar në këtë linjë argumentimi, D. Luka del në përfundimin se treva e sotme shqiptare, aty ku flitet shqip, është vetëm një pjesë e vendit të formimit të gjuhës shqipe. Kjo trevë gjuhësore ka pësuar gjatë kohëve tkurrje, rrudhje e ngjeshje, pra është një zonë ngushtimi të pandërprerë gjatë kohëve dhe për asnjë rast zonë ekspansioni...përkimet me rumunët nuk e prishin logjikën e faktit. Ato i përkasin një kohe të lashtë kur skajet e vendit të formimit të gjuhës shqipe mund të kenë takuar me skajet e vendit ku flitej rumanishtja, pra të jenë huazime të ndërsjella, ndërkaq nuk mund të mos pranohet edhe mundësia e një nënshtrese të përbashkët të të dy gjuhëve⁹. Në lidhje me studimet në fushën e historisë së shqipes, D. Luka këmbëngul se faktet jogjuhësore, qofshin këto edhe historike, arkeologjike etj. duhet vetëm të mbështesin argumentet gjuhësore. Sipas tij, kur ka si objekt kohën e formimit të gjuhës shqipe, në mungesë të leksikut të ilirishtes, duhet të bëjmë objekt studimi huazimet latine, të cilat janë një dëshmi

⁹ D.Luka, Studime gjuhësore VII, Shkodër, 2002, f.54

gjuhësore e kalimit nga ilirishtja në shqipe.”*Shqipja u formua si një gjuhë disi e ndryshme nga “nëna” e saj ilirishtja në të njëjtat treva në shek.I-IV të erës sonë, periudhë që paraqitet më intensive në ndërrimet që kanë kushtëzuar këtë kalim. Gjatë kësaj periudhe shqipja përvijoi tiparet gjuhësore duke trashëguar nga të gjitha nënsistemet e “nënës” së saj, ilirishtes, por duke formuar në të njëjtën kohë tipare të reja që e bënë të dallohej nga ajo. Kushtet historike të asaj kohe e përshpejtuan këtë formim. Në mesjetën e hershme shqipja u fut pak a shumë e kristalizuar në tiparet themelore të saj. Në këtë shkrim ne mundohemi t’i qasemi zgjidhjes së problemit jo me arsye të karakterit historik e me marrëdhënie probabiliteti, po kryesisht me argumente gjuhësore, që përbëjnë themelin e një gjuhe*”¹⁰. Këtu mund të veçojmë edhe një prej studimeve që lidhet me etnonimin *alban, arbën/rdhe shqip, shqiptar*¹¹. D. Luka, ndryshe nga autorët e tjerë të marrë me emërtimin e gjuhës dhe popullit tonë, e shtron për diskutim çështjen se përse ky emër (alban) nuk përmendet gjekundi te autorët antikë para shekullit të dytë; përse quhen Albanë; përse nuk përmenden më pas për nëntë shekuj (prej shek. II deri në shek.XI); përse ndryshon emri alban-arban? Ndërkohë që për ndërrimin e emrit nga *arbën* në *shqiptar*, sipas prof. D. Lukës, ngjan të jetë shkaktuar kryesisht nga lëkundja e atyre tipareve që përcaktonin etninë e shqiptarëve të asaj kohe dhe që i bënë ata të identifikoheshin dhe të dalloheshin nga popujt e tjerë. Në rrjedhën historike gjuha u bë tipari kryesor dallues, çka i dha hapësirë etnonimit të ri “shqiptar”. Sipas prof. D. Lukës, nëse historia e ndajfoljes shqip dhe përhapja e saj për të emërtuar gjuhën tonë (gjuha shqipe), paraqitet e diskutueshme, dy emërtimet e tjera *shqiptar* dhe *Shqipëri*, janë “pa asnjë dyshim rrjedhoja të së parës”, formuar brenda shqipes e me mjetet e saj¹². Prandaj hipotezat e tjera duhet të quhen të tejkaluara, përfshirë këtu edhe mendimin se *shqip* lidhet me *shqype* (emri i shpendit, Shqipëria –vendi i shqipeve) sepse, që nga autorët e vjetër të shqipes së shkruar të shekujve XVI-XVIII, bëhet qartë dallimi mes tyre.

¹⁰ D.Luka, *Rreth problemit të kohës së formimit të gjuhës shqipe*, Studime filologjike, nr. 4, Tiranë, 1988, f.108.

¹¹ D.Luka, *Studime gjuhësore, Alban, Arbën/r, Arbërn/r/i dhe shqip, shqiptar, Shqipëri*, Vëll.XV, Shkoder, 2013, f.209-249.

¹² D.Luka, *Studime gjuhësore, Alban, Arbën/r, Arbërn/r/i dhe shqip, shqiptar, Shqipëri*, Vëll.XV, Shkoder, 2013, f.248.

Njohës i thellë i problemeve të fonetikës historike

Prof. David Luka është dhe një prej emrave më në zë në fushën e studimeve të fonetikës historike. Studimet e tij (25 të tilla në këtë disiplinë) mbi theksin, apofoninë, metafoninë në gjuhën shqipe, si dhe mbi mjaft dukuri të tjera të lidhura me vokalizmin dhe sistemin bashkëtingëllor të gjuhës sonë. Studiuesi Petrit Kotrri vlerëson kontributin e D. Lukës në fushën e fonetikës historike, si puna e një njohësi të thellë të problemeve të kësaj discipline gjuhësore, “..por edhe për mënyrën e shqyrtimit dhe e argumentimit të çështjeve që trajtohen, duke qenë gjithnjë i motivuar për të dhënë gjykimin dhe vlerësimin e problemit nga pozitat e gjuhësisë së sotme shqiptare, përfshirë dukshëm edhe qëndrimin dhe mendimin e tij shkencor. Me metodën që përdor, duke u nisur së pari nga faktori i brendshëm për njohjen e dukurisë apo të procesit fonetik, e duke kaluar gjithnjë, kur është e nevojshme, në krahasimin e jashtëm të shqipes me gjuhë të tjera, Luka dëshmon profesionalizmin e tij në këtë vepër”¹³. Ndërsa punimin e tij mbi rotacizmin, studiuesi Shaban Demiraj, në veprën e tij “Fonologjia historike e gjuhës shqipe” e shtjellon dhe e radhit si në mes të atyre të studiuesve më të shquar të kësaj fushe, vendas dhe të huaj¹⁴.

Prof. David Luka zë kritik ndaj gjuhës standarde

Prof. David Luka ka qenë një ndër zërat që ka kritikuar *mënyrën e krijimit të gjuhës standarde*, apo gjuhën e njësuar letrare. Shpesh herë ai është keqkuptuar duke e mbajtur si një kritik ndaj gjuhës së njësuar, çka shtjellimi i mëposhtëm do të sqarojë sado pak qëndrimin e tij në lidhje me këtë çështje. Prof. D. Luka ka qenë një prej organizatorëve të konferencës së gjuhëtarëve shkodranë, zhvilluar në Shkodër më 1992 dhe një prej hartuesve të deklaratës së kësaj konference që nga Tirana u pa si një kërcënim ndaj standardit të dalë nga Kongresi i Drejtshkrimit të mbajtur më 1972.

Ajo që u shtrua si diskutim nga gjuhëtarët shkodranë më 1992 (20 vite pas), ishte sjellja e mendimit alternativ dhe hapja e normës gjuhësore. Kur e lexon sot deklaratën e hartuar nga D. Luka dhe gjuhëtarë të tjerë, 28 vite më përpara e sheh që kanë pasur një vizion të qartë dhe shumë gjëra do të ishin përmirësuar. Në lidhje me qëndrimet e tij mbi

¹³ P. Kotrri, “*Studime gjuhësore V*” e prof. David Lukës, vepër me vlerë për fonetikën historike të shqipes, në rev. “Phoenix”, Shkodër, nr.3-6, 2000, f.217.

¹⁴ Sh. Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996.

gjuhën standarde, edhe pse janë parë shtrembër nga ithtarët e “gjuhës së njësuar”, prof. David Luka ka mbajtur një qëndrim koherent (më 1992, 1996, 1998, 2002) “*nuk jemi për të prishur, por për të ndrequr*”¹⁵, se tashmë, gjuha letrare e njësuar, duke qenë pjesë e kulturës kombëtare, e ka fituar qytetarinë e vet. Ajo, pavarësisht se paraqet toskërishten letrare, do të luajë edhe në të ardhmen rolin e gjuhës standard. Gegërishtja, të përpunohet e të normëzohet që të përdoret me sukses në veprat e autorëve gegë. Gjuha letrare e njësuar mund dhe duhet të pasurohet më tej, po gjithnjë duke ruajtur veçoritë e nënsistemit mbi të cilin është ndërtuar¹⁶. Kush i ka lexuar këto pika, padyshim që nuk ka pasur arsye të mendojnë se gjuhëtarët shkodranë ndër to edhe prof. D. Luka, kanë qenë kundër standardit, kundër një gjuhe të njësuar, por përjashtimi i mendimit alternativ, pengimi i lëvrimit të gegërishtes se mund të çënojë gjuhën e njësuar, për ata ka qenë një dëm që i është bërë dhe i bëhet kulturës kombëtare shqiptare.

Prof. David Luka në studimin e tij “Pikëpamjet e Gjergj Fishtës për gjuhën e përbashkët shqipe”¹⁷ i riktheshet temës së gjuhës së njësuar. Pasi hedh poshtë me argumente dhe fakte që poeti i madh nuk ka qenë aspak kundër arritjes së një varianti gjuhësor të përbashkët, por me “gjuhë mushke” pat quajtur përzierjen pa asnjë kriter të toskërishtes me gegërishten (kështu e gjykonte ai të folmen kalimtare të Elbasanit), pasi “*.me u përbâ gjuha letrare nuk asht nevoja me krijue një gjuhë t’re*”. Duke parashtruar tri kushtet që duhet ta përcaktojnë këtë rrugë, D. Luka mbron edhe një herë idenë se: dija, planifikimi gjuhësor sipas konceptit të sociolinguistikës; koha, çasti i përshtatshëm, pasi të jenë pjekur kushtet, pasi të jenë kryer studimet përkatëse të dialekteve dhe veçanërisht atij që do të vihej në bazën e gjuhës së përbashkët dhe estetike, gjithçka të bëhej bukur, do të jepnin rezultatin e pritur dhe të pranuar nga të gjithë.

Konsiderata përmbyllëse

Vepra gjuhësore e prof. David Lukës është një prej arritjeve dinjitoze në fushën e studimeve albanologjike në përgjithësi dhe të gjuhësisë historike në veçanti. Ajo është modeli dhe rezultati se si përmes logjikës së ftohtë të fakteve dhe metodës rreptësisht shkencore nxirren në pah e

¹⁵ D. Luka, *10 vjetori i “Deklaratës” të gjuhëtarëve të Shkodrës*, Seminari V ndërkombëtar “Shkodra në shekuj”, vëll.II, Shkodër, 2006.

¹⁶ D.Luka, *Studime gjuhësore VII*, Shkodër, 2002, f.33.

¹⁷ D. Luka, *Studime gjuhësore XIV*, Shkodër, 2012, f.52.

rindërtohen dukuri gjuhësore nga njëra anë, por nga ana tjetër, për ne, lexuesit e saj, na zbulon tharmin e kombit që s'është ruajtur askund më mirë se në gjuhën tonë.

Eduard GRISHAJ

**ARSHI PIPA, URA LIDHËSE MES KULTURËS SHQIPTARE
DHE ASAJ EVROPIANE PERËNDIMORE**

- Në përkujtim të 100 vjetorit të lindjes -

Jeta, shkollimet dhe kontributet e para në kulturën shqiptare

Arshi Pipa lindi në Shkodër me 28 korrik 1920, në kohën kur në këtë qytet, për shkak të rrethanave historike, ishte vendosur pothuaj e gjithë elita intelektuale dhe politike e Shqipërisë. I ati, avokat Mustafa Pipa, që rridhte nga një familje patriotike libohovite, u vendos në Shkodër me detyrën e Kryetarit të Gjykatës Civile gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore, duke u bërë menjëherë pjesë e qenësishme e jetës shoqërore të këtij qyteti. Emri i tij renditet mes figurave më të shquara të elitës kombëtare patriotike, e cila jetonte e vepronte pothuajse e gjitha në Shkodër përgjatë dekadës së dytë të shekullit të kaluar. Ndaj nuk është e rastit që si Arshiu, ashtu dhe vëllai i tij më i madh Myzaferi, pa harruar dhe motrat e tyre ndoqën rrugëtimin e jetës të orientuar drejt kulturës, udhëhequr nga një kod parimesh fisnike me norma të shenjta si: dinjiteti i shpirtit të lirë, atdhedashuria dhe qëndresa, një rrugëtim që do të shoqërohet në vijim nga përndjekja me pasoja deri fatale, siç ndodhi me Myzaferin, vvarë nga dora kriminale e regjimit komunist.

Mësimet e para Arshiu i mori në vendlindje. Filloren dhe një pjesë të gjimnazit i kreu në kolegjin jezuit, për të vazhduar më pas në gjimnazin shtetnor të Shkodrës, në degën klasike. Ende nuk është bërë e qartë nga studiuesit nëse kjo zhvendosje u bë me dëshirë, apo me detyrim,

si rezultat i mbylljes së shkollave *joshtetnore* nga reforma Ivanaj. Por dimë, falë kujtimeve të bashkëkohësve, që ai ka qenë gjithnjë më i shquari në mësim dhe se pikërisht në atë kohë shfaqti dhe talentin e tij në letërsi me poezinë e titulluar: “Në lamin e luftës”, botuar tek revista *Cirka* në vitin 1936, një poezi epiko-lirike që vjen si një zë i qartë proteste ndaj tmerreve të luftës që mbjell veç vdekje. Në këtë periudhë zë fill edhe krijimi i vëllimit poetik *Lundërtarë*, të cilin do ta botojë në 1944, si dhe do të hidhet herë pas here edhe nga proza.

Përcaktuese për të kanë qenë studimet e larta, të cilat ai i kreu shkëlqyeshëm në Universitetin e Firences, pranë Fakultetit të Letrave dhe Filozofisë, ku në tetor të vitit 1942, do të mbrojë tezën me studimin e tij filozofik: *Morale e religione in Bergson*, duke shënuar kështu të parin kontribut të tijin si studiues shqiptar në kulturën botërore. Duhet thënë se Pipa, megjithatë si preferencë të parë duket se ka patur universitetet franceze, për arsye se paramendohej se jeta universitare italiane ishte dogmatizuar nga ideologjia mbizotëruese fashiste. Por siç, dihet, Arshiu nuk u josh nga asnjë propagandë totalitare. E ndoshta për këtë arsye zgjodhi të kryente tezën mbi filozofin francez.

Jetën pedagogjike ai e filloi në vitin shkollor 1941-1942 në gjimnazin e Tiranës, për të vijuar më pas 1942-1943 në gjimnazin e Shkodrës. Ndërsa në vjeshtën e vitit 1943 do të kthehet në Tiranë në Institutin Femënor “Donika Kastrioti”. Besnik i parimeve të lirisë ai refuzoi udhëzimet me frymë fashiste të drejtuesve të arsimit të kohës, duke rrezikuar jo pak nëse mbajmë parasysh që vëllai i tij Myzaferi, për të njëjtat shkaqe gjendej i internuar në Ventotene. Pikërisht në vitet e luftës, krahas ushtrimit të profesionit të pedagogut, ai do fokusohet në lëmin e kritikës, jo vetëm në aspektin teorik, por edhe në atë konkret me shkrime mbi Nolin, Konicën, Fishtën e Migjenin, të cilat do t’i botojë në revistat e kohës, *Shkëndija*, *Fryma*, që drejtohej nga i vëllai, Myzaferi dhe *Kritika*, e themeluar dhe e drejtuar nga ai vetë.

Persekutimi nga regjimi komunist

Përfundimi i luftës do ta gjejë në Tiranë. Si një personalitet tashmë i afirmuar i letrave shqipe do të ftohet për të kontribuar në zhvillimet letrare të kohës, por pikëpamjet e tij kritike nuk pëlqehen nga regjimi i porsainstaluar. Me 26 prill 1946 burgoset me akuzën: “agjitacion e

propagandë”. Ndërkohë, Sigurimi i kishte vrarë vëllanë, Myzaferin, në qelitë e paraburgimit në Shkodër. Lajmin e hidhur Arshiu do ta mësonte më vonë. Në burgun e Durrësit, në prag të lirit, i pyetur nga Sigurimi nëse ishte penduar dhe ishte i gatshëm të ndërronte rrugë, Arshiu do të deklaronte me përbuzje se nuk kishte ndryshuar asnjë mendim dhe nuk tundej nga pikëpamjet e tij. Përgjigja do t’i kushtonte vërtet shtrenjtë. E akuzuan për veprimtari armiqësore kundër pushtetit dhe pjesëmarrje në organizata subversive. E torturuan. Dënimi i dytë që vërtet i rëndë: njëzet vjet, nga të cilat vuajti vetëm gjysmën, burgjeve dhe kampeve me punë të detyruar: Durrës, Vloçisht, Gjirokastër, Tiranë, Burrel.

Krijimtaria poetike në kushtet e përndjekjes

Në këtë periudhë do të shkruajë vëllimin e njohur poetik *Libri i Burgut*, të cilin do ta nxjerrë përtej hekurave, të shkruar imët në fletë letrash duhani në takimet me familjarët. Motivet e vuajtjes dhe të dhimbjes fizike e shpirtërore, qëndresa, humaniteti i të burgosurve, plagët e shkaktuara nga vëllezërit, janë më të shpeshtat që ndeshen në këtë vepër, por nuk mungojnë dhe përsiatjet lirike mbi natyrën njerëzore, mbi femrën, shpresën, besimin, apo karakterizimet epike të modelit të kreshnikut, siç i gjejmë dendur në poemën e famshme *Kupe Danja*. Aty këtu, në vargje antitezash, ndeshim simbolikën biblike, shembullin universal përballë realitetit mizor të kohës. Këtij vëllimi autori do t’i shtonte në Shkodër edhe tre krijime poetike pas lirit të tij me 26 prill 1956: *Elegji për Gac Çunin*, *Vjeshhtë e dytë*, dhe *Për kryengritjen maxharre*. Vargu klasik, me rimarin e pasur dhe fuqinë e muzikalitetit ritmiko -plastik, larmia e formave të vjershërimit e bëjnë këtë libër unikal në letërsinë tonë.

Vepra e tij poetike, përbëhet nga katër vëllime. Përveç dy të parave janë edhe *Rusha* dhe *Autobiografi*. E para, një poemë e shkruar gjithashtu në burg është botuar në Mynih në 1968. Nga ana formale, poema përbën një ndërthurje të lirikës me epikën, ndërsa motivi i përplasjes etnike shqiptar dhe shqa, mbështetur tek raporti *vetja* dhe i *huaji* si dhe vetë sfondi historik mesjetar funksionalizojnë pabesinë e gjaksit serb si shkakun dhe thelbin e tragjedisë së personazheve shqiptare, të cilët, edhe në çastet e tyre fatale u përmbahen thuajse me naivitete kodeve kalorsiake të nderit fisnik. Në ndryshim me botimet e mësipërme,

vëllimi *Autobiografia* përbëhet nga krijime origjinale në gjuhë të huaja dhe në faza të ndryshme të krijimtarisë së tij. Kjo vepër u botua nga të afërmit pas vdekjes së autorit. Ndërsa botimi “Meridiana”, botuar më 1969 po në Mynih, është një përmbledhje poetike nga botimet e mëparshme duke përfshirë edhe ndonjë krijim të hershëm të pabotuar.

Arratisja, veprimtaria letrare e studimore jashtë atdheut

Arratisja e tij në verën e 1957 e rilidhi fizikisht me kulturën botërore por nuk e shkëputi shpirtërisht nga bota dhe kultura shqiptare. Në SH. B. A., krahas veprimtarisë profesionale si lektor në universitete të ndryshme, ku u shqua dhe gëzoi respektin e kolegëve dhe studentëve të shumtë, ai zhvilloi edhe një veprimtari të dendur akademike si studiues duke qenë i pranishëm në mjaft salla konferencash ndërkombëtare me kumtesa e me artikuj studimorë në botime prestigjioze mbi Danten, De Sanktisin, Ungaretin, Vikon, Manxonin, Montalen, Gramshin etj. Pipa përbën një nga urat më të forta të lidhjes së kulturës sonë kombëtare me kulturën perëndimore.

Natyrisht që për ne mbeten të rëndësishme kontributet e tij në albanologji dhe studimin e letrave shqipe. Kërkimet e tij studimore ndërkombëtarizuan vlerat estetike të poemës *Milosau* të De Radës. Përktheunë gjuhën angleze romanin *Kronikë në gur* të Kadaresë e po ashtu i çeli me mjeshtëri shqipes një dritare për të parë dritën e lirikës latine dhe asaj moderne evropiane përmes përkthimesh brilante. Ai korrigjoi gjithë përçudnimin që i bëri imazhit letrar të Migjenit kritika e realizmit socialist, duke e sjellë atë në dimensionet e mohuara tek studimi *Miti i perëndimit tek poezia e Migjenit*, botuar fillimisht në frëngjisht e ribotuar tek kryevepra studimore e tij *Trilogjia Albanica*, botuar në 1978 në Mynih, në një kolanë studimesh albanologjike. Çka duhet theksuar është se pas vdekjes së Koliqit dhe Valentinit, Pipa dhe Camaj kanë mbajtur mbi supe gjithë peshën e albanologjisë në mërgim, siç e dëshmojnë veprat e shumta të tyre dhe vetë revista *Albanica*, të cilën ata e themeluan në fillim të viteve nëntëdhjetë.

Qe i ashpër ndaj dikaturës staliniste shqiptare, por i dha shtytje të fortë çështjes së Kosovës si rrallë kush tjetër. Kontribuoi pareshtur për ruajtjen e identitetit shqiptar në diasporë duke marrë përsipër dhe riorganizimin e shoqatës *Vatra* në një kohë të rëndësishme historike.

Si përfundim, mund të themi se Pipa është ndër personalitetet e pakta ku ndeshen të ndërthurura pikëpamjet me qëndrimet, kurajua me durimin, mendja e ndritur dhe shpirti i pastër.

